



PROMOVIM I BASHKËPUNIMIT NËPËRMJET QEVERISJES SË MIRË NË IMPLEMENTIMIN E POLITIKËS KUNDËR KORRUPTIONIT

I Hulumtim dhe analiza



Република Македонија
ДРЖАВНА КОМИСИЈА
ЗА СПРЕЧУВАЊЕ НА КОРУПЦИЈАТА



PROMOVIM I BASHKËPUNIMIT NËPËRMJET QEVERISJES SË MIRË NË IMPLEMENTIMIN E POLITIKËS KUNDËR KORRUPSIONIT

I Hulumtim dhe analiza

Dhjetor, 2014

PROJEKTI:

PROMOVIM I BASHKËPUNIMIT NËPËRMJET QEVERISJES SË MIRË NË IMPLEMENTIMIN E POLITIKËS KUNDËR KORRUPSIONIT

MENAXHERË TË PROJEKTIT:

Vladimir Georgiev, Këshilltar Shtetëror, Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit

Maja Lazarova Krstevska, Zyrtar Nacional i Programit, Misioni i OSBE në Shkup

AGJENSIONI PËR HULUMTIM “RATING”:

Nikola Spasov, Drejtor Ekzekutiv

EKSPERTË:

Aleksandar Nikolov, Analizë Kualitative e Masave Kundër Korrupsionit në Sektorin Privat

Biljana Nikolovska Zhagar, Analizë Kualitative e Masave Kundër Korrupsionit në Sektorin Politik

Maksim Acevski, Analizë Kualitative e Masave Kundër Korrupsionit në Sektorin e Vetëqeverisjes Lokale / Sektori për Shoqëri Civile

Gorica Atanasova Gjorevska, Analizë Kualitative e Masave Kundër Korrupsionit në Sektorin e Administratës Publike

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека «Св. Климент Охридски», Скопје

PROMOVIM i bashkëpunimit nepermjet qever-isjes se mire ne implementimin e politikës kunder korrupsionit / [menaxhere te projektit Vladimir Georgiev, Maja Lazarova Krstevska ; experte Aleksandar Nikolov ... [и др.] ; perktheu Valon Abdiu]. - Shkup : OSCE, 2014. - 308 стр. : илустр. ; 24 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија кон главите

ISBN 978-608-4630-80-7

COBISS.MK-ID 97541130

Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimin apo qëndrimin e Misionit të OSBE-së në Shkup

Përmbajtja

PARATHËNIE	5
I. HULUMTIM TË OPINIONIT PUBLIK PËR KORRUPSIONIN NË	7
1. Hyrje.....	10
Qëllimet e hulumtimit	11
Metodologjia	11
2. Përhapja dhe llojet e korrupsionit në sektorin privat	13
2.1 Perceptimi për përhapjen e korrupsionit në sektorin privat.....	13
2.2. Gjendja me humbjen e marrëveshjeve të biznesit për shkak të korrupsionit.....	15
2.3. Perceptimi për mitën gjatë fitimit të tenderëve për furnizime publike	17
2.4. Korrupsioni gjatë dhënies së sponsorimeve dhe donacioneve	19
3. Format e pagesës së mitës	21
4. Shkaqet për ekzistimin e korrupsionit në sektorin privat	23
5. A ndejnë kompanitë obligim moral për të luftuar kundër korrupsionit?.....	25
6. Përhapja dhe zbatimi i masave të brendshme nëpër kompani për parandalimin e korrupsionit.....	26
7. Efektet nga legjislacioni nacional dhe nga gazetaria hulumtuese në parandalimin e korrupsionit në sektorin privat	29
8. Kontributi i subjekteve dhe i institucioneve që kanë kompetencë për parandalimin dhe ndëshkimin e korrupsionit në sektorin privat	30
9. A thua vallë ka sot më shumë ose më pak korrupsion në sektorin privat në krahasim me periudhën prej para 4 vitesh	32
2.Hulumtim për korrupsionin në politikë	35
Hyrje	36
Qëllimet e hulumtimit	37
Metodologjia	37
2. Perceptimi për përhapjen e korrupsionit në sistem	39
3. Shkalla e përhapjes së korrupsionit te partitë politike	39
3.1. Transparenca gjatë financimit të partive politike dhe blerja e ndikimit.....	43
3.2. Korrupsioni te partitë politike gjatë zgjedhjeve, financimi i fushatave zgjedhore dhe blerja e votave	45
4. Perceptimi për përhapjen e korrupsionit te pushteti qendror dhe ai lokal	48
4.1. Perceptimi për përhapjen e korrupsionit te qeveria	48
4.2. Perceptimi për përhapjen e korrupsionit në pushtetin lokal	50
5. Mënyra se si bartësit e funksioneve publike i shfrytëzojnë autorizimet publike	52
6. Kontributi i organeve dhe i institucioneve në parandalimin e korrupsionit në politikë.....	53
7. A ka sot më tepër ose më pak korrupsion në politikë në krahasim me periudhën prej para 4 vitesh.....	54
3. Hulumtim për korrupsionin në vetëqeverisjen lokale	59
1. Hyrje	60
Qëllimet e hulumtimit	61
Metodologjia	61
2. Korrupsioni në vetëqeverisjen lokale	63
2.1. Transparenca e vetëqeverisjes lokale.....	65
3. Procedurat e pushtetit lokal në të cilat qytetarët njohin prezencë të korrupsionit.....	69
4. Niveli i korruptueshmërisë së bartësve të funksioneve në vetëqeverisjen lokale	72
5. Niveli i ekspozimit ndaj korrupsionit i qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale.....	73
6. Gatishmëria e qytetarëve për të luftuar kundër korrupsionit	76
7. Vlerësimi i qytetarëve për suksesin e luftës kundër korrupsionit në nivel lokal.....	77
II. ANALIZA KUALITATIVE TË MASAVE KUNDËR KORRUPSIONIT DHE IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT SHETËTORË PËR PARANDALIM DHE LUFTËS KUNDËR KORRUPSIONIT DHE ZVOGËLIMIT TË KONFLIKTIT TË INTERESIT 2011-2015	81
1. Raporti nga analiza kualitative të masave kundër korrupsionit dhe implementimit të programit shtetërorë për parandalim dhe luftë kundër korrupsionit dhe zvogëlim të konfliktit të interesit 2011-2015 në sektorin privat	83
Përmbledhje	84
Hyrje.....	87
Konstatime	89
Rezultatet nga analizat kualitative	89
Problemi / faktori i rrezikut 1: Masat e pazhvilluara sa duhet për parandalimin e korrupsionit dhe përforcimin e integritetit të sektorit privat	89
Problemi / faktori i rrezikut 2: Njohuritë e pamjaftueshme për korrupsionin dhe konfliktin e interesave në sektorin privat	104
Problemi / faktori i rrezikut 3: Informimi i pamjaftueshëm për Ligjin për mbrojtje të konkurrencës dhe kapaciteti i pamjaftueshëm i Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës (KMK) për zbatimin e ligjit	109

<i>Problemi / faktori i rrezikut 4: Ka transparencë të pamjaftueshme të sponsorimeve, prapa së cilës fshihet mundësi për korrupsion...</i>	113
<i>Pasqyra e indekseve</i>	127
<i>Literatura e shfrytëzuar</i>	128
2. Raporti nga analiza kualitative të masave kundër korrupsionit dhe implementimit të programit shtetërorë për parandalim dhe luftë kundër korrupsionit dhe zvogëlim të konfliktit të interesit 2011-2015 në sektorin politik ..	133
Përmbledhje	134
Rezultatet nga analizat kualitative	135
<i>Problemi/faktori i rrezikut 1: Transparenca dhe mbikëqyrja e pamjaftueshme mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike, sindikatës dhe organizatave qytetare.....</i>	<i>135</i>
<i>Problemi/faktori i rrezikut 2: Në rregullativën zgjedhore dhe rregullativën tjetër që ka të bëjë me zgjedhjet, ka dobësi që shkaktojnë rrezik për shkeljen e saj të drejtpërdrejtë.....</i>	<i>161</i>
<i>Problemi/faktori i rrezikut 3: Shkalla e lartë e autorizimeve diskrete me dallime të mëdha në intensitetin e tyre ndërmjet funksioneve të ndryshme publike.....</i>	<i>181</i>
<i>Problemi/faktori i rrezikut 4: Mungesa e efekteve nga zbatimimi i Ligjit për lobim.....</i>	<i>185</i>
<i>Problemi/faktori i rrezikut 5: Përqindja e lartë e sjelljes së ligjeve me procedurë të shkurtuar, gjegjësisht me procedurë urgjente, (edhe pse Rregullorja e Kuvendit parasheh disa faza në përgatitjen e ligjeve), me çka nuk mundësohet përfshirja e subjekteve relevante shoqërore dhe atyre të interesuara në procesin ligjor.....</i>	<i>194</i>
Pasqyra e indekseve	200
Literatura e shfrytëzuar	201
3. Raporti nga analiza kualitative të masave kundër korrupsionit dhe implementimit të programit shtetërorë për parandalim dhe luftë kundër korrupsionit dhe zvogëlim të konfliktit të interesit 2011-2015 në sektorin e vetëqeverisjes lokale	203
Hyrje	204
Metodologjia	204
Përmbledhje	205
Rezultate na analiza kualitative	206
<i>Problemi/faktori i rrezikut 1: Procedura të ndërlikuara dhe të paqarta dhe probleme serioze në zbatimin e tyre në fushën e urbanizimit</i>	<i>206</i>
<i>Problemi/faktori i rrezikut 2: Devijime në menaxhimin me financat dhe pronën e vetëqeverisjes lokale.....</i>	<i>216</i>
<i>Problemi/faktori i rrezikut 3: Mungesa e garancive për zbatimin e rreptë të procedurave për punë</i>	<i>226</i>
<i>Problemi/faktori i rrezikut 4: Mungesa e vlerësimit të rrezikut nga paraqitja e korrupsionit në komuna</i>	<i>232</i>
Pasqura e indekseve	236
Literatura e shfrytëzuar	237
4. Raporti nga analiza kualitative të masave kundër korrupsionit dhe implementimit të programit shtetërorë për parandalim dhe luftë kundër korrupsionit dhe zvogëlim të konfliktit të interesit 2011-2015 në sektorin e administratës publike ...	239
Hyrje	240
Metodologjia	240
Përmbledhje	241
Rekomandime	243
Rezultatet nga analiza kualitative	244
<i>Problemi / faktori i rrezikut 1: Vendosija jo e plotë e sistemit të decentralizuar për menaxhim me mjetet publike dhe procedurat e paharmonizuara sa duhet për menaxhim dhe kontroll financiar</i>	<i>244</i>
<i>Problemi /faktori i rrezikut 2: Mungesa a garancive për zbatim të rreptë të procedurave për punë</i>	<i>250</i>
<i>Problemi/Faktori i rrezikut 3: Mungesa e vlerësimit të rrezikut nga paraqitja e korrupsionit në institucionet e administratës publike.....</i>	<i>264</i>
<i>Problemi/faktori i rrezikut 4: Mungesa e masave të sistematizuara për parandalimin e korrupsionit (planet për integritet).....</i>	<i>268</i>
<i>Problemi/faktori i rrezikut 5: Mungesa kontrollit publik mbi punën e administratës publike.....</i>	<i>274</i>
Pasqura e indekseve	281
Literatura e shfrytëzuar	282
5. Raporti nga analiza kualitative të masave kundër korrupsionit dhe implementimit të programit shtetërorë për parandalim dhe luftë kundër korrupsionit dhe zvogëlim të konfliktit të interesit 2011-2015 në sektorin e shoqërisë civile	283
Hyrje	284
Metodologjia	284
Përmbledhje	285
Rezultatet nga analiza kualitative	288
<i>Problemi/faktori i rrezikut 1: Jotransparencë gjatë ndarjes së mjeteve financiare publike për shoqatat dhe fondacionet.....</i>	<i>288</i>
<i>Problemi/faktori i rrezikut 2: Marrja e statusit të organizatës me interes publik.....</i>	<i>298</i>
<i>Problemi/faktori i rrezikut 3: . Ndarja e mjeteve publike për shoqatat e themeluara me qëllim të caktuar që krijon dyshim për harxhim korruptiv dhe joproduktiv të mjeteve publike.....</i>	<i>300</i>
Pasqura e indekseve	302
Literatura e shfrytëzuar	302

PARATHËNIE

Ky publikim është pjesë e aktiviteteve të projektit në kuadër të bashkëpunimit të Komisionit për parandalim të korrupsionit dhe Misionit të OSBE-së në Shkup në vitin 2013-2014. Në të janë publikuar gjithsejtë pesë analiza kualitative sipas metodologjisë së Sistemit nacional të integritetit të Transparency International dhe tre hulumtimeve të opinionit publik të kryera nga agjencia Rejting për perceptimin e qytetarëve rreth ekzistimit të korrupsionit në sektorë të përzgjedhur nga programi shtetërorë për parandalim dhe luftë kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesit 2011-2015. Këto raporte janë pjesë e planit disavjeçarë të OSBE-së për përkrahje të aktiviteteve kundër korrupsionit në shtet në pjesën e parandalimit dhe promovimit të bashkëpunimit rajonal.

Projekti: “Promovimi i bashkëpunimit nëpërmes qeverisjes së mirë në implementimin e politikës kundër korrupsionit” 2014 u implementua nga Misioni i OSBE-së në Shkup, Dikasteri për qeverisje demokratike në partneritet me Komisionin shtetërorë për parandalim të korrupsionit (KSHPK). Projekti përfshiu tri pjesë të lidhura njëra me tjetrën:

1. Përforsim të menaxhimit me sistemin e kualitetit në KSHPK;
2. Ndërtim të kapacitetit të njërive të vetëqeverisjes lokale për përpunim të strategjive për menaxhim me rreziqet nga korrupsioni;
3. Inkurajim të bashkëpunimit ndërkombëtarë dhe rajonal në mes të organeve nacionale kundër korrupsionit.

Qëllimi i tetë raporteve të shpallura në këtë publikim, që u përgatitën me një bashkëpunim direkt me KSHPK, është që t’i mundësojnë KSHPK-së analiza të bazuara në metodologji dhe hulumtim gjatë propozimit të masave më efikase dhe zgjidhje ligjore për të luftuar korrupsionin, si dhe të ris vetëdijen e shoqërisë civile dhe qytetarëve për aktivitetet dhe sfidat në fushën e parandalimit të korrupsionit në shtet. Rekomandimet e dhëna që përfshihen në kuadër të secilës analizë kualitative të publikuar për sektorët: privat, politik, vetëqeverisje lokale, administratë publike, dhe shoqërisë civile pritet të përfshihen në programin e ri Shtetërorë për parandalim dhe luftës kundër korrupsionit dhe të konfliktit të interesit dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë në rritje të integritetit, llogaridhënies dhe transparencës si principe bazë të qeverisjes demokratike që promovohen nga Misioni i OSBE-së në Shkup dhe KSHPK.

I. HULUMTIM TË OPINIONIT PUBLIK PËR KORRUPSIONIN NË:

1. SEKTORIN PRIVAT
2. SEKTORIN POLITIK
3. VETËQEVERISJES LOKALE

E bërë nga:



1. HULUMTIM PËR KORRUPSIONIN NË SEKTORIN PRIVAT

RAPORT NARATIV

1. HYRJE

Korrupsioni në sektorin privat paraqitet në shumë lloje të ndryshme. Më shpesh paraqitet në formë të mitës (ryshfetit), blerjes së ndikimit për vendime të caktuara, mashtrimin duke i anashkaluar ligjet dhe jotransparencës së procedurave. Ai është ngushtë i lidhur me korrupsionin në sektorin privat. Mita më shpesh shfrytëzohet për:

- fitimin e furnizimeve publike nga ana e pjesëmarrësve që janë më pak konkurrues në treg,
- ruajtjen e monopolit në treg, duke i penguar kompanitë konkurrencte që t'i ofrojnë produktet ose shërbimet e tyre në treg,
- krijimin e karteleve dhe monopoleve në treg, për fitimin e koncesioneve në tokë shtetërore, pa i plotësuar kushtet e nevojshme,
- fitimin e licencave dhe lejeve të ndryshme pa i plotësuar kushtet,
- fitimin e privilegjeve tatimore dhe lehtësimeve dhe në raste të tjera të ndryshme.

Hulumtimet e ndryshme ndërkombëtare për korrupsionin në sektorin e biznesit theksojnë se mita mund të paraqitet në forma të ndryshme – duke filluar nga dhënia e drejtpërdrejtë e mitës për personat që janë përgjegjës për marrjen e vendimeve dhe përshtatjen e tenderëve, pastaj nëpërmjet llojeve të ndryshme të marrëveshjeve të fshehta, klauzolave të fshehta për shërbime “konsultimesh” dhe provizioneve për “ndërmjetësim”, e deri te shfrytëzimi i llojeve të ndryshme të sponsorimit për persona, donacione për partitë politike dhe pagesa në baza të ndryshme, si kompensim për shërbimin e fituar joligjor, si dhe formimi i partneriteteve private-publike me klauzola të fshehta, e të ngjashme.

Ky lloj i korrupsionit në sektorin privat e dëmton tregun. E bën të pavlefshme konkurrencën e kompanive në treg, e rrezikon biznesin e kompanive që janë konkurrencte në treg, i dëmton konsumatorët dhe e dëmton buxhetin e shtetit. Korrupsioni në sektorin privat, shkakton, para së gjithash, jostabilitet ekonomik, shkelje të të drejtave të njeriut, e minon besimin në institucionet publike dhe i privon qytetarët nga kapitali dhe mjetet e nevojshme për zhvillim ekonomik. Për shembull, nëpërmjet korrupsionit, disa kompani, pavarësisht se a janë të vendit ose të huaja, mund t'i shmangen edhe obligimit për vendosjen e filtrave në repartet e tyre industriale për mbrojtjen e mjedisit jetësor, respektimit të standardeve për ushqim të shpejtë dhe import të barnave, si dhe respektimit të dispozitave për komunikacion të sigurt, me çka në mënyrë të drejtpërdrejtë rrezikohet shëndeti i njerëzve dhe siguria e tyre. Interesi privat dhe përfitimi personal nëpërmjet korrupsionit mund të vihen mbi interesin publik dhe interesin e komunitetit në tërësi.

Prandaj, në botë dhe te ne, lufta për parandalimin e këtij lloji të korrupsionit konsiderohet si aktivitet me rëndësi thelbësore për ndërtimin e integritetit, para së gjithash të institucioneve publike, por edhe të sektorit privat.

Në Programet shtetërore për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe të konfliktit të interesave për periudhën 2011-2015, KSHPK-ja i kushton vëmendje të veçantë edhe korrupsionit në sektorin privat. Sipas Programeve shtetërore, aktivitetet kryesore për parandalimin e korrupsionit në sektorin privat duhet ta mundësojnë: “avancimin e parimeve kryesore të sundimit të të drejtës, duke e promovuar udhëheqjen e mirë, praktikat dhe procedurat e mira, sigurimin e transparencës, llogaridhënies dhe të efikasitetit, mbrojtjen e konkurrencës, respektimin e ligjeve të tregut dhe traditat e mira afariste, me qëllim të forcimit të klimës së shëndoshë afariste në vend.”¹

1 Programet shtetërore për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe të konfliktit të interesave për periudhën 2011-2015

Në këto programe është paraparë edhe realizimi i hulumtimit me qëllim të detektimit të pengesave në parandalimin dhe ndëshkimin e korrupsionit në sektorin privat në vendin tonë, si bazë për tejkalimin e tyre.

Duke u nisur nga qëllimi i definuar në këtë mënyrë dhe në bashkëpunim me KSHPK-në dhe Misionin e OSBE-së në vendin tonë, ekipi hulumtues i agjencisë Rejting nga Shkupi, realizoi hulumtim të mendimit publik të 800 qytetarëve, të punësuar në sektorin privat nga i gjithë territori i vendit.

QËLLIMET E HULUMTIMIT

Qëllimet kryesore të hulumtimit ishin të mblidhen informata relevante për këto çështje:

- Nivelin dhe format e korrupsionit në sektorin privat në vend, në bazë të perceptimit të të punësuarve në sektorin privat për përhapjen dhe shkaqet e humbjes së biznesit për shkak të korrupsionit;
- Shkaqet për mbijetesën e korrupsionit në sektorin privat;
- Nivelin e vetëdijes për obligimin e kompanive për ta pamundësuar korrupsionin;
- Ekzistimin dhe zbatimin e masave të brendshme të kompanitë për parandalimin e korrupsionit;
- Efikasitetin e legjislacionit nacional dhe gazetarisë hulumtuese për parandalimin e korrupsionit në sektorin privat;
- Besimin në institucionet që kanë kompetencë për parandalimin dhe ndëshkimin e korrupsionit në sektorin privat;
- Nivelin e korrupsionit në sektorin privat sot, në krahasim me periudhën prej para 4 vitesh.

Ky hulumtim u përpilua në bazë të informatave për hulumtimet e ngjashme në botë nga ana e organizatës “Transparency International”, me qëllim që informatat e fituara të mund të jenë të krahasueshme me të dhënat nga vendet e tjera, të cilat janë fituar nga hulumtimet e ngjashme që janë realizuar gjatë disa viteve të kaluara.

METODOLOGJIA

Hulumtimi i mendimit publik për korrupsionin në sektorin privat në vendin tonë u realizua me metodën e anketës telefonike, në një mostër reprezentative prej 800 qytetarësh të punësuar në kompanitë private në vend. Anketa u realizua në periudhën prej 15 deri më 19 maj të vitit 2013.

Dezenimi i mostrës reprezentative që i pasqyron qëndrimet e qytetarëve në vend, që janë të punësuar në sektorin privat, kaloi nëpër disa procedura sistematike. Për të siguruar mostër reprezentative u respektuan disa procedura të caktuara gjatë formulimit të saj, që dalin nga rregullat për zgjedhje të rastësishme. Procedura për zgjedhje të mostrës u bazua në parimin për dizajn të mostrës rajonale dhe nacionale, që e definoi rajonin në përputhje me definicionin e tij nga Enti shtetëror për statistikë (NUTS3 the EU16). Në fakt, sipas strukturës gjeo-demografike të popullatës, Maqedona u nda në tetë rajone: i Shkupit, i Pollogut, i Pellagonisë, i Vardarit, Verilindor, Juglindor, Jugperëndimor dhe Lindor. Pastaj, në këtë mostër, në mënyrë proporcionale u përfshinë të anketuar nga të gjitha 84 komunat, duke e përfshirë edhe popullatën e qyteteve dhe të fshatrave. Numri i të anketuarve u shpërnda në mënyrë proporcionale sipas popullatës së përgjithshme të punësuar në sektorin privat në çdo rajon, duke i shfrytëzuar të dhënat zyrtare nga Anketa për fuqinë punëtore, që është realizuar nga Enti shtetëror për statistikë në vitin 2011. Gabimi statistikor për këtë lloj të hulumtimeve është +/- 3%.

Tabela 1: Struktura demografike e mostrës

Struktura demografike e mostrës		%
Rajoni	I Pellagonisë	15.3
	I Vardarit	8.6
	Verilindor	7.7
	Jugperëndimor	9.3
	I Shkupit	34.5
	Juglindor	7.2
	I Pollogut	6.3
	Lindor	11.1
		100
Lokacioni i kompanisë	Shkup	36.3
	Qytet më i madh	43.1
	Qytet më i vogël	17.6
	Fshat	2.9
		100
Madhësia e kompanisë	Deri në 10 të punësuar	38.4
	Prej 11 deri në 50 të punësuar	26.2
	Prej 51 deri në 100 të punësuar	7.2
	Mbi 101 të punësuar	28.2
		100
Vendi i punës në kompani	Pronar/drejtor/menaxher i përgjishthëm	20.1
	Udhëheqës/pozitë udhëheqëse/menaxhon të punësuar	23.7
	Pozitë joudhëheqëse	56.2
		100
Sektori në të cilin vepron kompania	Industria dhe xehetaria	19.4
	Tregtia	25.3
	Shërbimet	33.0
	Arsimi dhe shkenca	1.6
	Sektori shëndetësor	8.8
	Bujqësia	2.0
	Siguria dhe mbrojtja	0.5
	Ndërtimtaria	4.5
	Tjetër	5.0
		100
Gjinia	Femërore	45.4
	Mashkullore	54.6
		100


Të ardhurat mujore	Deri në 10.000 denarë	20.1
	Prej 10.000 deri në 18.000 denarë	48.5
	Prej 18.000 deri në 25.000 denarë	16.5
	Mbi 25.000 denarë	8.6
	Pa përgjigje	6.3
		100
Moshë	18 deri 29	12.9
	30 – 49	53.5
	50 – 64	33.0
	64 +	0.7
		100
Arsimi	Fillor dhe më pak	2.0
	I mesëm	58.0
	I lartë, universitar dhe Mr., Dr.	40.0
		100

2. PËRHAPJA DHE LLOJET E KORRUPSIONIT NË SEKTORIN PRIVAT

2.1 PERCEPTIMI PËR PËRHAPJEN E KORRUPSIONIT NË SEKTORIN PRIVAT


Korrupsioni si akt ndërmjet dy palëve (ose personave) ndodh në fshehtësi të plotë dhe vështirë zbulohet. Shkaku për këtë është se ai ndodh si marrëveshje ndërmjet dy palëve, me të cilat dëmtohet pala e tretë në sferën e biznesit, si për shembull konkurrenca, por njëkohësisht dëmtohen edhe qytetarët dhe buxheti shtetëror. Çdo dëshmi në publik, bile edhe dyshimet e bazuara për ekzistimin e korrupsionit në bazë të “zërave të dëgjuar”, mund të jenë bazë për ngritjen e hetimit, pas të cilit, nëse gjenden dëshmi të mjaftueshme, autorët mund të ballafaqohen me sanksione serioze. Por, pa marrë parasysh numrin e veprave të zbuluara dhe të sanksionura për korrupsion ose mitë në ndonjë vend, qytetarët në bazë të informatave që arrijnë te ata nga mediat, miqtë dhe përvoja e tyre profesionale, krijojnë perceptim për nivelin e përhapjes së korrupsionit. Në botë ekzistojnë metodologji të ndryshme për matjen e të ashtuqujturit Indeks i perceptimit për përhapjen e korrupsionit, i cili paraqet bazë për krahasimin e nivelit të korrupsionit në vende të ndryshme dhe për ndjekjen e përparimit në luftën kundër korrupsionit në secilin vend veç e veç.

Në këtë hulumtim, përhapja e nivelit të korrupsionit në sektorin privat, së pari u mat me pyetjen që iu parashtrua të punësuarve në sektorin privat në shkallën prej 1 deri në 10 (ku 1 do të thotë se aspak nuk përdorin mitë, ndërsa 10 se shumë shpesh përdorin mitë) të tregojnë se a thua vallë përdorin kompanitë private në vendin tonë mitë, gjegjësisht korrupsion, që të fitojnë kontratë ose që të sigurojnë ndonjë biznes. Siç mund të shihet nga përgjigjet e fituara, mendimet e të punësuarve janë mjaft të shpërndara. Nëse vlerësimet prej 1 deri në 3 në shkallën e përmendur paraqesin se ato aspak nuk përdorin ose rrallë përdorin mitë për të fituar ndonjë kontratë, vlerësimet 4 dhe 5 se përdorin mitë kohë pas kohe, vlerësimet 6 dhe 7 se shpesh përdorin mitë, ndërsa vlerësimet prej 8 deri në 10 se shumë shpesh përdorin mitë, atëherë do të fitohet shkalla e mëposhtme e përgjigjeve:



Grafiku 1: Në shkallën prej 1 deri në 10, ku 1 do të thotë se aspak nuk përdorin mitë, ndërsa 10 se shumë shpesh përdorin mitë, na tregoni se a përdorin kompanitë private në vendin tonë mitë, gjegjësisht korrupsion që të fitojnë kontratë ose që të sigurojnë ndonjë biznes

Ky vlerësim i të punësuarve për përhapjen e praktikës korruptive në sektorin privat është dukshëm më i butë kur të pyeten se a thua vallë përdorin mitë kompanitë në veprimtarinë e tyre ekonomike për të fituar ndonjë biznes. Në qoftë se sipas metodës së njëjtë sikurse te pyetja paraprake, i grupojmë edhe këto përgjigje në shkallën prej 1 deri në 10, atëherë do të shihet se kur bëhet fjalë për përhapjen e korrupsionit në veprimtarinë e tyre ekonomike, të punësuarit në përqindje më të vogël konsiderojnë se korrupsioni është i përhapur, gjegjësisht, përqindje më e vogël e të anketuarve konsiderojnë se kompanitë dhe firmat nga veprimtaria (sektori) i tyre përdorin korrupsion për të fituar ndonjë biznes.



Grafiku 2: Në shkallën prej 1 deri në 10, ku 1 do të thotë se aspak nuk përdorin mitë, ndërsa 10 se shumë shpesh përdorin mitë, sa do të thonit se kompanitë nga veprimtaria (sektori/industria) juaj përdorin mitë ose korrupsion që të fitojnë ndonjë biznes?


Nga këto përgjigje mund të konstatohet se të punësuarit dhe biznesmenët, në veprimtarinë e tyre vërejnë praktikë korruptive në masë më të vogël se sa që e vërejnë këtë në veprimtaritë e tjera, gjegjësisht se sa që konsiderojnë se praktika e tillë është e përhapur në veprimtaritë e tjera në sektorin privat.

Prej vitit 2011, organizata “Transparency International” e përgatit edhe Indeksin e paguesve të mitës në 28 vende të botës (**Bribe Payers Index 2011**) duke i anketuar biznesmenët. Në shkallën prej 0 deri në 10, ku 0 do të thotë se rregullisht paguhet mitë, ndërsa 10 do të thotë se asnjëherë nuk paguhet mitë, vendet vendosën në shkallën ndërmjet 0 dhe 10.²

² <http://bpi.transparency.org/bpi2011/>

2.2. GJENDJA ME HUMBEN E MARRËVESHJEVE TË BIZNESIT PËR SHKAK TË KORRUPSIONIT

Që të konstatohet se sa biznesi në vend pëson dëme të drejtpërdrejta nga korrupsioni dhe cila është përvoja personale e të punësuarve në sektorin privat në vend në këtë drejtim, pjesëmarrësve në këtë hulumtim iu parashtrua pyetja se a ka ndodhur që gjatë 12 muajve të fundit, kompania e tyre të mos fitojë ndonjë tender ose ndonjë biznes të ri për shkak të dhënies së mitës nga ana e konkurrentëve. Në këtë pyetje janë fituar këto përgjigje:




Grafiku 3: A ka ndodhur që gjatë 12 muajve të fundit kompania juaj të mos fitojë ndonjë tender ose ndonjë biznes të ri për shkak të dhënies së mitës nga ana e konkurrentëve tuaj?

Këto janë përgjigjet e atyre që kanë dhënë përgjigje konfirmuese ose negative në këtë pyetje dhe që kanë konsideruar se kanë informatë relevante, ndërsa nuk janë përfshirë përgjigjet e atyre të punësuarve që janë përgjigjur me “nuk e di” ose kompanitë e të cilëve nuk kanë marrë pjesë në asnjë tender gjatë 12 muajve të kaluar ose që nuk kanë kërkuar ndonjë biznes të ri.

Nga pronarët e anketuar të kompanive në këtë hulumtim, madje 40% kanë dhënë përgjigje pozitive në këtë pyetje, ndërsa 41.8% e të punësuarve në Shkup, gjithashtu janë përgjigjur se gjatë 12 muajve të kaluar kompania e tyre ka humbur ndonjë biznes për shkak të dhënies së mitës nga ana e konkurrentëve të tyre.

Analiza e përgjigjeve në këtë pyetje sipas veprimtarive tregon se dëme më të mëdha për shkak të pagesës së mitës nga ana e konkurrentëve kanë pësuar organizatat në fushën e ndërtimit, te të cilat 68.1% e të anketuarve kanë dhënë përgjigje konfirmuese në këtë pyetje, pastaj të punësuarit në tregti, 38.1% dhe të punësuarit në kompanitë bujqësore, prej të cilave 37.4% kanë dhënë përgjigje të këtyllë. Më pak të ekspozuara ndaj mitës së paguar nga konkurrenca e tyre gjatë 12 muajve të kaluar kanë qenë kompanitë nga industria, te të cilat 27.8% e të punësuarve kanë deklaruar se kompania e tyre ka humbur ndonjë tender ose ndonjë biznes për shkak se ndonjëra nga kompanitë konkurrencte ka shfrytëzuar mitën ose ndonjë lloj tjetër të korrupsionit.


Analiza e përgjigjeve sipas numrit të personave që janë të punësuar në kompani tregon se kompanitë që kanë prej 51 deri në 100 persona të punësuar, gjatë 12 muajve të kaluar kanë qenë më shumë të dëmtuara nga ky lloj i korrupsionit, ndërsa më pak janë dëmtuar kompanitë që kanë mbi 100 të punësuar.



Grafiku 4: A ka ndodhur gjatë vitit të fundit që kompania juaj të mos fitojë ndonjë tender ose ndonjë biznes të ri për shkak se ndonjëra nga kompanitë konkurrencte ka shfrytëzuar mitën ose ndonjë lloj tjetër të korrupsionit / sipas numrit të të punësuarve në kompani?

E njëjta pyetje është parashtruar në hulumtimin që është realizuar nga organizata “Transparency International”, në periudhën prej marsit deri në korrik të vitit 2011, ku janë përfshirë 3.000 biznesmenë nga 30 vende të botës, në mesin e të cilave nuk është vendi jonë.³ Nëse krahasohen përgjigjet e të punësuarve në vendin tonë në këtë pyetje, me përgjigjet e 3.000 biznesmenëve nga 30 vendet e mostrës së atij hulumtimi, arrihet në përfundimin se vendi jonë bën pjesë në mesin e vendeve ku shpesh humben marrëveshje biznesi për shkak të korrupsionit në biznes.


Më poshtë janë dhënë vendet me përqindje më të lartë të përgjigjeve konfirmuese në pyetjen se a ka humbur ndonjë biznes kompania e tyre (gjatë 12 muajve të kaluar) për shkak të mitës së paguar nga ana e ndonjë konkurenti të tyre:



Grafiku 5: Vendet me përqindje më të lartë të përgjigjeve konfirmuese në pyetjen se a ka humbur kompania e tyre ndonjë biznes (gjatë 12 muajve të kaluar) për shkak të pagesës së mitës nga ana e konkurrentëve të tyre


Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur vendet me nivel më të ulët të korrupsionit në biznes dhe me përqindje më të ulët të përgjigjeve pozitive në pyetjen se a ka humbur kompania e tyre ndonjë biznes për shkak të pagesës së mitës ose korrupsionit nga ana e konkurrentëve të tyre.

3 <http://www.transparency.org/research/bps2011>



Grafiku 6: Vendet me përqindje më të ulët të përgjigjeve konfirmuese në pyetjen se a ka humbur kompania e tyre ndonjë biznes (gjatë 12 muajve të kaluar) për shkak të pagesës së mitës nga ana e konkurrentëve të tyre

Analistët e këtij lloji të përgjigjeve thonë se, me qëllim të konstatimit më të mirë të gjendjeve, njohuritë e këtilla duhet të krahasohen me ndryshimet në indeksin global të korrupsionit, i cili publikohet për çdo vit dhe bazohet në një numër të madh të indikatorëve si dhe të indekseve të tjera për përhapjen e korrupsionit në biznes.



Grafiku 7: Indeksi global i korrupsionit në bazë të një numri të madh të indikatorëve si dhe të indekseve të tjerë për përhapjen e korrupsionit në biznes

Burimi: *Corruption Perceptions IndexGlobal Corruption Barometer*


2.3. PERCEPTIMI PËR MITËN GJATË FITIMIT TË TENDERËVE PËR FURNIZIME PUBLIKE

Në Programet shtetërore 2011- 2015 të miratuara nga KSHPK-ja, në pjesën e korrupsionit është theksuar se korrupsioni në sektorin privat është i lidhur me korrupsionin në sektorin publik. Me këtë rast theksohet se “në sektorin publik dhe atë privat, si probleme të rrezikshme dhe faktorë për korrupsion dhe konflikt të interesave janë konstatuar: shpenzimi i mjeteve publike dhe buxhetore nga ana e institucioneve shtetërore (tendencë për derdhjen e mjeteve buxhetore nëpërmjet kontratave për partneritet publik – privat ose nëpërmjet koncesioneve në sektorin privat), shpenzimi i mjeteve buxhetore në mënyrë jotransparente, selektive dhe me privilegje të ndryshme, mungesa e llogaridhënies, efikasitetit dhe mbikëqyrjes gjatë nënshkrimit të kontratave për donacione, sponsorime ose partneritete”.

Me qëllim që të mblidhen informata relevante për perceptimin e të punësuarve në sektorin privat për atë se a thua vallë e përdorin mitën kompanitë në vendin tonë për të siguruar ndonjë biznes duke fituar tenderë për furnizime publike nga ana e shtetit, pjesëmarrësve në anketë iu parashtrua pyetja: "Sa pajtoheni me deklaratën: Që të fitohet ndonjë biznes nëpërmjet tenderit shtetëror, kompanitë duhet të përdorin mitë?"

Siç mund të shihet nga përgjigjet e fituara në grafikun e mëposhtëm, mbi 70% e të punësuarve në sektorin privat në vendin tonë janë të bindur se që të fitohet ndonjë biznes nëpërmjet tenderit shtetëror, kompanitë duhet të përdorin mitë. Dyfish më i madh është numri i atyre që plotësisht pajtohen me këtë deklaratë, se sa ata që nuk pajtohen me deklaratën e këtillë.⁴

Sipas informatave nga Ministria për Financa dhe Byroja për furnizime publike e vendit tonë, në vitin 2012, për çdo ditë pune, mesatarisht janë realizuar nga 70 ankande elektronike. Janë nënshkruar pothuajse 24.000 kontrata për furnizime publike me vlerë të përgjithshme prej 917 milionë eurosh, gjegjësisht 12% e vlerës së Prodhimit të brendshëm bruto (PBB).⁵



Grafiku 8: Sa pajtoheni me deklaratën: Që të fitohet ndonjë biznes nëpërmjet tenderit shtetëror, kompanitë duhet të përdorin mitë?

Analiza e përgjigjeve në këtë pyetje sipas karakteristikave sociale-demografike të të anketuarve tregon se me këtë deklaratë më tepër pajtohen të anketuarit më të moshuar se sa ata më të rinjtë në sektorin privat. Nga të punësuarit e moshës prej 18 deri në 29 vjet, vetëm 28% plotësisht pajtohen me këtë deklaratë, ndërsa në mesin e të punësuarve të moshës prej 50 deri në 64 vjet, me këtë deklaratë plotësisht pajtohen 40% e të anketuarve. Në mesin e atyre që plotësisht pajtohen me këtë deklaratë, më e lartë është përqindja e shqiptarëve, 42% e të cilëve plotësisht pajtohen me këtë, në një përqindje pak më të vogël (36.6%) me këtë deklaratë pajtohen maqedonasit, ndërsa te bashkësitë e tjera etnike, çdo i anketuar i tretë (33.3%) plotësisht pajtohet se kompanitë përdorin mitë për të fituar ndonjë biznes nëpërmjet tenderit shtetëror. Pastaj, në kompanitë ku punojnë prej 11 deri në 50 persona, 41% e të anketuarve plotësisht pajtohen me këtë qëndrim, ndërsa me përqindje identike, me këtë deklaratë pajtohen edhe të punësuarit në kompanitë private jashtë Shkupit.

⁴ Në raportin më të ri të Qendrës për komunikime qytetare, e cila bën mbikëqyrje të rregullt të të gjitha furnizimeve publike në vend, thuhet se me anë të procedurës jotransparente, me negociata dhe pa publikim të shpalljes, në vitin 2012 janë shpenzuar 65 milionë euro. E-ankandi i obligueshëm ligjor nuk është zhvilluar në 40 për qind të mostrës së mbikëqyrrur, ndërsa në çdo e-ankand të katërt që është zhvilluar, nuk është zvogëluar çmimi fillestar. Në atë mënyrë, efekti i kursimit të mjeteve buxhetore nuk është realizuar te numri më i madh i furnizimeve – konstatohet në raport. Hulumtimi tregon edhe nivel rekord të tenderëve të anuluar në vitin 2012 - 24,2 për qind, që është niveli më i lartë në katër vitet e fundit.


⁵ <http://www.alfa.mk/News.aspx?ID=57151#.UaXPdtizegA>

Tabela 2: Sa pajtoheni me deklaratën: Që të fitohet ndonjë biznes nëpërmjet tenderit shtetëror, kompanitë duhet të përdorin mitë / sipas moshës së të anketuarve?

	18-29 vjet	30-49 vjet	50-64 vjet
Plotësisht pajtohem	28%	38%	40%
Kryesisht pajtohem	42%	37%	31%
Pajtohen	70%	74%	71%
Nuk pajtohen	30%	24%	27%
Kryesisht nuk pajtohem	12%	11%	9%
Aspak nuk pajtohem	18%	14%	18%
Nuk kam mendim	/	2%	3%

2.4. KORRUPSIONI GJATË DHËNIES SË SPONSORIMEVE DHE DONACIONEVE

Në mesin e të punësuarve në sektorin privat, gjithashtu është shumë i përhapur mendimi se sponsorimet dhe donacionet nga ana e kompanive private përdoren për mitë dhe korrupsion. Në pyetjen: “Sa pajtoheni me këtë deklaratë: Kompanitë i keqpërdorin donacionet dhe sponsorimet për qëllime korruptive?” janë fituar këto përgjigje:



Grafiku 9: Sa pajtoheni me këtë deklaratë: Kompanitë i keqpërdorin donacionet dhe sponsorimet për qëllime korruptive?

Si edhe te pyetja për tenderët shtetëror, edhe në këtë pyetje, rreth 70% e të anketuarve janë përgjigjur se plotësisht ose kryesisht pajtohen me deklaratën se kompanitë i keqpërdorin donacionet dhe sponsorimet për qëllime korruptive. Me këtë rast, numri i atyre që plotësisht pajtohen me këtë deklaratë është tre herë më i madh se sa numri i atyre që aspak nuk pajtohen.

Mirëpo, kur janë në pyetje keqpërdorimet me sponsorimet dhe donacionet, me deklaratën e tillë, në përqindje dukshëm më të madhe (40%), plotësisht pajtohen të rinjtë e moshës prej 18 deri në 29.

Tabela 3: Sa pajtoheni me këtë deklaratë: Kompanitë i keqpërdorin donacionet dhe sponsorimet për qëllime korrup-tive / sipas moshës?


	18-29 vjet	30-49 vjet	50-64 vjet
Plotësisht pajtohem	40.4%	29.1%	39.7%
Kryesisht pajtohem	35.1%	38.8%	30.8%
Pajtohen	75.5%	67.9%	70.5%
Nuk pajtohen	22.8%	27.4%	22.6%
Kryesisht nuk pajtohem	15.8%	16.0%	9.6%
Aspak nuk pajtohem	7.0%	11.4%	13.0%
Nuk kam mendim	1.8%	3.8%	6.2%
Nuk dëshiron të përgjigjet	.0%	.8%	.7%

Pastaj, me këtë deklaratë, plotësisht pajtohen pothuajse 38% e të punësuarve në kompanitë me mbi 100 të punësuar, ndërsa 36% e të punësuarve që nuk kanë pozitë udhëheqëse, gjithashtu, plotësisht pajtohen se kompanitë i keqpërdorin donacionet dhe sponsorimet për qëllime korruptive.

Tabela 4: Sa pajtoheni me këtë deklaratë: Kompanitë i keqpërdorin donacionet dhe sponsorimet për qëllime korruptive / sipas numri të punësuarve në kompani?

	Deri në 10 të punësuar	Prej 11 deri në 50 të punësuar	Prje 51 deri në 100 të punësuar	Mbi 101 të punësuar
Plotësisht pajtohem	31.8%	34.5%	28.1%	37.6%
Kryesisht pajtohem	38.2%	30.2%	37.5%	36.8%
Pajtohen	70.0%	64.7%	65.6%	74.4%
Nuk pajtohen	22.4%	30.2%	28.1%	24.0%
Kryesisht nuk pajtohem	12.4%	14.7%	15.6%	14.4%
Aspak nuk pajtohem	10.0%	15.5%	12.5%	9.6%
Nuk kam mendim	6.5%	5.2%	3.1%	1.6%
Nuk dëshiron të përgjigjet	1.2%	.0%	3.1%	.0%

Secili i anketuar i tretë te maqedonasit (33%) dhe një përqindje pak më e vogël (31%) e shqiptarëve, gjithashtu, plotësisht pajtohen me këtë deklaratë.



Grafiku 10: Sa pajtoheni me këtë deklaratë: Kompanitë i keqpërdorin donacionet dhe sponsorimet për qëllime korruptive / sipas përkatësisë etnike?

Sa i përket perceptimit të të punësuarve të grupuar sipas të ardhurave mujore, 38% e të punësuarve me të ardhura mujore deri në 10 mijë denarë, plotësisht pajtohen me deklaratën se sponsorimet dhe donacionet nga ana e kompanive përdoren për qëllime korruptive, ndërsa, në një përqindje pak më të ulët (36%), me këtë deklaratë plotësisht pajtohen të punësuarit që fitojnë prej 10 deri në 25 mijë denarë në muaj.

Nga struktura e këtyllë e përgjigjeve mund të konstatohet se të punësuarit që nuk marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes për dhënien e sponsorimeve dhe të donacioneve, këtë e konsiderojnë si derdhje jotransparente të mjeteve të kompanisë për personat dhe subjektet jashtë kompanisë, jo vetëm “për të fituar ndonjë biznes”, por edhe për përfitim personal të rrethit më të ngushtë të vendimmarrësve.


3. FORMAT E PAGESËS SË MITËS

Në luftën me konkurrentët për fitimin e kontratave të biznesit, ose për ruajtjen e monopolit, fitimin e përparësisë ose dobisë, kompanitë private përdorin metoda të ndryshme joetike. Më shpesh, në botë dhe te ne, konsiderohet se ka lidhje ndërmjet pronarëve, gjegjësisht menaxherëve të kompanive dhe pushtetit, të cilat ndërtohen në bazë të përkatësisë politike dhe afërsisë, ose në bazë të lidhjeve familjare-miqësore. Duke e keqpërdorur funksionin zyrtar, lidhjet e tilla mund t’u sigurojnë kompanive ose personave të caktuar qasje të privilegjuar deri te informatat që kanë të bëjnë me furnizimet publike ose me investimin dhe ato të shfrytëzohen për përshtatjen e tenderëve, për anulimin e tenderëve nëse oferta e klientit të pritur nuk është më e mira, dhe për një varg veprimesh të tjera korruptive nga të cilat të dy palët kanë dobi në dëm të kompanive konkurrencte, të qytetarëve dhe të buxhetit shtetëror. Kompanitë me lidhje, ndoshta nuk paguajnë mitë në mënyrë të drejtpërdrejtë, por më shpesh janë sponsorë joligjor të partive politike që e formojnë pushtetin ose të personave që në atë pushtet kanë pozita me ndikim. Kjo mënyrë e fitimit të bizneseve vlen edhe për pushtetin lokal, i cili gjithashtu harxhon shuma të mëdha për furnizime publike.

Ata të cilët nuk kanë lidhje të tilla politike ose familjare me pushtetin, ku bëjnë pjesë edhe kompanitë e huaja private në vend, për qëllime korruptive shfrytëzojnë kontrata korruptive, me ç’rast individëve të caktuar u paguhet shuma e kërkuar e parave (në para të gatshme, drejtpërdrejt në takim sy më sy, nëse bëhet fjalë për shumë të vogël parash ose nëpërmjet llogarive të fshehta me kontrata për shërbime konsultuese ose me provizion për ndërmjetësim). Keqpërdorimi i detyrës zyrtare, me të cilin privilegjohet ndonjë subjekt gjatë furnizimit publik, mund të jetë edhe re-

zultat i kundërshtëpërblimit të pritur nga ofruesi i shërbimit, si për shembull: punësimi i fëmijës, gruas ose ndonjë farefisi të tij në ndonjë kompani të suksesshme private, fitimi i qasjes së privilegjuar, sponsorime ose donacione (udhëtim, studim e të ngjashme). Dhe në fund, shërbimi që jepet nga ofruesi mund të jetë edhe nëpërmjet diskualifikimit të pabazë të konkurrentëve gjatë furnizimit publik, qysh në fazën e përcaktimit të kushteve të tenderit ose pas anulimit të tenderit dhe ndryshimit të kushteve të tij.

Që të mblidhen informata gjatë këtij hulumtimi për atë se me ndihmën e cilës nga format e lartpërmendura të sjelljes korruptive dhe joetike në vendin tonë fitohet ndonjë biznes gjatë aplikimit në tenderët shtetërorë, të punësuarve në sektorin privat iu parashtrua edhe kjo pyetje: “Nëpërmjet cilës nga format e shënuara të sjelljes korruptive dhe joetike, më lehtë fitohet ndonjë biznes nëpërmjet tenderit shtetëror?”



Grafiku 11: Nëpërmjet cilës nga format e shënuara të sjelljes korruptive dhe joetike, më lehtë fitohet ndonjë biznes nëpërmjet tenderit shtetëror?


Siç mund të vërehet nga përgjigjet e fituara, në vendin tonë është gjerësisht e përhapur bindja se para së gjithash, lidhjet, qoftë ato partiake, miqësore ose familjare, janë kanali më i rëndësishëm për të fituar ndonjë biznes kur shpallen tenderët publikë. Kjo do të thotë se te një numër i madh i të punësuarve në sektorin privat (50.1%) ekziston bindja se gjatë ndarjes së tenderëve publikë ka diskriminim të atyre kompanive, pronarët ose menaxhmenti i të cilave nuk konsiderohen të afërta me partitë politike që janë në pushtet ose nuk janë në ndonjë lidhje ose raport miqësor ose familjar.

Forma e dytë për të fituar ndonjë tender në mënyrë joetike dhe korruptive, sipas përgjigjeve të të anketuarve, është fuqia ekonomike e kompanisë që merr pjesë në ndonjë tender dhe aftësia e tyre për të paguar më tepër para, gjegjësisht shumë më të lartë për mitë, se sa konkurrentët e tjerë.

Dhe forma e tretë për të fituar ndonjë tender në mënyrë joligjore, sipas perceptimit të të punësuarve në sektorin privat është aftësia e kompanisë të ofrojë kundërshërbim ose ndonjë privilegj për ta fituar tenderin.

Lidhjet partiake, miqësore dhe familjare si formë për të fituar ndonjë biznes gjatë tenderëve publikë i përmendin, para së gjithash, të rinjtë e moshës ndërmjet 18 dhe 29 vjet. Siç mund të shihet nga tabela e mëposhtme, 54% e tyre i kanë përmendur këto mundësi si formë të korrupsionit nëpërmjet të së cilës më lehtë fitohet ndonjë biznes gjatë furnizimeve publike, ndërsa mendim të këtillë kanë edhe 61% e shqiptarëve, çdo i dyti maqedonas (50%), si dhe 47% e pjesëtarëve të bashkësive të tjera etnike. Lidhjet politike dhe familjare si formë më e përhapur për të fituar

ndonjë biznes gjatë tenderëve publikë, i përmendin edhe 53% e të punësuarve në kompani që kanë ndërmjet 11 dhe 50 persona të punësuar, si dhe 56% e të punësuarve që nuk janë në pozitë udhëheqëse.



Grafiku 12: Njëpërmjet cilës formë të shënuar të korrupsionit dhe të sjelljes joetike, më lehtë fitohet ndonjë biznes njëpërmjet tenderit shtetëror / sipas moshës së të anketuarve?


Mitën e drejtpërdrejtë me para, pavarësisht nga lidhjet, më shpesh e përmendin drejtorët dhe menaxherët e anketuar (34%), të punësuarit në kompani që kanë deri në 10 të punësuar (31%), dhe të punësuarit në qytetet e mëdha të vendit, jashtë Shkupit.

Ofrimin e kundërshtërbimeve dhe privilegjet si formë për të fituar më lehtë ndonjë tender publik, në përqindje më të lartë e përmendin personat që janë pronarë të kompanive. 15% e tyre e kanë theksuar këtë formë të sjelljes joetike dhe korruptive si mënyrë më efektive për të fituar ndonjë tender.

4. SHKAQET PËR EKZISTIMIN E KORRUPSIONIT NË SEKTORIN PRIVAT

Duke u nisur nga rezultatet të cilat arritëm nëpërmjet këtij hulumtimi, si dhe nga rezultatet e hulumtimeve që i ka realizuar “Transparency International”, mund të konstatojmë se në çdo vend të botës, në masë më të madhe ose më të vogël, njerëzit konsiderojnë se ka korrupsion, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Në qoftë se a absolutojmë çështjen e ekzistimit të korrupsionit, pyetja tjetër që meriton të analizohet është: Cilat janë shkaqet për ekzistimin e kësaj dukurie?


Me qëllim që të fitohet përgjigje për atë se cili është shkaku kryesor për ekzistimin e korrupsionit në sferën e biznesit, të punësuarve në kompanitë private në këtë hulumtim iu parashtrua pyetja: “Cili nga këto probleme është problemi kryesor në luftën kundër korrupsionit në sektorin privat: korrupsioni dhe mita nuk ndëshkohen sa duhet, përfitimet nga korrupsioni janë më të mëdha se sa dënimet, biznesi nuk e kupton këtë problem në mënyrë serioze ose për shkak se të mirat që janë fituar në mënyrë jashtëligjore nuk konfiskohen?”. Në këtë pyetje janë dhënë këto përgjigje:



Grafiku 13: Sipas jush, problemi kryesor në luftën kundër korrupsionit në sektorin privat te ne është se: korrupsioni dhe mita nuk ndëshkohen sa duhet, përfitimet nga korrupsioni janë më të mëdha se sa dënimet, biznesi nuk e kupton këtë problem në mënyrë serioze ose për shkak se të mirat që janë fituar në mënyrë jashtëligjore nuk konfiskohen?”

Nga përgjigjet e fituara mund të shihet se problemin kryesor në luftën kundër korrupsionit në sektorin privat, të punësuarit para së gjithash e shohin në atë se mita në vend nuk zbulohet dhe nuk ndëshkohet sa duhet, për faktin që ajo mbetet e pandëshkuar, me ç’rast edhe atëherë kur zbulohet dhe dënohet (sipas mendimit të 25% të pjesëmarrësve në anketë), konsiderohet se përfitimet nga korrupsioni janë më të mëdha se sa dënimet. Megjithatë, aspak nuk është e vogël përqindja e të punësuarve që konsiderojnë se njëri nga problemet kryesore në parandalimin e korrupsionit është fakti se biznesi nuk e kupton seriozisht nevojën për luftë kundër korrupsionit. Sipas këtij mendimi, biznesi korrupsionin e konsideron si fakt, gjegjësisht si ambient ndaj të cilit nuk dëshiron ose ndoshta mendon se nuk mund të ndikojë, e bile edhe se ekzistimi i korrupsionit nuk varet shumë nga integriteti i biznesit. Ky mendim është veçanërisht i përhapur te të punësuarit e moshës ndërmjet 50 dhe 65 vjet, 26% e të cilëve e kanë përmendur këtë si faktor për ekzistimin e korrupsionit, ndërsa përgjigje të këtillë kanë dhënë edhe 30% e të punësuarve në kompanitë që kanë mbi 100 të punësuar dhe 34% e të punësuarve me të ardhura mujore mbi 35 mijë denarë.


Duke u nisur nga fakti se korrupsioni në sektorin privat më shpesh është i lidhur me kompetencat e institucioneve të pushtetit dhe të individëve në të, në këtë hulumtim, të punësuarit në kompanitë private u pyetën se kush, sipas tyre, kontribuon më tepër për ekzistimin e korrupsionit në sektorin privat? (pronarët privatë, institucionet shtetërore ose të dy palët njëjloj).



Grafiku14: Sipas jush, kush kontribuon më tepër për ekzistimin e korrupsionit në sektorin privat? (pronarët privatë, institucionet shtetërore ose të dy palët njëjloj)

Nga përgjigjet e të punësuarve rezulton se mita që e paguajnë kompanitë private është në interes të ndërsjellë edhe të njerëzve të pushtetit edhe të atyre nga kompanitë private, të cilët me anë të mitës, realisht i anashkalojnë ose e pamundësojnë konkurrencën dhe ligjshmëritë e tregut. Por, një numër pak më i madh i të punësuarve në sektorin privat, për dhënien e mitës nga ana e sektorit privat, më tepër i akuzojnë institucionet e korruptuara shtetërore ose bartësit e pushtetit se sa pronarët e kompanive private. Në mesin e të punësuarve që fajin më tepër e shohin te institucionet shtetërore se sa te pronarët e kompanive private, përqindja më e lartë janë të punësuarit shqiptarë (23%), ndërsa maqedonasit me këtë deklaratë pajtohen në një përqindje pak më të vogël (18%). Sa i përket qëndrimeve të të punësuarve në kompanitë private të grupuara sipas madhësisë së tyre, të punësuarit në kompani që kanë ndërmjet 50 dhe 100 të punësuar, në përqindje më të lartë (28%) janë përgjigjur se për ekzistimin e korrupsionit në sektorin privat më së shumti kontribuojnë institucionet shtetërore.

Në një pyetje të ngjashme, në hulumtimin që tashmë e përmendëm të “Transparency International”, të realizuar në vitin 2011 në 30 vende⁶, janë fituar këto përgjigje:



Fotografia 1: Pengesat kryesore për parandalimin e korrupsionit në sektorin privat

Burimi: Transparency International


Nga këto rezultate, të cilat janë mesatare e përgjigjeve në 30 vendet e analizuara të botës, konstatohet se për parandalimin e korrupsionit në sektorin privat dhe për zhvillimin e sektorit privat me integritet, gjegjësisht për krijimin e ambientit të lirë të biznesit, duhet që secili nga këto subjekte: bartësit e funksioneve publike, pronarët e kompanive private, menaxherët dhe gjyqësia, ta marrë pjesën e tij të përgjegjësisë dhe të punojnë bashkërisht për ndryshimin e ambientit.

5. A NDJEJNË KOMPANITË OBLIGIM MORAL PËR TË LUFTUAR KUNDËR KORRUPSIONIT?

Korrupsioni si dukuri nuk mund të parandalohet vetëm me ashpërsimin e dënimeve dhe me rritjen e kapaciteteve intelektuale për zbulimin dhe ndëshkimin e tij. Si devijim shoqëror, kjo dukuri duhet të jetë moralisht e papranueshme për qytetarët dhe për të punësuarit e kompanive, dhe ata, për shkak të integritetit të tyre dhe integritetit të biznesit, duhet të ndjejnë obligim moral për të luftuar kundër dukurive të mitës dhe të korrupsionit në biznes. Ndjenja e obligimit moral për ta parandaluar korrupsionin flet për gatishmërinë e të punësuarve të miratojnë kode etike që e përjashtojnë sjelljen korruptive në biznes dhe t’u përmbahen atyre kodeve, të cilat u garantojnë konkurrentëve të tjerë në treg, sjellje korrekte dhe e ngushtojnë hapësirën për sjellje korruptive të njerëzve nga administrata publike ose të funksionarëve. Obligimi moral i të punësuarve për ta pamundësuar korrupsionin është bazë e aktivizmit të tyre për parandalimin dhe denoncimin e korrupsionit, për vendosjen e sistemit të sundimit të së drejtës dhe klimës me kushte të mira për udhëheqje të biznesit.

⁶ <http://www.transparency.org/research/bps2011/>

Duke u nisur nga e gjithë kjo, të anketuarve iu parashtrua edhe pyetja: “A do të thonit se kompania juaj e ka për obligim ta pamundësojë korrupsionin?”. Në grafikun e mëposhtëm janë prezantuar vetëm përgjigjet e atyre që kanë ditur të përgjigjen në këtë pyetje.



Grafiku 15: A do të thonit se kompania juaj e ka për obligim ta pamundësojë korrupsionin?

Analiza e përgjigjeve sipas karakteristikave sociale-demografike të të anketuarve tregon se vetëdija për obligimin moral të kompanive për luftë kundër korrupsionit është më e lartë te pronarët e kompanive, 60% e të cilëve kanë deklaruar se kompanitë e tyre kanë obligim ta pamundësojnë korrupsionin, të punësuarit në kompanitë që kanë mbi 100 të punësuar, 57% e të cilëve kanë dhënë përgjigje konfirmuese në këtë pyetje dhe të punësuarit me moshë prej 50 deri në 65 vjet, 60% e të cilëve kanë dhënë përgjigje të tillë.

Në hulumtimin e “Transparency International” të vitit 2011, në anketën që është bërë me 100 pronarë të kompanive private nga 30 vende, është parashtruar pyetja: “A ka kompania juaj obligim moral të luftojë kundër korrupsionit?”. Në këtë pyetje, përqindja e përbashkët e përgjigjeve konfirmuese ka qenë 79%. Por në Rusi, përgjigje konfirmuese në këtë pyetje kanë dhënë vetëm 45% e të anketuarve, në Malajzi 49%, në Egjipt 57%, etj. Obligimi moral i kompanive për të luftuar kundër korrupsionit është mjaft i përhapur në Japoni, me 85%, në Britaninë e Madhe me 81%, në SHBA me 78% etj⁷.

6. PËRHAPJA DHE ZBATIMI I MASAVE TË BRENDSHME NËPËR KOMPANI PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Me Programet shtetërore për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe të konfliktit të interesave 2011-2015, janë paraparë një sërë masash dhe aktiviteteve për aftësimin e kompanive private për luftën kundër korrupsionit. Me anë të bashkëpunimit me odat ekonomike në vend dhe me anë të sistemit të trajnimeve, bëhet përpjekje që kompanitë private, para së gjithash si subjekte të interesuara për mbrojtjen nga monoqolet, për mbrojtjen nga konkurrenca jolohale dhe nga korrupsioni, që e pamundëson funksionimin normal të tregut të lirë dhe konkurrencës së lirë, të implementojnë një sërë masash në punën e tyre, të cilat do të jenë në funksion të parandalimit dhe të ndëshkimit të korrupsionit.

Në këtë kontekst, të punësuarve në kompanitë private iu parashtrua edhe pyetja se a thua vallë ka masa për parandalimin e korrupsionit dhe a thua vallë zbatohen ato në kompanitë e tyre. Nga përgjigjet e fituara në këtë pyetje, të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, shihet qartë se pjesa më e madhe e të punësuarve janë të informuar për atë se a ekzistojnë ose jo, akte dhe aktivitete për parandalimin e korrupsionit në kompaninë e tyre, ndërsa më pak se 10% janë përgjigjur me nuk e di.

Në numrin më të madh të kompanive private ekziston institucioni i revizionit të brendshëm, ekzistojnë kodet etike me të cilat korrupsioni është definuar si akt jomoral, ekzistojnë dënime të


7 Survey of business people: <http://www.transparency.org/research/bps2011>

qarta për shkeljen e kodeve etike dhe ndalesa për pagesën e provizioneve ndërmjetësuese për “lehtësimin” e biznesit. Ajo që mund të vërehet në shikim të parë nga rezultatet është fakti se në numrin më të madh të kompanive nuk ekzistojnë masa për stimulimin e atyre që do të zbulojnë ndonjë rast të korrupsionit dhe se një numër relativisht i vogël i të punësuarve kanë dëgjuar për trajnimin e të punësuarve për aktivitete antikorruptive.

Tabela 5: A ekzistojnë në kompaninë tuaj këto masa për parandalimin e korrupsionit?

	Po	Jo	Nuk e di
	%	%	%
Masa për stimulimin e atyre që do të zbulojnë ndonjë rast të korrupsionit	38.1	58.0	3.9
Ndalohen provizionet/pagesat ndërmjetësuese për “lehtësimin” e biznesit	49.0	42.2	8.8
Politikë antikorruptive në formë të shkruar/kod etik afarist	42.2	41.0	8.8
Dënime të qarta për shkeljen e kodit	52.6	43.1	4.3
Trajnim për politikën antikorruptive të kompanisë	27.1	68.8	4.1
Revizion i brendshëm	56.2	40.4	3.4

Analiza e përgjigjeve të të punësuarve në këto pyetje tregon se te kompanitë me numër më të madh të të punësuarve disa nga masat e brendshme për parandalimin e korrupsionit janë më të pranishme se sa te kompanitë me numër më të vogël të punësuarish. Gjatë kësaj duhet pasur parasysh se në vendin tonë, 82% e subjekteve të regjistruara afariste (gjegjesisht shoqatave tregtare) janë kompani që kanë prej 1 deri në 9 të punësuar, ndërsa rreth 75% e tyre janë të regjistruara si tregtarë individualë. Sipas të dhënave nga ESHS-ja, në vitin 2012, në vend kanë qenë të regjistruara 74.424 subjekte afariste (shoqata tregtare, kompani). Në 82% prej tyre ka pasur prej 1 deri në 9 të punësuar, në 3,9% ka pasur prej 10 deri në 19 të punësuar, në 2,4% ka pasur prej 20 deri në 49 të punësuar, në 1,7% ka pasur prej 50 deri në 249 të punësuar dhe në 0.3% mbi 250 të punësuar. Numri më i madh i subjekteve afariste kanë qenë të regjistruara në sektorin e tregtisë dhe të ndreqjes së automjeteve, 27.307 ose 36.7% nga numri i përgjithshëm i subjekteve afariste, ndërsa, pothuajse 70% prej tyre, në regjistrin e shoqatave tregtare janë të regjistruara si tregtarë individualë.⁸



Grafiku 16: Përqindja e të anketuarve që kanë dhënë përgjigje konfirmuese se në kompaninë e tyre ekzistojnë Politikë antikorruptive në formë të shkruar/kod etik afarist dhe Revizion i brendshëm (sipas numrit të të punësuarve në kompani)

Fakti që masat e brendshme për parandalimin e korrupsionit janë të pranishme në numrin më të madh të kompanive me mbi 11 të punësuar dhe që të punësuarit në ato kompani janë të informuar për ekzistimin e kodit etik që e ndalon korrupsionin dhe për ekzistimin e revizionit të brendshëm që e kontrollon shpenzimin e përgjegjshëm të resurseve financiare të kompanisë dhe për masat e tjera për parandalimin e korrupsionit, flet për atë se numri më i madh i të punësuarve në vendin tonë janë të përfshirë me këto masa për parandalimin e korrupsionit.

Hulumtimi i “Transparency International” që është realizuar në 30 vende me 3.000 të anketuar, tregon rezultate të ngjashme për këtë temë.⁹

Tabela 6: Përgjigjet konfirmuese të të anketuarve nga hulumtimi i “Transparency International”, i realizuar në 30 vende, për masat e brendshme për parandalimin e korrupsionit te kompanitë

Masa të brendshme për parandalimin e korrupsionit	Përqindja e përgjigjeve konfirmuese
Kanë kod etik	74%
Kanë politikë antikorruptive	51%
Rregullisht realizojnë trajnime të të punësuarve për antikorruption	34%
Kanë të përfshira masa preventive për parandalimin e korrupsionit në strategjinë e tyre për menaxhim me rreziqet	52%
Ndalajnë pagesa për lehtësimin e biznesit	68%

Tabela 7: Krahasimi ndërmjet vendeve të botës (Transparency International) dhe vendit tonë (Agjencia Rejting) për ekzistimin e masave të brendshme për parandalimin e korrupsionit te kompanitë

Masa të brendshme për parandalimin e korrupsionit	Te ne	Mesatarja e 30 vendeve
Masa për stimulimin e atyre që do të zbulojnë raste të korrupsionit	38%	43%
Janë të ndaluara provizionet/pagesat për “lehtësimin” e biznesit	49%	68%
Politikë antikorruptive në formë të shkruar / kod etik afarist	42%	56%
Dënime të qarta për shkeljen e kodit	53%	74%
Trajnim për politikën antikorruptive të kompanisë	27%	34%
Revizion i brendshëm	56%	65%

Te kompanitë private të vendit, sipas informatave të të punësuarve, masat e brendshme për parandalimin e korrupsionit janë më pak të përfaqësuara se sa përfaqësimi mesatar i atyre masave te kompanitë e 30 vendeve të botës, ku bëjnë pjesë edhe ekonomitë më të zhvilluara botërore si SHBA-të, Brazili, Rusia, India dhe Kina. Por, kur shihet krahasimi, duhet pasur parasysh se me këtë hulumtim janë përfshirë vetëm nga njëqind pronarë të kompanive private nga secili vend i mostrës, ndërsa në këtë hulumtim janë anketuar 800 të punësuar nga numri i përgjithshëm i kompanive private në vendin tonë, në bazë të mostrës reprezentative.

9 <http://www.transparency.org/research/bps2011>

7. EFEKTET NGA LEGJISLACIONI NACIONAL DHE NGA GAZETARIA HULUMTUESE NË PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT NË SEKTORIN PRIVAT


Që të matet perceptimi i të punësuarve për efikasitetin e disave nga masat për parandalimin dhe ndëshkimin e korrupsionit në sektorin privat, në kuadër të këtij hulumtimi atyre iu parashtrua pyetja: “Sipas vlerësimit tuaj, cilat masa/faktorë janë efikase ose jo në parandalimin e korrupsionit te kompanitë private: legjislacioni antikorrupтив në vend, gazetaria hulumtuese dhe politika antikorrupтивe e kompanisë?”

Tabela 8: Për secilën nga këto masa/faktorë, a mendoni se janë efikase ose jo në parandalimin e korrupsionit në kompanitë private?

	Po (janë efikase)	Jo (nuk janë efikase)	Nuk e di
Legjislacioni antikorrupтив	32.7%	62.3%	5.0%
Gazetaria hulumtuese	49.2%	45.8%	5.0%
Politika antikorrupтивe e kompanisë / rregullat e udhëheqjes korporative (të definuara me kodet e odave ekonomike)	34.3%	55.5%	10.5%

Siç mund të shihet nga përgjigjet e prezantuara, secili i treti i anketuar i vlerëson si efikase Ligjet për parandalimin e korrupsionit dhe Kodet për sjellje etike të kompanive në parandalimin e korrupsionit (32.7% dhe 34.3%, respektivisht). Dy nga tre të punësuar në sektorin privat, këto dy masa të komunitetit i vlerësojnë si joefikase ose nuk e dijnë se a thua vallë janë efikase. Gazetarinë hulumtuese, si faktor për parandalimin e korrupsionit, kur në publik nxjerr fakte për ndonjë rast të korrupsionit, shumica e të punësuarve (49.2%) e konsiderojnë si mjet efikas kundër korrupsionit.

Të rinjtë e vendit, gjegjësisht personat e moshës ndërmjet 18 dhe 29 vjet, siç mund të shihet nga grafiku i mëposhtëm, në përqindje më të lartë besojnë në efikasitetin e legjislacionit antikorrupтив dhe të gazetarisë hulumtuese se sa ata më të vjetrit dhe ata më me përvojë.



Grafiku 17: Përqindja e të anketuarve që kanë dhënë përgjigje konfirmuese, gjegjësisht që besojnë në efikasitetin e legjislacionit antikorrupтив dhe gazetarisë hulumtuese (sipas moshës së të anketuarve)

Besimi në efikasitetin e legjislacionit antikorrupтив është mjaft i vogël (19%) te të punësuarit në kompani që kanë ndërmjet 51 dhe 100 të punësuar, për të cilët, më lartë thamë se kanë deklaruar se gjatë 12 muajve të kaluar kanë pësuar humbje më të mëdha për shkak të korrupsionit nga ana e konkurrentëve të tyre.

Në efikasitetin e gazetarisë hulumtuese për parandalimin e korrupsionit më tepër besojnë të punësuarit shqiptarë (58%) se sa të punësuarit maqedonas (49%) dhe të punësuarit që janë në pozita joudhëheqëse, 53% e të cilëve konsiderojnë se gazetaria hulumtuese është efikase në parandalimin e korrupsionit, për dallim nga ata që janë në pozita udhëheqëse, nga të cilët, vetëm 42.9% konsiderojnë se gazetaria hulumtuese është efikase.

Në hulumtimin e “Transparency International”, legjislacionin antikorruptiv si mjet efikas për parandalimin e korrupsionit e kanë vlerësuar, mesatarisht 38% e të anketuarve në 30 vendet, ndërsa gazetarinë hulumtuese, 49% e të anketuarve e kanë vlerësuar si mjet efikas për parandalimin e korrupsionit.¹⁰


Sa i përket efikasitetit të gazetarisë hulumtuese në parandalimin e korrupsionit, analistët kanë vërejtur se në disa vende, si për shembull në Brazil, ku mediat zbulojnë afëra të mëdha korrupsive në të cilat janë të përfshira kompani të fuqishme private dhe funksionare të qeverisë, efikasiteti i gazetarisë hulumtuese në vlerësimet e biznesmenëve arrin edhe deri në 70%. Por, ata theksojnë se hulumtimi dhe publikimi i fakteve për korrupsionin para publikut nga ana e gazetarëve mund të bëhet në vende ku denoncuesit e korrupsionit janë të mbrojtur me ligj dhe ku ata mund t’ia lejojnë vetëvetes t’i ndajnë informatat me gazetarët. Nga ana tjetër, ata potencojnë se, që gazetaria hulumtuese të jetë efikase, përveç trajnimeve të gazetarëve, nevojitet ambient në të cilin publiku nuk e toleron korrupsionin dhe insiston në atë që fajtorët të nxirren para gjyqit dhe të dënohen për veprat e kryera.¹¹

8. KONTRIBUTI I SUBJEKTEVE DHE I INSTITUCIONEVE QË KANË KOMPE- TENCË PËR PARANDALIMIN DHE NDËSHKIMIN E KORRUPSIONIT NË SEKTORIN PRIVAT

Një varg institucionesh në vend, si edhe në vendet e tjera, kanë kompetencë të luftojnë kundër korrupsionit. Qytetarët dhe të punësuarit në sektorin privat, për kontributin dhe rëndësinë e tyre në këtë luftë krijojnë një parafytyrim të vetin. Me qëllim që të kuptohet se si të punësuarit në sektorin privat e rangojnë për nga rëndësia rolin e të gjitha këtyre subjekteve në luftën kundër korrupsionit, në këtë hulumtim u parashtrua edhe pyetja se cili nga subjektet dhe institucionet e përmendura, sipas tyre, kontribuon më së tepërmi në luftën kundër korrupsionit në sektorin privat. Siç mund të shihet nga përgjigjet e tyre, të cilat janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm, numri më i madh i të anketuarve konsiderojnë se për parandalimin dhe ndëshkimin e korrupsionit në sektorin privat në vendin tonë, kontribut më të madh japin ata që kanë guxim ta denoncojnë korrupsionin (denoncuesit e korrupsionit) dhe ata që e informojnë publikun për sjelljen korruptive në sferën e biznesit (mediat). 19.9% e të anketuarve i kanë vlerësuar denoncuesit e korrupsionit dhe po i njëjti numër kanë theksuar se mediat që informojnë për ndonjë rast korrupsioni në sferën e biznesit, bëjnë pjesë në mesin e atyre që më së shumti kontribuojnë për parandalimin dhe ndëshkimin e korrupsionit në sektorin privat.

10 <http://www.transparency.org/research/bps2011/>

11 <http://blog.transparency.org/2012/10/31/the-power-of-journalism-as-an-anti-corruption-tool/>



Grafiku 18: Për cilin nga këto institucione do të thonit se më së shumti kontribuon në luftën kundër korrupsionit në sektorin privat?

Në vendin e tretë sipas efikasitetit për zbulimin dhe parandalimin e korrupsionit, sipas vlerësimit të të anketuarve gjendet policia, për të cilën 14% e të anketuarve kanë theksuar se është subjekti më efikas në këtë luftë, ndërsa për 12% të të anketuarve, ai është Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit.

Organizatrat ndërkombëtare si OSBE-ja dhe BE-ja, të cilat nëpërmjet programeve të tyre për trajnim, por, edhe nëpërmjet raporteve të tyre dhe aktivitetit të përgjithshëm, e fokusojnë vëmendjen e publikut mbi problemin e korrupsionit, janë potencuar si institucionet më efikase në këtë luftë nga ana e 10.4% e të anketuarve, ndërsa 6.5% prej tyre janë përgjigjur se më efikase në luftën kundër korrupsionit në sektorin privat te ne janë organizatat joqeveritare për luftë kundër korrupsionit.


Vetëm 2% e të punësuarve në sektorin privat si organ më efikas në luftën kundër korrupsionit e konsiderojnë Revizorin shtetëror, vetëm 0.2% si më efikase në këtë luftë e kanë potencuar Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës dhe vetëm 3.2% e kanë potencuar gjyqësinë si institucion më efikas në luftën kundër korrupsionit.

Analiza e përgjigjeve sipas karakteristikave socio-demografike të të anketuarve nuk tregon se ka dallim thelbësor në perceptimin e të punësuarve për efikasitetin e subjekteve dhe të institucioneve të përmendura. Megjithatë, duhet theksuar se efikasiteti i policisë në këtë luftë përmendet në vend të parë nga ana e të punësuarve me të ardhura më të ulëta personale. 23.6% prej tyre kanë dhënë përgjigje të tillë, ndërsa vetëm 7,7% e shqiptarëve etnik që janë anketuar e kanë potencuar policinë si subjekt më efikas në luftën kundër korrupsionit. Sa i përket maqedonasve, 15% prej tyre janë përgjigjur se ky institucion më së shumti kontribuon në luftën kundër korrupsionit në sektorin privat, kurse e ngjashme është edhe përqindja (14%) e bashkësive të tjera etnike që konsiderojnë se policia është instrumenti më efikas në luftën kundër korrupsionit.

9. A THUA VALLË KA SOT MË SHUMË OSE MË PAK KORRUPSION NË SEKTORIN PRIVAT NË KRAHASIM ME PERIUHDËN PREJ PARA 4 VITESH

Një pjesë e treguesve të përgjithshëm për luftën kundër korrupsionit në çdo vend duhet të jetë edhe ndjenja e qytetarëve, biznesmenëve dhe investitorëve, se ka më pak korrupsion se sa më parë dhe se në bazë të kësaj është përmirësuar edhe klima afariste.

Që të kuptohet se cili është niveli i perceptimit të tillë të të punësuarve në sektorin privat, në këtë hulumtim atyre iu parashtrua edhe pyetja: “Krahasuar me periudhën prej para katër vitesh, a do të thonit se sot, në bizneset në vend praktikohet: më tepër korrupsion, njëlloj sikurse edhe para katër vitesh ose më pak korrupsion?”



Grafiku19: Krahasuar me periudhën prej para katër vitesh, a do të thonit se sot, në bizneset në vend praktikohet: më tepër korrupsion, njëlloj sikurse edhe para katër vitesh ose më pak korrupsion?

Siç mund të shihet nga përgjigjet, 30% e të anketuarve vlerësojnë se korrupsioni në sektorin privat sot është më i vogël se sa para 4 vitesh. Përqindje e njëjtë e të anketuarve konsideron se korrupsioni në sektorin privat, që është i lidhur me korrupsionin në sektorin publik, nuk është zvogëluar në krahasim me nivelin e para 4 viteve, e gjithashtu edhe një e treta kanë vlerësuar se korrupsioni në sektorin privat është rritur në krahasim me nivelin e para 4 viteve. Duke i pasur parasysh këto rezultate, mund të konstatojmë se mbi 63% e të anketuarve, ose pothuajse 2/3 e tyre, konsiderojnë se në 4 vitet e fundit, korrupsioni në sektorin privat, ose ka mbetur në nivel të njëjtë, ose është rritur.

Analiza e përgjigjeve sipas karakteristikave socio-demografike të të anketuarve tregon se në mesin e atyre që konsiderojnë se sot në sektorin privat ka më tepër korrupsion se sa para 4 vitesh, numri më i madh janë: të anketuarit më të rinj të moshës ndërmjet 18 dhe 29 vjet, 40% e të cilëve kanë dhënë përgjigje të tillë, pastaj shqiptarët, 50% e të cilëve kanë dhënë përgjigje të tillë, e më pas të punësuarit në qytetet më të vogla në brendi të vendit (39%), të punësuarit me të ardhura personale mujore deri në 10.000 denarë (44%) dhe të punësuarit në kompani që kanë ndërmjet 51 dhe 100 të punësuar (47%).

Në vitin 2006, vendi ynë ishte i ranguar në vendin e 105-të sipas Indeksit për perceptimin e korrupsionit të organizatës ndërkombëtare “Transparency International”, ndërsa në vitin 2007, ajo ishte ranguar në vendin 84, nga gjithsej 179 vende. Në vitin 2008, vendi kishte përparim, duke kërcyer 12 vende dhe arriti në vendin e 72-të në shkallën antikorruptive nga gjithsej 180 vende të botës, siç publikoi “Transparency International”. Një përparim të vogël, duke kaluar në vendin e 71-të, vendi ynë regjistroi në vitin 2009, (ose saktë para 4 vitesh).

Sipas të dhënave të kësaj organizate joqeveritare, vendi ynë në vitin 2010 arriti në vendin e 62-të në konkurrencë të 178 vendeve, ndërsa gjatë dy viteve të kaluara u rangua në vendin e 69-të.

KONKLUDIME

1. Mbi 35% e të punësuarve në sektorin privat deklarojnë se gjatë 12 muajve të kaluar kompania e tyre nuk ka fituar ndonjë tender publik ose ka humbur ndonjë biznes për shkak të mitës së paguar, gjegjësisht korrupsionit të kryer nga ana e konkurrentëve të tyre. Po të krahasohet me gjendjen në këtë sektor me 30 vendet e tjera të botës, vendi ynë bën pjesë në mesin e vendeve në të cilat ekziston perceptim i lartë për ekzistimin e korrupsionit në sektorin privat.¹²
2. Çdo i punësuar i tretë në sektorin privat në vendin tonë konsideron se korrupsioni në sektorin privat është zvogëluar në krahasim me periudhën prej para 4 vitesh. Por, dy të tretat e tjera të të punësuarve në sektorin privat konsiderojnë se korrupsioni ka mbetur në nivel të njëjtë sikurse edhe para 4 vitesh ose se është rritur në krahasim me gjendjen prej para 4 vitesh.
3. Mbi 70% e të punësuarve në sektorin privat e ndajnë mendimin se “që të fitojnë ndonjë tender shtetëror, kompanitë në vend përdorin mitë”, e gjithashtu përqindje e njëjtë e tyre konsiderojnë se kompanitë i keqpërdorin donacionet dhe sponsorimet për qëllime korruptive.
4. Mënyra më e lehtë për të fituar ndonjë tender publik, nëpërmjet sjelljes korruptive dhe joetike, sipas vlerësimit të 50% të të punësuarve në sektorin privat, janë “lidhjet politike dhe familjare të biznesit me pushtetin”. Në vendin e dytë është fuqia ekonomike e kompanive për të paguar mitë, gjegjësisht paratë, dhe në vendin e tretë është aftësia e kompanisë të ofrojë kundërsërbim për “ofruesit e biznesit ose lehtësuesit” e biznesit, që mund të jetë punësim i ndonjë anëtari të familjes, sponsorim, donacion, e të ngjashme.
5. Si shkak kryesor për çrrenjosjen e vështirë të korrupsionit në sektorin privat, të punësuarit e konsiderojnë faktin se te ne korrupsioni nuk dënohet sa duhet; pastaj faktin se përfitimet nga korrupsioni janë më të mëdha se sa dënimet; por edhe për shkak se “biznesi nuk e kupton korrupsionin si problem serioz”, për të cilën gjë edhe vetë biznesi ka faj.
6. Sipas vlerësimit të mbi 68% të të anketuarve, për ekzistimin e korrupsionit në sektorin privat, në masë të njëjtë kontribuojnë edhe biznesmenët edhe bartësit e funksioneve publike. Për 18% prej tyre, megjithatë kontribut më të madh kanë bartësit e funksioneve publike, ndërsa 12% prej tyre shkakun kryesor e shohin te biznesmenët.
7. Në sferën e biznesit, sipas vlerësimit të të punësuarve, në sektorin privat nuk është ndër-tuar sa duhet vetëdija për obligimin afarist të çdo kompanie të luftojë kundër korrupsionit.
8. Nga masat për parandalimin e korrupsionit te kompanitë në vend, më të pranishme janë: revizioni i brendshëm; ekzistimi i kodit etik që ka të bëjë me parandalimin e korrupsionit; dënimet për shkeljen e kodit afarist dhe ndalesa për të paguar provizion ndërmjetësues për “lehtësimin” e biznesit. Akoma është i vogël numri i kompanive në të cilat është organizuar trajnim për parandalimin e korrupsionit dhe në të cilat ekzistojnë masa stimulative për denoncuesit e korrupsionit.
9. Të punësuarit në sektorin privat, nuk e konsiderojnë si shumë efikas legjislacionin antikorrup-tiv në vend, mirëpo 49.2% e tyre, “gazetarinë hulumtuese” e konsiderojnë si mjet efikas në parandalimin e korrupsionit. Nga ana tjetër, ajo është më e suksesshme në vendet në të cilat ekziston mbrojtje e sigurt e denoncuesve të korrupsionit dhe në të cilat institu-

cionet, e veçanërisht prokuroritë dhe gjyqësia, janë efikase në hulumtimin dhe sanksionimin e rasteve të korrupsionit që janë zbardhur publikisht ose të dyshimeve të publikuara për ekzistimin e korrupsionit.

10. Sipas vlerësimit të të punësuarve në sektorin privat, subjektet që më së shumti kontribuojnë për parandalimin e korrupsionit në sektorin privat në vend janë: denoncuesit e korrupsionit, mediat, policia, Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, zyrat e organizatave ndërkombëtare në vendin tonë, si ato të OSBE-së dhe të BE-së, pastaj organizatat joqeveritare për luftë kundër korrupsionit, gjyqësia, revizori shtetëror dhe Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës.

2.HULUMTIM PËR KORRUPSIONIN NË POLITIKË

RAPORT NARATIV

HYRJE

Korrupsioni në politikë paraqet një nga dukuritë më të përhapura në sistemet politike të shteteve nëpër botë. Në masë më të madhe ose më të vogël, ndaj kësaj dukurie nuk janë imun as demokracitë më të zhvilluara parlamentare, te të cilat ekziston mekanizëm i zhvilluar për parandalimin e sjelljes së papërgjegjshme të funksionarëve dhe të atyre që ushtrojnë detyra publike. Në kuptimin më të gjerë, korrupsioni në politikë mund të definohet si keqpërdorim i autorizimeve publike me qëllim të realizimit, para së gjithash, të përfitimit personal. Por, ka edhe definicione të tjera, të cilat e përcaktojnë këtë dukuri në mënyrë konkrete. Njëri nga to, korrupsionin në politikë, e definojnë si “sjellje që shmanget nga autorizimet formale të funksionit publik për arsye personale, përfitime në status ose në para, ose që i shkel rregullat që e ndalojnë shfrytëzimin e autorizimeve për qëllime personale”¹³. Edhe pse ky definicion e definojnë në mënyrë shumë më konkrete korrupsionin në politikë, megjithatë nuk e përfshin një kategori shumë të rëndësishme – shkeljen e interesit publik gjatë sjelljes korruptive. Disa autorë, siç është Karl Fridrih, gjatë definimit të korrupsionit në politikë, e marrin parasysh pikërisht interesin publik. Sipas tij, “Korrupsioni politik ekziston gjithmonë kur bartësi i autorizimeve publike merr shpërblime në para ose në ndonjë formë tjetër, të cilat nuk janë paraparë me ligj, që të ndër marrë aktivitete në interes të atyre që ia japin shpërblimin dhe me këtë i shkakton dëm interesit publik – të përgjithshëm”¹⁴. Ka definicione të shumta që kanë qasje të ndryshme gjatë përcaktimit të korrupsionit në politikë. Mu për këtë arsye, do të përiqemi t’i përmbledhim aspektet më të rëndësishme gjatë definimit të kësaj dukurie. Në këtë hulumtim, me termin *korrupsion në politikë nënkuptohet keqpërdorimi i autorizimeve publike me qëllim të përfitimit të dobisë personale dhe privilegjeve të cilat nuk janë paraparë me funksionin që kryhet dhe me të cilat dëmtohet interesi publik*.

Korrupsioni në politikë mund të definohet në mënyrë shumë më konkrete në qoftë se kjo përcillet nëpërmjet formave, llojeve dhe trajtave të paraqitjes së tij. Format më të shpeshta të paraqitjes së korrupsionit politik janë:

- *Mita (ryshfeti)* paraqet shpërblim në formë parash ose në ndonjë mënyrë tjetër që i jepet bartësit të funksionit publik në këmbim të shfrytëzimit të autorizimeve të tij zyrtare.
- *Përvetësimi i jashtëligjshëm (shpërdorimi)* paraqet keqpërdorim ose përvetësim të resurseve (të mirave) publike nga ana e bartësve të funksioneve publike.
- *Shantazhi* paraqet marrje të përdhunët të parave ose të mirave të ndonjë lloji tjetër nga persona të tretë, që e shfrytëzojnë bartësit e funksioneve publike duke i keqpërdorur autorizimet e tyre zyrtare dhe fuqinë e tyre politike.
- *Proteksioni (favorizimi)* paraqet praktikë të ndarjes së privilegjeve, përfitimeve, lehtësimeve të veçanta dhe resurseve publike vetëm personave ose grupeve të caktuara, me ç’rast qytetarët e tjerë vendosen në pozitë të pabarabartë.
- *Nepotizmi* paraqet lloj të veçantë të favorizimit, nëpërmjet të të cilit, bartësit e funksioneve publike e keqpërdorin pozitën e tyre në interes të anëtarëve të familjes së tyre të ngushtë.¹⁵ Sjellja e këtillë, kur është në dobi të interesit partiak quhet *kronizëm*.

Korrupsioni në politikë më shpesh kuptohet si metodë me të cilën shërbehen partitë politike gjatë financimit të fushatave parazgjedhore, procesit zgjedhor, si dhe aktit të votimit. Megjithatë, korrupsioni nuk është i lidhur vetëm me procesin zgjedhor, por me çdo sjellje të njerëzve

13 J. S. Nye, „Political Corruption: a Cost-Benefit Analysis“ in A. J. Heidenheimer, M. Johnston and V. LeVine, *Political Corruption: a Handbook* (New Brunswick NJ, Transaction, 1989), fq.966.

14 A. J. Heidenheimer, *Political Corruption: A Handbook*, Transaction Publishers, 1989, fq.10.

15 I. Amundsen, *Political Corruption: An Introduction to the Issues*, Chr. Michelsen Institute Development Studies and Human Rights, 1999. fq. 10 – 15. <http://www.cmi.no/publications/1999/wp/wp1999-7.pdf>

që kryejnë funksione publike, e cila shmanget nga parimi i “qeverisjes së mirë”. Sjellje korruptive ka edhe atëherë kur bartësit e funksioneve publike marrin vendime në interes të atyre që i financojnë ata ose në interes të partive të tyre politike. Në atë rast, interesi i përgjithshëm vihet në rend të dytë. Korrupsioni politik, poashtu, mund në masë të madhe t’i orientojë resurset shoqërore prej grupeve të varfëra dhe të marginalizuara drejt atyre që kanë status më të lartë shoqëror ose që kanë ndikim mbi institucionet dhe marrjen e vendimeve politike. Kjo e fundit është një dukuri mjaft e shpeshtë në vendet ku institucionet demokratike janë të dobëta ose ku ato nuk ekzistojnë.¹⁶

Pasojat negative nga korrupsioni në politikë ndjehen në çdo segment të jetës shoqërore. Në vendet ku institucionet nuk janë të fuqishme sa duhet dhe nuk kanë kontroll mbi korrupsionin, kapaciteti i institucioneve dobësohet edhe më tepër, e me këtë dobësohet edhe stabiliteti i rendit shoqëror në tërësi.¹⁷ Mu për këtë arsye, në vendet ku ka nivel më të ulët të korrupsionit, institucionet gëzojnë legjitimitet dhe përkrahje më të madhe nga qytetarët.

QËLLIMET E HULUMTIMIT

Qëllimet kryesore të këtij hulumtimi të bazuar në perceptimin e qytetarëve janë të mblidhen informata dhe të dhëna në lidhje me këto çështje:

- Niveli dhe format e korrupsionit në politikë në vendin tonë, në bazë të perceptimit të qytetarëve për ekzistimin dhe përhapjen e tij në institucionet e sistemit;
- Mënyra se si bartësit e funksioneve publike i shfrytëzojnë autorizimet publike;
- Shkalla e respektimit të standardeve etike nga bartësit e funksioneve publike gjatë kryerjes së autorizimeve ligjore;
- Niveli i korrupsionit që është i pranishëm te partitë politike gjatë financimit të fushatave zgjedhore dhe procesit zgjedhor;
- Shkalla e efikasitetit të organeve shtetërore dhe institucioneve shoqërore në parandalimin e korrupsionit në politikë;
- Niveli i korrupsionit në politikë sot, në krahasim me periudhën prej para 4 vitesh.

Ky hulumtim, në mes tjerash, u konceptua edhe në bazë të informatave dhe të dhënave nga hulumtimet e ngjashme në botë, nga ana e organizatës së njohur ndërkombëtare “Transparency International”, me qëllim që informatat e fituara të mund të krahasohen me të dhënat nga vendet e tjera, që janë fituar nga hulumtime të ngjashme, të cilat janë realizuar gjatë disa viteve të fundit.

METODOLOGJIA

Hulumtimi i mendimit publik për korrupsionin në politikë në vend u realizua me metodën e anketës telefonike, në një mostër reprezentative prej 1080 qytetarëve të moshës madhore të popullatës së vendit. Anketa u realizua në periudhën prej 1 korrikut deri më 5 korrik të vitit 2013.

Dezenimi i mostrës reprezentative që i pasqyron qëndrimet e qytetarëve të vendit kaloi nëpër disa procedura sistematike. Për të siguruar mostër reprezentative u respektuan disa procedura të caktuara gjatë formulimit të saj, që dalin nga rregullat për zgjedhje të rastësishme. Procedura për zgjedhje të mostrës u bazua në parimin për dezen të mostrës rajonale dhe nacionale, që e definoi rajonin në përputhje me definicionin e tij nga Enti shtetëror për statistikë (NUTS3 the EU16). Në fakt,

¹⁶ http://www.transparency.org/topic/detail/politics_and_government

¹⁷ I. Amundsen, Political Corruption: An Introduction to the Issues, Chr. Michelsen Institute Development Studies and Human Rights, 1999. fq. 10 – 15. <http://www.cmi.no/publications/1999/wp/wp1999-7.pdf>

sipas strukturës gjeo-demografike të popullatës, vendi u nda në tetë rajone: i Shkupit, i Pollogut, i Pellagonisë, i Vardarit, Verilindor, Juglindor, Jugperëndimor dhe Lindor. Pastaj, në këtë mostër, në mënyrë proporcionale u përfshinë të anketuar nga të gjitha 84 komunat, duke e përfshirë edhe popullatën e qyteteve dhe të fshatrave. Numri i të anketuarve u shpërnda në mënyrë proporcionale sipas popullatës së përgjithshme në çdo rajon, duke i shfrytëzuar të dhënat zyrtare nga regjistrimi i popullatës në vitin 2002. Gabimi statistikor për këtë lloj të hulumtimeve është +/- 3%.

Tabela1: Struktura demografike e mostrës


Struktura demografike e mostrës		%
Rajoni	I Pellagonisë	12.6
	I Vardarit	7.4
	Verilindor	7.8
	Jugperëndimor	11.3
	I Shkupit	27.8
	Juglindor	8.7
	I Pollogut	14.6
	Lindor	9.8
		100
Vendbanimi	Qytet	59.4
	Fshat	40.6
		100
Përkatësia etnike	Maqedonas	69.4
	Shqiptarë	24.3
	Tjetër	6.3
		100
Gjinia	Femërore	53.2
	Mashkullore	46.8
		100
Moshë	18 – 29	17.0
	30 -49	37.0
	50 -64	33.0
	Mbi 65	13.0
		100
Arsimi	Fillor dhe më pak	15.5
	I mesëm	52.8
	I lartë, universitar dhe Mr., Dr.	31.7
		100

2. PERCEPTIMI PËR PËRHAPJEN E KORRUPSIONIT NË SISTEM

Korrupsioni në sistem paraqet problem serioz me të cilin ballafaqohet pothuajse çdo vend në botë. Sipas hulumtimit të fundit të “Transparency International”: Global Corruption Barometer 2013: Report¹⁸, i cili është realizuar në një mostër prej 114.000 të anketuarve në 107 vende të botës, dhe ku është matur perceptimi i qytetarëve për shkallën e korrupsionit në segmente të ndryshme të jetës shoqërore, është konstatuar se në numrin më të madh të vendeve, qytetarët konsiderojnë se shkalla e korrupsionit është më e madhe pikërisht në institucionet politike të vendit të tyre. Duke u nisur nga këto rezultate nga njëra anë, e duke i pasur parasysh qëllimet e këtij hulumtimi nga ana tjetër, është e domosdoshme që së pari të mblidhen rezultatet nga matja e perceptimit për ekzistimin e korrupsionit në institucionet politike në vendin tonë, për shkak se vetëm në atë mënyrë mund të fitohet pasqyrë reale për perceptimin sa i përket korrupsionit në politikë në përgjithësi.

Pyetëtori për këtë hulumtim u modelua që të mat perceptimin e qytetarëve për përhapjen e korrupsionit në këto institucione:

- Partitë politike;
- Qeverinë e vendit dhe ministritë;
- Kuvendin e vendit;
- Kryetarin e vendit



Grafiku 1: Sipas jush, sa është i pranishëm korrupsioni në secilin prej segmenteve të përmendura të sistemit në vend?

Të anketuarit kishin mundësi të rrethojnë më tepër se një opcion nga ato që ishin ofruar. Siç mund të vërejmë nga grafiku i paraqitur më lartë, të anketuarit në këtë hulumtim, në përqindje më të madhe (51.4%) konsiderojnë se te partitë politike ka shumë korrupsion, e pastaj vijnë ministritë (43.3%), qeveria (42.2%), kryetari i shtetit (33.9%) dhe Kuvendi (31.9%).


3. SHKALLA E PËRHAPJES SË KORRUPSIONIT TE PARTITË POLITIKE

Demokracia parlamentare nuk mund të paramendohet pa ekzistimin e partive politike, të cilat paraqesin mjet nëpërmjet të të cilit qytetarët i artikulojnë interesat e tyre në institucionet e sistemit. Qëllimi përfundimtar i çdo partie politike është që nëpërmjet pjesëmarrjes dhe fitores në zgjedhje ta marrë mbi vete udhëheqjen e shtetit. Por, që ta realizojnë këtë qëllim, partitë politike, jo rrallë shfrytëzojnë edhe metoda korruptive. Duke e pasur parasysh pozitën kyçe të partive politike në jetën politike të një shoqërie, çështja se a ka korrupsion në to është me rëndësi të jashtëzakonshme.

Sipas hulumtimit të fundit të “Transparency International”, të anketuarit në madje 51 nga 107 vende, i përfshijnë partitë politike në mesin e institucioneve më të korruptuara në vendin e tyre.¹⁹

Sa i përket vendeve të rajonit, 72% e të anketuarve në Kroaci²⁰ dhe në Shqipëri²¹ konsiderojnë se partitë politike në vendin e tyre janë të korruptuara plotësisht ose në masë të madhe, ndërsa me këtë deklaratë pajtohen edhe 75% e të anketuarve në Kosovë²², 76% e të anketuarve në Bullgari²³, 77% e të anketuarve në Bosnjë dhe Hercegovinë²⁴, ndërsa madje 80% e të anketuarve në Serbi²⁵ janë përgjigjur se partitë politike në vendin e tyre janë të korruptuara plotësisht ose në masë të madhe.

Megjithatë, perceptimi i këtillë për korrupsionin që ekziston te partitë politike nuk është karakteristikë vetëm për vendet ballkanike të pas-tranzicionit, por, siç vërteton hulumtimi i njëjtë, ky mendim është gjerësisht i përhapur edhe te qytetarët në pothuajse çdo vend të botës. Kështu, për shembull, madje edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, qytetarët në përqindje më të madhe (76%) konsiderojnë se mu partitë politike janë segmenti më i korruptuar në shoqërinë e tyre.²⁶



Grafiku 2: Sipas jush, sa është i pranishëm korrupsioni në secilin prej segmenteve të përmendura të sistemit në vend: Partitë politike në vend?

Nga grafiku i mësipërm mund të vërehet se 51.4% ose pak më shumë se gjysma e të anketuarve konsiderojnë se te partitë politike në vendin tonë ka shumë korrupsion, ndërsa 35.9% konsiderojnë se partitë janë mesatarisht të korruptuara. Duke i pasur parasysh këto rezultate, mund të konstatohet se në bazë të perceptimit të të anketuarve, partitë politike janë subjektet më të korruptuara në politikën e vendit tonë.

Sipas karakteristikave socio-demografike të të anketuarve, vërehet se meshkujt në një përqindje pak më të lartë (53.1%) konsiderojnë se te partitë politike në vendin tonë ka shumë korrupsion, për dallim nga 50.1% të femrave që janë përgjigjur në mënyrë të njëjtë. Pastaj, të anketuarit që i takojnë popullatës më të moshuar (mbi 65 vjet), poashtu në përqindje më të lartë (59.6%) konsiderojnë se te partitë politike ka shumë korrupsion.

19 <http://www.transparency.org/gcb2013/results>

20 <http://www.transparency.org/gcb2013/country?country=croatia>

21 <http://www.transparency.org/gcb2013/country?country=albania>


22 <http://www.transparency.org/gcb2013/country?country=kosovo>

23 <http://www.transparency.org/gcb2013/country?country=bulgaria>

24 http://www.transparency.org/gcb2013/country?country=bosnia_and_herzegovina

25 <http://www.transparency.org/gcb2013/country?country=serbia>


26 http://www.transparency.org/gcb2013/country?country=united_states



Grafiku 3: Sipas jush, sa është i pranishëm korrupsioni në secilin prej segmenteve të përmendura të sistemit në vend: Partitë politike në vend?/sipas moshës së të anketuarve

Pastaj, shqiptarët etnik në përqindje më të lartë (59.1%) konsiderojnë se partitë janë shumë të korrupsionuara, për dallim nga 49.4% të maqedonasve etnik dhe 44.1% të pjesëtarëve të bashkësive të tjera etnike në vend, të cilët janë përgjigjur në mënyrë të njëjtë.

Sikurse edhe të rezultatet që kishin të bëjnë me institucionet e tjera politike, të anketuarit që nuk janë anëtarë të ndonjë partie politike, në përqindje më të lartë (55.0%) konsiderojnë se te partitë politike ka shumë korrupsion. Mirëpo, duhet theksuar se edhe të anketuarit që janë anëtarë të ndonjë partie politike, në përqindje mjaft të lartë (43.5%) konsiderojnë se ka shumë korrupsion në këto organizata politike.




Grafiku 4: Sipas jush, sa është i pranishëm korrupsioni në secilin prej segmenteve të përmendura të sistemit në vend: Partitë politike në vend?/sipas anëtarësisë së të anketuarve në ndonjë parti politike

Qëllimi dhe funksioni kryesor i partive politike është të jenë mjet nëpërmjet të të cilit qytetarët do të përfaqësohen në institucionet e sistemit.


Prandaj, ka nevojë të hulumtohet edhe çështja që ka të bëjë me interesat që i mbrojnë partitë politike derisa e ushtrojnë pushtetin në një vend.

Mu për këtë arsye, të anketuarve në këtë anketë iu parashtrua pyetja se interesin e kujt e mbrojnë partitë derisa janë në pushtet.



Grafiku 5: Kur partitë janë në pushtet, a e mbrojnë, para së gjithash:

Siç mund të shihet, madje 43.3% e të anketuarve konsiderojnë se partitë në pushtet e mbrojnë interesin e ngushtë partiak, ndërsa 27.5% konsiderojnë se, derisa janë në pushtet, partitë e mbrojnë interesin e sponsorëve të pasur. Vetëm 10.8% e të anketuarve konsiderojnë se partitë politike e mbrojnë interesin e qytetarëve në periudhën kur e ushtrojnë pushtetin.




Grafiku 6: Kur partitë janë në pushtet, a e mbrojnë, para së gjithash:/sipas përkatësisë etnike të të anketuarve

Duke i krahasuar përgjigjet me karakteristikat socio-demografike të të anketuarve, vërejtëm se të anketuarit me arsim të lartë dyvjeçar ose universitar, në përqindje më të ulët (9.9%) konsiderojnë se partitë i mbrojnë interesat e qytetarëve, por edhe në përqindje më të lartë (48.3%) konsiderojnë se partitë, derisa janë në pushtet, e mbrojnë interesin e ngushtë partiak. Pastaj, 13.5% e maqedonasve etnik konsiderojnë se partitë, derisa janë në pushtet, i mbrojnë interesat e qytetarëve, ndërsa me këtë deklaratë pajtohen vetëm 4.5% e shqiptarëve etnik dhe 4.4% e pjesëtarëve të etnitetëve të tjera në vend. Gjithashtu, madje 57.6% e shqiptarëve etnik konsiderojnë se partitë, derisa janë në pushtet, e mbrojnë interesin e ngushtë partiak, me të cilën gjë pajtohen edhe 42.6% e pjesëtarëve të bashkësive të tjera etnike, si dhe 38.4% e maqedonasve etnik.

3.1. TRANSPARENCA GJATË FINANÇIMIT TË PARTIVE POLITIKE DHE BLERJA E NDIKIMIT

Rregullativat që kanë të bëjnë me financimin e partive politike dallojnë nga vendi në vend. Por, pothuajse në të gjitha demokracitë mund të vërehet trend i rritjes së shpenzimeve që janë të nevojshme për funksionimin e tyre. Ka më tepër arsye për një trend të këtillë. Së pari, sot, më tepër se kurdoherë, sukcesi i partive politike varet nga reklamimi, i cili jo vetëm që kushton shumë, por është edhe mënyra më efikase për ta njoftuar elektoratin me qëllimet dhe programin e partisë politike. Në qoftë se në të kaluarën funksionimi i partive politike varej nga puna vullnetare e anëtarëve të saj, sot, ato gjithnjë e më tepër varen nga angazhimi i agjencive profesionale për marketing dhe i konsultantëve politikë, të cilët në këmbim të shërbimeve të tyre marrin kompensim nga partitë politike. Madje edhe në periudhën ndërmjet cikleve zgjedhore, partitë politike nuk mund t'i shmangen harxhimit të mjeteve financiare me qëllim që ta ruajnë praninë e tyre në media. Mu për këtë arsye, partitë politike i përdorin të gjitha mjetet që janë në dispozicion që ta ruajnë pozitën e tyre, mirëpo, ndonjëherë kur harxhohen mjetet ligjore, partitë politike përdorin edhe metoda joligjore (korruptive). Prandaj, në vitet e fundit, skandalet më të mëdha korruptive në vendet e Evropës nuk kanë të bëjnë me keqpërdorimin individual të autorizimeve publike, por me financimin joligjor dhe jotransparent të partive politike.²⁷

Me qëllim që ta konstatojmë perceptimin e qytetarëve të vendit tonë për transparencën në financimin e partive politike, të anketuarve iu parashtrua kjo pyetje: “A mendoni se financimi joligjor është i pranishëm te partitë politike?” Janë fituar këto të dhëna për perceptimin e të anketuarve:




Grafiku 7: A mendoni se financimi joligjor është i pranishëm te partitë politike?

Siç mund të shikojmë, madje 2/3 e të anketuarve konsiderojnë se financimi joligjor te partitë politike është shumë i pranishëm ose mesatarisht i pranishëm, për dallim nga 27.1% e të anketuarve që janë përgjigjur se ai është pak i pranishëm ose aspak nuk është i pranishëm. Po t'i krahasojmë përgjigjet e këtyre dy ekstremeve, do të vërejmë se madje 32.0% e të anketuarve konsiderojnë se financimi joligjor te partitë është shumë i pranishëm, për dallim nga 6.0%, të cilët konsiderojnë se ai nuk është aspak i pranishëm. Megjithatë, këto të dhëna, pa verifikimin e a asaj se sa qytetarët janë të informuar për burimet ligjore dhe mënyrat e financimit të partive politike, mund të krijojnë një përshtypje joobjektive dhe negative për financimin ligjor të partive politike.


27 P. Heywood, Political Corruption: Problems and Perspectives. Political Studies, 45. fq. 417–435

Gjithashtu, meshkujt në përqindje më të lartë (37.2%) konsiderojnë se financimi joligjor i partive është shumë i pranishëm, për dallim nga femrat, te të cilat kjo përqindje është 27.4%. Pastaj, për dallim nga ata me nivel më të ulët të arsimit, të anketuarit që kanë të kryer së paku arsim të lartë dyvjeçar ose universitar, në përqindje më të lartë (34.6%) kanë deklaruar se financimi joligjor i partive është shumë i pranishëm. Shqiptarët etnik në përqindje më të lartë (38.3%) konsiderojnë se financimi joligjor te partitë politike është shumë i pranishëm, për dallim nga maqedonasit etnik (29.3%) dhe pjesëtarët e bashkësive të tjera etnike (36.8%).




Grafiku 8: A mendoni se financimi joligjor është i pranishëm te partitë politike?/sipas arsimit të të anketuarve

Pastaj, është analizuar edhe perceptimi i të anketuarve për financimin e partive politike me qëllim që të fitohet kundërshtëpërblim prej tyre dhe janë fituar këto rezultate:



Grafiku 9: Sa është e përhapur praktika që partitë të financohen që të fitohet kundërshtëpërblim prej tyre?

Sipas përgjigjeve, mbi 2/3 e të anketuarve konsiderojnë se praktika që partitë të financohen që të fitohet ndonjë kundërshtëpërblim prej tyre është shumë e përhapur ose mesatarisht e përhapur, ndërsa 26.8% konsiderojnë se praktika e tillë është pak e përhapur pak ose aspak nuk është e përhapur.




Grafiku 10: Sa është e përhapur praktika që partitë të financohen që të fitohet kundërshtëpërlim prej tyre?/sipas arsimit të të anketuarve

Duke i pasur parasysh karakteristikat socio-demografike, shkalla e perceptimit për këtë dukuri është shumë e përhapur dhe rritet në mënyrë proporcionale me moshën e të anketuarve. Kështu, 25.9% e të anketuarve të moshës prej 18 deri në 29 vjet, janë përgjigjur se praktika që të financohen partitë për të fituar kundërshtëpërlim prej tyre është shumë e përhapur, 33.0% e të anketuarve të moshës prej 50 deri në 64 vjet e kanë të njëjtin mendim, ndërsa te të anketuarit e moshës mbi 65 vjeçare kjo përqindje është madje 35.5%.

Pastaj, perceptimin se kjo dukuri është shumë e përhapur, në përqindje më të lartë e kanë ata që kanë të kryer së paku arsim të lartë ose universitar (34.3%), me të cilën gjë pajtohen edhe 30.5% e personave që kanë të kryer arsim të mesëm, gjegjësisht 26.8% e atyre me mësim fillor.

3.2. KORRUPSIONI TE PARTITË POLITIKE GJATË ZGJEDHJEVE, FINANCIMI I FUSHATAVE ZGJEDHORE DHE BLERJA E VOTAVE


Që të fitohet një pasqyrë për shkallën dhe format e korrupsionit me të cilat shërbehen partitë politike, duhet të hulumtohet edhe perceptimi i qytetarëve për sjelljen e partive politike gjatë zgjedhjeve. Nga të anketuarit është kërkuar të përgjigjen se a mendojnë se financimi i partive për fushatat zgjedhore është ligjor dhe transparent, dhe nëse po, në çfarë shkalle.



Grafiku 11: A do të thoshit se financimi i partive politike për fushatat zgjedhore është:

Rezultatet tregojnë se 56.0% e të anketuarve konsiderojnë se financimi i partive politike për fushatat zgjedhore është jotransparent dhe joligjor, për dallim nga 35.8% të cilët konsiderojnë se ai është transparent dhe ligjor. Megjithatë, duhet përsëri të potencohet dallimi në përgjigjet e dhëna nga dy ekstremet. Në fakt, vetëm 6.8% e të anketuarve konsiderojnë se financimi i fushatave zgjedhore të partive është plotësisht transparent dhe ligjor, ndërsa 28.2% konsiderojnë se financimi është krejtësisht jotransparent dhe joligjor.

Sipas karakteristikave socio-demografike të të anketuarve, meshkujt në përqindje më të lartë (33.1%) konsiderojnë se fushatat zgjedhore financohen krejtësisht në mënyrë joligjore dhe jotransparente, për dallim nga 23.9% të grave që e ndajnë mendimin e njëjtë. Pastaj, perceptimi për shkallën e financimit joligjor dhe jotransparent të partive gjatë fushatave zgjedhore rritet me moshën e të anketuarve, dhe kështu, në qoftë se 23.8% e të anketuarve të moshës prej 18 deri në 29 vjet konsiderojnë se financimi është krejtësisht joligjor dhe jotransparent, madje 35.5% e atyre që janë më të vjetër se 65 vjet e kanë mendimin e njëjtë.




Grafiku 12: A do të thoshit se financimi i partive politike për fushatat zgjedhore është:/sipas moshës së të anketuarve

Pastaj, madje 37.1% e shqiptarëve etnik konsiderojnë se financimi i partive gjatë fushatave zgjedhore është krejtësisht joligjor dhe jotransparent, për dallim nga 34.0% e pjesëtarëve të bashkësive të tjera etnike dhe 23.1% e maqedonasve etnik, të cilët janë përgjigjur në mënyrë të njëjtë.

Korrupsioni i partive politike gjatë zgjedhjeve nuk ka të bëjë vetëm me mënyrën e financimit të tyre gjatë fushatës parazgjedhore. Jo rrallë, partitë politike përpiqen edhe t'i blejnë votuesit në periudhën parazgjedhore me qëllim që si kundërshpërblim ta fitojnë votën e tyre dhe me këtë t'i rrisin gjasat e tyre për sukses në zgjedhje. Format e mitës (ryshfetit) të cilat i shfrytëzojnë partitë politike janë nga më të ndryshmet, duke filluar nga shpërblimet e njëhershme materiale e deri te premtimet për punësim ose ndonjë lloj tjetër të shërbimit.


Me qëllim që të fitohen informata se a e përdorin partitë politike në vendin tonë ndonjëherë nga këto metoda korruptive, të anketuarve në këtë hulumtim iu parashtrua kjo pyetje: "Sa është i pranishëm korrupsioni (blerja) e trupit votues në zgjedhjet në vend?". U fituan këto rezultate:



Grafiku 13: Sa është i pranishëm korrupsioni (blerja) e trupit votues në zgjedhjet në vend?

Sipas rezultateve të fituara, mbi 2/3 ose më saktë 67.7% e të anketuarve konsiderojnë se gjatë zgjedhjeve, blerja e votave është shumë e pranishme ose mesatarisht e pranishme, përballë 28.8% të të anketuarve, të cilët konsiderojnë se blerja e votave është pak e pranishme ose aspak nuk është e pranishme. Pastaj, madje 40.6% e të anketuarve janë përgjigjur se praktika e këtillë është shumë e pranishme, përballë vetëm 8.2% të të anketuarve që janë përgjigjur se praktika e blerjes së votave aspak nuk është e pranishme gjatë zgjedhjeve.

Se praktika e blerjes së votave është shumë e pranishme, në përqindje më të lartë (49.2%) konsideron popullata me moshë më të re (18 – 29 vjet), pastaj ata që jetojnë në fshat (45.2%), si dhe pjesëtarët e bashkësive të tjera etnike, por edhe shqiptarët etnik, gjysma e të cilëve konsiderojnë se praktika e blerjes së votave gjatë zgjedhjeve është dukuri shumë e pranishme.



Grafiku 14: Sa është i pranishëm korrupsioni (blerja) e trupit votues në zgjedhjet në vend?/sipas përkatësisë etnike të të anketuarve

Sipas hulumtimeve që e masin ekspozimin e qytetarëve ndaj blerjes së votave të tyre nga ana e partive politike, mund të vërehet se qytetarët që jetojnë në mjediset rurale, ata që kanë të ardhura më të vogla, si dhe ata me nivel më të ulët të arsimit, shumë më shpesh janë të ekspozuar ndaj blerjes së votës së tyre nga ana e partive politike ose kandidatëve gjatë zgjedhjeve.²⁸


28 UNODC: Korrupsioni në vend: Mita e përjetuar nga qytetarët, 2011.

4. PERCEPTIMI PËR PËRHAPJEN E KORRUPSIONIT TE PUSHTETI QENDROR DHE AI LOKAL

4.1. PERCEPTIMI PËR PËRHAPJEN E KORRUPSIONIT TE QEVERIA

Duke e pasur parasysh perceptimin e përhapur në masë të madhe për ekzistimin e korrupsionit në organet e pushtetit në pothuajse të gjitha vendet e botës, në këtë hulumtim është bërë përpjekje që të matet perceptimi i qytetarëve të vendi tonë.


Në pyetjen “Sipas jush, sa është i pranishëm korrupsioni në Qeverinë e vendit?” përgjigjet janë dhënë në këtë mënyrë:



Grafiku 15: Sipas jush, sa është i pranishëm korrupsioni në secilin prej segmenteve të përmendura të sistemit në vend: Qeverinë e vendit?

Shihet se 42.2% e të anketuarve konsiderojnë se korrupsioni në Qeverinë e vendit është i pranishëm në masë të madhe. Gjithashtu, duhet të merret parasysh edhe fakti se pothuajse 1/3 e të anketuarve konsiderojnë se në qeveri ka korrupsion në nivel mesatar, ndërsa 10.1% janë përgjigjur se në qeveri nuk ka aspak korrupsion. Perceptimi për ekzistimin e korrupsionit në pushtetin ekzekutiv është relativisht i lartë edhe te vendet e tjera të rajonit. Në fakt, sipas hulumtimit të realizuar nga organizata ndërkombëtare Gallup, të anketuarit në vendet e rajonit, pothuajse pa përjashtim, konsiderojnë se korrupsioni i qeverisë në vendin e tyre është i përhapur në masë të madhe.²⁹

Në bazë të karakteristikave socio-demografike janë fituar këto rezultate:




Grafiku 16: Sipas jush, sa është i pranishëm korrupsioni në secilin prej segmenteve të përmendura të sistemit në vend: Qeverinë e vendit?"/sipas arsimit

²⁹ <http://www.balkan-monitor.eu/index.php/dashboard>


Siç mund të vërehet edhe nga vetë grafiku, përqindja më e lartë e të anketuarve që kanë të kryer arsim të lartë dyvjeçar ose universitar (47.7%) konsiderojnë se në qeveri ka shumë korrupsion, përballë atyre me arsim të mesëm (39.1%) dhe fillor (41.7%), të cilët në përqindje më të ulët pajtohen me deklaratën e njëjtë.

Përveç kësaj, karakteristike është edhe ajo se shqiptarët etnik në një përqindje shumë më të lartë konsiderojnë se ka korrupsion në Qeverinë e vendit. Në fakt, madje 60.6% e tyre janë përgjigjur se në qeveri ka shumë korrupsion, për dallim nga 35.7% e maqedonasve etnik dhe 42.6% e pjesëtarëve të bashkësive të tjera etnike që janë përgjigjur në mënyrë të njëjtë. Poashtu, duhet potencuar edhe të dhënë se mbi 25% e maqedonasve etnik konsiderojnë se ka pak ose nuk ka aspak korrupsion në qeveri, ndërsa ajo përqindje te shqiptarët etnik është dukshëm më e vogël dhe është 8.7%.



Grafiku 17: Sipas jush, sa është i pranishëm korrupsioni në secilin prej segmenteve të përmendura të sistemit në vend: Qeverinë e vendit?/sipas përkatësisë etnike


Pastaj, të anketuarit që nuk janë anëtarë të asnjë partie politike në përqindje më të madhe (44.6%) janë përgjigjur se te qeveria ka shumë korrupsion, për dallim nga ata që janë anëtarë të ndonjë partie politike, prej të cilëve 37.1% pajtohen me këtë deklaratë.



Grafiku 18: Sipas jush, sa është i pranishëm korrupsioni në secilin prej segmenteve të përmendura të sistemit në vend: Qeverinë e vendit?/sipas anëtarësisë në ndonjë parti politike

4.2. PERCEPTIMI PËR PËRHAPJEN E KORRUPSIONIT NË PUSHTETIN LOKAL


Me qëllim që të matet perceptimi i qytetarëve për ekzistimin e korrupsionit në pushtetin lokal, të anketuarve iu parashtrua pyetja: “Sipas jush, sa është i pranishëm korrupsioni në pushtetin lokal?”. Të anketuarit u përgjigjën në këtë mënyrë:



Grafiku 19: Sipas jush, sa është i pranishëm korrupsioni në secilin prej segmenteve të përmendura të sistemit në vend: Pushtetin lokal?

Mund të vërehet se pothuajse gjysma e të anketuarve (49.6%) konsiderojnë se te pushteti lokal ka shumë korrupsion, ndërsa vetëm 7.6% konsiderojnë se aspak nuk ka korrupsion. Kjo është një e dhënë brengosëse, nëse merret parasysh fakti se pushteti lokal menaxhon me problemet lokale dhe komunale të komunave, me ç’rast qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë i ndjejnë pasojat dhe rezultatet e korrupsionit.


Gjithashtu, mund të konstatohet se të anketuarit që kanë të kryer së paku arsim të lartë dyvjeçar ose universitar, në përqindje më të lartë (51.7%) konsiderojnë se te pushteti lokal ka shumë korrupsion, por edhe në përqindje më të vogël (5.5%) konsiderojnë se nuk ka aspak korrupsion. Të anketuarit që i takojnë popullatës me moshë më të re (18 - 29 vjet), për dallim nga grupmoshat e tjera, në një përqindje pak më të lartë (41.6%) konsiderojnë se në pushtetin lokal ka shumë korrupsion.



Grafiku 20: Sipas jush, sa është i pranishëm korrupsioni në secilin prej segmenteve të përmendura të sistemit në vend: Pushtetin lokal?/sipas moshës së të anketuarve

Pastaj, të anketuarit që jetojnë në qytet, në përqindje më të lartë (52.7%) konsiderojnë se te pushteti lokal ka shumë korrupsion, për dallim nga ata që jetojnë në fshat, 45% e të cilëve e kanë perceptimin e njëjtë. Nga ana tjetër, maqedonasit etnik, në përqindje më të lartë (51.1%)

pajtohen me këtë deklaratë, për dallim nga 46.2% e shqiptarëve etnik dhe 45.6% e pjesëtarëve të bashkësive të tjera etnike.



Grafiku 21: Sipas jush, sa është i pranishëm korrupsioni në secilin prej segmenteve të përmendura të sistemit në vend: Pushtetin lokal?/sipas përkatësisë etnike të të anketuarve

Duke i analizuar rezultatet sipas rajoneve, vërehet se të anketuarit e rajonit të Pellagonisë në përqindje më të lartë (58.4%) konsiderojnë se në pushtetin lokal ka shumë korrupsion, e pastaj vijnë rajoni Verilindor (52.9%), rajoni i Vardarit (52.5%) dhe rajoni i Shkupit (50.7%). Megjithatë, në të gjitha rajonet e vendit ka përqindje relativisht të lartë të bindjes se pushteti lokal është i korruptuar.

Tabela 2: Sipas jush, sa është i pranishëm korrupsioni në secilin prej segmenteve të përmendura të sistemit në vend: Pushtetin lokal?/sipas rajoneve

	Shumë	Mesatarisht	Pak	Nuk ka korrupsion	Nuk e di / P.P.
Verilindor	52.9%	30.6%	4.7%	8.2%	3.5%
Lindor	44.3%	27.4%	17.0%	9.4%	1.9%
Juglindor	41.5%	36.2%	8.5%	8.5%	5.3%
I Shkupit	50.7%	26.2%	9.9%	7.9%	5.3%
I Pollogut	49.4%	29.1%	17.1%	2.5%	1.9%
I Pellagonisë	58.4%	23.4%	7.3%	8.8%	2.2%
I Vardarit	52.5%	28.8%	7.5%	8.8%	2.5%
Jugperëndimor	43.9%	27.6%	15.4%	8.9%	4.1%

5. MËNYRA SE SI BARTËSIT E FUNKSIONEVE PUBLIKE I SHFRYTËZOJNË AUTORIZIMET PUBLIKE

Që të fitohet një pasqyrë e plotë për ekzistimin dhe përhapjen e korrupsionit në politikë, hulumtimi është realizuar jo vetëm në nivel institucional, por edhe në nivel individual.


Kështu, të anketuarve iu parashtruan pyetje që kanë të bëjnë me mënyrën se si njerëzit që janë në pushtet i kryejnë funksionet publike në vend. Konkretisht, pyetjet kishin të bëjnë me atë se a e shfrytëzojnë njerëzit që janë në pushtet funksionin e tyre për interesin e tyre personal, a marrin mitë, a sillen si të paprekshëm nga ligji dhe organet kompetente, a e kryejnë punën e besuar vetëm në interes publik, a e paraqesin realisht gjendjen e tyre pronësore dhe a përpiqen të jenë shembull pozitiv në mjedisin e tyre të punës dhe atë privat.

Tabela 3: Sa nga njerëzit që janë në pushtet e bëjnë këtë?

	Numri më i madh	Shumica	Vetëm disa	Askush	Nuk e di / P.P.
E shfrytëzojnë pushtetin për interesin e tyre personal	42.8%	30.8%	23.5%	2.4%	0.5%
Marrin mitë	24.0%	31.4%	35.0%	4.4%	5.2%
Sillen sikur janë të paprekshëm nga ligji dhe organet kompetente	26.9%	31.8%	34.7%	3.8%	2.8%
Punën e besuar e kryejnë vetëm në interes publik	13.1%	30.3%	44.1%	9.4%	3.1%
Realisht e paraqesin gjendjen e tyre pronësore	4.5%	11.1%	39.0%	43.1%	2.3%
Përpiqen të jenë shembull pozitiv në mjedisin e tyre të punës dhe atë privat	16.0%	29.2%	39.4%	13.4%	1.9%

Siç mund të shihet nga tabela e mësipërme, madje 42.8% e të anketuarve në këtë hulumtim konsiderojnë se njerëzit në pushtet e shfrytëzojnë atë për interesin e tyre personal. Gjithashtu, e lartë është edhe përqindja (30.8%) e atyre që konsiderojnë se shumica e njerëzve në pushtet i keqpërdorin autorizimet publike për qëllime personale. Pastaj, pothuajse çdo i anketuar i katërt (24.0%) konsideron se numri më i madh i njerëzve marrin ryshfet, ndërsa 31.4% janë përgjigjur se shumica e njerëzve në pushtet e bëjnë të njëjtën. Vetëm 3.8% e të anketuarve konsiderojnë se asnjë nga ata që kryejnë funksione publike nuk sillet si i paprekshëm nga ligji dhe organet kompetente, e gjithashtu, në nivel të ulët brengosës është edhe përqindja (13.1%) e të anketuarve që konsiderojnë se njerëzit në pushtet punën e besuar e kryejnë vetëm në interes publik. Pastaj, e ulët është edhe përqindja (4.5%) e të anketuarve që konsiderojnë se ata që janë në pushtet realisht e paraqesin gjendjen e tyre pronësore, ndërsa 16.0% konsiderojnë se funksionarët përpiqen të jenë shembull pozitiv në mjedisin e tyre të punës dhe atë privat.

Që të çrrënjoset korrupsioni në politikë në një vend, është shumë me rëndësi që njerëzit që kryejnë funksione publike t'i respektojnë edhe standardet etike që dalin nga funksioni që e kryejnë. Prandaj, të anketuarve iu parashtrua pyetja: “Në krahasim me periudhën e mëparshme, a respektohen sot standardet etike nga ana e bartësve të funksioneve publike?”. Të anketuarit u përgjigjën në këtë mënyrë:



Grafiku 22: Në krahasim me periudhën e mëparshme, a respektohen sot standardet etike (morale) nga ana e bartësve të funksioneve publike?

Siç mund të vërehet, përqindja më e lartë (51.1%) e të anketuarve konsiderojnë se standardet etike sot respektohen më pak nga funksionarët, në krahasim me periudhën e mëparshme, për dallim nga ata që konsiderojnë se standardet etike sot respektohen më shumë (45.9%). Megjithatë, duhet të merren parasysh përgjigjet e dy ekstremeve në pyetjen e parashtruar. Në fakt, çdo i anketuar i katërt (25.8%) konsideron se standardet etike sot respektohen më pak se sa më parë, ndërsa vetëm 11.0% konsiderojnë se standardet etike sot respektohen shumë më tepër nga ana e bartësve të funksioneve publike në krahasim me periudhën e mëparshme.

6. KONTRIBUTI I ORGANEVE DHE I INSTITUCIONEVE NË PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT NË POLITIKË

Një sërë institucioneve në vend, sikurse edhe në vendet e tjera, kanë kompetencë të luftojnë kundër korrupsionit në politikë. Me qëllim që të kuptohet se si qytetarët në vendin tonë e ranojnë rolin e të gjitha këtyre subjekteve për nga rëndësia, në këtë hulumtim u parashtrua edhe pyetja se cili nga organet e përmendura, sipas tyre, mund të kontribuojë më së shumti në parandalimin e korrupsionit në politikë.




Grafiku 23: Cili nga këto organe mund të kontribuojë më së shumti në parandalimin e korrupsionit në sektorin politik?

Edhe pse kompetencat e institucioneve të përmendura në luftën kundër korrupsionit janë të ndryshme, bie në sy përçindja e lartë e të anketuarve që janë përgjigjur se asnjë institucion nuk mund të kontribuojë në parandalimin e korrupsionit në politikë. Madje 20.5% e të anketuarve konsiderojnë se asnjë institucion nuk mund të luftojë në mënyrë efikase kundër kësaj dukurie.

7. A KA SOT MË TEPËR OSE MË PAK KORRUPSION NË POLITIKË NË KRAHASIM ME PERIUdhËN PREJ PARA 4 VITESH

Pjesë e treguesve të përgjithshëm për luftën kundër korrupsionit në politikë në çdo vend duhet të jetë edhe ndjenja e qytetarëve se ka më pak korrupsion se sa më parë dhe se në bazë të kësaj, institucionet dhe bartësit e funksioneve publike i kryejnë autorizimet e tyre në mënyrë ligjore dhe transparente.

Me qëllim që të zbulohet niveli i perceptimit të këtillë, të anketuarve në këtë hulumtim iu parashtrua edhe pyetja: “Sipas jush, korrupsioni në politikë në vend, në krahasim me periudhën prej para 4 vitesh: është zvogëluar dukshëm, është zvogëluar pak, është njëloj sikurse para 4 vitesh, është rritur pak ose është rritur dukshëm?”




Grafiku 24: Sipas jush, korrupsioni në politikë në vend, në krahasim me periudhën prej para 4 vitesh: është zvogëluar dukshëm, është zvogëluar pak, është njëloj sikurse para 4 vitesh, është rritur pak ose është rritur dukshëm?

Sipas rezultateve të fituara, 40% e të anketuarve konsiderojnë se në krahasim me periudhën prej para 4 vitesh, sot korrupsioni në politikë është zvogëluar, 26.0% konsiderojnë se ai është në nivel të njëjtë, ndërsa 32.1% konsiderojnë se ai është rritur. Pastaj, 13.3% e të anketuarve konsiderojnë se korrupsioni në politikë është zvogëluar dukshëm, për dallim nga 19.4% e të anketuarve që konsiderojnë se në krahasim me periudhën prej para 4 vitesh, sot korrupsioni është rritur dukshëm.


Kur do të merren parasysh karakteristikat socio-demografike të të anketuarve, mund të vërehet se nuk ka ndonjë dallim të theksuar ndërmjet perceptimit të meshkujve dhe femrave kur bëhet fjalë për këtë çështje. Sa i përket moshës së të anketuarve, mund të vërehet se popullata më e moshuar (mbi 65 vjet) në përqindje më të lartë (14.2%) janë përgjigjur se sot ka dukshëm më pak korrupsion, mirëpo në të njëjtën kohë, kjo popullatë në përqindje më të lartë (24.1%) është përgjigjur se sot ka dukshëm më tepër korrupsion në politikë në krahasim me periudhën prej para 4 vitesh. Për t'u theksuar janë edhe dallimet në perceptimin e të anketuarve sipas nivelit

të arsimit. Të anketurit që kanë të kryer më shumti shkollë fillore ose më pak, në përqindje më të ulët (9.5%) konsiderojnë se niveli i korrupsionit sot është zvogëluar dukshëm, ndërsa 23.2% e të anketuarve të kësaj kategorie konsiderojnë se niveli i korrupsionit sot është rritur dukshëm.




Grafiku 25: Sipas jush, korrupsioni në politikë në vend, në krahasim me periudhën prej para 4 vitesh: është zvogëluar dukshëm, është zvogëluar pak, është njëlloj sikurse para 4 vitesh, është rritur pak ose është rritur dukshëm?/sipas arsimit të të anketuarve

Sipas përkatësisë etnike të të anketuarve, mund të vërejmë se maqedonasit etnik në përqindje më të lartë (46.6%) konsiderojnë se korrupsioni në politikë është zvogëluar në krahasim me periudhën prej para 4 vitesh, ndërsa shqiptarët etnik në përqindje më të lartë (45.1%) konsiderojnë se niveli i korrupsionit sot, është rritur në krahasim me periudhën prej para 4 vitesh.



Grafiku 26: Sipas jush, korrupsioni në politikë në vend, në krahasim me periudhën prej para 4 vitesh: është zvogëluar dukshëm, është zvogëluar pak, është njëlloj sikurse para 4 vitesh, është rritur pak ose është rritur dukshëm?/sipas përkatësisë etnike të të anketuarve

Për t’u theksuar janë edhe rezultatet nga përgjigjet e të anketuarve në bazë të anëtarësisë së tyre në ndonjë parti politike. Në fakt, pothuajse çdo anëtar i dytë i ndonjë partie politike (49.2%) konsideron se niveli i korrupsionit sot është zvogëluar, për dallim nga 29.2% të tyre që konsiderojnë se ky nivel është rritur. Nga ana tjetër, në qoftë se analizohen rezultatet e përgjigjeve të atyre që nuk janë anëtarë të ndonjë partie politike, mund të vërehen qëndrime kryesisht të balancuara. Në fakt, 36.0% e këtyre të anketuarve konsiderojnë se niveli i korrupsionit sot është zvogëluar, 33.6% se është rritur, ndërsa 28.3% se niveli i korrupsionit në politikë sot është njëlloj sikur para 4 vitesh.



Grafiku 27: Sipas jush, korrupsioni në politikë në vend, në krahasim me periudhën prej para 4 vitesh: është zvogëluar dukshëm, është zvogëluar pak, është njëlloj sikurse para 4 vitesh, është rritur pak ose është rritur dukshëm?/sipas anëtarësisë së të anketuarve në ndonjë parti politike

Duke i pasur parasysh rezultatet deri të të cilat erdhëm, mund të përfundojmë se të anketuarit në një përqindje pak më të lartë konsiderojnë se niveli i korrupsionit sot është zvogëluar në krahasim me periudhën prej para 4 vitesh. Megjithatë, duhet të merret parasysh fakti se pothuajse çdo i treti i anketuar konsideron se niveli i korrupsionit në politikë sot është rritur, ndërsa çdo i katërti konsideron se niveli i korrupsionit ka mbetur në nivelin e njëjtë.

PËRFUNDIME

1. Hulumtimi i konfirmoi rreziqet e konstatuara për korrupsionin politik në vend në Programin shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave për periudhën 2011-2015.
2. Sipas perceptimit të qytetarëve, te partitë politike dhe institucionet e pushtetit qendror dhe atij lokal, ka korrupsion të përhapur në masë të madhe.
3. Partitë politike në vend (siç është rasti edhe në të gjitha vendet e rajonit, por edhe më gjerë në botë) nga ana e qytetarëve perceptohen si institucione ku korrupsioni është i përhapur në masë të madhe.
4. Vetëm 10% e qytetarëve konsiderojnë se derisa janë në pushtet, partitë i mbrojnë interesat e qytetarëve, 24% konsiderojnë se ato i mbrojnë para së gjithash, sponsorët e pasur, ndërsa 43% konsiderojnë se ato e mbrojnë vetëm interesin e ngushtë partiak.
5. Sipas qytetarëve të anketuar, në masë të madhe është e përhapur bindja se motiv kryesor për financimin e partive politike është fitimi i kundërshtëpërblyerit prej tyre.
6. Dy të tretat e të anketuarve konsiderojnë se financimi joligjor i partive në vend është i përhapur gjerësisht.
7. Mbi 56% e qytetarëve konsiderojnë se financimi i fushatave zgjedhore në vend është kryesisht ose plotësisht jotransparent dhe joligjor, ndërsa mbi dy të tretat ose 68% e të anketuarve mendojnë se partitë shfrytëzojnë sasi të konsiderueshme parash ose shumë para për t'i korruptuar votuesit.
8. Përshtypja për nivelin e lartë të financimit joligjor të partive politike te të anketuarit është rezultat i drejtpërdrejtë i faktit që ka shkallë të ulët të transparencës së financimit dhe të punës financiare të partive politike.

-
9. Perceptimi i qytetarëve të anketuar për moralin dhe sjelljen e bartësve të pushtetit është i pakënaqshëm.
 10. Çdo i anketuar i pestë është i bindur se askush nuk mund ta parandalojë korrupsionin politik në vend.
 11. Matja e perceptimit për efikasitetin në luftën për parandalimin e korrupsionit politik tregoi se 40% e të anketuarve besojnë se sot ka më pak korrupsion politik se sa para 4 vitesh. 32% janë të bindur në të kundërtën, gjegjësisht se ka më shumë korrupsion se sa para 4 vitesh dhe 26% konsiderojnë se niveli i korrupsionit politik nuk ka ndryshuar gjatë 4 viteve të kaluara.
 12. Hulumtimi konfirmoi se gjatë vlerësimit të sukseshmërisë në ballafaqimin me korrupsionin janë fituar përgjigje me konotacion partiak. Në fakt, anëtarët e partive politike kanë deklaruar se gjendja është përmirësuar, ndërsa ata që nuk janë anëtarë të ndonjë partie politike janë përgjigjur se gjendja është përkeqësuar. Hulumtimi në tërësi tregoi se qytetarët e anketuar, prej të cilëve 29% janë anëtarë të partive politike, nuk kanë mendim të mirë për shumicën e personave që janë bartës të funksioneve publike. Konstatimi kyç ka të bëjë me moralin e ulët, nivelin e lartë të përhapjes dhe të mosndëshkimit të korrupsionit politik, si dhe me besimin e ulët se ekzistojnë masa efikase për parandalimin e tij.

BIBLIOGRAFIA DHE HULUMTIMET E SHFRYTËZUARA:

- J. S. Nye, „*Political Corruption: a Cost-Benefit Analysis*“ in A. J. Heidenheimer, M. Johnston and V. LeVine, *Political Corruption: a Handbook* (New Brunswick NJ, Transaction, 1989).
- J. Heidenheimer, *Political Corruption: A Handbook*, Transaction Publishers, 1989.
- Amundsen, *Political Corruption: An Introduction to the Issues*, Chr. Michelsen Institute Development Studies and Human Rights, 1999.
- P. Heywood, *Political Corruption: Problems and Perspectives*. Political Studies, 45
- http://www.transparency.org/topic/detail/politics_and_government
- Transparency International: Global Corruption Barometer 2013
- Transparency International: *Buying Influence: Money and Elections in the Balkans*, 2013.
- UNODC: *Korrupsioni në vend: Mita e përjetuar nga qytetarët, 2011*.
- Transparency International: *Blerja e ndikimit: Paratë dhe politika në vend, 2013*.
- <http://www.balkan-monitor.eu/index.php/dashboard>
- <http://www.transparency.org/gcb2013>
- [http://www.transparency.org/gcb2013/country?country=macedonia_\(fyr\)](http://www.transparency.org/gcb2013/country?country=macedonia_(fyr))
- <http://www.transparency.org/gcb2013/country?country=croatia>
- <http://www.transparency.org/gcb2013/country?country=albania>
- <http://www.transparency.org/gcb2013/country?country=kosovo>
- <http://www.transparency.org/gcb2013/country?country=bulgaria>
- http://www.transparency.org/gcb2013/country?country=bosnia_and_herzegovina
- <http://www.transparency.org/gcb2013/country?country=serbia>
- http://www.transparency.org/gcb2013/country?country=united_states

3. HULUMTIM PËR KORRUPSIONIN NË VETËQEVERISJEN LOKALE

RAPORT NARATIV

1. HYRJE

Decentralizimi i pushtetit është një nga përfitimet më të rëndësishme të sistemeve politike demokratike. Nëpërmjet tij, procesi i vendimmarrjes afrohet te qytetarët, duke u mundësuar atyre pjesëmarrje më të madhe gjatë krijimit të politikave me rëndësi lokale. Bartja e kompetencave të caktuara nga pushteti qendror te ai lokal është cilësi thelbësore që e mundëson realizimin e suverenitetit të qytetarëve edhe në nivel lokal.

Por, me rritjen e kompetencave të vetëqeverisjes lokale, njëkohësisht rriten edhe mundësitë për sjellje korruptive te bartësit e funksioneve publike në kuadër të saj. Dukuria e korrupsionit te vetëqeverisja lokale paraqet një problem tejet serioz nëse merret parasysh fakti se qytetarët në mënyrë më të drejtpërdrejtë i ndejnë pasojat dhe rezultatet e punës së saj.

Mu për këto arsye, duhet të hulumtohen kushtet dhe shkaqet që dërgojnë në paraqitjen e korrupsionit te vetëqeverisja lokale, për shkak se vetëm në atë mënyrë ka mundësi që ai të neutralizohet duke implementuar politika adekuate.

Sipas Robert Klitgardit, më thjeshtë, korrupsioni mund të definohet si “shumë e monopolit të fuqisë (pushtetit) dhe diskrecionit gjatë marrjes së vendimeve minus llogaridhënia”³⁰. Në kuptim më të gjerë, korrupsioni mund të definohet si “sjellje e bartësve të funksioneve publike me të cilën keqpërdoret pushteti i dhënë, me qëllim që të fitohet dobi personale”.³¹ Në kuadër të vetëqeverisjes lokale, qytetarët i zgjedhin organet e pushtetit lokal me qëllim që ato t’i kryejnë funksionet të cilat ju janë dhënë për ta realizuar interesin publik. Korrupsioni paraqitet atëherë kur bartësit e funksioneve publike i shfrytëzojnë autorizimet publike që të ndikojnë në shpërndarjen e resurseve komunale në mënyrë që është e kundërt me aktet ligjore, me qëllim që të fitohet dobi personale.³²

Që të kemi pasqyrë më të qartë për korrupsionin në vetëqeverisjen lokale, duhet atë ta ndjekim edhe nëpërmjet formave dhe llojeve të tij.

Përveç mitës, shantazhit dhe nepotizmit, të cilat paraqiten në të gjitha nivelet e politikës në një shoqëri, organizata ndërkombëtare “Transparency International”, në publikimin e saj të fundit³³, thekson disa lloje të veprimeve korruptive që janë karakteristike për vetëqeverisjen lokale. Korrupsioni në nivel lokal më shpesh paraqitet si:

- *Marrëveshje e fshehtë* ndërmjet dy palëve në sektorin publik dhe/ose atë privat, për të ndërmarrë aktivitete të mashtrimit ose të shpërdorimit, që për qëllim përfundimtar ka fitimin e dobisë së paligjshme financiare.
- *Konflikt i interesave* që paraqitet atëherë kur individit që ka funksion publik ballafaqohet me konflikt ndërmjet kompetencave dhe obligimeve të tij nga njëra anë, dhe interesave të tij personale nga ana tjetër.
- *Mashtrim*, që paraqet akt të mashtrimit të qëllimshëm të dikujt, me qëllim që mashtruesi të fitojë ndonjë dobi financiare, politike ose të ndonjë lloji tjetër.
- *Dhurim i të mirave materiale* personave me autorizime publike, me qëllim që të ndikohet në rezultatin përfundimtar gjatë ndarjes së resurseve publike ose gjatë nënshkrimit të kontratave për furnizime publike, në dobi të atyre që japin dhurata.

30 http://www.icgg.org/downloads/contribution02_klitgaard.pdf

31 Transparency International: Corruption Perception Index 2011

http://www.transparency.org/cpi2011/in_detail

32 Corruption in UK Local Government: The Mounting Risks. Transparency International UK, October 2013. fq.12

33 Po aty. fq: 16 - 18

- *Keqpërdorim i pozitës*, është akt me të cilin ai që ka funksion publik i shfrytëzon informatat deri te të cilat vjen si rezultat i pozitës së tij, për të fituar ndonjë privilegj ose dobi personale.
- *Lobim joligjor*, gjegjësisht ndikim që bëhet në mënyrë *jotransparente*, që e bëjnë kompanitë, organizatat dhe individët mbi bartësit e autorizimeve publike, me qëllim që të miratojnë politika në dobi të tyre, ku është përfshirë edhe realizimi i dobisë së paligjshme materiale.

Dukuria e korrupsionit në kuadër të vetëqeverisjes lokale është problem global. Me të ballafaqohen edhe vendet me traditë të madhe demokratike dhe me mekanizëm të zhvilluar institucional për zbulimin e keqpërdorimeve që i bëjnë bartësit e funksioneve publike. Megjithatë, korrupsioni në vetëqeverisjen lokale paraqitet atëherë kur bartësit e funksioneve publike kanë mundësi më të madhe të kenë diskrecion në procesin e vendimmarrjes, ose të jenë instanca e vetme që ka kompetencë për të marrë ndonjë vendim. Mekanizmi i pazhvilluar sa duhet për parandalimin e sjelljes korruptive aq edhe kontribuon që funksionarët të inkurajohen se sjellja e tyre joligjore do të kalojë pa u vërejtur dhe pa u ndëshkuar.³⁴ Në kushte kur mungon përgjegjësia, bartësit e funksioneve publike kanë mundësi ta keqpërdorin pushtetin për përfitim personal. Mu për këto arsye, ka nevojë për rregullativë cilësore ligjore dhe institucione funksionale që do ta zbatojnë atë, për shkak se vetëm në atë mënyrë bëhet e mundur që funksionarët t'i kryejnë autorizimet e tyre në mënyrë të përgjegjshme dhe transparente.

QËLLIMET E HULUMTIMIT

Qëllimet kryesore të këtij hulumtimi të bazuar në perceptimin e qytetarëve, janë të mblidhen informata dhe të dhëna për këto çështje:

- Nivelin dhe format e korruptimit të organet e vetëqeverisjes lokale në bazë të perceptimit të qytetarëve për ekzistimin dhe përhapjen e tij;
- Shkallën e informimit të qytetarëve për punën e vetëqeverisjes lokale, si dhe shkallën e kënaqësisë nga mënyra e funksionimit të saj;
- Ekspozimi i drejtpërdrejtë i qytetarëve ndaj aktiviteteve korruptive të organet e vetëqeverisjes lokale dhe bartësit e autorizimeve publike në nivel lokal;
- Gatishmëria e qytetarëve të denoncojnë korruptimin të organet kompetente dhe kënaqësia nga efikasiteti i tyre;
- Niveli i korruptimit në vetëqeverisjen lokale sot, në krahasim me periudhën e njëjtë prej para 2 vitesh.

Ky hulumtim, në mes tjerash, u konceptua edhe në bazë të informatave dhe të dhënave nga hulumtimet e ngjashme nga ana e organizatës së njohur ndërkombëtare “Transparency International”, si dhe në bazë të hulumtimeve lokale, që si subjekt të analizës së tyre e kanë vetëqeverisjen lokale dhe funksionimin e saj.

METODOLOGJIA

Hulumtimi i mendimit publik për korrupsionin në vetëqeverisjen lokale u realizua me metodën e anketës telefonike, në një mostër reprezentative prej 1080 qytetarëve të moshës madhore të pullatës së vendit. Anketa u realizua në periudhën prej 28 tetorit deri më 1 nëntor të vitit 2013.

Deenimi i mostrës reprezentative që i pasqyron qëndrimet e qytetarëve të vendit kaloi nëpër disa procedura sistematike. Për të siguruar mostër reprezentative u respektuan disa procedura

34 Robert Klitgaard: *Controlling Corruption*, University of California Press: 1998

të caktuara gjatë formulimit të saj, që dalin nga rregullat për zgjedhje të rastësishme. Procedura për zgjedhjen e mostrës u bazua në parimin për dezen të mostrës rajonale dhe nacionale, që e definoi rajonin në përputhje me definicionin e tij nga Enti shtetëror për statistikë (NUTS3 the EU16). Në fakt, sipas strukturës gjeo-demografike të popullatës, vendi u nda në tetë rajone: i Shkupit, i Pollogut, i Pellagonisë, i Vardarit, Verilindor, Juglindor, Jugperëndimor dhe Lindor. Pastaj, në këtë mostër, në mënyrë proporcionale u përfshinë të anketuar nga të gjitha 81 komunat, duke e përfshirë edhe popullatën e qyteteve dhe të fshatrave. Numri i të anketuarve u shpërnda në mënyrë proporcionale sipas popullatës së përgjithshme në çdo rajon, duke i shfrytëzuar të dhënat zyrtare nga regjistrimi i popullatës në vitin 2002. Gabimi statistikor për këtë lloj të hulumtimeve është +/- 3%.

Tabela 1: Struktura demografike e mostrës

Struktura demografike e mostrës		%
Rajoni	I Pellagonisë	12.7
	I Vardarit	7.5
	Verilindor	8.2
	Jugperëndimor	11.4
	I Shkupit	27.9
	Juglindor	8.7
	I Pollogut	14.3
	Lindor	9.3
		100
Vendbanimi	Shkup	21.2
	Qytet më i madh	23.1
	Qytet më i vogël	15.7
	Fshat	40.0
		100
Përkatësia etnike	Maqedonas	68.1
	Shqiptarë	24.5
	Tjetër	7.4
		100
Gjinia	Femërore	52.7
	Mashkullore	47.3
		100

Moshë	18 - 29	11.3
	30 -49	36.5
	50 -64	32.0
	Mbi 65	20.2
		100
Arsimi	Fillor dhe më pak	19.9
	I mesëm	47.9
	I lartë, universitar dhe Mr., Dr.	32.2
		100

2. KORRUPSIONI NË VETËQEVERISJEN LOKALE

Në Programin shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit të KSHPK-së për periudhën 2011-2015³⁵, është theksuar se: "Vetëqeverisja lokale si segment në sistemin politik të vendit, sipas kompetencave dhe autorizimeve të saj, ka rol të rëndësishëm në realizimin dhe përmbushjen e lirive dhe të drejtave ligjore të qytetarëve. Futja e decentralizimit dhe bartja e disa kompetencave të rëndësishme nga pushteti qendror në atë lokal dhe faza në të cilën gjendet ky proces, që nënkupton decentralizim edhe në sferën fiskale, dhe gjithashtu edhe menaxhim me pronën që është në pronësi të shtetit, e bëjnë sektorin e vetëqeverisjes lokale të ndjeshëm nga sjellja korruptive".

Në këtë program, gjithashtu është konstatuar se "në detektimin e formave të korrupsionit dhe konfliktit të interesave në vetëqeverisjen lokale janë konstatuar përputhje të gjeneratorëve të korrupsionit në nivel qendror dhe në atë lokal". Si gjeneratorë kryesorë për paraqitjen e korrupsionit dhe konfliktit të interesave në punën e administratës publike në vetëqeverisjen lokale, në programin shtetëror theksohen:

- procedurat që nuk janë rregulluar sa duhet për punën e administratës publike në vetëqeverisjen lokale, që lënë hapësirë për vendime arbitrare
- mungesa e garancave për zbatim të rreptë të procedurave për punë
- mungesa e delegimit të kompetencave (ekzistimi i vendimmarrjes së centralizuar)
- mungesa e vlerësimit të rrezikut nga paraqitja e korrupsionit në administratën publike në nivel lokal dhe mungesa e përgatitjes së planeve për integritet dhe për parandalimin e korrupsionit
- mosbërja publike e punës së administratës komunale, dhe
- mungesa e kontrollit mbi punën e administratës publike

Në bazë të rreziqeve dhe gjeneratorëve të konstatuar për sjellje korruptive në vetëqeverisjen lokale, në programin shtetëror të KSHPK-së për periudhën 2011-2015, janë paraparë një sërë aktivitete dhe masash për zvogëlimin e rreziqeve për korrupsion dhe për parandalimin e korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes lokale.

35 <http://www.dksk.org.mk/images/stories/pdf/drzavna%20programa/dprograma%2026.12.11.pdf>


Në këtë periudhë, sipas programit të KSHPK-së për parandalimin e korrupsionit në nivel lokal, aktivitetet e mëposhtme janë me rëndësi të veçantë:

1. Në njësitë e vetëqeverisjes lokale të insistohet për zbatim konsekuent të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik, sa i përket përditësimit të planeve urbanistike në detale nëpër komuna, në afatet e caktuara me ligj dhe me një procedurë transparente dhe pjesëmarrëse.
2. Që të parandalohet keqpërdorimi i mjeteve financiare dhe i pronës së komunës, insistohet të respektohet obligimi që plani për investime dhe për zhvillimin e komunës të miratohet nëpërmjet një procedure transparente dhe të përmbajë dinamikë dhe priotete për realizimin e tij.
3. Kërkohet që buxheti i komunës të përshtatet me planin e saj vjetor, atë afatmesëm dhe afatgjatë për zhvillim dhe investime, ndërsa ndjekja e shkallës dhe mënyrës së realizimit të buxhetit, të zhvillohet në mënyrë të pandërprerë, nëpërmjet një sistemi financiar-kompjuterik që është krijuar për këtë qëllim.
4. Insistohet për pjesëmarrje transparente dhe participative gjatë miratimit të planeve për furnizimet publike dhe investimet publike në komunë
5. Insistohet për zbatim efikas të kompetencave fiskale që u janë bartur komunave në kuadër të procesit të decentralizimit fiskal, kryesisht nëpërmjet trajnimeve për të gjithë të punësuarit dhe nëpërmjet sistemit për ndjekje dhe mbikëqyrje të Ministrisë për Financa.
6. Potencohet obligimi për krijimin dhe ekipimin e njësive për revizion të brendshëm në çdo komunë, ndërsa me ndryshimin e Ligjit për kontroll të brendshëm publik financiar të futen licenca për punë për revizorët e brendshëm.
7. Kërkohet nga njësitë e vetëqeverisjes lokale të përgatisin strategji për menaxhim me rreziqet dhe të përgatitet një regjistër për rreziqet nga korrupsioni, nëpër komuna dhe te qyteti i Shkupit, me çka do të mundësohet krijimi i kushteve themelore për ndërtimin dhe përforcimin e integritetit individual dhe institucional të njësive të vetëqeverisjes lokale.

Duke u nisur nga ideja kryesore e projektit, për shfrytëzimin e hulumtimit në funksion të vlerësimit të gjendjeve dhe përparimit gjatë realizimit të Programit shtetëror, kësaj radhe, në vetëqeverisjen lokale, qytetarëve iu parashtruan një varg pyetjesh në lidhje me perceptimin e tyre për korrupsionin në njësitë e vetëqeverisjes lokale, se sa personalisht kanë qenë të ekspozuar ndaj korrupsionit dhe si i vlerësojnë rezultatet në planin e parandalimit të korrupsionit në vetëqeverisjen lokale.

2.1. TRANSPARENCA E VETËQEVERISJES LOKALE

Për shkak se transparenca në punën e vetëqeverisjes lokale është njëri nga parakushtet kryesore për parandalimin e korrupsionit, pjesëmarrësve në këtë hulumtim, fillimisht ju parashtrua pyetja: “A do të thonit se për punën e komunës jeni: plotësisht të informuar, kryesisht të informuar, kryesisht nuk jeni të informuar, aspak nuk jeni të informuar ose aspak nuk jeni të interesuar për informata të këtilla?”




Grafiku 1: A do të thonit se për punën e komunës jeni: plotësisht të informuar, kryesisht të informuar, kryesisht nuk jeni të informuar, aspak nuk jeni të informuar ose aspak nuk jeni të interesuar për informata të këtilla?

Siç mund të shihet nga përgjigjet e fituara, një përqindje mjaft e lartë e qytetarëve të vendit konsiderojnë se janë të informuar për punën e organeve të vetëqeverisjes lokale në komunën e tyre. Analiza e përgjigjeve të fituara në këtë pyetje çon në konstatimin se informimi i qytetarëve për punën e organeve të vetëqeverisjes lokale dukshëm rritet me shkallën e arsimit të tyre.

Kështu për shembull, në mesin e qytetarëve me arsim të lartë dyvjeçar dhe universitar, 61,2% kanë deklaruar se janë të informuar për punën e komunës. Në mesin e qytetarëve me arsim të mesëm, 43,4% janë të informuar, ndërsa në mesin e qytetarëve me arsim fillor, për punën e komunës janë të informuar 31,6%. Fakti që pothuajse dy të tretat e qytetarëve me arsim të lartë konsiderojnë se janë plotësisht ose kryesisht të informuar për punën e organeve të vetëqeverisjes lokale në komunën e tyre, sugjeron se ka transparencë relativisht të lartë në punën e organeve të zgjedhura të vetëqeverisjes lokale dhe të administratës publike lokale. Gjithashtu, fakti që vetëm 1,2% e të anketuarve kanë thënë se nuk janë të interesuar për punën e vetëqeverisjes lokale dërgon në konstatimin se përfshirja e qytetarëve në punën e vetëqeverisjes lokale, por edhe vetëdija se është me rëndësi të jenë të informuar për punën e saj, është mjaft e lartë.


Në mesin e qytetarëve që jetojnë në komunat me numër të vogël të banorëve në vend, sipas rezultateve nga ky hulumtim, më i madh është numri i atyre që konsiderojnë se janë të informuar sa i përket punës së vetëqeverisjes lokale në krahasim me qytetarët që jetojnë në qytetet më të mëdha dhe në Shkup. Në mesin e qytetarëve që jetojnë në komunat më të vogla, 55% kanë deklaruar se konsiderojnë se janë të informuar për punën e komunës. Pastaj, në mesin e qytetarëve që jetojnë në qytetet më të mëdha, përqindja e atyre që janë të informuar është 53%, ndërsa në mesin e qytetarëve të Shkupit, kjo përqindje është 51%. Mirëpo, në mesin e banorëve të fshatrave që janë më të largëta nga qendrat komunale, përqindja e atyre që konsiderojnë se janë të informuar për punën e vetëqeverisjes lokale është 37%. Mundësia e qytetarëve në komunat më të vogla për komunikim më intensiv me të punësuarit në vetëqeverisjen lokale dhe për t'i kuptuar informatat me anë të komunikimit ndërpersonal, e jo vetëm nëpërmjet mediave, me gjasë është njëri nga shkaqet për transparencën më të madhe të punës në ato komuna, mirëpo njëkohësisht është edhe pengesa më e madhe për paraqitjen e veprimeve korruptive që do të mbeteshin të panjohura për publikun lokal.



Grafiku 2: A do të thonit se për punën e komunës jeni: plotësisht të informuar, kryesisht të informuar, kryesisht nuk jeni të informuar, aspak nuk jeni të informuar ose aspak nuk jeni të interesuar për informata të këtilla? / sipas arsimit të të anketuarve

Duke u nisur nga supozimi se shkalla e komunikimit me organet komunale, besimi në to, si edhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me korrupsionin janë ngushtë të lidhura me madhësinë dhe zhvillimin e vetë komunës, komunat i ndajmë në tre grupe, edhe atë: komuna të vogla (deri në 10.000 banorë), komuna të mesme (prej 10.000 deri në 30.000 banorë) dhe komuna të mëdha (mbi 30.000 banorë). Analiza e këtillë e kryqëzuar na dha rezultate mjaft interesante, të cilat do t'i prezantojmë si pjesë përbërëse të analizës.

Në bazë të informatave që janë në dispozicion të qytetarëve, ata i formojnë mendimet dhe vlerësimet e tyre për punën e vetëqeverisjes lokale, dhe gjithashtu edhe për shkallën e mundshme të përhapjes së korrupsionit në komunën e tyre. Duke u nisur nga ajo se një nga qëllimet kryesore të luftës kundër korrupsionit është të sigurohet sjellje e tillë e organeve të vetëqeverisjes lokale dhe administratës publike lokale me të cilën do të parandalohen keqpërdorimet eventuale të mjeteve të buxhetit komunal, pjesëmarrësve në këtë hulumtim iu parashtrua edhe pyetja: “Sa pajtoheni me deklaratën se mjetet e buxhetit të komunës suaj shfrytëzohen për nevojat e qytetarëve”?



Grafiku 3: Sa pajtoheni me deklaratën se mjetet e buxhetit të komunës tuaj shfrytëzohen për nevojat e qytetarëve?

Nga përgjigjet e të anketuarve në këtë pyetje, mund të vërehet se është mjaft e lartë përqindja e atyre që mendojnë se mjetet e buxhetit në komunën e tyre nuk shfrytëzohen për nevojat e qytetarëve. Perceptimi i këtyre sugjeron se te qytetarët ka një dyshim të përhapur në masë të gjerë për ekzistimin e keqpërdorimeve gjatë harxhimit të mjeteve buxhetore komunale, por edhe për paraqitjen e mundshme të korrupsionit në mesin e funksionarëve të vetëqeverisjes lokale dhe të administratës së saj publike.

Analiza e përgjigjeve të fituara nga të anketuarit dërgon në konstatimin se në mesin e qytetarëve që konsiderojnë se janë më mirë të informuar për punën e vetëqeverisjes lokale në komunën e tyre, më i madh është numri i atyre që pajtohen me deklaratën se mjetet e buxhetit të komunës së tyre shfrytëzohen për nevojat e qytetarëve. Kështu për shembull, në mesin e të anketuarve me arsim të lartë dyvjeçar dhe atyre me arsim universitar, vetëm 39.4% konsiderojnë se buxheti i komunës së tyre nuk shfrytëzohet për nevojat e qytetarëve. Pastaj, në mesin e të anketuarve me arsim të mesëm, përqindja e atyre që dyshojnë se mjetet buxhetore shfrytëzohen ashtu siç duhet është 52.4%, ndërsa në mesin e të anketuarve që kanë të kryer më së shumti shkollë fillore, numri i atyre që mendojnë se buxheti i komunës nuk shfrytëzohet për nevojat e qytetarëve është plot 60.0%. Gjithashtu, një numër relativisht i lartë prej 8.4% të tyre janë përgjigjur se nuk e dinë se si shfrytëzohen mjetet buxhetore.


Nëse analizohen përgjigjet në këtë pyetje sipas nivelit të informimit të qytetarëve për punën e organeve të vetëqeverisjes lokale, bëhet e qartë se informimi më i mirë i qytetarëve rezulton me besim më të madh dhe me dyshim më të vogël për ekzistim të korrupsionit gjatë harxhimit të mjeteve buxhetore të komunës.

Tabela 2: Përqindja e qytetarëve që pajtohen me deklaratën se buxheti në komunën e tyre harxhohet sipas nevojave të qytetarëve / sipas nivelit të informimit të tyre për gjendjen në komunë:

	Plotësisht jeni të informuar	Kryesisht jeni të informuar	Kryesisht nuk jeni të informuar	Aspak nuk jeni të informuar
Plotësisht pajtohem	37.4%	16.5%	4.7%	3.5%
Kryesisht pajtohem	30.3%	48.8%	35.3%	17.6%
Pajtohen	67.7%	65.3%	40.0%	21.1%
Nuk pajtohen	30.3%	31.8%	53.7%	73.3%
Kryesisht nuk pajtohem	13.1%	16.0%	25.8%	17.6%
Aspak nuk pajtohem	17.2%	15.8%	27.9%	55.6%
Nuk e di / P.P.	2.0%	2.9%	6.3%	5.6%


Këta përgjigje mund të interpretohen në dy mënyra. E para është se kur qytetarët janë të informuar më mirë ose kur mendojnë se kanë informata të mjaftueshme për punën e vetëqeverisjes lokale, ata realisht më pak u besojnë akuzave për keqpërdorime të mjeteve buxhetore nga ana e pushtetit lokal. Mosinformimi i qytetarëve për cilat do qoftë arsye, le hapësinë të madhe për dyshime se ka korrupsion. Mënyra e dytë e interpretimit të këtyre përgjigjeve do të ishte se – perceptimi për keqpërdorimin e mundshëm të mjeteve buxhetore të komunës te popullata me nivel më të ulët të arsimit është si rezultat i asaj se pjesa më e madhe e kësaj popullate jeton në fshatra ose në paratagje të qyteteve, kështu që vlerësimi i tyre se buxheti nuk shfrytëzohet për nevojat e qytetarëve mund të jetë rezultat jo aq i dyshimeve për sjelljeve korruptive të këtyre mjeteve, sa i ndjenjës se buxhetet shfrytëzohen për zbukurimin e qyteteve, e jo edhe për zgjidhjen e problemeve të fshatrave dhe lagjeve ku ata jetojnë. Gjithashtu, për shkak të gjendjes së rëndë sociale, shtresat më të ulëta sociale shpeshherë kanë qëndrim më kritik ndaj pushtetit se sa qytetarët që janë në gjendje më të mirë materiale.

Nga analiza e përgjigjeve në këtë pyetje sipas përkatësisë etnike, del se qytetarët me përkatësi etnike shqiptare në numër shumë më të madh se sa qytetarët me përkatësi etnike maqedonase konsiderojnë se buxhetet e komunave ku ata jetojnë nuk shfrytëzohen për nevojat e qytetarëve. Përgjigje të këtilla kanë dhënë 64% e tyre, ose dy të tretat e të anketuarve, ndërsa nga qytetarët me përkatësi etnike maqedonase, përgjigje të tillë kanë dhënë 44% e tyre.



Grafiku 4: Sa pajtoheni me deklaratën se mjetet e buxhetit të komunës suaj shfrytëzohen për nevojat e qytetarëve? / sipas përkatësisë etnike të të anketuarve

Analiza e përgjigjeve të fituara në këtë pyetje sipas shpërndarjes rajonale të popullatës, tregon se në rajonin Verilindor dhe në rajonin e Pollogut ka mendim të përhapur në masë të gjerë në mesin e qytetarëve se mjetet e buxhetit nuk shfrytëzohen për nevojat e qytetarëve, ndërsa vlerësime dukshëm më të favorshme për shfrytëzimin e mjeteve buxhetore ka në rajonin Juglindor dhe atë të Vardarit.



Grafiku 5: Përqindja e qytetarëve që nuk pajtohen me deklaratën se mjetet buxhetore të komunës shfrytëzohen për nevojat e qytetarëve / sipas rajoneve

Në raport me madhësinë e komunave, mund të vërehet se komunat e vogla kanë dhënë përgjigje diçka më pozitive, gjegjësisht në përqindje më të lartë konsiderojnë se mjetet buxhetore harxhohen në dobi të qytetarëve, në krahasim me komunat e mesme dhe ato të mëdhatë.

3. PROCEDURAT E PUSHTETIT LOKAL NË TË CILAT QYTETARËT NJOHIN PREZENCË TË KORRUPSIONIT

Me procesin e rritjes së autorizimeve të vetëqeverisjes lokale e veçanërisht me decentralizimin fiskal, njësitë e vetëqeverisjes lokale në vend fituan të drejta dhe kompetenca dukshëm më të mëdha në fusha të cilat janë me rëndësi jetike për qytetarët e komunës.

Përveç që janë rritur mundësitë për punësime në administratën publike, në ndërmarrjet publike që i themelojnë komunat, kopshtet, në shkollat fillore dhe ato të mesme, si dhe në institucionet e tjera në nivel lokal, komunat fituan edhe buxhete relativisht të mëdha që shfrytëzohen për furnizime publike, për përmirësimin e infrastrukturës së komunës, por edhe për ndërtimin e objekteve. Pastaj, komunat fituan kompetenca për miratimin dhe ndryshimin e planeve urbanistike në detale, menaxhimin me tokën ndërtimore, caktimin e tatimit në pronë, si dhe sigurimin e mbikëqyrjes inspektuese. Me këtë, siç është konstatuar në programin për parandalimin e korrupsionit të KSHPK-së, “sektori i vetëqeverisjes lokale bëhet i ndjeshëm nga sjellja korruptive”³⁶.

Me qëllim që të kuptohet se te cilat aktivitete të autoriteteve lokale qytetarëve më shpesh njohin sjellje korruptive, në këtë hulumtim, atyre iu parashtrua pyetja: “Sa do të thonit se korrupsioni është i pranishëm te organet e komunës gjatë realizimit të këtyre aktiviteteve që janë në kompetencë të saj?”

Tabela 3: Sa do të thonit se korrupsioni është i pranishëm te organet e komunës gjatë realizimit të këtyre aktiviteteve që janë në kompetencë të saj:


	Shumë	Mesatarisht	Pak	Nuk ka korrupsion	Nuk e di / P.P.
Punësimit	45.1%	19.9%	9.1%	13.8%	12.1%
Punës së shërbimeve të inspeksionit	25.7%	29.1%	10.2%	16.9%	18.1%
Ndarjes së furnizimeve publike nga ana e komunës	22.0%	30.1%	11.9%	15.2%	20.8%
Dhënies së lejeve për ndërtim	21.2%	23.2%	11.4%	19.5%	24.7%
Miratimit ose ndryshimit të planeve urbanistike	20.3%	24.1%	11.9%	21.4%	22.3%
Përcaktimit të tatimeve në pronë	16.3%	21.8%	9.9%	30.6%	21.4%

Përgjigjet e fituara në këtë pyetje, që janë paraqitur në tabelën e mësipërme, dërgojnë në disa përfundime:

Së pari, në qoftë se ka korrupsion në nivel lokal që kuptohet si “keqpërdorim i autorizimeve zyrtare për të realizuar dobi personale”, atëherë qytetarët këtë më së shumti e vërejnë në fushat ku familjet e tyre janë të prekura në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ekzistimi i tij. Sipas përgjigjeve që i kanë dhënë të anketuarit kjo është fusha e punësimit. Nga përgjigjet e fituara në këtë pyetje, bëhet e qartë se punësimi në organet e vetëqeverisjes lokale, në administratën e saj, në ndërmarrjet lokale publike, ose në institucionet që janë në kompetencë të vetëqeverisjes lokale (sh-

36 <http://www.dksk.org.mk/images/stories/pdf/drzavna%20programa/dprograma%2026.12.11.pdf>

kollat fillore dhe të mesme, kopshtet etj.), për numrin më të madh të qytetarëve paraqet proces në të cilin korrupsioni në nivel lokal është më së shumti i pranishëm, gjegjësisht i dukshëm. Madje, edhe atëherë kur nuk bëhet fjalë për korrupsion klasik në kuptim të “këmbimit të shërbimit për para”, por, për keqpërdorim klasik të funksionit gjatë procesit të punësimeve të reja, duke i anashkaluar dispozitat për qëllime partiake ose për shkak të lidhjeve familjare-miqësore, qytetarët këtë e përjetojnë si korrupsion (prishje) të vetëqeverisjes lokale.



Grafiku 6: Sa do të thonit se korrupsioni është i pranishëm në organet e komunës gjatë punësimit? / sipas përkatësisë etnike të të anketuarve

Fakti se korrupsioni gjatë punësimit përjetohet edhe si diskriminim, tregojnë përgjigjet e pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike për përhapjen e korrupsionit gjatë punësimit në nivel lokal. Por, nga ana tjetër, nëse shihen përgjigjet e qytetarëve në rajonet me përkatësi dominante etnike shqiptare dhe maqedonase, mund të vërehet se përshtypja për përhapjen e korrupsionit gjatë punësimit në nivel lokal është më e përhapur.

Tabela 4: Sa do të thonit se korrupsioni është i pranishëm në organet e komunës gjatë punësimit? / sipas rajoneve

	Verilindor	Lindor	Juglindor	I Shkupit	I Pollogut	I Pellagonisë	I Vardarit	Jugperëndimor
Shumë	47%	42%	38%	41%	53%	49%	47%	46%
Mesatarisht	16%	18%	24%	19%	21%	20%	27%	17%
Pak	16%	6%	14%	7%	10%	9%	10%	6%
Nuk ka korrupsion	12%	19%	17%	14%	9%	12%	14%	17%
Nuk e di / P.P.	9%	15%	7%	19%	7%	10%	2%	14%

Pastaj, menjëherë pas punësimit, qytetarët vërejnë korrupsion në nivel lokal gjatë punës së shërbimeve të inspeksionit. Duke pasur parasysh se një numër i madh i tyre i nënshtrohen mbikëqyrjes inspektuese, duke filluar nga pirja e duhanit në vendet e ndaluara, e deri te kontrollimi i ndërtimeve pa leje, qytetarët kanë përshtypjen se ka korrupsion në punën e shërbimeve të inspeksionit në nivel lokal. Akuzat për veprim të pabarabartë të shërbimeve të inspeksionit në të gjitha rastet e shkeljes së ligjit, ndikojnë që qytetarët të vazhdojnë të kenë përshtypjen se sjellja e këtillë e tyre është e motivuar nga korrupsioni i mundshëm ose nga interesat.

Në vend të tretë qytetarët e rangojnë korrupsionin që paraqitet gjatë furnizimeve publike nga ana e vetëqeverisjes lokale. Varësisht nga madhësia e tyre, por edhe nga fuqia financiare, komunat harxhojnë sasi të ndryshme të mjeteve buxhetore për furnizimet publike. Sipas të dhënave që i publikoi Qendra për komunikime qytetare, për furnizime publike harxhohen nga 3 euro për krye banori në komunën e Orizares, e deri në 400 euro në komunat më të pasura, si në komunën e Qendrës.³⁷ Edhe

37 http://kapital.mk/MK/makedonija/96115/opshtinite_troshat_od_2_do_400_evra_po_zhitel_na_javni_nabavki.asp


pse një numër i vogël i qytetarëve janë të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në biznesin me furnizimet publike, ata vlerësojnë se ka korrupsion në nivel lokal në këtë sferë, ndërsa përshtypja e këtillë me gjasë është rezultat i informatave që arrijnë deri te ata në rrugë joformale, por edhe nëpërmjet mediave. Gjithashtu, analizat e Qendrës që janë bërë në fillim të këtij viti, tregojnë se numri më i madh i furnizimeve bëhen në mënyrë jotransparente, nëpërmjet marrëveshjeve të drejtpërdrejta. Një numër i madh i qytetarëve të vendit bëjnë pjesë në kategorinë e qytetarëve që janë të liruar nga pagesa e tatimit në pronë, para së gjithash, për shkak të pronës së vogël me të cilën disponojnë. Prandaj, siç mund të vërehet në përgjigjet e tyre, ata konsiderojnë se nuk ka shumë korrupsion në atë fushë të vetëqeverisjes lokale. Por, edhe pse numri më i madh i tyre nuk janë shumë të njoftuar me procesin e ndryshimit të planeve urbanistike në detale dhe të dhënies së lejeve për ndërtim, ata edhe në këto fusha të veprimit të pushtetit lokal (të cilave u është kushtuar vëmendje e madhe në programin e KSHPK-së) vërejnë prani të nivelit të lartë të korrupsionit.

Perceptimi për korrupsion gjatë ndryshimit të planeve urbanistike, padyshim është i kushtëzuar nga shkalla e urbanitetit të komunitetit dhe madhësia e vetë komunës. Kështu, në komunat e mëdha, siç është qyteti i Shkupit dhe komunat më të mëdha, qytetarët perceptojnë përhapje shumë më të madhe të korrupsionit në këtë fushë se sa në qytetet më të vogla dhe në fshatrat, ku çmimi i tokës ndërtimore (dhe gjithashtu edhe i pronave që mund të fitohen me ndryshim korruptiv të planeve urbanistike) është dukshëm më i vogël.

Tabela 5: Sa do të thonit se korrupsioni është i pranishëm gjatë miratimit ose ndryshimit të planeve urbanistike? / sipas vendbanimit të të anketuarve

	Shkup	Qytet më i madh	Qytet më i vogël	Fshat
Shumë	25%	20%	20%	18%
Mesatarisht	22%	28%	29%	21%
Pak	10%	15%	8%	13%
Nuk ka korrupsion	20%	17%	24%	24%
Nuk e di / P.P.	23%	20%	19%	24%

Nga ana tjetër, analiza sipas madhësisë së komunave, gjithashtu dërgon në përfundimin se nivel më i lartë i korrupsionit për këtë çështje perceptohet në komunat e mëdha dhe ato mesatarisht të mëdha, në krahasim me komunat e vogla, të cilat realisht rallë disponojnë me tokë tërheqëse ose më pak janë të ekspozuara ndaj këtij lloji të korrupsionit. Kjo nuk vlen vetëm për çështjen e lejeve për ndërtim, por në përgjithësi për perceptimin e përgjithshëm për ekzistimin e korrupsionit.




Grafiku 7: Sa do të thonit se korrupsioni është i pranishëm në organet e komunës gjatë punësimit? / sipas përkatësisë etnike të të anketuarve

Grafiku i mësipërm dërgon në një përfundim shumë të rëndësishëm. Në komunat më të vogla, ku qytetarët kanë më tepër informata për punën e komunës, personalisht i njohin bartësit e funksioneve publike, por edhe realisht ka më pak hapësirë për keqpërdorim për shkak të resurseve të vogla që i kanë komunat, perceptimi për ekzistimin e korrupsionit është dukshëm më i vogël. Edhe pse faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në perceptimin për ekzistimin e korrupsionit janë fuqia financiare dhe potenciali i komunave, ndikim jo më të vogël mbi perceptimin ka edhe shkalla e njohjes së punës së funksionarëve lokalë, karakteristikave të tyre personale dhe qasja në punë, që është më e lartë në komunat e vogla. Kjo do të thotë se në komunat më të mëdha, ku autoritetet lokale janë më të largëta nga qytetarët, ndërsa kompetencat janë më të mëdha, dyshimi për keqpërdorim të funksionit publik të qytetarët është më i madh. Me transparencë më të madhe, informim të qytetarëve dhe përfshirje të tyre më të madhe në procesin e marrjes së vendimeve në komunat e mëdha, dukshëm mund të përmirësohet edhe perceptimi sa i përket ekzistimit të korrupsionit dhe të rritet besimi i qytetarëve në institucionet lokale.

4. NIVELI I KORRUPTUESHMËRISË SË BARTËSVE TË FUNKSIONEVE NË VETËQEVERISJEN LOKALE


Ky hulumtim e konfirmoi tezën se më të korruptueshëm (por edhe që më tepër perceptohen si të korruptuar) janë personat që në nivel lokal disponojnë me fuqi më të madhe, kanë më tepër të autorizime diskrete dhe të cilët, falë natyrës së punës së tyre dhe pavarësisë, mund t'i lejojnë vetes që disa nga aktivitetet e tyre t'i kryejnë në mënyrë më pak transparente.

Në favor të këtij supozimi janë edhe rezultatet e prezantuara në grafikun e mëposhtëm.



Grafiku 8: Sipas jush, cili nga funksionet e shënuara të komunës ka më tepër gjasa të keqpërdoret:

Në pyetjen në të cilën nga të anketuarit u kërkua të përgjigjen se cili nga funksionet e shënuara, sipas tyre, ka më tepër gjasa të keqpërdoret, pothuajse çdo qytetar i katërt theksoi se ky është funksioni i kryetarit të komunës. Pas tij vijnë inspektorët në njësitë lokale, të punësuarit në administratën komunale dhe drejtorët e ndërmarrjeve publike lokale dhe të institucioneve që janë në kompetencë të vetëqeverisjes lokale. Më në fund gjenden anëtarët e këshillave komunalë, për të cilët dihet se nuk kanë fuqi individuale për të vendosur për ndonjë çështje, por vendimet i marrin me shumicë votash, në mbledhje që janë të hapura për publikun.




Grafiku 9: Sipas jush, cili nga funksionet e shënuara të komunës ka më tepër gjasa të keqpërdoret: / sipas madhësisë së komunës

Nga ky grafik shihet distribuimi i përgjigjeve të qytetarëve sipas madhësisë së komunës në të cilën jetojnë, dhe ai gjithashtu i tregon disa dallime të rëndësishme. I pari, në komunitat e vogla dhe të mesme, ku kryetarët e komunave më shpesh janë të vetmit që kanë fuqi të madhe arbitrare dhe mundësi për të vendosur, ata perceptohen se janë më të korruptueshëm në krahasim me kryetarët e komunave në komunitat e mëdha. Në mungesë të shërbimeve të mëdha të inspeksionit, këshillit të fuqishëm komunal, por edhe modelit tepër të centralizuar të udhëheqjes, kryetarët e komunave të vogla e bartin gjithë “përgjegjësinë” para qytetarëve. Krejtësisht ndryshe është situata dhe perceptimi në komunitat e mëdha. Është interesante se në komunitat e mëdha, më së shumti korrupsion qytetarët vërejnë te shërbimet e inspeksionit, që dallon shumë nga përgjigjet e qytetarëve në komunitat e vogla dhe ato të mesme. Kjo dërgon në përfundimin se në komunitat ku nëpunësit nuk janë të kontrolluar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të fuqishme nga kryetari i komunës dhe nga këshilli komunal, gjegjësisht ku ka mundësi për korrupsion në më tepër nivele (e jo vetëm në një nivel si te komunitat e vogla), perceptimi për ekzistimin e korrupsionit është më i madh. Kjo vërtetohet edhe nga analiza e dy pyetjeve të ardhshme.

5. NIVELI I EKSPOZIMIT NDAJ KORRUPSIONIT I QYTETARËVE NË NJËSITË E VETËQEVERISJES LOKALE

Për nivelin e ekzistimit të korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes lokale nuk mjafton të matet vetëm perceptimi për ekzistimin dhe përhapjen e tij. Në qoftë se dëshirojmë të krijojmë një pasqyrë më reale për ekzistimin e kësaj dukurie negative, duhet ta analizojmë edhe ekspozimin e drejtpërdrejtë të qytetarëve ndaj aktiviteteve eventuale korruptive, me të cilat shërbehen bartësit e autorizimeve publike në kuadër të vetëqeverisjes lokale.


Mu për këto arsye, të anketuarve në këtë hulumtim iu parashtrua pyetja: “Gjatë 12 muajve të kaluar, a thua vallë ju kanë kërkuar, ju personalisht ose ndonjë anëtar i familjes suaj të ngushtë, para, mall ose shërbim për kryerjen ose përsheptimin e ndonjë pune në komunë?”



Grafiku 10: Gjatë 12 muajve të kaluar, a thua vallë ju kanë kërkuar, ju personalisht ose ndonjë anëtar i familjes suaj të ngushtë, para, mall ose shërbim për kryerjen ose përsheptimin e ndonjë pune në komunë?


Siç mund të shihet nga përgjigjet e fituara që janë prezantuar në grafikun e mësipërm, 6.5% e të anketuarve janë përgjigjur në mënyrë konfirmuese në këtë pyetje. Edhe pse në shikim të parë kjo përqindje duket e ulët, duhet theksuar se bëhet fjalë për ekspozim të drejtpërdrejtë ndaj aktiviteteve korruptive me të cilat shërbehen bartësit e autorizimeve publike në vetëqeverisjen lokale, gjegjësisht kjo përqindje e paraqet numrin e qytetarëve të cilëve në mënyrë të drejtpërdrejtë u janë kërkuar para, mall ose ndonjë lloj tjetër i shërbimit si zëvendësim për ta kryer ndonjë punë në komunë.

Në qoftë se i krahasojmë rezultatet e fituara me përkatësinë etnike të të anketuarve, do të fitojmë rezultate interesante. Në fakt, shqiptarët etnik në vend, në përqindje mjaft të lartë janë të ekspozuar ndaj korrupsionit të drejtpërdrejtë në kuadër të vetëqeverisjes lokale, për dallim nga bashkësitë e tjera etnike, duke i përfshirë edhe maqedonasit etnik. Madje 11% e shqiptarëve etnik janë përgjigjur se në 12 muajt e kaluar dikush u ka kërkuar para, mall ose ndonjë lloj shërbimi tjetër për ta kryer ose për ta përshpejtuar ndonjë punë në komunë, për dallim nga 7% e të anketuarve nga bashkësitë e tjera etnike dhe 5% të maqedonasve etnik që kanë dhënë përgjigje të njëjtë.




Grafiku 11: Gjatë 12 muajve të kaluar, a u janë kërkuar, juve personalisht ose ndonjë anëtar i të familjes suaj të ngushtë, para, mall ose shërbim për kryerjen ose përshpejtimin e ndonjë pune në komunë? / sipas përkatësisë etnike të të anketuarve

Pastaj, në qoftë se i krahasojmë përgjigjet e fituara në secilin nga tetë rajonet e vendit, gjithashtu, mund të vijmë në rezultate interesante. Madje 10% e të anketuarve në rajonin Verilindor dhe atë të Vardarit janë përgjigjur se kanë qenë të ekspozuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ndaj korrupsionit nga ana e pushtetit lokal, për dallim nga vetëm 1% e të anketuarve në rajonin e Pellagonisë, të cilët kanë dhënë përgjigje konfirmuese në këtë pyetje. Gjithashtu, një përqindje relativisht e lartë (8%) e ekspozimit të drejtpërdrejtë ndaj korrupsionit në nivel lokal ekziston edhe në rajonin e Shkupit dhe atë Jugperëndimor në vend.



Grafiku 12: Gjatë 12 muajve të kaluar, a u janë kërkuar, juve personalisht ose ndonjë anëtar të familjes suaj të ngushtë, para, mall ose shërbim për kryerjen ose përsheptimin e ndonjë pune në komunë? / sipas rajoneve


Ajo që në mënyrë të vazhdueshme paraqitet si përfundim gjatë gjithë analizës ishte fakti se në komunat më të vogla, perceptimi për ekzistimin e korrupsionit është më i vogël, por më e vogël është edhe vetë paraqitja e tij. Nga përgjigjet e fituara në këtë pyetje, të analizuara sipas madhësisë së komunës, mund të konstatohet se sa më e madhe që është komuna (me më tepër banorë dhe më tepër fuqi), aq më të mëdha janë gjasat që qytetarët të jenë të ekspozuar ndaj korrupsionit.



Grafiku 13 : Gjatë 12 muajve të kaluar, a u janë kërkuar, juve personalisht ose ndonjë anëtar të familjes suaj të ngushtë, para, mall ose shërbim për kryerjen ose përsheptimin e ndonjë pune në komunë? / sipas madhësisë së komunës

Kjo përsëri është rezultat i faktit se në komunat më të vogla mundësia për korrupsion është më e vogël, për vetë faktin se ato nuk disponojnë me buxhete të mëdha, tokë ose resurse të tjera. Por, fakti që format e ndryshme të korrupsionit zbulohen shumë më lehtë në mjediset e vogla, raportet e afërta dhe komunikimi i qytetarëve me autoritetet lokale, si dhe shkalla më e lartë e besimit, i zvogëlon gjasat për korrupsion.

Siç është theksuar në pjesën hyrëse të këtij hulumtimi, korrupsioni te vetëqeverisja lokale ka forma dhe lloje të ndryshme dhe me të mund të ballafaqohet çdo qytetar i njësisë së vetëqeverisjes lokale. Megjithatë, rreziku më i madh nga ekspozimi i drejtpërdrejtë ndaj sjelljes korruptive ekziston te ata njerëz, të cilët kur parashtrajnë kërkesa deri te organet e vetëqeverisjes lokale, vijnë në kontakt të drejtpërdrejtë me të.




Grafiku 14: Gjatë 12 muajve të kaluar, a u janë kërkuar, juve personalisht ose ndonjë anëtar i të familjes suaj të ngushtë, para, mall ose shërbim për kryerjen ose përshpejtimin e ndonjë pune në komunë? / të anketuarit që kanë kërkuar ndonjë shërbim nga ndonjë organ i vetëqeverisjes lokale

Siç mund të shohim nga rezultatet e paraqitura në grafikun e mësipërm, madje 9.6% e të anketuarve që kanë dorëzuar ndonjë kërkesë deri te organet e vetëqeverisjes lokale janë përgjigjur se për këtë u janë kërkuar para, mall ose ndonjë lloj tjetër i shërbimit. Duke i pasur parasysh këto rezultate, mund të konstatojmë se rreziku nga sjellja korruptive rritet në mënyrë proporcionale me numrin e kërkesave që dorëzohen te organet e vetëqeverisjes lokale, ndërsa qytetarët që dorëzojnë kërkesa janë më të ekspozuar ndaj ndikimeve korruptive dhe shantazhit.

6. GATISHMËRIA E QYTETARËVE PËR TË LUFTUAR KUNDËR KORRUPSIONIT


Një nga armët kryesore në luftën kundër korrupsionit janë pikërisht qytetarët, të cilët për shkak të standardeve të tyre të larta morale, jo vetëm që nuk futen në marrëveshje korruptive me bartësit e funksioneve publike, por edhe e denoncojnë sjelljen e tillë. Ekzistimi i individëve të këtillë në mesin e qytetarëve, të cilët janë të njohur edhe si fishkëllues (whistleblowers), është me rëndësi të jashtëzakonshme për luftën kundër korrupsionit, jo vetëm për shkak se në mënyrë të drejtpërdrejtë ndihmojnë në parandalimin e tij, por edhe për shkak se dërgojnë porosi deri te bartësit e funksioneve publike, se mu ata mund të jenë “viktima” të zbulimit që ndikon në zvogëlimin e kësaj dukurie. Gjithashtu, konstatimet e të gjitha hulumtimeve të deritanishme tregojnë se edhe vetë qytetarët janë të vetëdijshëm për rëndësinë që e kanë ata në procesin e parandalimit, gjegjësisht zvogëlimin të korrupsionit.

Në këtë hulumtim u parashtrua edhe pyetja: Gjatë 12 muajve të kaluar, a keni denoncuar personalisht deri te organet kompetente ndonjë paligjshmëri ose parregullsi që është në kompetencë të komunës? Në të janë fituar këto përgjigje.



Grafiku 15: Gjatë 12 muajve të kaluar, a keni denoncuar personalisht deri te organet kompetente ndonjë paligjshmëri ose parregullsi që është në kompetencë të komunës?


Siç mund të shihet nga përgjigjet e fituara, vetëm 7% e qytetarëve të anketuar kanë denoncuar parregullsi deri te ndonjëri nga organet kompetente, që aspak nuk paraqet përqindje të ulët, nëse merret parasysh fakti se gjithsej 30% të qytetarëve kanë pasur ndonjë lloj kontakti ose pune në komunë gjatë 12 muajve të fundit. Ajo që është me rëndësi të theksohet është se pyetja ka të bëjë me denoncimin në përgjithësi, të çfarëdo lloji të parregullsive ose keqpërdorimeve, e jo konkretisht për denoncimin e korrupsionit. Në këtë mënyrë u përpoqëm të matim se sa është gatishmëria e përgjithshme e qytetarëve të marrin pjesë në proceset shoqërore dhe sa janë ata të vetëdijshëm për nevojën e bashkëpunimit të këtillë me institucionet, me qëllim që të kontrollohet puna e organeve komunale. Përqindja e qytetarëve që kanë denoncuar parregullsi aspak nuk është e ulët, por përqindja e qytetarëve që janë të kënaqur nga veprimi i organeve kompetente pas denoncimit të tyre është tepër e ulët. Në fakt, vetëm 1.1 për qind prej atyre 7% që kanë denoncuar ndonjë parregullsi janë përgjigjur se janë të kënaqur me atë se si kanë vepruar organet kompetente pas denoncimit nga ana e tyre, ndërsa 6,2% kanë thënë se janë të pakënaqur. Ose, nëse llogaritet vetëm përqindja e atyre që kanë denoncuar (7,2%), madje 69,6% kanë thënë se janë plotësisht të pakënaqur, 15,2% kanë thënë se janë kryesisht të pakënaqur, 13,9% kanë thënë se janë kryesisht të kënaqur, ndërsa vetëm 1,3% kanë thënë se janë plotësisht të kënaqur.



Grafiku 16: A jeni të kënaqur me veprimin e organeve kompetente në këtë rast? (N=87, qytetarë që kanë denoncuar parregullsi)

7. VLERËSIMI I QYTETARËVE PËR SUKSESIN E LUFTËS KUNDËR KORRUPSIONIT NË NIVEL LOKAL

Perceptimi për përparimin në luftën kundër korrupsionit, si dhe zvogëlimi ose rritja e tij reale, para së gjithash është rezultat i përvojës personale të qytetarëve me këtë dukuri, por edhe i informatave që arrijnë deri te ata nëpërmjet kanaleve të ndryshme të informimit, para së gjithash nëpërmjet mediave masive. Në hulumtimet e deritanishme që u realizuan në kuadër të këtij projekti, pothuajse për të gjitha fushat, perceptimi i qytetarëve është se në krahasim me periudhën prej para dy vitesh, sot korrupsioni është i pranishëm më pak. Në fakt, në pyetjen “Në krahasim me periudhën prej para dy vitesh, a do të thonit se në komunën tuaj sot ka më pak ose më tepër korrupsion?”, janë fituar këto përgjigje:



Grafiku 17: Në krahasim me periudhën prej para dy vitesh, a do të thonit se në komunën tuaj sot ka më pak ose më tepër korrupsion

Çdo i anketuar i tretë konsideron se në përgjithësi, korrupsioni në nivel lokal është zvogëluar dukshëm ose pak, ndërsa 19,2% mendojnë se është rritur. Megjithatë, që të matet përparimi real sa i përket këtij problemi, duhet të bëhet një analizë reale statistikore, e cila për shkak të ndjeshmërisë së temës, vështirë mund të bëhet. Analizat e kryqëzuara çojnë në përfundimin se perceptimi për rritjen e korrupsionit është më i lartë te shqiptarët etnik se sa te maqedonasit etnik, mirëpo nuk ka dallime më të mëdha te kategoritë e tjera të qytetarëve.

PËRFUNDIME:

- Shkalla e informimit për punën e vetëqeverisjes lokale te qytetarët e vendit është relativisht e lartë (46.8). Banorët e komunave të vogla janë më të informuar, për dallim nga ata që jetojnë në komunat më të mëdha dhe në qytetin e Shkupit.

Është mjaft e lartë përqindja e atyre që mendojnë se mjetet e buxhetit në komunën e tyre nuk shfrytëzohen për nevojat e qytetarëve por, me gjasë, për disa nevoja të tjera. Perceptimi kompletohet nëse merret parasysh lidhja ndërmjet qytetarëve të përmendur më lartë me shkallën e informimit për menaxhimin me mjetet komunale, me ç'rast mund të nxirret përfundimi se qytetarët më të informuar nuk dyshojnë fillimisht se ka korrupsion, por e kontestojnë përdorimin e mjeteve buxhetore për qëllime të tjera publike.

- Shqiptarët etnik në përqindje më të lartë konsiderojnë se buxheti nuk shfrytëzohet në interes të qytetarëve. Qytetarët konsiderojnë se korrupsioni në vetëqeverisjen lokale më së shumti është i pranishëm gjatë punësimit (45.1%). Pastaj vijnë korrupsioni gjatë punës së shërbimeve të inspeksionit (25.7%) dhe korrupsioni gjatë ndarjes së furnizimeve publike nga ana e komunës (22.0%). Perceptimi për ekzistimin e korrupsionit gjatë punësimit është më i lartë te shqiptarët etnik (54.0%), ndërsa banorët në komunat më të mëdha dhe në qytetin e Shkupit, për dallim nga ata që jetojnë në fshat, në përqindje më të lartë vërejnë korrupsion gjatë miratimit dhe ndryshimit të planeve urbanistike në komunë.
- Në komunat më të vogla, ku qytetarët kanë më tepër informata për punën e komunës, ata personalisht i njohin bartësit e funksioneve publike, por edhe realisht ka më pak hapësirë për keqpërdorim për shkak të resurseve të vogla që i kanë komunat, perceptimi për ekzistimin e korrupsionit është dukshëm më i vogël.
- Kryetarët e komunave perceptohen si më të korruptueshëm (24.1%). Pastaj vijnë inspektorët (17.7%) dhe administrata komunale (14.5%). Prandaj, mund të konstatohet se ka

dyshim më të madh për korrupsion te institucionet te të cilat ka të koncentruar fuqi më të madhe ekzekutive dhe mundësi më të mëdha për sjellje të vendimeve me diskrecion. Këshilltarët në këshillat komunalë, që nuk kanë fuqi ekzekutive, në përqindje më të ulët (8.2%) perceptohen si të korruptueshëm.

- Në komunat e vogla dhe të mesme, kryetarët e komunave perceptohen si më të korruptueshëm, në krahasim me kryetarët e komunave më të mëdha. Nga ana tjetër, në komunat e mëdha, qytetarët korrupsion më të madh vërejnë te shërbimet e inspeksionit që do të thotë se në komunat ku nëpunësit nuk janë të kontrolluar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të fuqishme nga kryetari i komunës dhe këshilli komunal, gjegjësisht ku ka mundësi për korrupsion në më tepër nivele, perceptimi për ekzistimin e korrupsionit është më i madh.
- 6.5% e të anketuarve kanë thënë se për të kryer ndonjë punë në komunë u janë kërkuar para, mall ose ndonjë lloj shërbimi tjetër, gjegjësisht se janë ballafaquar drejtpërdrejt me korrupsionin. 11% e shqiptarëve etnik janë përgjigjur se janë ballafaquar drejtpërdrejt me korrupsionin, ndërsa 7.1% e banorëve në komunat e mëdha kanë dhënë përgjigje të njëjtë. Pothuajse nga çdo i dhjeti qytetar (9.6%) që ka kërkuar ndonjë shërbim nga organet komunale janë kërkuar para ose ndonjë lloj tjetër shërbimi.
- 7.2% e të anketuarve kanë denoncuar deri te organet kompetente ndonjë paligjshmëri ose parregullsi që është në kompetencë të komunës, ndërsa madje 85% e tyre nuk kanë qenë të kënaqur nga veprimi i tyre.
- Në përgjithësi, qytetarët mendojnë se sot ka më pak korrupsion se sa në periudhën para dy vitesh, ndërsa 19,2% e tyre mendojnë se sot niveli i korrupsionit është më i madh.

BIBLIOGRAFIA DHE HULUMTIMET E SHFRYTËZUARA:

- http://www.icgg.org/downloads/contribution02_klitgaard.pdf
- TransparencyInternational: CorruptionPerceptionIndex 2011
- http://www.transparency.org/cpi2011/in_detail
- Corruption in UK Local Government: The Mounting Risks. Transparency International UK, October 2013.
- Robert Klitgaard: *Controlling Corruption*, University of California Press: 1998.
- J. S. Nye, „*Political Corruption: a Cost-Benefit Analysis*“ in A. J. Heidenheimer, M. Johnston and V. LeVine, *Political Corruption: a Handbook* (New Brunswick NJ, Transaction, 1989).
- J. Heidenheimer, *Political Corruption: A Handbook*, Transaction Publishers, 1989.
- P. Heywood, *Political Corruption: Problems and Perspectives*. Political Studies, 45
- Programi shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit (2011 – 2015)
- <http://www.dksk.org.mk/images/stories/pdf/drzavna%20programa/dprograma%2026.12.11.pdf>
- http://kapital.mk/MK/makedonija/96115/opshtinite_troshat_od_2_do_400_evra_po_zhitel_na_javni_nabavki.asp
- <http://www.politicalcorruption.net/2009/01/30/types-of-corruption-found-in-local-government/>
- <http://www.theguardian.com/local-government-network/2013/oct/09/corruption-local-government-robert-barrington>

II. ANALIZA KUALITATIVE TË MASAVE KUNDËR KORRUPSIONIT DHE IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT SHETËTORË PËR PARANDALIM DHE LUFTËS KUNDËR KORRUPSIONIT DHE ZVOGËLIMIT TË KONFLIKTIT TË INTERESIT 2011-2015:

1. Raport për masat kundër korrupsionit në sektorin privat
2. Raport për masat kundër korrupsionit në sektorin politik
3. Raport për masat kundër korrupsionit në sektorin e vetëqeverijes lokale
4. Raport për masat kundër korrupsionit në sektorin e administratës publike
5. Raport për masat kundër korrupsionit në sektorin e shoqërisë civile

**1. RAPORTI NGA ANALIZA KUALITATIVE TË MASAVE KUNDËR KORRUPSIONIT
DHE IMPLEMENTIMIT TË PROGRAMIT SHTETËRORË PËR PARANDALIM DHE
LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT DHE ZVOGËLIM TË KONFLIKTIT TË INTERESIT
2011-2015 NË SEKTORIN PRIVAT**

Përgatiti: Aleksandar Nikollov

PËRMBLEDHJE

Ky dokument është raport nga analiza cilësore e masave antikorruptive dhe nga zbatimi i “Programit shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe parandalimin dhe zvogëlimin e konfliktit të interesave 2011–2015” (Programi shtetëror) në pjesën e sektorit privat. Është i orientuar drejt problemeve të identifikuara në Programin shtetëror, me ç’rast nëpërmjet disa indikatorëve i vlerëson masat antikorruptive dhe zbatimin e Programit shtetëror, i përcakton anët e fuqishme dhe të dobëta të asaj që është bërë deri tani dhe jep rekomandime për avancimin e luftës kundër korrupsionit në sektorin privat. Qëllimi kryesor i kësaj analize është t’i ndihmojë Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit (KSHPK) në ndjekjen e zbatimit të Programit shtetëror, përmirësimin e indikatorëve, konstatimin e problemeve të reja, përgatitjen e aktiviteteve të reja ose përshtatjen e aktiviteteve të parapara. KSHPK-ja luan rol kyç në luftën kundër korrupsionit si institucion që i identifikon mangësitë dhe fushat e rrezikshme, ku ka nevojë të punohet edhe më tutje, por edhe si institucion që vazhdimisht i avancon metodat për ndjekjen e zbatimit të Programit shtetëror, të bazuara jo vetëm në indikatorë kuantitativë, por edhe cilësor.

Në thelb, analiza merret me problemet që kanë të bëjnë me gjithë sektorin afarist, por, formalisht ajo është e orientuar kah ndëmmarrjet që më shumë se gjysma janë në pronësi private. Programi shtetëror trajton 4 probleme që ndërlidhen me korrupsionin dhe konfliktin e interesave në sektorin privat, edhe atë:

1. masat e pazhvilluara sa duhet për parandalimin e korrupsionit dhe përforcimin e integritetit të sektorit privat;
2. njohuritë e pamjaftueshme për korrupsionin dhe konfliktin e interesave në sektorin privat;
3. informimi i pamjaftueshëm për Ligjin për mbrojtje të konkurrencës dhe kapaciteti i pamjaftueshëm i Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës (KMK) për zbatimin e ligjit;
4. transparenca e pamjaftueshme e sponsorimeve, prapa së cilës fshihet mundësia për korrupsion;

Për tejkalimin e këtyre problemeve janë paraparë gjithsej 13 aktivitete, 14 indikatorë të aktivitetit dhe 12 indikatorë të efektivitetit. Analiza cilësore parashtroi njëmbëdhjetë pyetje - indikatorë, të cila më shpesh janë të lidhura me aktivitetet e parapara në Programin shtetëror, por, ekzistojnë edhe raste kur ata identifikojnë ndonjë aspekt të problemit që duhet të merret parasysh në mënyrë plotësuese nga KSHPK-ja dhe faktorët e tjerë në sektorin privat.

Në lidhje me **problemin 1** – masat e pazhvilluara sa duhet për parandalimin e korrupsionit dhe përforcimin e integritetit të sektorit privat, analiza përcaktoi katër pyetje – indikatorë për gjendjen. Ligji për shoqatat tregtare parasheh dispozita solide për parandalimin dhe veprimin gjatë konfliktit të interesave, si dhe për parandalimin e korrupsionit. Prandaj, Programi shtetëror fokusohet në masat vullnetare për parandalimin e korrupsionit dhe të konfliktit të interesave. Plani aksional në Programin shtetëror parasheh aktivitetet për miratimin e kodeve të sjelljes për kryerje korrekte, të ndërgjegjshme dhe të drejtë të aktiviteteve afariste, për parandalimin e konfliktit të interesave dhe zbatimin e praktikave të mira në bashkëpunimin ndërmjet subjekteve private dhe atyre shtetërore. Edhe pse në vend ekzistojnë një sërë modelesh të kodeve të sjelljes, megjithatë ato nuk përmbajnë dispozita të veçanta për donacionet, sponsorimet dhe prokurimet publike – të cilat kanë rrezik të lartë për paraqitjen e korrupsionit dhe të konfliktit të interesave – ndërsa dispozitatat për nxitjen e denoncimit të shkeljeve që kanë të bëjnë me kodin dhe për mbrojtjen e denoncuesve nuk janë të detajuara sa duhet. Anë tjetër e dobët është zbatimi, si dhe mbikëqyrja e tyre. Gjithashtu, nuk ekzistojnë simulime për zhvillimin e programeve të kompanive për respektimin e ligjeve dhe dispozitave të tjera dhe të programeve për sjellje etike. Kontrolli i harmonizimi

mit me dispozitat, si funksion i brendshëm, është i detyrueshëm vetëm për disa subjekte afariste, për shembull për bankat dhe fondet investuese. Rregullativa ligjore e vendit, kërkon detyrimisht nga kompanitë që të kenë të dhëna për pronarët e tyre nominalë, por jo edhe për pronarët e fundit, dhe t'i dorëzojnë këto të dhëna, ndërsa bazat e të dhënave nuk mundësojnë kontrollim të thjeshtë dhe të shpejtë të pronësisë së fundit dhe të kontrollit të fundit mbi ndërmarrjet. Vetëm prej kompanive nga fusha të caktuara me rrezik të madh për larje të parave kërkohet të sigurojnë të dhëna edhe për pronësinë e fundit të klientëve të tyre. Nevojitet transparencë më e madhe për pranuesit e mjeteve publike, si dhe avancim i informimit dhe i mbikëqyrjes në sferën e kufizimit të angazhimeve të personave të mëparshëm zyrtar në sektorin privat. Rregullativa sa i përket raporteve financiare, revizionit dhe kontabilitetit, në segmente të caktuara, madje i tejkalon edhe standardet ndërkombëtare³⁸, por ka nevojë për edukim më të madh në kuadër të këtyre profesioneve për mënyrat për parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit.

Në lidhje me **problemin 2** – njohuritë e pamjaftueshme për korrupsionin dhe konfliktin e interesave në sektorin privat, analiza përcaktoi tre pyetje – indikatorë për gjendjen. Në përputhje me Programin shtetëror, KSHPK-ja nënshkroi memorandum bashkëpunimi për përkrahje të ndërsjellë³⁹ me disa përfaqësues të sektorit afarist (odat ekonomike, klasterët dhe organizatat e punëdhënësve), i cili, në mes tjerash, ka të bëjë edhe me këmbimin e informatave që janë në dispozicion dhe me bashkëpunimin për të realizuar edukime dhe trajnime. Mungojnë dispozita të veçanta ligjore për ta nxitur denoncimin e dyshimeve për korrupsion dhe të aktiviteteve të tjera joligjore në sektorin privat dhe për mbrojtjen e personave që bëjnë denoncime të tilla, por, KSHPK-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, tashmë është duke punuar në përgatitjen e sistemit adekuat. Edhe përkundër asaj se me Programin shtetëror janë paraparë aktivitete adekuate, nuk janë mbajtur trajnime të veçanta për parandalimin e korrupsionit në sektorin privat, ndërsa bashkëpunimi me këtë sektor zhvillohet në nivel të konsultimit dhe të informimit për masat antikorruptive, të cilat i inicon KSHPK-ja. Çështja e antikorrupsionit figuron në agjendën e sektorit afarist gjatë komunikimit me pushtetin, por, në përgjithësi, nuk është prioritet. Marrë në përgjithësi, sektori afarist nuk e nxit sa duhet ose nuk e përkrah sa duhet shoqërinë civile në luftën kundër korrupsionit. Çështja e korrupsionit dhe e antikorrupsionit në sektorin privat mbetet e pahulumtuar sa duhet.

Në lidhje me **problemin 3** – informimin e pamjaftueshëm për Ligjin për mbrojtje të konkurrencës dhe kapacitetin e pamjaftueshëm të Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës (KMK) për zbatimin e ligjit, analiza përcaktoi dy pyetje – indikatorë për gjendjen. Akoma ka nevojë për përfundim kadrovik dhe financiar të KMK-së, e kjo është detektuar edhe në Programin shtetëror. KMK-ja ka mbajtur disa takime me përfaqësues të organeve të tjera për përfundimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, por mbetet që në kohën që vjen, ato të rezultojnë me këmbim të shtuar të informatave. Është vërejtur informim i pamjaftueshëm edhe te organet kontraktuese edhe te subjektet afariste, në aspekt të kontratave të ndaluara, rolit të organeve kompetente dhe mundësive për parandalimin e korrupsionit, ndërsa për tejkalimin e kësaj gjendjeje janë përgatitur edhe dy udhëzues që u dedikohen organeve kontraktuese. Edhe përkundër asaj se është paraparë me Programin shtetëror, akoma nuk është ndryshuar neni 283 i Kodit penal. Dënimet e parapara në të për personat përgjegjës te personat juridik, e pengojnë vendosjen e një programi që do t'i motivonte ndërmarrjet t'i paraqesin rastet e karteleve dhe llojet e tjera të kontratave të ndaluara. Në edukimet që i mban Byroja për prokurime publike për organet kontraktuese, vërehet një përfaqësim i pamjaftueshëm i gjykatësve, që ndikon negativisht në cilësinë e procedurave gjyqësore që kanë të bëjnë me keqpërdorimet gjatë prokrimeve publike.

38 Për shembull, madje edhe shoqëritë me madhësi mesatare janë të obliguara të mbajnë kontabilitet sipas Standardeve ndërkombëtare për raportim financiar, në vend që t'i zbatojnë Standardet më të thjeshta ndërkombëtare për raportim financiar për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

39 <http://www.dksk.org.mk/images/stories/pdf/memor-pri-sek.pdf>

Në lidhje me **problemin 4** – transparencën e pamjaftueshme të sponsorimeve, prapa së cilës fshihet mundësia për korrupsion, analiza përcaktoi dy pyetje – indikatorë për gjendjen. Plani aksional i Programit shtetëror parasheh katër aktivitete në këtë sferë, prej të cilave, deklarata e detyrueshme për konflikt të interesave dhe shpallja e detyrueshme e sponsorimeve, nga ana e komunitetit afarist, u vlerësuan si ngarkesë plotësuese në procedurën edhe ashtu të ndërlikuar për shfrytëzimin e stimulimeve tatimore që i ofron shteti. Sa i përket zgjidhjeve ligjore, analiza e vërtetoi nevojën për futjen e elementeve të detyrueshme antikorruptive në kontratat për donacion/sponsorim, por konstatoi se në këtë sferë mungojnë edhe dispozita të veçanta në modelet për kodet etike në sektorin privat. Përveç kësaj, është konstatuar edhe mungesë e obligimit ligjor për të mbajtur regjistër të donacioneve dhe të sponsorimeve në veprimtaritë publike, si dhe për të pasur bazë publike të të dhënave për donacionet dhe sponsorimet që janë si rezultat i stimulimeve tatimore. Është vërtetuar se ka transparencë të pamjaftueshme në sektorin privat, në aspekt të donacioneve dhe të sponsorimeve që i jep ky sektor.

Rekomandime

Në bazë të analizës janë dhënë këto rekomandime të përgjithshme, të cilat janë shqyrtuar më detajisht në pjesën e konstatimeve të analizës dhe në pjesën e pasqyrës dhe të caktimit të prioriteteve të rekomandimeve:

- Problemi 1 – masat e pazhvilluara sa duhet për parandalimin e korrupsionit dhe përforcimin e integritetit të sektorit privat
 - o nxitje për zhvillimin dhe zbatimin e standardeve dhe të procedurave përkatëse për mbrojtjen e integritetit të subjekteve nga sektori privat (prioriteti 1)
 - o krijimi i bazave të përditësuara të të dhënave për kontrollimin e pronësisë së fundit dhe të kontrollit të fundit mbi ndërmarrjet, dhe vënia e tyre në dispozicion (prioriteti 2)
 - o përforcimi i zbatimit të kufizimeve që kanë të bëjnë me aktivitetet e personave të mëparshëm zyrtar (prioriteti 1)
 - o avancimi dhe centralizimi i publikimit onlajn të personave nga sektori privat që kanë pranuar mjete publike në çfarëdo forme (për shembull, subvencione, ndihmë shtetërore, prokurime publike), vlera e tyre dhe për çfarë kanë qenë të dedikuara (prioriteti 2)
- Problemi 2 – njohuritë e pamjaftueshme për korrupsionin dhe konfliktin e interesave në sektorin privat
 - o Avancimi i bashkëpunimit ndërmjet organeve të rendit dhe subjekteve afariste (prioriteti 1)
 - o Nxitja e autoriteteve nga ana e sektorit privat për parandalimin dhe represionin e korrupsionit (prioriteti 2)
 - o Bashkëpunimi me iniciativat antikorruptive të shoqërisë civile dhe përkrahja e tyre financiare nga ana e sektorit privat (prioriteti 1)
- Problemi 3 – informimi i pamjaftueshëm për Ligjin për mbrojtje të konkurrencës dhe kapaciteti i pamjaftueshëm i Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës (KMK) për zbatimin e ligjit
 - o Avancimi i shkathtësive, potencialit kadrovik të organeve shtetërore dhe i mekanizmave për parandalimin dhe zbulimin e kontratave të ndaluara, në të cilat janë përfshirë ofruesit gjatë prokurimeve publike (prioriteti 1)
 - o Edukimi dhe përkrahja e mëtutjeshme e subjekteve afariste për rregullativën që ka të bëjë me mbrojtjen e konkurrencës dhe zbatimin e saj (prioriteti 2)

- Problemi 4 – transparenca e pamjaftueshme e sponsorimeve, prapa së cilës fshihet mundësia për korrupsion
 - o avancimi i mekanizmave për integritet që t’i përfshijnë në mënyrë adekuate donacionet dhe sponsorimet (prioriteti 1)
 - o mbajtja e evidencës adekuate për donacionet dhe sponsorimet që janë rezultat i stimuleve tatimore (prioriteti 2)

HYRJE

Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit (KSHPK) rregullisht e përcjell realizimin e aktiviteteve të “Programit shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe parandalimin dhe zvogëlimin e konfliktit të interesave 2011–2015” (Programi shtetëror). Për këtë qëllim përdor indikatorë të aktivitetit dhe indikatorë të efektivitetit.

Misioni i OSBE-së në Shkup realizon aktivitete disaveçare në përkrahje të implementimit të Programit shtetëror. Në vitin 2012, Misioni bashkëpunoi me KSHPK-në për zhvillimin e metodologjisë për vlerësim cilësor të aktiviteteve dhe të indikatorëve nga Programi shtetëror, me pilot analizë cilësore për sektorin e arsimit dhe sportit, me vlerësim të perceptimit të publikut për tre sektorë nga Programi shtetëror, si dhe me përforsim të kapaciteteve të KSHPK-së për zhvillimin e konceptit të integritetit dhe të evidencës elektronike të të dhënave. Në vitin 2013, KSHPK-ja e vazhdoi bashkëpunimin me Misionin e OSBE-së në Shkup, në kuadër të projektit “Promovimi i parimeve për qeverisje të mirë në zbatimin e politikës antikorruptive”. Kjo rezultoi me përkrahje për përgatitjen e analizës cilësore dhe realizimin e hulumtimit të mendimit publik për tre sektorë të rinj nga Programi shtetëror – sektorin privat, sektorin politik dhe vetëqeverisjen lokale.

Ky dokument është raport nga analiza e kryer cilësore në pjesën e sektorit privat. Edhe pse analiza, në thelb, merret me probleme që ndërliken me gjithë sektorin afarist, formalisht ajo është e orientuar kah ndërmarrjet që më shumë se gjysma janë në pronësi private. Megjithatë, kjo nuk duhet t’i pengojë organet shtetërore dhe ndërmarrjet që janë në pronësi të shtetit, që t’i përdorin njohuritë për avancim të mëtutjeshëm të integritetit të kompanive që janë pjesë e sektorit publik – në definicionin e tij më të gjerë. Në këtë drejtim, edhe KSHPK-ja duhet të vlerësojë se a ka nevojë të futet pjesë e veçantë në Programin shtetëror, që është e orientuar në mënyrë specifike kah ndërmarrjet që janë në pronësi të shtetit. Edhe përkundër asaj se rregullativa ligjore për subjektet afariste që janë në pronësi private, vlen edhe për ato që janë në pronësi shtetërore, këto të fundit kanë përgjegjësi më gjera, prandaj, për to vlejné edhe mekanizma plotësuese rregullatore dhe dispozita plotësuese ligjore⁴⁰.

Metodologjia e analizës është e bazuar në konceptin e Sistemit nacional për integritet të “Transparency International”, si dhe në dispozitat e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit, që kanë të bëjnë me sektorin privat. Problemet e shqyrtuara janë marrë nga Programi shtetëror. Nën çdo problem janë përcaktuar indikatorë për gjendjen dhe përparimin, si dhe rekomandime për përmirësimin e rezultateve. Me indikatorët vlerësohen tre aspekte, gjegjësisht kategori – (1) kapaciteti për funksionim i sektorit, i ndarë në dy nënkategori, që të mund të vlerësohen resurset institucionale dhe pavarësia, (2) udhëheqja vetanake, në kuptim të ekzistimit të transparencës dhe të mekanizmave për integritet, që paraqiten si dy nënkategori, (3) kontributi ndaj integritetit të gjithmbarshëm, i shprehur nëpërmjet nënkategorive të angazhimit të sektorit privat në politikën nacionale antikorruptive dhe të përkrahjes së iniciativave qytetare antikorruptive. Në kategorinë e udhëheqjes, metodologjia lejon përdorimin edhe të një nënkategorie - llo-

⁴⁰ Për shembull, Ligji për parandalimin e korrupsionit, në të cilin, përveç dispozitave që do të vlejné për të gjitha shoqatat tregtare, ka edhe dispozita të veçanta për ndërmarrjet publike dhe personat e tjerë juridikë që disponojné me kapital shtetëror.

garidhënies. Ajo është e lidhur me cilësinë e udhëheqjes korporative dhe mbikëqyrjen e tij, dhe në të ardhmen analiza mund të jetë më gjithëpërfshirëse, duke i përfshirë edhe këto aspekte.

Si burime të të dhënave u shfrytëzuan:

- Analiza juridike – analiza e ligjeve relevante, akteve nënligjore dhe dokumente dhe raporte të tjera zyrtare.
- Intervista me burime kyçe të informatave, edhe atë me Odën Ekonomike të vendit, Konfederatën e Biznesit të vendit, Byronë për prokurime publike, Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës dhe Ministrinë për Drejtësi. Ftesa iu dërguan edhe Lidhjes së Odave Ekonomike të vendit dhe Odës Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore.

Në bazë të të dhënave të mbledhura, në qershor të vitit 2013, hulumtuesi përgatiti propozim-vlerësime për secilin indikator, edhe atë nga dy aspekte – de jure, sa i përket kornizës ligjore, dhe de facto, gjegjësisht gjendjes në praktikë. Përrjashtim paraqet kategoria për kontributin ndaj integritetit të gjithmbarshëm, ku ka vetëm nga një notë për çdo indikator, gjegjësisht nota ka të bëjë edhe me kornizën ligjore edhe me gjendjen në praktikë. Gjatë vlerësimit të indikatorëve, për kornizën ligjore është përdorur shkalla në tre nivele prej 1 deri në 5, me ç’rast: 1 = jo (nuk ekziston korniza adekuate ligjore), 3 = pjesërisht, 5 = po. Për vlerësimin e gjendjes në praktikë është përdorur shkalla në pesë nivele prej 1 deri në 5, me ç’rast: 1 = në masë shumë të vogël, 2 = në masë të vogël, 3 = në masë të caktuar, 4 = në masë të madhe, 5 = në masë shumë të madhe.

Rezultatet u prezantuan para faktorëve relevantë dhe u verifikuan prej tyre, të cilët diskutuan për konstatimet dhe për vlerësimet në lidhje me pyetjet e indikatorëve, me qëllim që të verifikohen, të konfirmohen ose të plotësohen të dhënat dhe rezultatet. Në bazë të këtij verifikimi, bëhet edhe finalizimi i analizës.

Për t’i paraqitur në mënyrë më të qartë, notat e veçanta janë mbledhur, dhe mesi aritmetik është paraqitur në pjesën “Pasqyra e indekseve”, si notë e përgjithshme për çdo nënkategori, kategori dhe për gjithë shtyllën⁴¹ që ka të bëjë me sektorin privat. Në pjesën e njëjtë, notat e mbledhura janë shprehur edhe si përqindje e notës maksimale të mundshme. Megjithatë, duhet theksuar se, para së gjithash, kjo është analizë cilësore, kështu që notat e dhëna janë vetëm indikative.

Pas kësaj hyrjeje janë dhënë konstatimet e analizës, e më pas pasqyra e rekomandimeve dhe caktimi i prioriteteve të tyre, pasqyra e indekseve, si dhe lista e literaturës së shfrytëzuar.

⁴¹ Qasja e sistemit nacional për integritet e “Transparency International” i vlerëson “shtyllat” kryesore në sistemin për udhëheqje të mirë të një vendi. Njëra nga shtyllat ka të bëjë me sektorin privat.

KONSTATIME

Problemi i korrupsionit dhe i konfliktit të interesave në sektorin privat në Programin shtetëror është përpunuar nëpërmjet katër problemeve:

1. masat e pazhvilluara sa duhet për parandalimin e korrupsionit dhe përforcimin e integritetit të sektorit privat;
2. njohuritë e pamjaftueshme për korrupsionin dhe konfliktin e interesave në sektorin privat;
3. informimi i pamjaftueshëm për Ligjin për mbrojtje të konkurrencës dhe kapaciteti i pamjaftueshëm i Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës (KMK) për zbatimin e ligjit;
4. transparenca e pamjaftueshme e sponsorimeve, prapa të cilës fshihet mundësia për korrupsion

Në këtë analizë cilësore janë parashtruar njëmbëdhjetë pyetje-indikatorë për problemet e lartpërmendura. Këto pyetje-indikatorë, më shpesh, janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me aktivitetet e parapara në Programin shtetëror, por ekzistojnë edhe raste kur identifikojnë ndonjë aspekt të problemit që duhet të merret parasysh në mënyrë plotësuese nga KSHPK-ja, organet tjera dhe faktorët e sektorit privat.

REZULTATET NGA ANALIZAT KUALITATIVE

Problemi / faktori i rrezikut 1:
Masat e pazhvilluara sa duhet për parandalimin e korrupsionit dhe përforcimin e integritetit të sektorit privat
Arsyetimi:
Në përputhje me Konventën e Kombeve e Bashkuara kundër korrupsionit, duhet të futen masa për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave në sektorin privat.

Institucioni: KSHPK-ja dhe organet e tjera relevante; odat ekonomike dhe organizatat e punëdhënësve; Bursa për letra me vlerë e vendit

Kategoria: Udhëheqja – mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A nxitet zhvillimi dhe zbatimi i standardeve dhe i procedurave për mbrojtjen e integritetit të subjekteve nga sektori privat – duke i përfshirë edhe kodet e sjelljes për kryerje korrekte, të ndershme dhe të drejtë të aktiviteteve afariste dhe të aktiviteteve të të gjitha profesioneve relevante – si dhe për pengimin e konfliktit të interesave dhe zbatimin e praktikave të mira komerciale ndërmjet subjekteve afariste, dhe gjithashtu edhe në raportet e tyre kontraktuese me shtetin?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi për notën e dhënë:

Në përputhje me nenin 12.2. (b) të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit, Plani aksional i Programit shtetëror parasheh aktivitetet për miratimin e kodeve të sjelljes për kryerjen korrekte, të përgjegjshme dhe të drejtë të aktiviteteve afariste, për parandalimin e konfliktit të interesave, dhe për zbatimin e praktikave të mira, në bashkëpunim ndërmjet subjekteve private dhe atyre shtetërore.

Në vend ka së paku tre modele të përgjithshme të *kodeve për etikë afariste*⁴², një pjesë e të cilave janë përgatitur ose janë promovuar në bashkëpunim me shtetin:

- “Kodi etik afarist” i promovuar nga Konferedata e biznesit të vendit dhe Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit;
- “Kodi i etikës dhe sjelljes afariste të shoqatave aksionare”,⁴³ dhe “Kodi i etikës dhe sjelljes afariste për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”⁴⁴ të përgatitura nga Transparency International dhe Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore.

Bursa për letra me vlerë e vendit ka *Kodin për udhëheqje korporative të shoqatave aksionare*⁴⁵ që janë të listuara në bursë. Ai është i detyrueshëm për shoqatat që janë të listuara në segmentin Super listimi, dhe ato janë të obliguara që njëherë në vit të dorëzojnë raport me deklaratë për atë se a i ka zbatuar kompania parimet dhe secilën dispozitë të Kodit, e për ato që nuk janë zbatuar të japë arsytim se pse nuk e ka bërë këtë. Sektori joqeveritar, gjithashtu është aktiv në promovimin e kornizave për programe antikorruptive për subjektet afariste. Për shembull, në vitin 2010 është përkthyer dhe është publikuar në maqedonisht iniciativa e Transparency International, “Parimet afariste për luftën kundër mitës.”⁴⁶

Megjithatë, modelet e përgjithshme të kodeve nuk përmbajnë dispozita të veçanta për donacionet dhe sponsorimet dhe për furnizimet publike – të cilat kanë rrezik të madh për paraqitjen e korrupsionit dhe të konfliktit të interesave – ndërsa dispozitat për nxitjen e denoncimit të shkeljeve që kanë të bëjnë me kodet, ligjet dhe mbrojtjen e denoncuesve nuk janë të detajuara sa duhet.

Ka edhe disa *kode etike në nivel të degëve të veçanta ekonomike ose profesionit*, si për shembull:

- Kodi etik i ndërmjetësuesve për shitblerje të patundshmërive i Grupacionit të agjencive për patundshmëri pranë Odës Ekonomike të vendit
- Kodi etik i këshilltarëve që është promovuar nga Agjencia për përkrahjen e ndërmarrësisë;
- Kodi etik i specialistëve për marrëdhënie me publikun (PR), i Asociacionit për marrëdhënie me publikun i vendit;
- Kodi etik i anëtarëve të Shoqatës për marrëdhënie me publikun të vendit;
- Kodi për etikë profesionale të avokatëve, bashkëpunëtorëve profesionalë të avokatëve, dhe avokatëve praktikantë të Odës së avokatëve të vendit.

42 Në literaturë ndonjëherë bëhet dallim ndërmjet kodit të sjelljes dhe kodit etik. Gjatë kësaj, i pari më tepër ka të bëjë me definimin e rregullave për sjellje të pranueshme, ndërsa kodi etik më tepër fokusohet në përshkrimin e vlerave të përgjithshme, si dhe në përkrahjen e organizatës për zbatimin e këtyre vlerave në punën e përditshme. Për nevojat e këtij dokumenti, të dyja shprehjet konsiderohen sinonime. Për më tepër informata për dallimin ndërmjet këtyre dy instrumenteve shih p.sh. faqet 34–35 të: Towards a Sound Integrity Framework: Instruments, Processes, Structures and Conditions for Implementation, OECD, 2010.

43 http://www.transparency.org.mk/images/stories/eticki_kodeks_za_akcionerski_drustva.pdf

44 http://www.transparency.org.mk/images/stories/eticki_kodeks_za_mali_i_sredni_pretpriyatija.pdf

45 http://www.mse.mk/Repository/UserFiles/File/Misev/Regulativa/Akti%20na%20berza/Kodeks_za_korporativno_uprvuvanje.pdf

46 http://www.transparency.org.mk/images/stories/bpcb_macedonian_ver.pdf

Për disa kategori të caktuara të subjekteve afariste ekziston edhe obligim ligjor për përgatitjen dhe zbatimin e kodeve etike dhe futjen e *kontrollit për harmonizim e punës me dispozitat*. Në përputhje me nenin 93 të Ligjit për *bankat*, këshilli drejtues i bankës përgatit kod etik, ndërsa sipas nenit 100, personat me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta janë të obliguar që rregullisht, çdo gjashtë muaj, të japin deklaratë me shkrim për ekzistimin ose mosekzistimin e konfliktit të interesave. Sipas nenit 99 të po këtij ligji, këshilli drejtues i bankës është i obliguar të emërojë person ose të organizojë shërbim për kontroll të harmonizimit të punës së bankës me dispozitat, me qëllim të identifikimit dhe të ndjekjes së rreziqeve nga mosharmonizimi i punës së bankës me dispozitat. Si rrezik i mosharmonizimit me dispozitat konsiderohet edhe rreziku nga masat e shqiptuara nga ana e Bankës Popullore, nga humbjet financiare dhe rreziku i reputacionit, si pasojë e lëshimeve në harmonizimin e punës së bankës me dispozitat. Për kontrollin e harmonizimit të punës së bankës me dispozitat dorëzohet raport mujor deri te këshilli drejtues dhe raport tremujor deri te këshilli mbikëqyrës. Për mospërbushjen e këtyre obligimeve është paraparë gjobë për bankën, për personin përgjegjës dhe për personin me të drejta dhe autorizime të veçanta në bankë. Sipas nenit 21 të Ligjit për fonde investuese, *shoqatat për udhëheqje me fondet investuese* duhet të miratojnë kod për sjellje etike në punë, si dhe rregullore për konfliktin e interesave. Sipas nenit 28, shoqatat për udhëheqje me fondet investuese duhet të kenë të punësuar person përgjegjës për kontroll të harmonizimit të punës së shoqatës me dispozitat. Për mospërbushjen e këtyre obligimeve është paraparë gjobë për personin juridik dhe për personin përgjegjës të personit juridik, si dhe ndalesë e përkohshme për kryerjen e veprimtarisë së shoqatës.

Rregullativa e vendit, për dallim nga praktikat më të mira nga vendet e tjera, nuk mundëson në mënyrë eksplicite *trajtim më të favorshëm të kompanive* që kanë miratuar standarde dhe procedura për mbrojtjen e integritetit dhe për parandalimin e konfliktit të interesave. Për shembull, në SHBA janë paraparë⁴⁷ tetë kritere minimale⁴⁸ të programit organizativ për t'iu përmbytur ligjeve dhe dispozitave të tjera, e gjithashtu edhe për sjellje etike, në bazë të të cilit, organizata mund të ketë të drejtë për sanksion të zvogëluar në qoftë dënohet.⁴⁹ Gjithashtu, udhëzimet e përmendura rekomandojnë që gjykatat t'i obligojnë organizatat që janë të dënuara me dënim me kusht, të miratojnë program për t'iu përmbytur ligjeve dhe dispozitave të tjera, si dhe program për sjellje etike. Më këto dy masa nxiten organizatat, duke i përfshirë edhe ndërmarrjet, të miratojnë programe të këtilla. Në Britaninë e Madhe, udhëzimi i ministrisë britaneze për drejtësi⁵⁰ definon gjashtë parime për zhvillimin e programit efektiv për t'iu përmbytur dispozitave kundër mitës. Ligji kundër mitës në Britaninë e Madhe⁵¹ i mbron kompanitë nga përgjegjësia penale në qoftë se kanë pasur procedura përkatëse, të dedikuara për parandalimin e mitës (sikurse ato që janë shënuar në udhëzimin e përmendur), mirëpo të cilat janë shkelur nga ndonjë i punësuar i tyre ose ndonjë person tjetër i lidhur me ta.⁵²

Sipas nenit 28-a të Kodit penal të vendit, personi juridik është përgjegjës për veprën penale që e ka kryer ndonjë i punësuar ose përfaqësues i tij, me të cilën është realizuar përfitim i konsiderueshëm material ose dikujt tjetër i është shkaktuar dëm i konsiderueshëm, nëse deri te vepra ka ardhur për shkak të lëshimit të mbikëqyrjes së detyrueshme të organit për administrim, organit udhëheqës ose organit mbikëqyrës. Kjo mund të vlejë edhe për raste të korrupsionit (për shembull, mitës), por paraqet një formulim implicit dhe shumë të kufizuar në krahasim me zgjidhjet që përdoren në SHBA dhe në Britaninë e Madhe. Kjo na çon te kriteret për sistemet

47 Federal Sentencing Guidelines for Organizations, United States Sentencing Commission, http://www.ussc.gov/Guidelines/2012_Guidelines/index.cfm.

48 Gjenden në këtë link: http://www.ussc.gov/Guidelines/2012_Guidelines/Manual_HTML/8b2_1.htm.

49 Zvogëlimi i sanksionit për këtë arsye, në praktikë është i përealizueshëm kur bëhet fjalë për rastet antitrust.

50 <http://www.justice.gov.uk/downloads/legislation/bribery-act-2010-guidance.pdf>

51 <http://www.legislation.gov.uk/ukpga/2010/23>

52 Neni 7 i Ligjit parasheh vepër të re kundërligjore për subjektet afariste, të cilat nuk do të arrijnë ta parandalojnë personin të japë mitë në dobi të tyre.

adekuate për mbikëqyrje të personave juridik. Gjithashtu, me nenin e njëjtë të ligjit, personi juridik është përgjegjës për veprën penale edhe në qoftë se organi për administrim, organi udhëheqës ose organi mbikëqyrës nuk e kanë penguar kryerjen e saj. Me këtë zvogëlohet stimulimi ligjor për personat juridik që të zhvillojnë sisteme adekuate për mbikëqyrje, për shkak se, pa marrë parasysh kualitetin e sistemeve të tilla, ata mund të jenë përgjegjës për një vepër të këtillë penale edhe vetëm për faktin se nuk e kanë penguar atë.

Sipas nenit 147 të Ligjit për furnizime publike, operatorët ekonomikë dorëzojnë *deklaratë se në pesë vitet e fundit nuk u është shqiptuar vendim i plotëfuqishëm gjyqësor* për pjesëmarrje në ndonjë organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim ose larje parash. Në qoftë se është marrë ndonjë vendim i tillë gjyqësor, sipas nenit 146 të po këtij ligji, operatori ekonomik përjashtohet nga procedura për dhënien e kontratës për furnizim publik. Mund të konsiderohet se edhe dispozita e këtillë ndihmon në mënyrë indirekte që subjektet afariste të zhvillojnë sisteme për mbrojtjen e integritetit.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi për notën e dhënë:

Sipas një ankete relevante⁵³, menaxherët e vendit japin notë mesatare për sjelljen etike të subjekteve afariste në raportet e tyre me kompanitë e tjera, nëpunësit shtetëror dhe politikanët. Është me rëndësi të theksohet se sa i përket këtij aspekti të klimës afariste, vendi është i ranguar më poshtë në raport me treguesit e tjerë dhe e zë vendin e 100-të në listën me 144 vende⁵⁴.

Përkundër ekzistimit të llojeve të shumta të kodeve që kanë të bëjnë me biznesin në vend, është pikëpyetje se sa ato zbatohen në praktikë. Miratimi i një kodi etik në një kompani është hapi i parë për avancimin e sistemeve për integritet, por ai nuk do të japë rezultate në qoftë se kompania nuk i kushton vëmendje edukimit të të punësuarve dhe aktorëve të tjerë sa i përket kodit dhe zbatimit të tij në punën e përditshme, në qoftë se nuk parashesh shpërblime dhe sanksione për respektimin ose mosrespektimin e tyre në politikat për burime njerëzore, në qoftë se nuk zhvillon kanale për dhënien e këshillave dhe parashtrimin e ankesave. E hapur është edhe çështja se sa modelet e kodeve përshtaten dhe pranohen nga kompanitë. Tre kodet e përgjithshme për etikë afariste që u përmendën më lartë nuk i nënshtrohen mekanizmave të veçantë për mbikëqyrje të zbatimit të tyre dhe për sanksionim të mospërputhjeve eventuale. Një pjesë e kodeve të degëve afariste, gjegjësisht kodeve profesionale, kanë të parapara organe që i shqyrtojnë rastet e mospërputhjeve të mundshme me dispozitat e kodeve, dhe të cilat kanë mundësi të propozojnë masa korrigjuese. Megjithatë, gjatë hulumtimit nuk u gjetën të dhëna të publikuara për aktivitetin e këtyre organeve dhe për rezultatet e tyre në aspekt të sigurimit të respektimit të dispozitave të kodeve, që le çështje të hapura sa i përket funksionalitetit të tyre.

Kyçja e shtetit në zhvillimin dhe promovimin e kodeve të sjelljes⁵⁵ dhe në masat e tjera të ngjashme, kontribuon në implementimin e tyre efektiv. Praktika të mira nga vendet e tjera të cilat mund t'i zbatojnë edhe organet tona shtetërore janë: dhënia e sqarimeve për përgjegjë-

53 Global Competitiveness Report 2012-2013, World Economic Forum, fq. 241.

54 Sipas hulumtimit të njëjtë, Shqipëria, Turqia, Kroacia dhe Mali i Zi, janë të ranguar më lartë në rajonin e Evropës Juglindore sa i përket kësaj çështjeje.

55 United Nations Convention against Corruption, article 12(2b).

sitë ligjore nga instrumentet e këtilla; dhënia e shembujve praktikë për çështje me të cilat mund të ballafaqohen të punësuarit në sektorin privat, e të cilat mund të përfshihen me instrumentet e këtilla; sqarimi i procedurave dhe dhënia e përkrahjes për sjelljen e drejtë dhe të pranueshme gjatë rasteve kur mund të paraqiten dilema te entitetet private; rekomandimi i doracakëve dhe i rregullave të zhvilluara nga institucionet ndërkombëtare⁵⁶ që të shërbejnë si bazë për zhvillimin e kodeve vendore; publikimi i listave të kompanive që janë të obliguara t'i respektojnë parimet anti-korruptive dhe i raporteve të tyre periodike në këtë sferë; nxitja e bashkëpunimit, transparencës dhe integritetit në disa degë ekonomike me rrezik të lartë, për shembull industria ekstraktuese, industria farmaceutike, ose ndërtimtaria; nxitja për miratimin e kodeve etike, pakteve për integritet⁵⁷, programeve për trajnim për integritet, procedurave për denoncimin e mashtrimit dhe të korrupsionit në mesin e subjekteve afariste private që pranojnë mjete publike (për shembull, subjektet afariste që kanë nënshkruar kontratë për furnizim publik).

Rekomandime

- Caktimi i standardeve minimale për programin organizativ për t'iu përmbajtur ligjeve dhe dispozitave të tjera, dhe për sjellje etike, në bazë të të cilit ndërmarrjet mund të kenë të drejtë për sanksion të zvogëluar për veprime të kryera kundërligjore.
- Plotësimi i modeleve të kodeve etike dhe të kodeve për sjellje të mirë korporative me dispozita të detajuara për:
 - o parandalimin e korrupsionit gjatë donacioneve, sponsorimeve dhe furnizimeve publike;
 - o nxitjen për denoncimin e dyshimeve për korrupsion dhe aktivitetet e tjera joligjore, futjen e procedurave dhe kanaleve për denoncim, mbrojtjen e personave që bëjnë denoncime të tilla, dhe sanksione kundër hakmarrjes ose diskriminimit ndaj personave të tillë;
 - o sistemin për mbikëqyrje dhe respektim të kodeve në nivel të kompanisë, por edhe në nivel të degës ekonomike, rajonit ose ekonomisë.
- Fushatë publike me përkrahje nga organet shtetërore për pranim më të madh të kodeve etike dhe të kodeve për udhëheqje të mirë korporative nga ana e subjekteve afariste, duke përfshirë edhe publikimin e emrave të kompanive që kanë miratuar ndonjë kod të caktuar. Fushata duhet t'u kushtojë vëmendje të veçantë degëve ekonomike dhe aktivitetet që kanë rrezik më të madh për korrupsion.
- Publikimi i mekanizmave për mbikëqyrje dhe respektim të kodeve dhe të rezultateve të arritura.

Institucioni: Ministria për ekonomi, Regjistri qendror, Depozituesi qendror i letrave me vlerë, Bursa për letra me vlerë e vendit, Komisioni për letra me vlerë

Kategoria: Udhëheqja – transparenca

Pyetja-indikator: A duhet të kërkohet nga ndërmarrjet të kenë të dhëna për personat juridik dhe fizik që e kanë pronësinë e fundit ose kontrollin e fundit mbi ndërmarrjet, ndërsa nga investuesit dhe të autorizuarit të dorëzojnë të dhëna për pronësinë e fundit dhe kontrollin e fundit mbi ndërmarrjet?

⁵⁶ Për shembull "Good practice guide on internal controls, ethics and compliance" dhe "Principles on Corporate Governance" të OBEZH-it, "Rules of Conduct and Recommendations on Combating extortion and bribery" nga International Chamber of Commerce, "Business Principles for Countering Bribery" nga Transparency International, "Principles for Countering Bribery" nga "Partnering against Corruption Initiative" (PACI) nga World Economic Forum.

⁵⁷ Pakti për integritet është marrëveshje ndërmjet organit kontraktues dhe bartësit të furnizimit që i definon disa rregulla dhe procedura anti-korruptive, duke përfshirë edhe sistem për mbikëqyrje. Resurse mund të gjenden në këtë ueb-faqe: http://www.transparency.org/whatwedo/tools/resources_about_integrity_pacts/3/

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi për notën e dhënë:

Neni 12.2.(c) i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit e potencon nevojën për zhvillimin e transparencës te subjektet e sektorit privat, duke e përfshirë edhe identifikimin e personave juridik dhe fizik që janë të përfshirë në pronësinë dhe udhëheqjen e ndërmarrjeve.

Rreziqet për korrupsion, konflikt të interesave dhe lloje të ndryshme të keqpërdorimeve janë më të mëdha në kushte kur nuk është transparent identiteti i personave që luajnë rol të rëndësishëm në themelimin e subjekteve afariste dhe në menaxhimin e tyre. Praktika në botë tregon se te rastet e mëdha korruptive, korporatat shfrytëzohen për t'u fshehur identiteti i personave fizik që janë të përfshirë në korrupsion.⁵⁸ Sipas rekomandimeve të FATF-së të vitit 2012,⁵⁹ vendet duhet të sigurojnë të dhëna për *pronësinë e fundit*⁶⁰ të kompanive, të cilat duhet të vihe në dispozicion ose në nivel të kompanisë, ose në nivel të regjistrit të shoqatave tregtare.⁶¹

Programi shtetëror nuk e trajton këtë çështje, prandaj më poshtë është dhënë një pasqyrë e gjendjes, me qëllim që të vlerësohet se a ia vlen të zhvillohet një aktivitet përkatës në këtë sferë.

Sipas rregullativës që është në fuqi në vend, Regjistri qendror mban evidencë për pronarët nominalë të shoqatave tregtare dhe personave të tjerë juridik.⁶²

Sipas nenit 11 të Ligjit për parandalimin e larjes së parave dhe të ardhurave tjera nga vepra ndëshkuese dhe financimi i terrorizmit, institucionet financiare dhe disa kategori të tjera të personave juridik⁶³ duhet ta identifikojnë dhe ta vërtetojnë pronarin e fundit të klientit që është subjekt juridik. Kur nuk mund ta vërtetojnë identitetin e pronarit të fundit në ndonjë mënyrë tjetër, duhet të marrin deklaratë për pronar të fundit nga klienti, të cilën pastaj janë të obliguar ta vërtetojnë në bazë të të dhënave nga "burime të pavaruara dhe të sigurta".

Sipas nenit 67 të Ligjit për letra me vlerë, Depozituesi qendror i letrave me vlerë është i obliguar që në ditën e parë të punës të çdo muaji, në ueb-faqen e tij të publikojë listë të personave fizik dhe juridik që posedojnë mbi 5% të cilësdo qoftë klasë të letrave me vlerë në shoqatat aksionare, të cilat mbahen në Regjistrin e shoqatave aksionare me obligime të veçanta. Depozituesi publikon edhe arkiv të listave të këtilla⁶⁴. Sipas nenit 158 të po këtij ligji, shoqatat aksionare që janë të regjistruara në Regjistrin e shoqatave aksionare me obligime të veçanta, janë të obliguara që në afat prej një ditë pune, deri te Komisioni për letra me vlerë të dorëzojnë raport, në qoftë se ka ndonjë informatë që ndikon në çmim – për shembull përfitim ose tjetërsim të mbi 5% të mjeteve

58 van der Does de Willebois, Emile; Halter, Emily M.; Harrison, Robert A.; Park, Ji Won; Sharman, J. C.. 2011. The Puppet Masters : How the Corrupt Use Legal Structures to Hide Stolen Assets and What to Do About It. © World Bank, fq. 17; <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/2363> License: CC BY 3.0 Unported.

59 Rekomandimet e FATF-së nga muaji shkurt i vitit 2012, http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/pdfs/FATF_Recommendations.pdf

60 Pronësia nominale ka të bëjë me personat fizikë dhe juridikë që i posedojnë ose i kontrollojnë ndërmarrjet. Pronësia e fundit i vërteton edhe personat fizikë që qëndrojnë prapa ndonjë personi juridik që paraqitet si pronar nominal i ndonjë ndërmarrjeje, ose lidhjet ndërmjet personave fizikë dhe personave juridikë që mund të shfrytëzohen për kontroll të ndonjë ndërmarrjeje.

61 Shihni edhe propozimin e Komisionit Evropian për direktivën e katërt për parandalimin e larjes së parave "Proposal for a Directive on the prevention of the use of the financial system for the purpose of money laundering and terrorist financing", COM/2013/045 final - 2013/0025 (COD).

62 Regjistri nuk i shënon ndryshimet në pronësinë e shoqatave aksionare pas themelimit të tyre.

63 Për shembull, ata që merren me shitblerje të patundshmërive, shitblerje të veturave, shërbime të revizionit dhe të kontabilitetit, shërbime notere, shërbime të avokaturës dhe shërbime të tjera juridike; shërbime konsultative; këshilltarë për investime dhe për tatime.

64 <http://www.cdhv.mk/default-MK.asp?ItemID=81>

të shoqatës aksionare, dorëheqje, shkarkim ose emërim të anëtarëve në organet udhëheqëse. Këtë raport, Komisioni e publikon në ueb-faqen e tij, ndërsa në afat prej pesë ditësh, shoqata duhet atë ta publikojë në një gazetë të përditshme. Sipas nenit 166-b, shoqatat aksionare dhe personat e tjerë juridik – emitues të letrave me vlerë, letrat e të cilëve me vlerë nuk listohen në bursë dhe nuk janë të regjistruara në Regjistrin e shoqatave aksionare me obligime të veçanta për raportim, janë të obliguara që në ueb-faqen e bursës për letra me vlerë t’i publikojnë ndryshimet mbi 10% në strukturën pronësore, dhe ndryshimet në organet e administrimit dhe të udhëheqjes në afat prej dhjetë ditësh. Sipas nenit 38 të Rregullave për listim në Bursën e letrave me vlerë të vendit, shoqatat e listuara duhet të publikojnë njoftim për të gjitha ndryshimet në pronësi, gjatë të cilave disa pronarë kanë përfituar 5% të kapitalit aksionar me të drejtë vote, si dhe kur ata e kanë zvogëluar pjesëmarrjen e tyre. Megjithatë, të gjitha këto informata për të cilat ekziston obligim ligjor për raportim ose për publikim kanë të bëjnë me *pronësinë nominale* të shoqatave aksionare, por nuk është e thënë që ato t’i zbulojnë edhe personat fizik që qëndrojnë prapa personave juridik - pronarë të letrave me vlerë.

Nga ajo që u tha më lartë, mund të përfundojmë se rregullativa ligjore e vendit kërkon detyrimisht nga kompanitë që të disponojnë, por edhe t’i dorëzojnë të dhënat për pronarët e tyre nominalë, *por më shpesh, jo edhe për pronarët e fundit*. Regjistri i shoqatave tregtare dhe i personave të tjerë juridik, gjithashtu është i kufizuar vetëm në mbajtjen e të dhënave për pronësinë nominale. Vetëm nga kompanitë që merren me veprimtari të caktuara me rrezik të lartë për larje parash, të definuara me Ligjin për parandalimin e larjes së parave dhe të ardhurave tjera nga vepra ndëshkuese dhe financimi i terrorizmit, kërkohen të mblidhen të dhëna edhe për pronësinë e fundit të klientëve.

Gjithashtu, ekzistojnë edhe *mekanizma për përforcimin e kontrollit mbi subjektet afariste*, që, pavarësisht nga pronësia mund të shfrytëzohen nga ndonjë person fizik, ose nga ndonjë person fizik që vepron nëpërmjet ndonjë personi juridik, për realizimin e kontrollit efektiv mbi kompanitë. Për shembull, Ligji për shoqatat tregtare me nenet 392, 392-b dhe 392-c mundëson që aksionerët të mund të përfaqësohen nga ndonjë person i autorizuar në kuvendin e aksionarëve. Një person i autorizuar mund të përfaqësojë më tepër aksionarë, ndërsa kompanitë janë të obliguara të ruajnë të dhëna për autorizimet e dhëna për kuvende të caktuara të aksionarëve. Më parë ligji i kufizonte autorizimet e këtilla që të vlejnin vetëm për një kuvend të aksionarëve, por me ndryshimet e vitit 2011, autorizimi i dhënë mund të vlejë edhe deri në dy vjet. Me këtë, është shtuar rreziku që autorizimet e aksionarëve të shfrytëzohen si mekanizëm i rëndësishëm për përforcimin e kontrollit mbi subjektet afariste. Aksionarët janë të obliguar t’i njoftojnë shoqatat për autorizimet e këtilla, por përveç për shoqatat që janë të listuara në bursë dhe për ato me obligime të veçanta për raportim, për këtë nuk është paraparë ndonjë afat i detyrueshëm, kështu që në praktikë, shoqata mund të marrë informata për autorizimet e dhëna, pak para se të mbahet kuvendi i aksionarëve.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi për notën e dhënë:

Bazat ekzistuese të të dhënave me të cilat disponojnë organet shtetërore mundësojnë verifikim të thjeshtë dhe të shpejtë të pronësisë nominale, por jo edhe të pronës së fundit dhe të kontrollit të fundit mbi ndërmarrjet. Të dhënat për pronësinë nominale janë në dispozicion për publikun në bazë të kërkesave individuale deri te Regjistri qendror⁶⁵, ndërsa për qasje në secilën informatë paguhet kompensim prej 256 denarësh. Megjithatë, gjendja në këtë sferë nuk është shumë e mirë as në pjesën tjetër të Evropës. Sipas një studimi të paradokohshëm, ku janë përfshirë 34 vende evropiane në mesin e të cilave është edhe vendi⁶⁶, vetëm në katër prej tyre⁶⁷, entitetet që janë të obliguara t'i regjistrojnë subjektet afariste mundësojnë qasje të publikut në të dhënat për pronarët e fundit, ndërsa në dy vende të tjera, regjistrat disponojnë me të dhëna të këtylla, por nuk i publikojnë ato.⁶⁸

Nga ana tjetër, është diskutabil fakti se institucionet financiare dhe kategoritë e tjera të parapara të subjekteve juridike⁶⁹, a bëjnë dhe si e bëjnë verifikimin në bazë të "burimeve të pavaruara dhe të sigurta", të deklaratave të klientëve për pronarët e fundit që kanë mbi 25% të pronësisë ose të kontrollit. Kjo vlen veçanërisht kur kihet parasysh se me lartë u theksua se nuk ekzistojnë burime të tilla për verifikimin e pronarit të fundit, së paku jo për pjesën më të madhe të personave juridik, kështu që është vështirë të zbatohet ky obligim i ligjit. Gjithashtu, ky sistem funksionon në bazë të premisë se klienti në të ardhmen do të njoftojë për ndryshimin e pronarëve të fundit, gjegjësisht do ta përditësojë deklaratën e dhënë më parë, gjë që është paraparë si obligim në vërejtjet për deklaratat për pronarin e fundit që i shfrytëzojnë institucionet financiare. Është pikëpyetje se a ua sqarojnë institucionet financiare këtë obligim klientëve dhe sa e bëjnë këtë gjatë plotësimit ose dorëzimit të deklaratave për pronar të fundit.

Rekomandimi

Krijimi i bazave të përditësuara të të dhënave për verifikim të thjeshtë, të shpejtë dhe të sigurt të pronësisë së fundit dhe të kontrollit të fundit mbi ndërmarrjet, dhe vënia e tyre në dispozicion për organet relevante shtetërore dhe palët e interesuara.

Institucioni: Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës, KSHPK-ja, Agjencia për përkrahje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural

Kategoria: Kapaciteti – pavarësia

Pyetja-indikator: A ekzistojnë masa preventive për keqpërdorimin e procedurave që i rregullojnë bizneset, duke i përfshirë edhe procedurat që kanë të bëjnë me subvencionet dhe lejet që jepen nga ana e shtetit për aktivitete komerciale?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

65 Të dhëna të përditësuara për pronësinë nominale për shoqatat aksionare mban Depozituesi qendror i letrave me vlerë.

66 The identification of beneficial owners in the fight against money laundering, Final Report of Project BOWNET – Identifying the Beneficial Owner of legal entities in the fight against money laundering; <http://www.bownet.eu/materials/BOWNET.pdf>

67 Estonia, Italia, Romania, Sllovenia.

68 Faqja 60 e studimit të përmendur.

69 Të definuara me Ligjin për parandalimin e larjes së parave dhe të ardhurave tjera nga vepra ndëshkuese dhe financimi i terrorizmit.

Arsyetimi për notën e dhënë:

Neni 12.2. (d) i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit e përmend parandalimin e keqpërdorimit të procedurave që i rregullojnë subjektet private, ndërsa neni 12.2 (e) e përmend parandalimin e konfliktit të interesave duke i kufizuar angazhimet e personave të mëparshëm zyrtarë në sektorin privat. Përvojat botërore flasin se dhënia e subvencioneve dhe e lejeve për aktivitete të caktuara komerciale, kryerja e mbikëqyrjes dhe e kontrollit, si dhe fushat e tjera ku shteti intervenon në jetën ekonomike dhe në sektorin privat, janë të ekspozuara ndaj korrupsionit ose ndonjë keqpërdorimi tjetër. Keqpërdorimet e këtilla mund të manifestohen edhe nëpërmjet “trajtimit më të favorshëm”, të paarsyetuar, të disa subjekteve afariste nga organet rregullatore ose dhënies së informatave të ndjeshme për tregun, me të cilat disponojnë organet rregullatore, e si kundërshtpërbllim atyre t’u premtohet punësim i mëvonshëm, angazhim me honorar, fitim i pronësisë të subjekti afarist që i është nënshtruar rregullacionit ose ndonjë lloj dobie tjetër.

Programi shtetëror nuk e trajton këtë çështje, prandaj më poshtë është dhënë një pasqyrë e gjendjes me qëllim që të vlerësohet se a ia vlen të zhvillohet një aktivitet përkatës në këtë sferë.

Neni 17 i Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave parasheh ndalesë trevjeçare për punësim në sektorin privat të personave zyrtarë nga sektori publik, si dhe për përfitim të aksioneve gjegjësisht pjesëve të subjektit juridik, në qoftë se bëhet fjalë për subjekte të cilat është kryer mbikëqyrje ose me të cilat është vendosur çfarëdo qoftë raporti kontraktual gjatë kryerjes së autorizimeve ose obligimeve zyrtare. Ekziston edhe kufizim dyvjeçar për përfaqësimin e subjekteve juridike, nëse personi zyrtar më parë ka qenë i përfshirë në marrjen e vendimit për ndonjë lëndë që ka të bëjë me ato subjekte. Është paraparë gjobë për personat zyrtarë, personat fizik dhe juridik që do të veprojnë në kundërshtim me këto dispozita.⁷⁰ Kufizimi i këtillë kohor prej dy deri në tre vjet për aktivitetet e personave të mëparshëm zyrtarë, si duket është i rreptë, veçanërisht nëse krahasohet me konstatimin se në shembuj të tjerë të njohur në botë, pranohet një kornizë prej një deri në dy vjet – edhe pse ekzistojnë edhe vende me kufizime deri në pesë vjet.⁷¹ Sipas nenit 20-c të po këtij ligji, nëse personi zyrtar në afat prej tre vjetësh punësohet në ndonjë shoqatë tregtare ose në ndonjë person tjetër juridik në sektorin privat, është i obliguar që në afat prej 30 ditësh, për këtë ta njoftojë Komisionin shtetëror për parandalimin e korrupsionit. Ligji nuk parasheh një obligim të këtillë gjatë angazhimit të personave të mëparshëm zyrtarë si këshilltarë me honorar ose nënkontraktues, por kjo sferë është e përfshirë me Kodin etik të nëpunësve shtetëror. Në fakt, sipas nenit 9, paragrafi 4 të Kodeksit, nëpunësi shtetëror nuk guxon të pranojë bashkëpunim me persona fizik ose juridik që kanë ose kanë pasur interes ekonomik nga vendimet ose aktivitetet e organit në “të cilin ai ka qenë i punësuar në tre vitet e fundit”⁷². Neni 7 i Kodit etik të nëpunësve shtetëror dhe neni 10 i Kodit etik të nëpunësve publik i obligon nëpunësit ta sigurojnë fshehtësinë e nevojshme dhe mbrojtjen adekuate të informatës që e kanë kuptuar në bazë të pozitës së tyre në administratë. Neni 15 i Kodit etik të nëpunësve publik ndalon përdorimin për përfitim personal të informatave të cilat nëpunësi publik i ka kuptuar gjatë punës. Formulimet në Kodin etik të nëpunësve shtetëror dhe në Kodin etik të nëpunësve publik, si duket janë mjaft të gjera që ta përfshijnë edhe shmangien e përdorimit të informatave të brendshme (ang. insider information) në dëm të punëdhënësit të mëparshëm ose në dëm të konkurrentëve. Në qoftë

70 Neni 31-a i Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave.

71 OECD (2010), Post – Public Employment: Good Practices for Preventing Conflict of Interest, OECD Publishing, faqet 68–69. <http://dx.doi.org/10.1787/9789264056701-en>.

72 Formulimi “organi në të cilin ai ka qenë i punësuar në tre vitet e fundit” mund të interpretohet në, së paku, dy mënyra. Mund t’i përfshijë të gjithë nëpunësit shtetërorë, të cilët, kurdoqoftë gjatë tre viteve të fundit kanë qenë të punësuar në organin përkatës, ose, nëse kuptohet tekstualisht, mund t’i përfshijë vetëm nëpunësit shtetërorë, të cilët, gjatë gjithë tre viteve të fundit kanë qenë të punësuar në organin përkatës. Edhe pse, si duket qëllimi i Ministrisë për shoqëri informatike dhe administratë, e cila e ka përpiluar propozim-tekstin e ligjit, ka qenë më i afërt me mënyrën e parë të interpretimit, megjithatë, ky joprecizitet mund të shkaktojë huti, e madje edhe përpjekje për keqpërdorim.

se vepron në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara me kodet, nëpunësit kanë përgjegjësi disiplinore⁷³, kështu që mungon mekanizmi për sanksionimin e shkeljes së dispozitave që vlejné pas përfundimit të marrëdhënies së punës në shërbimin shtetëror ose publik.⁷⁴ Gjithashtu, në Ligjin për nëpunësit shtetëror dhe në Ligjin për nëpunësit publik është paraparë se nëpunësit e kryejné punën pa u udhëhequr në këtë rast nga interesat personale financiare dhe pa i keqpërdorur autorizimet dhe statusin që e kanë.⁷⁵ Pastaj, nëpunësi shtetëror është i obliguar ta ruajë informatën shtetërore dhe atë të klasifikuar – obligim ky që zgjat deri në tre vjet pas përfundimit të shërbimit.⁷⁶ Dispozitë të ngjashme përmban edhe Ligji për nëpunës shtetëror.⁷⁷ Me ligj nuk është paraparë kompensim për personat e mëparshëm zyrtarë në qoftë se të gjitha këto ndalesa dhe kufizime, atyre u pamundësojnë të fitojné të ardhura adekuate. Megjithatë, me Ligjin për rrogë dhe kompensime të tjera për deputetët dhe personat e tjerë të zgjedhur dhe të emëruar, është paraparë mundësia që deputetët, funksionarët dhe punëtorët udhëheqës, të marrin rrogë në afat prej tre deri në tetëmbëdhjetë muaj pas përfundimit të funksionit.⁷⁸

Bëhet fjalë për harmonizim të plotë të rregullativës për kontrollin e ndihmës shtetërore me legjislacionin e BE-së.⁷⁹

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi për notën e dhënë:

Sipas sondazhit të menaxherëve që është realizuar për nevojat e Raportit global për konkurrencën⁸⁰, në vend nuk është i shprehur në masë të madhe keqpërdorimi i mjeteve publike si pasojë e korrupsionit, jo vetëm në krahasim me indikatorët e tjerë të klimës afariste në vend, por edhe në krahasim me rezultatet e vendeve të tjera⁸¹. E njëjta mund të thuhet edhe për shpeshësinë e pagesave të parregullta dhe për mitën – në mes tjerash edhe gjatë marrjes së lejeve nga shteti⁸² – ndërsa në masë më të vogël edhe për favorizimin gjatë marrjes së vendimeve sa i përket politikave dhe ndarjes së kontratave nga ana e organeve të administratës shtetërore dhe nga organet rregullatore⁸³.

73 Neni 1, paragrafi 3 i Kodit etik për nëpunësit shtetërorë dhe i Kodit etik për nëpunësit publikë.

74 Derisa të mos sigurohet mekanizëm për kompensimin e fitimit të humbur për shkak të respektimit të kufizimeve, që do të vlente për të gjithë personat e mëparshëm zyrtarë, e jo vetëm për një pjesë të tyre, autori nuk rekomandon përforcimin e sanksioneve të parapara për mosrespektimin e dispozitave. Një pasqyrë e mekanizmave për sanksionimin e personave zyrtarë dhe të subjekteve nga sektori privat që kanë bërë shkelje të kufizimeve, mund të gjendet në faqet 82–85 të OBEZH-it (2010), Post - Public Employment: Good Practices for Preventing Conflict of Interest, OECD Publishing. <http://dx.doi.org/10.1787/9789264056701-en>.

75 Në nenin 18 të Ligjit për nëpunësit shtetërorë dhe nenin 24 të Ligjit për nëpunësit publikë.

76 Neni 20 i Ligjit për nëpunësit shtetërorë.

77 Shih nenin 11 të Ligjit për nëpunësit publikë.

78 Neni 19 i Ligjit për rrogë dhe kompensime të tjera për deputetët në Kuvendin e vendit dhe personat e tjerë të zgjedhur dhe të emëruar në vend.

79 Raporti vjetor i Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës për vitin 2012, fq. 26; Programi nacional për miratimin e legjislacionit të BE-së, revizioni i vitit 2013, fq. 94.

80 Global Competitiveness Report 2012-2013, World Economic Forum, fq. 241.

81 Sipas hulumtimit të njëjtë, vetëm Mali i Zi është ranguar më mirë se Maqedonia në rajonin e Evropës Juglindore sa i përket kësaj çështjeje.

82 Sipas hulumtimit të njëjtë, Maqedonia është ranguar më mirë në rajonin e Evropës Juglindore sa i përket kësaj çështjeje.

83 Sipas hulumtimit të njëjtë, Bosnja dhe Hercegovina, Turqia dhe Mali i Zi janë ranguar më mirë se Maqedonia në rajonin e Evropës Juglindore sa i përket kësaj çështjeje.

Në aspektin e dhënies së lejeve, si shembull i mirë mund të përmendet ndarja e lejeve për transport ndërkombëtar CEMT/KEMT⁸⁴. Ky proces, i cili tashmë tetë vite realizohet publikisht dhe në mënyrë elektronike, është pranuar nga shfrytëzuesit e lejeve, gjegjësisht transportuesit, gjë që ofron transparencë dhe me të minimizohen mundësitë për ndikimin e faktorit njeri gjatë zgjedhjes së firmave që marrin leje, si dhe mundësia për korrupsion.

Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës ka numër më të madh të vendimeve për ndihmë shtetërore që janë sjellë në vitin 2011 në krahasim me vitin 2010⁸⁵, ndërsa në vitin 2012 ka rritje të numrit të kërkesave për mendime dhe të njoftimeve-notifikimeve të dorëzuara për ndihmë shtetërore që vijnë nga ana e ministrive.⁸⁶ Te një pjesë e ndihmës së ndarë shtetërore për sektorin privat nuk publikohet vlera e saj. Sipas Raportit vjetor të Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës për vitin 2012, “nuk ekziston [gjithmonë⁸⁷] mundësia të vendosen shuma parash”, për shkak se përfitimet që parashihen me Ligjin për zonat industriale zhvillimore teknologjike për investitorët, nuk përfshijnë gjithmonë grante, por kanë të bëjnë edhe me stimulime tatimore dhe lirim nga pagimi i tatimeve. Kontrollimi i vendime të marra për ndihmën e ndarë shtetërore, tregon se më shpesh nuk publikohet lartësia e stimulimeve tatimore ose doganore. Madje edhe në rastet kur ndihma konkrete ka përfshirë grante të dedikuara për investitorët, shuma e tyre nuk është publikuar çdoherë. Sipas raporteve mediatike, “bëhen përjashtime shikuar nga aspekti i negociatave, që qeveria të mos vihet në pozitë që të detyrohet të gjithëve t’u ofrojë ndihmë të njëjtë që të vijnë të investojnë në vend”⁸⁸. Edhe pse ky qëndrim është i arsyeshëm, kjo praktikë mund të krijojë përshtypje se nuk ka transparencë në harxhimin e mjeteve publike, dhe mundë të çojë në rrezik të shtuar për korrupsion.

Është pozitive që Agjencia për përkrahjen financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural ka publikuar listë të shfrytëzuesve që e kanë keqpërdorur ndihmën financiare⁸⁹. Megjithatë, në atë listë gjenden vetëm dy persona fizik, në kushte kur vetëm në vitin 2012, ndihma financiare për bujqësinë dhe zhvillimin rural ishte programuar të jetë rreth 120 milionë euro. Në vende të tjera, për shembull në Sllovaki, kërkohet edhe publikimi onlajn i personave që kanë marrë ndonjë lloj subvencioni, vlera e tij, si dhe të dhëna për mënyrën e përzgjedhjes së tyre.⁹⁰ Bashkimi Evropian ka krijuar sistem onlajn, ku mund të ndiqen pranuesit e granteve dhe personat që kanë nënshkruar marrëveshje me BE-në në bazë të procedurave për furnizime publike.⁹¹ Në këtë kuptim, është për t’u përshëndetur fakti që në në sistemin elektronik të furnizimeve publike është futur një funksionalitet i ri – publikimi i njoftimeve për kontratat e realizuara. Nëpërmjet tij mundësohet paraqitja e realizimit real të kontratave për furnizime publike, me çka organet kontraktuese do të mund të bëjnë korrigjim të vlerës fillestare të njoftimit për kontratën e nënshkruar. Megjithatë, shfrytëzimi i këtij funksionaliteti është opcional, gjegjësisht i është lënë vullnetit të mirë të organeve kontraktuese që të bëjnë një njoftim të tillë.

Në aspekt të zbatimit të dispozitave për kufizimin e punësimit të personave zyrtarë në ndonjë shoqatë tregtare ose në ndonjë person tjetër juridik në sektorin privat, në raportet vjetore të Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit për vitet 2011 dhe 2012, nuk theksohet se komisioni ka marrë njoftim për ndonjë punësim të këtyllë, në përputhje me nenin 20-c të këtij

84 European Conference of Ministers of Transport (ECMT) / Conférence européenne des ministres des Transports (CEMT).

85 European Commission 2012 Progress Report, fq. 33.

86 Raporti vjetor i Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës për vitin 2012, faqe 32.

87 Vërejtje e autorit.

88 “Cilat kompani marrin ndihmë shtetërore dhe për çka?!” , magazina Kapital, 20 shtator 2013, http://www.kapital.mk/MK/magazin/96717/koi_kompanii_dobivaat_drzhavna_pomosh_i_za_shto_!.aspx

89 http://www.pa.gov.mk/Root/mak/_docs/Black_list_15032013.pdf (qasur më 27.05.2013).

90 Shih: Recent Slovak Anti-corruption Measures, Transparency International Slovakia, 2012; http://www.transparency.sk/wp-content/uploads/2010/01/Gov-anticorruption-measures_Kurian.pdf (qasur më 27.05.2013).

91 http://ec.europa.eu/contracts_grants/beneficiaries_en.htm

ligji, ose se ka marrë njoftim se ndonjë person zyrtar ka përfituar aksione, gjegjësisht pjesë të subjektit juridik mbi të cilin ka kryer kontroll. Fakti që ligjërisht nuk është paraparë kompensim gjatë *gjithë* periudhës sa zgjat ndalesa për të *gjithë* personat e mëparshëm zyrtarë, në qoftë se ndalesa u pamundëson të ardhura adekuate për shkak të pamundësisë për punësim te ndonjë person juridik ose për përfaqësim të ndonjë personi juridik gjatë periudhës relativisht të gjatë sa është paraparë ndalesa, krijon rrezik të lartë për shkeljen e ndalesës së këtillë. Në kushte kur ekziston një rrezik i tillë dhe kur është i madh numri i personave zyrtarë që janë përfshirë me këtë ligj⁹² – e kur megjithatë mungon dorëzimi i njoftimeve të këtilla – duhet të përforcohet mbikëqyrja në këtë sferë.

Rekomandime

- Përforcimi i zbatimit të kufizimeve që kanë të bëjnë me aktivitetet e personave të mëparshëm zyrtarë
 - o Zhvillimi i një mekanizmi për kontrollin e përmbushjes së neneve 17 dhe 20-c të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave (për shembull, duke zhvilluar një bazë të dhënash me organet që rregullojnë degë të caktuara ekonomike dhe të punësuarit në to, që kanë autorizime dhe obligime të caktuara rregullatore, dhe duke i krahasuar automatikisht të dhënat që gjenden në këtë bazë me të dhënat për të punësuarit e rinj nga evidenca e Agjencisë për punësim të vendit, ose me të dhënat për ndryshimin e pronësisë së aksioneve nga Depozituesi qendror i letrave me vlerë).
 - o Komunikimi i kufizimeve që kanë të bëjnë me aktivitetet e personave të mëparshëm zyrtarë nëpërmjet informimit për kufizimet (duke e përfshirë edhe njoftimin formal të personave të rinj zyrtarë për kufizimet dhe përkujtimi për kufizimet i personave zyrtarë të cilëve u përfundon shërbimi gjatë pranimit-dorëzimit të detyrës ose nëpërmjet letrës), këshillimit (duke e përfshirë edhe dhënien e këshillave kur do të kërkohet kjo, qarkoret vjetore, programet për trajnim për integritetin e personave zyrtarë dhe për sektorin privat), dhe përfshirjes së kufizimeve në dokumentet formale që kanë të bëjnë me sektorin privat (për shembull, në dokumentacionin për tenderë dhe në kontratat për furnizime publike).
- Avancimi dhe centralizimi i publikimit onlajn të personave nga sektori privat që kanë pranuar ndonjë lloj të mjeteve publike (për shembull subvencione, furnizime publike), shuma e pranuar dhe për çfarë qëllimi.

Institucioni: Ministria për financa, organizatat relevante profesionale, odat ekonomike dhe organizatat e punëdhënësve

Kategoria: Udhëheqja – transparencja

Pyetja-indikator: A i nënshtrohen ndërmarrjet private kontrollit të mjaftueshëm të brendshëm revizor dhe a mbajnë kontabilitet përkatës, si dhe a u nënshtrohen raportet financiare, procedurave përkatëse për revizion të jashtëm?

92 Si shembull për atë se si mund të përpilohen përjashtimet nga kufizimet që e marrin parasysh fuqinë e personit të mëparshëm zyrtar për të ndikuar mbi vendimet që janë marrë, si dhe mundësitë që i ka pasur për qasje në të dhënat e ndjeshme, shih shembullin e Kanadasë në faqen 80 të OBEZH-it (2010), Post-Public Employment: Good Practices for Preventing Conflict of Interest, OECD Publishing. <http://dx.doi.org/10.1787/9789264056701-en>.

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi për notën e dhënë:

Neni 12.2. (f) i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit e potencon nevojën e ndërmarrjeve private, duke e marrë parasysh edhe strukturën dhe madhësinë e tyre, që t'i nënshtrohen kontrollit të mjaftueshëm të brendshëm revizor, i cili do të ndihmonte në parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit, ndërsa raportet e obligueshme financiare të atyre ndërmarrjeve t'u nënshtrohen procedurave përkatëse të revizionit.

Në Programin shtetëror nuk ekzistojnë aktivitete të veçanta që lidhen me këtë indikator, prandaj analiza është orientuar drejt shqyrtimit të nevojës për zgjerimin e aktiviteteve.

Në përputhje me nenin 469 të Ligjit për shoqatat tregtare, të gjitha shoqatat e mesme dhe të mëdha tregtare, bankat dhe shoqatat e sigurimit, shoqatat që janë të listuara në bursë, si dhe shoqatat që hyjnë në konsolidim, mbajnë **kontabilitet** në përputhje me Standardet ndërkombëtare për raportim financiar (SNRF). Të gjitha shoqatat e tjera mbajnë kontabilitet në përputhje me Standardin ndërkombëtar për subjekte të vogla dhe të mesme. Dispozitat e Ligjit për mbajtjen e kontabilitetit vlejné edhe për personat juridikë që nuk konsiderohen si tregtarë, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ndonjë ligj tjetër. Dispozitat, sipas të cilave, madje edhe shoqatat e mesme janë të obliguara të mbajnë kontabilitet në përputhje me SNRF-në, janë madje edhe më të rrepta se sa praktika ndërkombëtare në këtë sferë.

Në vitin 2010 është ndryshuar dhe është plotësuar Ligji për shoqatat tregtare⁹³ me çka është futur obligimi për organizimin e shërbimit të detyrueshëm për **revizion të brendshëm** te shoqatat aksionare që janë të klasifikuara si tregtarë të mëdhenj në përputhje me dispozitat e Ligjit për shoqatat tregtare, si dhe te shoqatat, aksionet e të cilave janë të listuara në bursë, gjegjësisht shoqatat të cilat, në përputhje me Ligjin për letra me vlerë, kanë obligime të veçanta për raportim. Shërbimi për revizion të brendshëm bën revizion të vazhdueshëm dhe të plotë të ligjshmërisë, drejtësisë dhe shpejtësisë së punës së shoqatës nëpërmjet: vlerësimit të përshatshmërisë dhe efikasitetit të sistemeve për kontroll të brendshëm; vlerësimit të zbatimit të politikave për menaxhim me rreziqet; vlerësimit të mënyrës si është vendosur sistemi informatik; vlerësimit të saktësisë dhe të vërtetësisë së librave tregtarë dhe raporteve financiare; kontrollimit të saktësisë, vërtetësisë së raportimit dhe raportimit në kohë në përputhje me dispozitat dhe ndjekjes së respektimit të dispozitave, politikave dhe procedurave të shoqatës. Me Ligjin për bankat⁹⁴, këshilli mbikëqyrës i bankës është i obliguar të organizojë shërbim për revizion të brendshëm, i cili i ka kompetencat e njëjta siç u theksua më lartë, por përveç kësaj edhe: ndjekjen e respektimit të dispozitave, kodit etik, politikave dhe procedurave; vlerësimin e sistemeve për parandalimin e larjes së parave dhe vlerësimin e shërbimeve që i merr banka nga shoqatat për shërbime ndihmëse të bankës. Shërbimi për revizion të brendshëm te bankat dhe shoqatat e tjera tregtare është i obliguar që të përgatisë raport gjysmëvjetor dhe raport vjetor për punën e tyre dhe t'i dorëzojë ato në organin për mbikëqyrje dhe në organin për administrim⁹⁵. Organi për mbikëqyrje është i obliguar ta dorëzojë raportin vjetor të shërbimit te kuvendi i shoqatës⁹⁶. Shërbimi për revizion të brendshëm është i obliguar menjëherë ta njoftojë organin për mbikëqyrje dhe organin për administrim në qoftë se gjatë kontrollit ka konstatuar mosrespektim të standar-

93 Shih nenet e reja 451-a, 451-b, 451-c dhe 451-d që janë futur me nenin 10 të Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për shoqatat tregtare, Gazeta zyrtare e vendit, nr. 48/2010.

94 Shih nenet 95 deri në 98.

95 Te bankat dhe deri te këshilli për revizion i bankës.

96 Te bankat dhe deri te Banka Popullore.

deve për menaxhim me rreziqet dhe se organi për administrim nuk i respekton dispozitat dhe aktet e përgjithshme dhe procedurat interne të shoqatës ose të bankës.

Sipas nenit 28 të Ligjit për fondet investuese, shoqatat për menaxhim me fondet investuese duhet të kenë të emëruar një revizor të brendshëm të autorizuar.

Sipas Ligjit për supervizion të sigurimeve (nenet 123–128), organi mbikëqyrës i shoqatës për sigurime është i obliguar të vendosë revizion të brendshëm si njësi të veçantë organizative, me së paku një revizor të autorizuar. Revizorët e brendshëm konstatojnë se shoqata për sigurime: a i kryen punës e sigurimeve në përputhje me ligjin, si dhe në përputhje me dispozitat e brendshme të shoqatës për sigurime, me të cilat rregullohet puna e shoqatës për sigurime; a mban libra tregtare dhe a përgatit raporte vjetore, a përpilon dokumente të kontabilitetit, a i vlerëson linjat në bilancet afariste dhe në llogaritë vjetore, si dhe a e njofton publikun për të dhënat nga raportet vjetore në përputhje me këtë ligj, si dhe në përputhje me dispozitat e brendshme me të cilat rregullohet puna e shoqatës për sigurime. Së paku dy herë në vjet, revizorët e brendshëm përgatisin raporte për revizionin e brendshëm që e kanë realizuar, të cilat i dorëzohen organit mbikëqyrës të shoqatës për sigurime. Raporti vjetor i dorëzohet për mendim Agjencisë për supervizion të sigurimeve, ndërsa organi mbikëqyrës është i obliguar që raportin, së bashku me mendimin e Agjencisë për supervizion të sigurimeve, ta vë në rend dite të kuvendit vjetor të aksionarëve.

Në përputhje me nenin 39 të Ligjit për revizion, shoqatat aksionare me obligime të veçanta për raportim janë të obliguara të formojnë këshill për revizion⁹⁷. Shumica e anëtarëve të këshillit për revizion zgjidhen nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës, ndërsa së paku një anëtar është i pavarur dhe ka njohuri nga fusha e kontabilitetit ose revizionit. Këshilli për revizion i kryen këto punë: e ndjek revizionin ligjor të raporteve financiare; e ndjek harmonizimin e punës me dispozitat që kanë të bëjnë me standardet e kontabilitetit dhe raportet financiare; e ndjek procesin e revizionit dhe e vlerëson punën e shoqatës për revizion ose të revizorit të autorizuar – tregtar individual; propozon shoqatën për revizion; e ndjek punën dhe e vlerëson efikasitetin e revizionit të brendshëm dhe të sistemeve për menaxhim me rreziqet.

Revizioni i jashtëm i pavarur i raporteve financiare është i detyrueshëm për tregtarët e mëdhenj dhe të mesëm që janë të organizuar si shoqata aksionare, shoqata, letrat e të cilëve me vlerë janë të listuara në bursë, dhe për tregtarët e mëdhenj dhe të mesëm që janë të organizuar si shoqata me përgjegjësi të kufizuar.⁹⁸ Këto shoqata janë të obliguara të kenë mendim të revizorëve për raportet financiare më së voni një muaj para mbajtjes së mbledhjes së bashkë-pronarëve, gjegjësisht kuvendit. Revizori i autorizuar i raporteve financiare dorëzon raport për revizionin e kryer, sipas Standardeve ndërkombëtare për revizion, që përditësohen për çdo vit, me qëllim të harmonizimit me standardet aktuale, ashtu siç janë plotësuar, ndryshuar ose miratuar nga ana e Federatës ndërkombëtare të kontabilistëve (IFAC). Raporti për revizionin e kryer, së bashku me llogarinë vjetore dhe raportet financiare dhe raportin vjetor i dorëzohet këshillit të drejtorëve, këshillit mbikëqyrës, gjegjësisht kontrollorit, e pastaj edhe mbledhjes së bashkë-pronarëve, gjegjësisht kuvendit.

Ligji parasheh mbrojtje të veçantë për pronarët pakicë, me çka bashkë-pronarët që posedojnë një të dhjetën e kapitalit kryesor të shoqatës me përgjegjësi të kufizuar, kanë të drejtë të përcaktojnë revizor të autorizuar që të bëjë revizion të veçantë të llogarisë së fundit vjetore dhe të raporteve financiare.⁹⁹ Revizori është i obliguar që raportin nga revizioni i kryer, pa vonesë t'ia dorëzojë drejtorit dhe këshillit mbikëqyrës, nëse shoqata ka organ për mbikëqyrje.¹⁰⁰ Aksiona-

97 Shoqata që ka bërë ofertë publike të letrave me vlerë, ose që ka kapital kryesor në vlerë prej një milion eurosh në kundërvlerë në denarë dhe më shumë se 50 aksionarë, ose që është listuar në bursë.

98 Neni 478 i Ligjit për shoqatat tregtare.

99 Neni 229 i Ligjit për shoqatat tregtare.

100 Neni 230 i Ligjit për shoqatat tregtare.

ri ose grupi i aksionarëve që posedojnë së paku 10% të kapitalit kryesor të shoqatës tregtare, kanë të drejtë të kërkojnë nga organi udhëheqës të thërrasë kuvend të shoqatës tregtare ku do të emërohet revizor i autorizuar që do të bëjë kontroll, revizion, verifikim ose shërbime që bëjnë pjesë në fushëveprimin e aktiviteteve të shoqatës tregtare, për të cilat, në kërkesë është shprehur dyshim se mund të kenë parregullsi të mundshme.¹⁰¹

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi për notën e dhënë:

Barrën më të madhe nga ndryshimet në raportimin financiar të cilat bëhen për shkak të pranimit të Standardeve ndërkombëtare për raportim financiar e mbajnë kontabilistët. “Akoma është i madh numri i kontabilistëve, aktivitetet e të cilëve për edukimin e vet profesional përfundojnë me leximin e publikimeve periodike të organizatave profesionale, që është e nevojshme, por, as për së afërmi e mjaftueshme.”¹⁰²

Pozitive është ajo se në vitin 2012 është formuar instituti i kontabilistëve dhe i kontabilistëve të autorizuar, i cili: mban regjistra të kontabilistëve dhe të kontabilistëve të autorizuar, bën kontroll të punës së tyre, organizon dhe realizon provim për marrjen e certifikatës për kontabilist, gjegjësisht certifikatës për kontabilist të autorizuar; lëshon certifikatë për kontabilist dhe certifikatë për kontabilist të autorizuar; jep dhe merr licenca për punë për tregtarët individualë – kontabilistë, tregtarët individualë – kontabilistë të autorizuar dhe shoqatat për kryerjen e punëve të kontabilitetit; organizon dhe zbaton trajnim për avancim të vazhdueshëm profesional; e ndjek zbatimin e Kodit etik për kontabilistët profesionalë të Federatës ndërkombëtare të kontabilistëve; i përkthen Standardet ndërkombëtare për raportim financiar dhe Standardet ndërkombëtare për raportim financiar për subjektet e vogla dhe të mesme.

Futja e revizionit të brendshëm të detyrueshëm do të kontribuojë për përmirësimin e procesit të raportimit financiar të subjekteve afariste, dhe për avancimin e kontrollit dhe të mbikëqyrjes së funksioneve të ndërmarrjes.

Punën e revizionit të pavarur e avancon Instituti i revizorëve të autorizuar të vendit. Instituti mban regjistër të revizorëve të autorizuar dhe regjistër të shoqatave për revizion dhe revizorëve të autorizuar – tregtarë individualë; realizon provime për marrjen e titullit revizor i autorizuar; i jep propozim ministrit për financa për të dhënë leje për punë për shoqatën për revizion, revizorin e autorizuar - tregtar individual dhe për të dhënë certifikatë për revizor të autorizuar; organizon dhe zbaton edukim të vazhdueshëm profesional; e ndjek zbatimin e Standardeve ndërkombëtare për revizion (SNR) dhe të Kodit etik për kontabilistët profesionalë të Federatës ndërkombëtare të kontabilistëve (FNK) të shoqatave për revizion dhe të revizorët e autorizuar – tregtarë individualë; i përkthen dhe i përditëson SNR-të, Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (SNK), Standardet ndërkombëtare për raportim financiar (SNRF), Kodin etik për kontabilistët profesionalë të FNK-së dhe Standardet ndërkombëtare për kontroll të kualitetit.

101 Neni 460-c i Ligjit për shoqatat tregtare.

102 Janka Dimitrova, Përgjegjësia e kontabilistëve, menaxhmentit dhe revizorëve për vërtetësinë, kualitetin dhe kredibilitetin e raporteve financiare, fq.9.

Rekomandim

Për shkak se rekomandimi do të ishte në lidhje me edukimin e mëtutjeshëm të revizorëve (të brendshëm dhe të jashtëm) dhe të kontabilistëve për mënyrat për parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit në sektorin privat, ai është përfshirë në një rekomandim të ngjashëm, më të gjerë, nën problemin e dytë që është përshkruar më poshtë.

Problemi / faktori i rrezikut 2:

Njohuritë e pamjaftueshme për korrupsionin dhe konfliktin e interesave në sektorin privat

Arsyetimi:

Njohuritë e pamjaftueshme për problemin e korrupsionit dhe të konfliktit të interesave dhe ndikimin e tyre shkatërrues, krijon nevojën për zbatimin e trajnimeve dhe intensifikimin e bashkëpunimit ndërmjet sektorit privat dhe atij publik.

Institucioni: KSHPK-ja dhe organet e tjera relevante; odat ekonomike dhe organizatat e punëdhënësve

Kategoria: Udhëheqja – mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A avancohet bashkëpunimi ndërmjet organeve të rendit dhe subjekteve relevante private në drejtim të identifikimit dhe të zbulimit të parregullsisve që mund të jenë indikator për sjellje korruptive, ose për organizimin e trajnimeve, përgatitjen e materialeve informative dhe dhënien e këshillave për subjektet afariste për marrjen e masave parandaluese?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi për notën e dhënë:

Neni 12.2. (a) i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit ka të bëjë me avancimin e bashkëpunimit ndërmjet organeve për zbatimin e ligjit dhe subjekteve relevante private. Shpeshherë, konkurrentët janë ata që vërejnë parregullsi ose aktivitete apo transaksione të dyshimta gjatë aktiviteteve të tyre të rregullta financiare dhe komerciale. Prandaj, ata mund t'u ndihmojnë organeve shtetërore gjatë identifikimit dhe zbulimit të parregullsisve që mund të jenë indikatorë për sjellje korruptive.¹⁰³ Nga ana tjetër, organet shtetërore mund t'u japin këshilla ose sugjerime subjekteve afariste për mënyrat më të mira se si ta parandalojnë korrupsionin ose si të vendosin mekanizma preventive. Kombet e Bashkuara¹⁰⁴ potencojnë praktika të mira që kanë të bëjnë me disa instrumente kontraktuese ose ligjore, që zbatohen në vende të tjera, siç janë: nënshkrimi i memorandumit për bashkëpunim dhe këmbim të informatave me sektorin e biznesit gjatë hulumtimit të rasteve të korrupsionit dhe të konfliktit të interesave, ose obligimi për institucionet financiare, si dhe subjektet afariste në veprimtaritë specifike, të denoncojnë transaksione të dyshimta (më shpesh që lidhen me luftën kundër larjes së parave dhe financimin e aktiviteteve terroriste). Në këtë sferë mund të përmendet së paku një aktivitet nga Programi shtetëror që tashmë është

¹⁰³ United Nations Convention against Corruption, article 12(2a).

¹⁰⁴ Implementation of article 12 of the United Nations Convention against Corruption, including the use of public - private partnerships, fq. 10, Conference of the States Parties to the United Nations Convention against Corruption – Open – ended Intergovernmental Working Group on Prevention, 2012.

realizuar. KSHPK-ja në vitin 2011 nënshkroi memorandum për bashkëpunim për përkrahje të ndërsjellë¹⁰⁵ me disa përfaqësues të sektorit afarist (odat ekonomike, klasterët dhe organizatat e punëdhënësve), i cili, në mes tjerash, ka të bëjë edhe me këmbimin e informatave që janë në dispozicion dhe bashkëpunimin në realizimin e edukimit dhe trajnimit.

Më poshtë është dhënë një pasqyrë e aspekteve të tjera të gjendjes që ndërlidhet me këtë pyetje-indikator, me qëllim që të vlerësohet se a do të ishte e dobishme të zhvillohen aktivitete plotësuese në Programin shtetëror në këtë sferë.

Sipas nenit 58 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit, çdo i punësuar në bankë, kursimore, këmbimore, shoqatë sigurimesh, bursë ose në ndonjë organizatë tjetër financiare është i obliguar që menjëherë ta denoncojë ndonjë transaksion të dyshimtë që ka lidhje me korrupsionin. Denoncimi i dorëzohet personit përgjegjës në atë subjekt juridik, organet e përcaktara me ligj dhe në KSHPK, ndërsa për mosdenoncim është paraparë gjobë. Sipas nenit 41 të po këtij ligji, funksionari i zgjedhur ose i emëruar, si dhe personi zyrtar ose personi përgjegjës në një ndërmarrje publike, institucion publik ose në ndonjë subjekt tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror, është i obliguar ta denoncojë çdo vepër të dënueshme me ligj që lidhet me korrupsionin, si dhe çdo shkelje të dispozitave të këtij ligji, për të cilat ka kuptuar gjatë kryerjes së detyrës së tij. Për mosdenoncim është paraparë gjobë, përveç nëse mosdenoncimi është vepër penale. Është interesante se ky ligj e kufizon obligimin për denoncim të korrupsionit sipas nenit 41, vetëm për personat përgjegjës të subjektet juridike me kapital shtetëror. Mungojnë dispozita të veçanta ligjore për nxitjen e denoncimit të dyshimeve për korrupsion dhe aktivitete të tjera joligjore në sektorin privat dhe për mbrojtjen e personave që bëjnë denoncim të tillë. Dispozitat e këtilla duhet t'i përfshijnë të punësuarit në sektorin privat, të punësuarit e përkohshëm, konsultantët, praktikantët dhe personat e tjerë që janë të angazhuar në sektorin privat, të cilët nuk janë në marrëdhënie klasike të punës. Si shembull i mirë në këtë fushë, përmendet Ligji për publikim me interes publik në Britaninë e Madhe¹⁰⁶, që parashih tre nivele të denoncimit: denoncime të brendshme të punëdhënësit, denoncime të organet rregullatore, sqarime më të gjera për policinë, mediat, deputetët dhe instancat e tjera. Duke shkuar prej nivelit të parë drejt nivelit të tretë, ashpërsohen kushtet që janë vendosur, të cilat duhet të plotësohen që denoncuesi të mund të gëzojë mbrojtje në bazë të ligjit. KSHPK-ja në bashkëpunim me Ministrinë për Drejtësi, realizoi një mision ekspertësh për ta analizuar legjislacionin anti-korruptiv të vendit me një theks të veçantë në normimin e mbrojtjes së "denoncuesve", si dhe një studim fizibiliteti, gjegjësisht Udhërrëfyes për implementimin e sistemit të "denoncuesve" në vend. Sipas informatave nga KSHPK-ja, tashmë ekziston grupi i punës për ndryshimin edhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e korrupsionit, i cili, në mes tjerash, ka për qëllim edhe krijimin e sistemit për mbrojtjen e personave që denoncojnë raste të korrupsionit edhe në sektorin privat. Praktikantët më të mira nga vendet e tjera flasin se sistemi duhet të definojë edhe kanale dhe procedura përkatëse për denoncim, t'i definojë aktivitetet e mundshme hakmarrëse ose diskriminuese që janë të orientuara drejt denoncuesve, ta përcaktojë organin që do t'i pranojë dhe do t'i hulumtojë ankesat për këto aktivitete, si dhe të caktojë sanksione për aktivitetet e tilla.¹⁰⁷

Sipas Ligjit për parandalimin e larjes së parave dhe të ardhurave tjera nga vepra ndëshkuese dhe financimi i terrorizmit, institucionet financiare dhe subjektet afariste që merren me veprimtari të caktuara me rrezik të shtuar për larje të parave, janë të obliguara të bëjnë identifikim dhe analizë të klientëve dhe të transaksioneve, si dhe t'i denoncojnë dhe t'i vendosin në pritje transaksionet e dyshimta. Kjo është me rëndësi për shkak se larja e parave mund të lidhet edhe me të ardhura nga aktivitetet korruptive.

105 <http://www.dksk.org.mk/images/stories/pdf/memor-pri-sek.pdf>

106 Public Interest Disclosure Act, <http://www.legislation.gov.uk/ukpga/1998/23/contents>

107 Whistle blower protection: encouraging reporting, CleanGovBiz, 2012, <http://www.oecd.org/cleangovbiz/toolkit/50042935.pdf> G20 compendium of best practices on whistleblower protection legislation: G20 Anti-Corruption Action Plan, Action Point 7: Protection of Whistleblowers, 2010, <http://www.oecd.org/general/48972967.pdf>

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi për notën e dhënë:

Kombet e Bashkuara¹⁰⁸ potencojnë praktika të mira nga vendet e tjera për bashkëpunim ndërmjet organeve për zbatimin e ligjit dhe subjekteve relevante private, siç janë: caktimi i pikave për kontakt në organet shtetërore për këmbimin e informatave të këtitilla, ose përkrahja e subjekteve private në ballafaqimin me konfliktet që mund t'i kenë kur dëshirojnë të ofrojnë informata të këtitilla, e në të njëjtën kohë janë të kufizuara me rregullat për mbrojtjen e privatësisë, fshehtësisë ose fshehtësisë bankare.

Në përputhje me memorandumun e nënshkruar, KSHPK-ja në vitin 2012 dhe 2013 ka organizuar së paku dy tryeza të rrumbullakëta në temën e parandalimit të korrupsionit dhe të konfliktit të interesave në sektorin privat, ku janë inkuadruar edhe përfaqësues të sektorit privat. Përveç kësaj, përfaqësues të sektorit privat janë inkuadruar edhe në konferencën vjetore për vlerësimin e realizimit të Programit shtetëror, që është mbajtur në vitin 2013, e gjithashtu ka vazhduar edhe bashkëpunimi në fushën e realizimit të aktiviteteve të përbashkëta në projekte.¹⁰⁹ Përfaqësuesit e sektorit privat në këtë mënyrë kanë pasur mundësi të japin propozime për ndryshimin e aktiviteteve ekzistuese ose për futjen e aktiviteteve të reja në Programin shtetëror.

Edhe përkundër asaj se në Programin shtetëror janë paraparë aktivitete përkatëse, nuk janë mbajtur trajnime të veçanta për parandalimin e korrupsionit për sektorin privat.

Qeveria e vendit ka lëshuar në përdorim linja të veçanta telefonike, në të cilat, qytetarët, subjektet afariste dhe organizatat e tjera mund të denoncojnë raste të korrupsionit te disa institucione (për shembull, Drejtoria doganore, Drejtoria për të hyra publike, Ministria për Transport dhe Lidhje, Ministria për Punë të Brendshme, Ministria për Mbrojtje), dhe këtë gjë e kanë bërë edhe disa njësi të vetëqeverisjes lokale (për shembull Prilepi).

Rekomandimi

- Organet shtetërore në bashkëpunim me përfaqësuesit e sektorit afarist të bëjnë edukim të mëtutjeshëm dhe të japin përkrahje për subjektet afariste për rregullativën për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, dhe të fusin mekanizma për parandalimin e korrupsionit; të bëhet edukimi i revizorëve (të brendshëm dhe të jashtëm) dhe i kontablistëve për mënyrat për parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit në sektorin privat.
- Realizimi i hulumtimeve për masat antikorruptive të ndërmarrjeve të vendit, vlerësimi i efektivitetit të instrumenteve të veçanta, zhvillimi i analizave lokale për rastet konkrete të zbatimit të masave antikorruptive dhe shembuj të praktikave më të mira.
- Futja e mekanizmave për denoncim dhe mbrojtje përkatëse ligjore për denoncuesit e korrupsionit në sektorin privat.

¹⁰⁸ Implementation of article 12 of the United Nations Convention against Corruption, including the use of public – private partnerships, fq. 10, Conference of the States Parties to the United Nations Convention against Corruption – Open - ended Intergovernmental Working Group on Prevention, 2012.

¹⁰⁹ Raporti për zbatimin e Memorandumit për bashkëpunim për përkrahje të ndërsjellë për parandalimin e korrupsionit dhe të konfliktit të interesave me përfaqësuesit e sektorit privat – periudha: janar - qershor 2013, KSHPK, 2013. <http://www.dksk.org.mk/images/stories/pdf/sorabotka/izvestaj%20-%20ps.pdf>

Institucioni: Odat ekonomike dhe organizatat e punëdhënësve

Kategoria: Kontributi për integritetin e gjithëmbarshtëm – angazhimi në politikën nacionale për antikorrupsion

Pyetja-indikator: Në çfarë mase sektori privat e nxit pushtetin të bëjë parandalimin dhe represionin e korrupsionit?

Nota - de jure dhe de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi për notën e dhënë:

Sipas sondazhit të paradokohshëm¹¹⁰, madje 47% e subjekteve afariste janë deklaruar se nuk ndiejnë obligim moral në luftën kundër korrupsionit. Çështja e antikorrupsionit figuron në agjendën e sektorit afarist gjatë komunikimit me pushtetin, por në përgjithësi nuk është prioritet. Të rralla janë deklaratat nga përfaqësuesit e shoqatave të sektorit afarist që e thërrasin pushtetin të luftojë kundër korrupsionit. Kur shoqatat e mëdha afariste dhe odat ekonomike realizojnë takime me pushtetin ose me bartës të funksioneve të larta politike, sektori afarist më shpesh i potencon problemet që kanë të bëjnë me infrastrukturën e pazhvilluar transportuese dhe energjetike, çmimin e lartë të lëndëve energjetike, borxhet e shtetit ndaj ekonomisë, lartësinë e doganave, tatimeve dhe kontributeve për sigurim social. Më të rralla janë rastet kur sektori afarist e parashtron temën e korrupsionit, e bile edhe atëherë, kjo më shpesh lidhet me vërejtjet për mënyrën e realizimit të furnizimeve publike. Sa i përket iniciativave konkrete të orientuara drejt pushtetit, e që janë të inicuar nga komuniteti afarist, mund të përmendet dokumenti “Nevojat antikorruptive të komunitetit afarist të vendit – apel publik deri te pushteti dhe politikanët”¹¹¹, ku janë theksuar çështjet prioritare antikorruptive me të cilat duhet ballafaqohet pushteti, e që janë kyçe për krijimin e kushteve të barabarta për garë ndërmjet subjekteve afariste.

Anëtarësia e subjekteve afariste nga vendi në iniciativën e Marrëveshjes globale të Kombeve të Bashkuara – e cila, në mes tjerash, përmban edhe një parim që ka të bëjë me luftën kundër korrupsionit – është në nivel jashtëzakonisht të ulët. Në ueb-faqen e iniciativës¹¹² janë shënuar vetëm 14 anëtare nga komuniteti ynë afarist, nga të cilat për dy prej tyre është theksuar se nuk dorëzojnë raport vjetor për përparimin në zbatimin e parimeve.

Njëra nga mënyrat se si sektori privat mund të ndihmojë në luftën kundër korrupsionit është në qoftë se në nivel të degëve ekonomike ose të tërë ekonomisë, publikohen vlerësime periodike për harxhimet nga korrupsioni, si për subjektet afariste, ashtu edhe për rritjen ekonomike dhe konkurrencën. Sektori afarist mund të përkrahë edhe hulumtime dhe analiza të pavarura që do të mundësojnë kuantifikim të harxhimeve të tij nga korrupsioni. Në këtë drejtim, në kuadër të projektit “Iniciativa antikorruptive e ndërmarrësve”, që është realizuar nga Konfederata e biznesit të vendit dhe Aleanca e biznesit të Sllovakisë, është publikuar një dokument me titull “Harxhimet nga korrupsioni”, ku është dhënë një pasqyrë e qasjeve dhe përpjekjeve ndërkombëtare për t’i matur harxhimet nga korrupsioni dhe pasojat mbi indikatorët e rritjes ekonomike.¹¹³

110 Sondazh i realizuar nga Agjencia për hulumtimin e mendimit publik dhe komunikime strategjike Rejting, për KSHPK-në dhe OSBE-në.

111 Konfederata e biznesit të Maqedonisë.

112 <http://www.unglobalcompact.org/>

113 Zuzana Dančíková, Costs of Corruption, Transparency International Slovakia, 2012.

http://www.transparency.sk/wp-content/uploads/2010/01/Costs-of-Corruption_Dancikova.pdf

Rekomanime

- Publikimi më konsekuent i pasojave të dokumentuara të dëmshme nga korrupsioni mbi ndërmarrjet, rritjen ekonomike dhe konkurrencën, nga ana e përfaqësuesve të sektorit afarist.
- Arritja e konsensusit në komunitetin afarist për masat më prioritare që do të kontribuojnë në luftën kundër korrupsionit në sektorin privat, dhe përfaqësim te pushteti për zbatimin e atyre masave që janë në kompetencë të organeve shtetërore.

Institucioni: Odat ekonomike dhe organizatat e punëdhënësve

Kategoria: Kontributi për integritetin e gjithëmbarshtëm – përkrahje për iniciativat qytetare për antikorrupsion

Pyetja-indikator: Në çfarë mase sektori privat e nxit dhe/ose e përkrah shoqërinë civile në luftën kundër korrupsionit?

Nota - de jure dhe de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi për notën e dhënë:

Në përgjithësi, sektori afarist në masë të pamjaftueshme e nxit ose e përkrah shoqërinë civile në luftën kundër korrupsionit.

Gjatë zhvillimit të kodeve të etikës afariste, të cilat u përmendën më lartë, është evident bashkëpunimi i sektorit privat me organizatat qytetare. Edhe pse periodikisht paraqiten shembuj të këtyllë të bashkëpunimit të sektorit privat me organizatat qytetare në iniciativat reformuese për antikorrupsion, roli i komunitetit afarist, në përgjithësi është reaktiv dhe simbolik. Sektori privat shumë rrallë jep përkrahje financiare për iniciativat e shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit.

Rekomandim:

- Bashkëpunim me iniciativat për antikorrupsion të shoqërisë civile dhe përkrahje financiare për to nga ana e sektorit privat.

Problemi / faktori i rrezikut 3:

Informimi i pamjaftueshëm për Ligjin për mbrojtje të konkurrencës dhe kapaciteti i pamjaftueshëm i Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës (KMK) për zbatimin e ligjit

Arsyetimi:

Për shkak të informimit të pamjaftueshëm për dispozitat e ligjit, numri i denoncimeve që parashtrohen në KMK është i vogël, veçanërisht në pjesën e kontratave të ndaluara. Gjithashtu, KMK-ja nuk disponon me kapacitete të mjaftueshme.

Institucioni: Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës, Byroja për furnizime publike dhe organet kontraktuese

Kategoria: Kapaciteti – resurset

Pyetja-indikator: A disponojnë organet relevante shtetërore me shkathësi, potencial kadrovik dhe mekanizma për parandalimin dhe zbulimin e kontratave të ndaluara ku janë përfshirë ofertesit gjatë furnizimeve publike?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi për notën e dhënë:

Sipas nenit 14 të Ligjit për furnizime publike, Byroja për furnizime publike organizon dhe bën trajnimin për edukim të nëpunësve dhe të profesionistëve të tjerë në lidhje me furnizimet publike, për të cilën gjë merr edhe mjete të veçanta buxhetore. Megjithatë, në nënaktin ligjor që e rregullon në mënyrë më precize edukimin për furnizime publike¹¹⁴, nuk është theksuar në mënyrë eksplicite mundësia për organizimin e trajnimeve tematike, që të mund të mbahen edhe trajnime të veçanta për parandalimin e korrupsionit gjatë furnizimeve publike.

Në propozim-strategjinë për zhvillimin e sistemit për furnizime publike 2013–2017 është paraparë futja e sistemit për analizë automatike dhe paralajmërim për indikacionet për ekzistimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave gjatë furnizimeve – të cilat duhet t'i bëjë sistemi informatik i furnizimeve publike. Byroja për furnizime publike deri tani nuk ka paraparë resurse për operacionalizimin e kësaj ideje.

Përfaqësuesit e sektorit afarist përmendin disa faktorë, të cilët, sipas tyre, kanë efekt të zvogëlimit të konkurrencës në furnizimet publike, stimulim të arritjes së marrëveshjes ndërmjet ofertuesve për ndarjen e tenderëve dhe arritjen e marrëveshjes së ndërsjellë për çmimet. Këtu janë përmendur këto arsye: pranimi i çmimit si faktor dominant gjatë marrjes së vendimeve për furnizimet publike, deklaratat për pranimin e pagesave me vonesë dhe mënyrat e tjera për shtyrjen e pagesës së furnizimeve, si dhe mundësia ligjore që praktikohet shpesh për nënshkrimin e anekseve të kontratave për furnizime publike, me të cilat, në mënyrë plotësuese rritet vlera e kontratave për furnizime publike që janë nënshkruar inicialisht.

¹¹⁴ Rregullorja për programin për realizimin e edukimit për furnizimet publike, programin për realizimin e trajnimit për trajnues për furnizimet publike, formën dhe përmbajtjen e certifikatës për provimin e dhënë për person për furnizime publike dhe për trajnues, si dhe lartësinë e kompensimit që e paguajnë pjesëmarrësit e edukimit, Gazeta zyrtare nr. 90/2012.

Zbatimi efektiv i masave tolerante të parapara me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës është i kufizuar për shkak të dispozitave kundërshtuese në Kodin penal.¹¹⁵ Ky problem tashmë është identifikuar në *Programin shtetëror* dhe është paraparë të tejkalohet me ndryshimin e nenit 283 të Kodit penal. Sipas NPAA-së për periudhën 2013–2015, Kuvendi i vendit është dashur ta shqyrtojë ndryshimin deri më 30 qershor 2013. Në fakt, neni kontestues në Kodin penal parashihet dënim me burg për personin përgjegjës të personi juridik që ka marrë pjesë në kontratë të ndaluar, në kohëzgjatje prej 1 deri në 10 vjet, që e pamundëson efektivitetin e nenit 65 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, i cili parashihet lirim të plotë nga gjopa për ndërmarrjen e cila e ka pranuar pjesëmarrjen e saj në kartel. Kjo zgjidhje çon në pamundësi për të vendosur program të zbatueshëm që do t'i motivonte ndërmarrjet të ndihmojnë në zbulimin e karteleve. Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës në periudhën prej vitit 2010 deri në vitin 2012, disa herë ka kërkuar nga Ministria për Drejtësi si propozues i autorizuar të përgatisë propozim-ndryshime për nenin 283 të Kodit penal, në drejtim të stimulimit të denoncimit të rasteve të kontratave të ndaluar. Ministria për Drejtësi ka reaguar ndaj kërkesave të këtilla dhe grupi i punës për përgatitjen e tekstit për ndryshime të Kodit penal ka përgatitur një version, sipas të cilit, në nenin 283 shihet paragrafi i ri 2. Në atë paragraf qëndron formulimi se “Personi përgjegjës të personi juridik do të lirohet nga dënimi në qoftë se ka zbuluar ose nëse ka dhënë kontribut të konsiderueshëm në zbulimin e kontratës së nënshkruar, vendimit të marrë ose sjelljes së koordinuar që janë të ndaluara me ligj...” – dhe kjo ka çuar deri te lirimi ose zvogëlimi i gjobës së personit juridik. Edhe pse ky ndryshim i planifikuar akoma nuk është pjesë përbërëse e Kodit penal, ka indikacione se operacionalizimi i tij do të bëhet së shpejti.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi për notën e dhënë:

Në trajnimet e përgjithshme që i mban Byroja për furnizime publike për organet kontraktuese¹¹⁶ është përfshirë edhe një pjesë për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave të furnizimet publike. Me ndihmë nga vendet e huaja, është përpiluar dhe është shtypur një udhëzues për organet kontraktuese¹¹⁷, me shembuj praktikë, i cili, në mes tjerash, i shqyrton edhe mënyrat për zbulimin e shoqatave të karteleve dhe karteleve të çmimeve gjatë furnizimeve publike. Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës në bashkëpunim me Byronë për furnizimet publike, në vitin 2013 ka përgatitur edhe një udhëzues për organet shtetërore që të mund ta njohin sjelljen antikorruptive të furnizimet publike. Pas finalizimit të udhëzuesit, është planifikuar që ai të vendoset dhe të jetë në dispozicion në ueb-faqet e këtyre organeve. Përveç kësaj, është paraparë që gjatë trajnimeve të dedikuara për organet shtetërore të shpërndahet edhe një broshurë e shkurtër me çështjet kyçe, si dhe këto aspekte të përfshihen më detajisht në trajnimet e Byrosë për furnizime publike për organet kontraktuese.

Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës ka mbajtur disa takime me përfaqësuesit e organeve të tjera për përforsimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, por mbetet që në të ardhmen ato të rezultojnë me këmbim të shtuar të informatave.

115 European Commission 2012 Progress Report, faqe 33.

116 Ka të bëjë me trajnimet pesëditore.

117 Zbulimi i manipulimeve në procedurat për ndarjen e kontratave për furnizime publike dhe hapat e njëpasnjëshëm për kontrollim, Projekti twinning i financiar nga BE-ja “Përkrahje për sistemin e furnizimeve publike”, Byroja për furnizime publike.

Buxheti i Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës akoma është më i vogël se sa buxheti i vitit 2009¹¹⁸, ndërsa mjetet e miratuara për vitin 2013 janë, për pothuajse 30%, më të ulëta nga mjetet e kërkuara. Gjithashtu, Komisioni nuk fiton mjete të veçanta me të cilat mund të bëjë edukim të organeve shtetërore dhe operatorëve ekonomikë për rregullativën për mbrojtjen e konkurrencës. Në pjesën e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, Komisioni funksionon me përkrahje të shtatë të punësuarve, numër ky që është dukshëm më i vogël se sa numri i pozitive të parapara me sistematizimin e vendeve të punës. Në Programin nacional për miratimin e legjislacionit të BE-së, revizioni i vitit 2013, në pjesën e prioriteteve afatshkurta, është paraparë që në vitin 2013 të realizohen punësime të reja në pjesën e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.¹¹⁹ Megjithatë, realizimi i përkushtimit të këtillë nuk është i sigurt.

Në propozim-strategjinë për zhvillimin e sistemit për furnizime publike 2013–2017, është paraparë që te furnizimet që janë vlerësuar se kanë me vlerë mbi 130.000 euro, të jetë i detyrueshëm kontrolli i deklaratave për konflikt të interesave nga ana e Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit. Kjo le hapësirë për diskutim se një gjë e tillë do të kërkonte përfundim të potencialeve aktuale kadrovike të komisionit, në drejtim të angazhimit të ekspertëve, të cilët me njohuritë për mundësitë për korrupsion te furnizimet publike do të mund t'i përpunojnë këto deklarata.

Në edukimet për organet kontraktuese që i mban Byroja për furnizime publike, është vërejtur përfaqësim i pamjaftueshëm i gjykatësve, që ka ndikim negativ në kualitetin e procedurave gjyqësore që kanë të bëjnë me keqpërdorimet gjatë furnizimeve publike. Byroja për furnizime publike është përpjekur ta përmirësojë përfshirjen e gjykatësve, mirëpo nëpër gjykata akoma dominon perceptimi se trajnimet e këtilla janë të dedikuara vetëm për nëpunësit që i udhëheqin procedurat për furnizime publike.

Rekomandime

- Byroja për furnizime publike së bashku me KSHPK-në ta vlerësojnë mundësinë për futje të sistemit për paralajmërim automatik gjatë ekzistimit të indikacioneve për korrupsion dhe konflikt të interesave te furnizimet publike.
- Në përputhje me atë që është paraparë në Programin shtetëror, Ministria për Drejtësi t'i intensifikojë aktivitetet për operacionalizimin e propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit penal, ku është përfshirë ndryshimi dhe plotësimi i nenit 283.
- Përforcimi kadrovik dhe financiar i Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës, në pjesën e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.
- Në bashkëpunim ndërmjet KSHPK-së, Byrosë për furnizime publike dhe Akademisë për gjykatës dhe prokurorë, të inicohen trajnime të dedikuara për gjykatësit, për keqpërdorimet e mundshme gjatë furnizimeve publike, me theks të veçantë në kontratat e ndaluara gjatë procedurave për furnizime publike.

118 European Commission 2012 Progress Report, faqe 33.

119 Faqe 95.

Institucioni: Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës, Byroja për furnizime publike dhe organet kontraktuese

Kategoria: Kapaciteti – resurset

Pyetja-indikator: A janë të njoftuara subjektet private me dispozitat për mbrojtjen e konkurrencës sa i përket kontratave të ndaluara, rolin e organeve kompetente shtetërore dhe mundësitë për parandalimin e korrupsionit?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi për notën e dhënë:

Nënakti ligjor që e rregullon në mënyrë më precize edukimin për furnizimet publike¹²⁰ parasheh trajnime për operatorët ekonomikë, por nuk është theksuar në mënyrë eksplicite mundësia për organizimin e trajnimeve tematike, që të mund të mbahen edhe trajnime të veçanta për parandalimin e korrupsionit, veçanërisht në aspekt të kontratave të ndaluara.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi për notën e dhënë:

Ligji për mbrojtjen e konkurrencës është në fuqi disa vjet, prandaj edhe komuniteti afarist është pjesërisht i njoftuar me dispozitat e tij. Megjithatë, gjatë trajnimeve që i mban Byroja për furnizime publike për operatorët ekonomikë është vërejtur se subjektet afariste nuk janë të njoftuara me ekzistimin e Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës dhe rolin e tij. Byroja gjithashtu ka pranuar ankesa nga operatorët ekonomikë për uljen joreale të çmimeve gjatë procedurave për furnizime publike, që do të thotë se ato nuk janë dërguar në vendin e vërtetë, gjegjësisht të Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës. Prandaj, duhet të bëhet organizimi i trajnimeve nëpërmjet odave ekonomike dhe organizatave të punëdhënësve e në bashkëpunim me Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës dhe Byronë për furnizime publike, me qëllim që operatorët ekonomikë të njoftohen me atë se cilat janë të drejtat që mund të mbrohen dhe procedurat që mund të ngriten në bazë të rregullativës për mbrojtjen e konkurrencës.

Rekomandim

- Organet shtetërore në bashkëpunim me shoqatat e sektorit afarist të inicojnë edukim të mëtutjeshëm dhe përkrahje të subjekteve afariste për rregullativën që ka të bëjë me mbrojtjen e konkurrencës dhe zbatimin e saj.

¹²⁰ Rregullorja për programin për realizimin e edukimit për furnizimet publike, programin për realizimin e trajnimit për trajnues për furnizimet publike, formën dhe përmbajtjen e certifikatës për provimin e dhënë për person për furnizime publike dhe për trajnues, si dhe për lartësinë e kompensimit që e paguajnë pjesëmarrësit e edukimit, Gazeta zyrtare nr. 90/2012.

Problemi / faktori i rrezikut 4:

Ka transparencë të pamjaftueshme të sponsorimeve, prapa së cilës fshihet mundësi për korrupsion

Arsyetimi:

Sponsorimet nuk janë të dukshme për publikun e gjerë, dhe për këtë arsye, për to ekziston bindja se kanë prapavijë të turbullt. Duhet të arrihet transparencë për qëllimet, vlerën dhe llojin e sponsorimit dhe për sponsorët.

Institucioni: Ministria për Drejtësi, organet që e përcaktojnë interesin publik, odat ekonomike dhe organizatat e punëdhënësve**Kategoria: Udhëheqja – mekanizmat për integritet**

Pyetja-indikator: A përfshijnë mekanizmat për integritet, duke i përfshirë edhe kodet etike dhe kodet për udhëheqje korporative të sektorit afarist, rregulla për donacionet dhe sponsorimet që të sigurohet transparenca e tyre dhe të sigurohet se ato nuk përdoren për fshehje të mitës, pagesave të parregullta ose pagesave të njerëzve të afërt?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi për notën e dhënë:

Për vërtetimin e interesit publik që lidhet me ndonjë donacion ose sponsorim dhe përfitimin e të drejtës për stimulim tatimor për këtë arsye, donatori ose sponsori duhet të përgatisë dhe të dorëzojë kontratë me shkrim për donacion ose sponsorim në Ministrinë për Drejtësi, ku duhet të përfshihet edhe qëllimi i përkrahjes. Megjithatë, nuk ekziston ndonjë formular i detyrueshëm që është i standardizuar, e as ndonjë dispozitë në rregullativë që më detajisht do ta përcaktonte përmbajtjen e kontratës (elementet antikorrupive, definim të asaj që pranohet dhe që dorëzohet, ndëshkime për mospërmbushje të obligimeve, etj.), edhe pse kjo është paraparë si aktivitet në Programin shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit. Për shembull, disa korporata multinacionale¹²¹ në rregullat e tyre antikorrupive vendosin klauzola të detyrueshme në kontratat me të cilat vërtetohet se përfaqësuesi i pranuesit nuk është person zyrtar, i punësuar në administratën publike ose në ndonjë parti politike, e në qoftë se gjendja e tillë ndryshon, për këtë është i obliguar menjëherë ta njoftojë ofruesin e donacionit ose të sponsorimit, me ç'rast kontrata do të ndërpritet. Në nenin 4 të Ligjit për donacione dhe për sponsorime në veprimtaritë publike ku parashihet obligimi për nënshkrimin e kontratës për donacion, mund të futet dispozitë se kontratat për donacion patjetër duhet të përfshijnë edhe klauzola antikorrupive, e për këtë mund të shërbejnë modelet e pranuar ndërkombëtare. Model i zhvilluar më detajisht është klauzola e Odës ndërkombëtare të tregtisë ("International Chamber of Commerce")¹²², e cila ka për qëllim të sigurojë se kontrata nuk ka të bëjë me përfitimin e dobisë së paarsyetuar, të drejtpërdrejtë ose indirekte, nëpërmjet mitës, zhvatjes, tregtisë me ndikim ose larjes së të ardhurave nga praktikant korruptive. Kjo veçanërisht ka të bëjë me rastet ku janë të përfshirë persona zyrtarë, parti politike dhe përfaqësues të tyre, si dhe kandidatë për ndonjë funksion politik. Klauzola e këtillë mund të përkthehet dhe të përshtatet me terminologjinë tonë juridike.

121 Për shembull, Arcelor Mittal, shih <http://www.arcelormittalsa.com/Portals/0/Anti-Corruption%20Guidelines.pdf>

122 <http://www.iccwbo.org/Data/Policies/2012/ICC-Anti-corruption-Clause/>

Sipas rregullativës së vendit, pas shfrytëzimit të donacionit/sponsorimit, pranuesi i tij, së bashku me Raportin për donacionin/sponsorimin - i cili përmban informatë të detajuara për formën e donacionit/sponsorimit dhe përdorimin e tij – deri te DHP-ja duhet të dorëzojë edhe vërtetim për donacionin/sponsorimin, me të cilin e vërteton pranimin e mjeteve, si dhe dëshmi për shfrytëzimin e mjeteve të pranuar për qëllimin e caktuar. Megjithatë, me qëllim të përcaktimit të saktë të përgjegjësisë dhe të pasojave nga keqpërdorimi, pas realizimit të donacionit/sponsorimit, në nenin 4 të Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike, mund të futet dispozitë se kontrata patjetër duhet të përmbajë klauzolë sipas të cilës, në rast të keqpërdorimit të donacionit ose sponsorimit, pranuesi do t'ia kthejë mjetet e keqpërdorura ofruesit të donacionit/sponsorimit, ndërsa shtetit do t'ia kthejë stimulimet e shfrytëzuara tatimore.

Një element tjetër që është paraparë në program është edhe futja e obligimit për nënshkrimin e Deklaratës për mosekzistim/ekzistim të konfliktit të interesave për të gjitha palët gjatë sponsorimeve. Sipas përfaqësuesve të komunitetit afarist, deklarata e këtillë do të çonte në ngarkimin e mëtutjeshëm të procedurës për shfrytëzimin e stimulimeve tatimore të parapara me Ligjin për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike dhe për pasojë edhe në zvogëlimin e interesit të kompanive për përkrahjen e aktiviteteve të dobishme për shoqërinë. Edhe përfundimet nga diskutimi mbikëqyrës në Komisionin për kulturë të Kuvendit të vendit, në temën “Implementimi i Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike”, të mbajtur më datë 21.07.2010, e potencojnë nevojë për thjeshtësimin e procedurave administrative që kanë të bëjnë me ligjin, thjeshtësimin e procedurës për realizimin e stimulimeve tatimore, dhe zvogëlimin e vëllimit të dokumentacionit të detyrueshëm. Prandaj, KSHPK-së i rekomandohet që ta zvogëlojë rrezikun nga paraqitja e konfliktit të interesave gjatë donacioneve dhe sponsorimeve, duke i përforcuar dhe duke i promovuar dispozitat në kodet etike të sektorit privat, që do të kenë për qëllim të fusin vetërregullim në sektorin privat në këtë sferë, në vend që të futet deklarata e detyrueshme për konflikt të interesave.

Sa i përket kodeve vullnetare, “Kodi etik i biznesit” i promovuar nga Konfederata e biznesit e vendit, “Kodi i etikës dhe i sjelljes afariste i shoqatave aksionare” dhe “Kodi i etikës dhe i sjelljes afariste për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme” i Transaprecy International, Odës Ekonomike të vendit dhe Odës Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore, si dhe “Kodi për udhëheqje korporative për shoqatat aksionare”, nuk kanë dispozita të veçanta për donacionet dhe sponsorimet, por përmbajnë dispozita për parandalimin e konfliktit të interesave dhe shmangien e dhënies së drejtpërdrejtë dhe indirekte të mitës. “Kodi etik i biznesit”, përmban edhe masa antikorrupive në raportet kontraktuese me shtetin, të cilat gjithashtu mund të jenë relevante, kur pranuesi i donacionit është sektori publik – që është rast i shpeshtë.

Sfidë të veçantë paraqet fakti që numri më i madh i organeve kompetente nuk kanë përcaktuar dhe nuk kanë publikuar kritere objektive për përcaktimin e interesit publik gjatë donacioneve dhe sponsorimeve që u nënshtrohen stimulimeve tatimore, që le hapësirë për jokonsekuencë dhe interpretim subjektiv të interesit publik nga ana e personave përgjegjës, dhe e vë në dyshim transparencën e procedurës.¹²³ Në praktikë, është veçanërisht e vështirë të dallohet interesi publik nga aktivitetet komerciale në fushën e kulturës dhe të sportit – ku janë të orientuara edhe numri më i madh i donacioneve dhe i sponsorimeve. Si shembull pozitiv, Ministria e Kulturës ka publikuar se mendimet që i jep për vërtetimin e interesit publik, i bën në bazë të kritereve të kodifikuara, të publikuara në rregullore¹²⁴ – edhe pse ky akt nënligjor është miratuar para se të miratohet Ligji për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike. Por, madje edhe në këtë sferë, e cila ka shkuar më përpara me kodifikimin e interesit publik, nuk mund të thuhet se

¹²³ Analizë e zbatimit të Ligjit për donacionet dhe sponsorimet në veprimtaritë publike, 2007 – 2011, Shoqata “Konekt” dhe Qendra evropiane për të drejtën joprofitabile (QEDJ), 2012.

¹²⁴ Rregullorja për kriteret për financimin e programeve, gjegjësisht projekteve sipas veprimtarive të veçanta të kulturës (Gazeta zyrtare e vendit, nr.61/2004).

ekzistojnë kritere gjithëpërfshirëse, për shkak se nuk ka kritere të kodifikuara për përcaktimin e interesit publik në kulturë në nivel lokal, gjegjësisht të interesit lokal në kulturë. Prandaj, kodifikimi i kritereve precize për përcaktimin e interesit publik në këtë sferë dukshëm do ta zvogëlonte rrezikun për paraqitjen e korrupsionit.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi për notën e dhënë:

Të rralla janë rastet kur kompanitë publikojnë ekzistimin e mekanizmave të veçanta për parandalimin e korrupsionit dhe të konfliktit të interesave gjatë donacioneve dhe sponsorimeve që i japin. Një pjesë e vogël e kompanive publikojnë të dhëna për vlerën e donacioneve dhe të sponsorimeve që i japin, për çka i japin ato, e ndonjëherë edhe për pranuesit dhe shfrytëzuesit e fundit. Kjo më shpesh bëhet në ueb-faqet e tyre, në ueb-faqet e grupacioneve amë, pjesë përbërëse e të cilave janë, ose në raportet me shkrim për punën e kompanisë.

Rekomandime

- Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike që të parashihet se:
 - o kontratat për donacion patjetër duhet të përfshijnë klauzola antikorrupive, të bazuara na modelet e pranuar ndërkombëtare;
 - o kontrata patjetër duhet të përmbajë klauzolë sipas të cilës, në rast të keqpërdorimit të donacionit ose sponsorimit, pranuesi do t'ia kthejë mjetet e keqpërdorura ofruesit të donacionit/sponsorimit, ndërsa shtetit do t'ia kthejë stimulimet e shfrytëzuara tatimore.
- Definimi dhe publikimi i kritereve objektive nga ana e organeve shtetërore për përcaktimin e interesit publik të donacioneve dhe të sponsorimeve që u nënshtrohen stimulimeve tatimore.
- Plotësimi i modeleve të kodeve etike dhe kodeve për udhëheqje të mirë korporative me dispozita të detajuara për parandalimin e korrupsionit dhe të konfliktit të interesave gjatë donacioneve dhe sponsorimeve, si dhe dispozita për publikimin e vlerës së donacioneve dhe sponsorimeve që jepen, për çfarë qëllimi jepen ato dhe kush janë pranuesit e tyre.

Institucioni: DHP-ja, Regjistri qendror, odat ekonomike dhe organizatat e punëdhënësve

Kategoria: Udhëheqja – transparenca

Pyetja-indikator: A ekziston evidencë përkatëse e donacioneve dhe sponsorimeve dhe a mbahet regjistër i donacioneve dhe sponsorimeve nga sektori afarist, të cilat u nënshtrohen stimulimeve tatimore?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi për notën e dhënë:

Sipas nenit 19 të Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike¹²⁵, ofruesi dhe pranuesi i donacionit dhe i sponsorimit, për të cilat është vërtetuar se janë me interes publik, janë të obliguar që të dorëzojnë Raport për donacionin dhe sponsorimin e dhënë dhe të pranuar (formularët “UJP-DIS/DV” dhe “UJP-IDS/PR”) deri te Drejtoria për të hyra publike, më së voni 30 ditë nga dita e plotësimit të kontratës për donacion ose sponsorim.

Në Ligjin për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike nuk ka dispozita me të cilat rregullohet mbajtja e regjistrit për donacione dhe sponsorime. Prandaj, Ministria për Drejtësi nuk është e obliguar të ketë bazë me të dhëna me kërkesat e parashtuara dhe të shqyrtuara për ta konstatuar interesin publik, si dhe qëllimin për të cilin janë dedikuar mjetet, me çka vështirësohet ndjekja e trendeve në këtë fushë dhe implementimi i ligjit.

Me nenin 170 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore¹²⁶ është përcaktuar se Ministria për Shëndetësi mban regjistrë të donacioneve dhe të sponsorimeve që jepen për punëtorët dhe bashkëpunëtorët shëndetësorë, dhe që janë të dedikuara për pjesëmarrje në takime profesionale, seminare, punëtori dhe ngjarje të ngjashme për aftësim dhe avancim plotësues. Me rregullore të veçantë¹²⁷ parashihet se regjistri përmban të dhëna për pranuesin e sponsorimit/donacionit, ngjarjen për të cilin jepet ai, qëllimi për të cilin janë dedikuar mjetet dhe vlerën e përgjithshme. Ministria ka obligim që më së voni deri më 15 janar të vitit aktual, në ueb-faqen e saj të publikojë raport vjetor nga regjistri ku janë të shënuara të dhënat për numrin e përgjithshëm të punëtorëve shëndetësorë, gjegjësisht bashkëpunëtorëve shëndetësorë që kanë marrë pëlqim për sponsorime dhe donacione, vlerën e përgjithshme të sponsorimeve dhe të donacioneve, si dhe për çka janë dedikuar sponsorimet dhe donacionet.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi për notën e dhënë:

Formularët për raport për donacionin dhe sponsorimin e dhënë dhe të pranuar (formularët “UJP-DIS/DV” dhe “UJP-IDS/PR”) nuk mundësojnë të shënohen dhe të ndahen donacionet dhe sponsorimet nga personat fizik dhe juridik të vendit dhe të huaj, e as që mund të ndiqet qëllimi për të cilin janë dhënë.

Formularët për raportim financiar vjetor nga personat juridik nuk mundësojnë shënim të veçantë të donacioneve dhe të sponsorimeve të ofruesit e tyre. Ndërsa, te pranuesit e donacioneve dhe të sponsorimeve, këto formularë nuk mundësojnë që të shënohen dhe të ndahen donacionet dhe sponsorimet nga personat fizik dhe juridik të vendit dhe të huaj, e as që mund të ndiqet

125 Gazeta zyrtare e vendit, nr.47/06, 86/08 dhe 51/2011.

126 Gazeta zyrtare e vendit 43/12 dhe 145/12.

127 Rregullorja për regjistrimin e pëlqimeve për sponsorime dhe donacione të punëtorëve të shëndetësisë, gjegjësisht bashkëpunëtorëve të shëndetësisë, Gazeta zyrtare e vendit, nr. 60/12.

qëllimi për të cilin janë dhënë. Prandaj, Regjistri qendror disponon vetëm me informatën për nivelin e përgjithshëm të donacioneve nga subjektet afariste, i cili në vitin 2010 ka qenë mbi tetë milionë euro.¹²⁸

Ministria për Drejtësi në ueb-faqen e saj nuk publikon bazë me të dhëna për kërkesat e parashtruara dhe të shqyrtuara, për ta konstatuar interesin publik, si dhe qëllimin për të cilin janë dedikuar mjetet, me çka vështirësohet ndjekja e trendeve në këtë fushë dhe implementimi i ligjit. E ngjashme është gjendja edhe me ministritë përkatëse, të cilat, shpeshherë, nuk kanë të dhëna për donacionet dhe sponsorimet në veprimtaritë me interes publik që janë në domenin e tyre, e për të cilat e kanë konfirmuar interesin publik. Siç pranojnë edhe vetë institucionet, një pjesë e donacioneve, veçanërisht në arsim, aspak nuk evidentohen.¹²⁹ Përjashtim i rëndësishëm është shëndetësia, ku Ministria për Shëndetësi disponon me të dhëna për pranuesin e donacionit/sponsorimit për aftësim dhe avancim plotësues për punëtorët dhe bashkëpunëtorët shëndetësorë, ngjarjen për të cilën jepet, qëllimin për të cilin janë dedikuar mjetet dhe vlerën e përgjithshme. Megjithatë, në momentin e përgatitjes së kësaj analize, Ministria për Shëndetësi në ueb-faqen e saj nuk kishte publikuar raport vjetor nga regjistri për vitin 2012 – edhe përkundër obligimit ligjor për ta bërë këtë. Prandaj, duhet të parashihet publikimi i bazës së të dhënave për donacionet dhe sponsorimet që u nënshtrohen stimulimeve tatimore, që do të përfshijë së paku të dhëna për vlerën e mjeteve të dhëna, vlerën e stimulimeve tatimore, si dhe veprimtaritë me interes publik për të cilat janë dhënë ato. Për shkak se rekomandimi ka për qëllim t'i përfshijë donacionet dhe sponsorimet e realizuara, e jo ato të planifikuara, institucioni më adekuat për zbatimin e tij është DHP-ja, e deri diku edhe Regjistri qendror – duke pasur parasysh faktin se ato janë pozitive që të marrin të dhëna për harxhimet e subjekteve afariste.

Rekomandime

- Plotësimi i Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike që:
 - o të futet dispozitë me të cilën do të rregullohet mbajtja e regjistrit të donacioneve dhe sponsorimeve në veprimtaritë publike;
 - o të parashihet publikimi i bazës së të dhënave për donacionet dhe sponsorimet që u janë nënshtuar stimulimeve tatimore, që do të përfshijë së paku të dhëna për vlerën e mjeteve të dhëna, vlerën e stimulimeve tatimore, si dhe veprimtaritë me interes publik për të cilat janë dhënë ato.

¹²⁸ Analizë e zbatimit të Ligjit për donacionet dhe sponsorimet në veprimtaritë publike, 2007 – 2011, Shoqata “Konekt” dhe Qendra evropiane për të drejtën joprofitabile (QEDJ), 2012.

¹²⁹ Sipas dëshmisë së ministrit të atëhershëm për arsim dhe shkencë, z. Nikolla Todorov, në debatin mbikëqyrës në Kuvend - të mbajtur në vitin 2010 – në temën “Implementimi i Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike”.

PASQYRA E REKOMANDIMEVE DHE ÇAKTIMI I PRIORITETEVE TË TYRE

Qëllimi	Opcionet strategjike ¹	Pengesat	Zgjidhja për tejkalimin e pengesave	Vlerësimi i ndikimit për arritjen e qëllimit ²	Aktorët kryesorë	Prioriteti	
<p>1. Problemi / faktori i rrezikut nga Programi shtetëror:</p> <p>Nxjtja për zhvillimin dhe zbatimin e standardeve dhe procedurave adekuatë për mbrojtjen e integritetit të subjekteve nga sektori privat</p>	<p>Plotësimi i modeleve të kodeve etike dhe të kodeve për sjellje të mirë korporative</p>	<p>Interesimi i dobët i subjekteve afariste për pranimin e modeleve</p> <p>Mungesa e mekanizmave për zbatim</p>	<p>Promovimi i kodeve, me përkrahje nga organet shtetërore dhe futja e sanksioneve të zvogëluara për veprimet e kryera kundërligjore</p> <p>Futja e sistemit për mbikëqyrje dhe respektim të kodet, si dhe të standardet minimale për programin organizativ për respektim të ligjeve dhe të dispozitave të tjera</p>	Mesatar	KSHPK-ja, odat ekonomike, shoqatat e punëdhënësve, Bursa për letra me vlerë e vendit	1	
	<p>Fushatë publike për pranim më të madh të kodeve etike dhe kodeve për sjellje të mirë korporative nga ana e subjekteve afariste</p>	<p>Shpenzimet e larta</p> <p>Skepticizmi i komunitetit afarist</p>	<p>Futja e sanksioneve të zvogëluara për vepra të kryera kundërligjore</p>	<p>Sigurimi i përkrahësve mediaticë</p>	Mesatar	KSHPK-jaA, odat ekonomike, shoqatat e punëdhënësve, Bursa për letra me vlerë e vendit, mediat, agjencitë për reklamim, personalitete të njohura si promotorë	
	<p>Publikimi i mekanizmave dhe i aktiviteteve për mbikëqyrje dhe respektim të kodeve dhe të rezultateve të arritura</p>	<p>Mungesa e sistemit për mbikëqyrje dhe respektim të kodeve</p>	<p>Futja e sistemit për mbikëqyrje dhe respektim të kodet, si dhe të standardet minimale për programin organizativ për respektim të ligjeve dhe të dispozitave të tjera</p> <p>Futja e obligimit për publikim të kodet, si dhe të standardet minimale për programin organizativ për respektim të ligjeve dhe të dispozitave të tjera</p>	<p>Futja e sistemit për mbikëqyrje dhe respektim të kodet, si dhe të standardet minimale për programin organizativ për respektim të ligjeve dhe të dispozitave të tjera</p>	I ulët	KSHPK-ja, odat ekonomike, shoqatat e punëdhënësve, Bursa për letra me vlerë e vendit	
<p>Përcaktimi i standardeve minimale për programin organizativ për respektim të ligjeve dhe të dispozitave të tjera dhe për sjellje etike, në bazë të të cilës ndërmerret mund të kenë të drejtë për sanksion të zvogëluar për vepra të kryera kundërligjore</p>	<p>Mungesa e ekspertizës specifike</p> <p>Procesi i gjatë i ndryshimit të kornizës ligjore</p> <p>Procesi i gjatë dhe i shtrenjtë për informimin dhe trajnimin e organeve që shqiptojnë sanksione, si dhe i subjekteve afariste</p>	<p>Mungesa e ekspertizës specifike</p> <p>Procesi i gjatë dhe i shtrenjtë për informimin dhe trajnimin e organeve që shqiptojnë sanksione, si dhe i subjekteve afariste</p>	<p>Shfrytëzimi i përkrahjes teknike donatore dhe përvojave të dëshmuara nga vendet e tjera</p>	I lartë	KSHPK-ja, Ministria për Drejtësi, Akademia për gjykatës dhe prokurorë publik, odat ekonomike, shoqatat e punëdhënësve		

Qëllimi	Opcionet strategjike ¹	Pengesat	Zgjidhja për tejkalimin e pengesave	Vlerësimi i ndikimit për arritjen e qëllimit ²	Aktorët kryesorë	Prioriteti
Krijimi i bazave të përditësuara me të dhëna për verifikimin e pronësisë së fundit dhe kontrollit të fundit mbi ndërmarrjet, dhe vënia e tyre në dispozicion	Kërkesa që kompanitë ose regjistri i shoqatave tregtare dhe personat e tjerë juridik të mbajnë të dhëna të këtuja	Shpenzimet e larta dhe mungesa e ekspertizës specifike Procesi i gjatë për ndryshimin e kornizës ligjore	Shfrytëzimi i përvojave të vendeve të tjera evropiane	Mesatar	KSHPK-ja, Drejtoria për zbulim financiar, Regjistri qendror i vendit, odat ekonomike	2
	Shfrytëzimi dhe avancimi i burimeve të tjera me të dhëna: baza private me të dhëna dhe dokumentacion juridik (p.sh. dokumentacioni nga kuvendet e aksionarëve; ose deklaratat për pronësinë e fundit të dorëzuara nga personat juridik); ueb-faqet e organeve dhe rregullatorëve mbikëqyrës, dhe burime të tjera në internet; burime të DHP-së organeve rregullatore financiare	Vështirësi gjatë analizës dhe sigurimit të rahasueshmërisë së të dhënave nga burimet e ndryshme Probleme me vërtetësinë dhe kualitetin e të dhënave të tilla	Shfrytëzimi i përvojave për softuer, platforma dhe procedura të tjera të vendeve të tjera evropiane	Mesatar	KSHPK-ja, Drejtoria për zbulim financiar, Komisioni për letra me vlerë, DHP-ja	

1. Opcionet strategjike mund të jenë edhe komplementare. Për shkak të kufizimeve të hapësirës, ato janë paraqitur në version të shkurtuar. Në formë të plotë janë paraqitur si rekomandime nën çdo pyetje-indikator, si dhe në përmbledhje.

2. Vlerësimi e merr parasysh edhe ndikimin e opcionit mbi realizueshmërinë e opcioneve të tjera strategjike – në rastet kur ato janë komplementare.

Qëllimi	Opcionet strategjike ¹	Pengesat	Zgjidhja për tejkalimin e pengesave	Vlerësimi i ndikimit për arritjen e qëllimit ²	Prioriteti
Përforcimi i zbatimit të kufizimeve që kanë të bëjnë me aktivitetet e personave të mëparshëm zyrtarë	Përpilimi i kontrollimit e përmbushjes së neneve 17 dhe 20-c nga Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave (për shembull, baza e të dhënave të organeve që rregullojnë degë të caktuara ekonomike dhe e të punësuarve në to, me autorizime dhe detyra adekuate rregullatore, dhe krahasimi automatik i të dhënave në të më të dhënat për të punësuarit e rinj nga evidenca e APRIM-së, ose me të dhënat për ndryshimin e pronësisë së aksioneve nga Depozituesi qendror i letrave me vlerë)	Shpenzimet e larta për zgjidhje informatike Përfshirja e madhe e personave për të cilët vlejné kufizimet Pamundësia për kompensim të fitimit të humbur për shkak të kufizimeve të gjithë personat e mëparshëm zyrtarë	Shfrytëzimi i përvojave për softuer, platforma dhe procedura të tjera të vendeve të tjera Shfrytëzimi i përvojave për futjen e përjashtimeve nga kufizimet që e marrin parasysh fuqinë e nëpunësit të mëparshëm për të ndikuar në vendimet që janë marrë, si dhe mundësitë që i ka pasur për qasje në të dhënat e ndjeshme	I lartë	1 Aktorët kryesorë KSHPK-ja, Agjencia për punësim e vendit, Depozituesi qendror i letrave me vlerë, Regjistri qendror i vendit KSHPK-ja, Ministria për shoqëri informatike dhe administratë, Agjencia për administratë, Byroja për furnizime publike

Qëllimi	Opcionet strategjike ¹	Pengesat	Zgjidhja për tejkalimin e pengesave	Vlerësimi i ndikimit për arritjen e qëllimit ²	Aktorët kryesorë	Prioriteti
Avancimi dhe centralizimi i publikimit onlajn të personave nga sektori privat që kanë pranuar ndonjë lloj të mjeteve publike (për shembull subvencione, furnizime publike), shuma e pranuar dhe për çfarë qëllimi.	Zhvillimi i një platforme qendrore onlajn, e cila do të mundësojë kërkim të të dhënave	Shpenzimet e larta për bashkimin e bazave të ndryshme të të dhënave Mospublikimi i vlerës së disa llojeve të caktuara të ndihmës shtetërore Pengesat që kanë të bëjnë me privatësinë e personave fizik	Shfrytëzimi i përkrahjes teknike dhe financiare nga donatorët Publikimi i mundshëm në formë të përmbledhur i vlerës së ndihmës, sipas zonave për zhvillim teknologjik-industrial Bashkëpunimi me Drejtorinë për mbrojtjen e të dhënave personale për definimin e kornizës përkatëse për mbrojtjen e privatësisë së personave fizik	I lartë	KSHPK-ja, Byroja për furnizime publike, Agjencia për përkrahje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural, Ministria për Ekonomi, Ministria për Punë dhe Politikë Sociale, Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor, Agjencia për investime të huaja dhe promovim të eksportit	2
	Hapja e ueb-faqes qendrore me linke që çojnë në faqe të tjera me baza të të dhënave me lloje të ndryshme të mjeteve publike	Mospublikimi i vlerës së disa llojeve të caktuara të ndihmës shtetërore Pengesat që kanë të bëjnë me privatësinë e personave fizik	Publikimi i mundshëm në formë të përmbledhur i vlerës së ndihmës, sipas zonave për zhvillim teknologjik-industrial Bashkëpunimi me Drejtorinë për mbrojtjen e të dhënave personale për definimin e kornizës përkatëse për mbrojtjen e privatësisë së personave fizik	Mesatar	Njëlloj sikurse në fushën e mësipërme	

2. Problemi / faktori i rrezikut nga Programi shtetëror: Njohuritë e pamjaftueshme për korrupsionin dhe interesave e interesave në sektorin privat

1 Opcionet strategjike mund të jenë edhe komplementare. Për shkak të kufizimeve të hapësirës, ato janë paraqitur në version të shkurtuar. Në formë të plotë janë paraqitur si rekomandime nën çdo pyetje-indikator, si dhe në përmbledhje.

2 Vlerësimi e merr parasysh edhe ndikimin e opcionit mbi realizueshmërinë e opcioneve të tjera strategjike – në rastet kur ato janë komplementare.

Qëllimi	Opcionet strategjike ¹	Pengesat	Zgjidhja për tejkalimin e pengesave	Vlerësimi i ndikimit për arritjen e qëllimit ²	Prioriteti
<p>Avancimi i askëpunimit ndërmjet organeve të rendit dhe subjekteve afariste</p>	<p>Organizimi i trajnimeve nga organet shtetërore, organizatat e sektorit afarist dhe organizatat profesionale, që u dedikohen subjekteve afariste, për rregullativën për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, për futjen e mekanizmave për parandalimin e korrupsionit; edukimi i revizorëve (të brendshëm dhe të jashtëm) dhe i kontabilitistëve për mënyrat e parandalimit dhe zbulimit të korrupsionit në sektorin privat. Përgatitja e materialeve informative</p>	<p>Mungesa e mjeteve financiare në buxhet, te organizatat e sektorit afarist dhe te organizatat profesionale</p>	<p>Shfrytëzimi i përkrahjes teknike dhe financiare nga donatorët, si dhe bashkëpunimi me organizatat joqeveritare që kanë projekte në këtë sferë</p>	<p>I lartë</p>	<p>Aktorët kryesorë</p> <p>KSHPK-ja dhe organet e tjera relevante, odat ekonomike, organizatat e punëdhënësve, organizatat profesionale të revizorëve dhe të kontabilitistëve, organizatat joqeveritare</p> <p>1</p>
<p>Ofrimi i këshillave dhe dhënia e përgjigjeve në pyetje specifike</p>	<p>Futja e mekanizmave për denoncimin dhe mbrojtjen përkatëse ligjore të denoncuesve të korrupsionit në sektorin privat</p>	<p>Njëloj sikurse në fushën e mësipërme</p> <p>Njëloj sikurse në fushën e mësipërme</p>	<p>Shfrytëzimi i përkrahjes teknike dhe financiare nga donatorët</p> <p>Shfrytëzimi i përkrahjes teknike dhe financiare nga donatorët</p>	<p>I ulët</p> <p>I lartë</p>	<p>Njëloj sikurse në fushën e mësipërme</p> <p>Njëloj sikurse në fushën e mësipërme</p>
<p>Realizimi i hulumtimeve për masat antikorruptive të ndërmarrjeve të vendit, vlerësimi i efektivitetit të instrumenteve të veçanta, zhvillimi i analizave lokale për rastet konkrete të zbatimit të masave antikorruptive dhe shembuj të praktikave më të mira</p>	<p>Procesi i gjatë dhe i shtrenjtë për informimin dhe trajnimin e organeve për mbikëqyrje, organeve që shqiptojnë sanksione, si dhe të subjekteve afariste</p>	<p>Mungesa e mjeteve financiare për të bërë analiza</p>	<p>Shfrytëzimi i përkrahjes teknike nga donatorët dhe i përvojave dhe zgjidhjeve të dëshmuara nga vendet tjera</p>	<p>I lartë</p>	<p>Ministria për Drejtësi, KSHPK-ja, odat ekonomike, organizatat e punëdhënësve, sindikatet</p>
<p>Realizimi i hulumtimeve për masat antikorruptive të ndërmarrjeve të vendit, vlerësimi i efektivitetit të instrumenteve të veçanta, zhvillimi i analizave lokale për rastet konkrete të zbatimit të masave antikorruptive dhe shembuj të praktikave më të mira</p>	<p>Mungesa e mjeteve financiare për të bërë analiza</p>	<p>Mungesa e mjeteve financiare për të bërë analiza</p>	<p>Shfrytëzimi i përkrahjes teknike dhe financiare nga donatorët, si dhe bashkëpunimi me organizatat joqeveritare që kanë projekte në këtë sferë</p>	<p>Mesatar</p>	<p>KSHPK-ja dhe organet e tjera relevante, odat ekonomike, organizatat e punëdhënësve</p>

Qëllimi	Opcionet strategjike ¹	Pengesat	Zgjidhja për tejkalimin e pengesave	Vlerësimi i ndikimit për arritjen e qëllimit ²	Aktorët kryesorë	Prioriteti
Nxitija e pushtetit nga ana e sektorit privat për parandalimin dhe represionin e korrupsionit	Publikimi më konsekuent i pasojave të dokumentuara të dëmshme nga korrupsioni mbi ndërmarrjet, rritjen ekonomike dhe konkurrencën nga ana e përfaqësuesve të sektorit afarist. Arritja e konsensusit në komunitetin afarist për masat më prioritare që do të kontribuojnë në luftën kundër korrupsionit në sektorin privat, dhe përfaqësim të pushteti për zbatimin e atyre masave që janë në kompetencë të organeve shtetërore.	Mungesa e mjeteve financiare për të bërë analiza	Shfrytëzimi i përkrahjes teknike dhe financiare nga donatorët, si dhe bashkëpunimi me organizatat joqeveritare që kanë projekte në këtë sferë	Mesatar	KSHPK-ja dhe organet e tjera relevante, odat ekonomike, organizatat e punëdhënësve	2
Bashkëpunimi i sektorit privat me iniciativat antikorruptive të shoqërisë civile dhe përkrahja e tyre financiare	Njëlliloj sikurse edhe të qëllimi “avancimi i bashkëpunimit ndërmjet organeve të rendit dhe subjekteve afariste”	Bashkëpunimi mjaft i kufizuar ndërmjet përfaqësuesve të sektorit afarist në këtë sferë	Interaksiioni i organeve shtetërore me të gjithë përfaqësuesit e sektorit afarist	Mesatar	KSHPK-ja dhe organet e tjera relevante, odat ekonomike, organizatat e punëdhënësve	1

3. Problemi / faktori i rrezikut nga Programi shtetëror: informimi i pamjaftueshëm për Ligjin për mbrojtje të konkurrencës dhe kapaciteti i pamjaftueshëm i Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës (KMK) për zbatimin e ligjit

- Opcionet strategjike mund të jenë edhe komplementare. Për shkak të kufizimeve të hapësirës, ato janë paraqitur në version të shkurtuar. Në formë të plotë janë paraqitur si rekomandime nën çdo pyetje-indikator, si dhe në përmbledhje.
- Vlerësimi e merr parasysh edhe ndikimin e opcionit mbi realizueshmërinë e opcioneve të tjera strategjike – në rastet kur ato janë komplementare.

Qëllimi	Opcionet strategjike ¹	Pengesat	Zgjidhja për tejkalimin e pengesave	Vlerësimi i ndikimit për arritjen e qëllimit ²	Aktorët kryesorë	Prioriteti
Avancimi i shkathëtsisë, potencialit kadrovik të organeve shtetërore dhe mekanizmave për parandalimin dhe zbulimin e kontratave të ndaluara, në të cilat janë përfshirë ofertuesit gjatë furnizimeve publike	Vlerësimi i mundësive për futjen e paralajmërimit automatik gjatë ekzistimit të indikacioneve për korrupsion dhe konflikt të interesave të furnizimit publikë intensifikimi i aktiviteteve për operacionalizimin e propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit penal, ku është përfshirë ndryshimi dhe plotësimi i nenit 283	Mungesa e mjeteve financiare / Mungesa e mjeteve financiare	Shfrytëzimi i përkrahjes teknike nga donatorët dhe i përvojave dhe zgjidhjeve të dëshmuara nga vendet tjera	I lartë	Byroja për furnizime publike, KSHPK-ja	1
Përforcimi kadrovik dhe financiar i Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës në pjesën e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës	Të inicohen trajnime që u dedikohen gjykatësve për keqpërdorimet e mundshme gjatë furnizimeve publike, me theks të veçantë në aspektin e kontratave të ndaluara gjatë procedurave për furnizime	Mungesa e mjeteve financiare	Angazhimi të publiku për domosdoshmërinë e përforcimit të këtyre	I lartë	Ministria për Drejtësi	
Edukimi i mëtutjeshëm dhe përkrahja e subjekteve afariste për rregullativën që ka të bëjë me mbrojtjen e konkurrencës dhe zbatimin e saj	Organizimi i trajnimeve nga organet shtetërore dhe organizatat e sektorit afarist, si dhe organizatat profesionale	Mosekzistimi i interesimit të gjykatësit	Sqarim se bëhet fjalë për trajnime që janë të dedikuara për gjykatësit që kanë raste që ndërlidhen me furnizimet publike, e jo për trajnime që janë të dedikuara për personat që punojnë në gjykata, të cilët janë të përfshirë në procedurat për furnizime publike	Mesatar	KSHPK-ja, Byroja për furnizime publike dhe Akademia për gjykatës dhe prokurorë	2
	Përgatitja e materialeve informative	Mungesa e mjeteve financiare në buxhet, të organizatat e sektorit afarist dhe të organizatat profesionale	Shfrytëzimi i përkrahjes teknike dhe financiare nga donatorët, si dhe bashkëpunimi me organizatat joqeveritare	I lartë	Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës, KSHPK-ja, shoqatat e sektorit afarist, shoqatat dhe fondacionet	
	Ofrimi i këshillave dhe dhënia e përgjigjeve për pyetjet specifike	Njëlloj sikurse në fushën e mësipërme	Shfrytëzimi i përkrahjes teknike dhe financiare nga donatorët	I ulët	Njëlloj sikurse në fushën e mësipërme	
		Njëlloj sikurse në fushën e mësipërme	Shfrytëzimi i përkrahjes teknike dhe financiare nga donatorët	I lartë	Njëlloj sikurse në fushën e mësipërme	
4. Problemi / faktori i rrezikut nga Programi shtetëror: transparencja e pamjaftueshme e sponsorimeve, prapa së cilës fshihet mundësia për korrupsion						

Qëllimi	Opcionet strategjike ¹	Pengesat	Zgjidhja për tejkalimin e pengesave	Vlerësimi i ndikimit për arritjen e qëllimit ²	Aktorët kryesorë	Prioriteti
Avancimi i mekanizmave për integritet që në mënyrë adekuate t'i përfshijnë donacionet dhe sponsorimet	Ndryshim i Ligjit për donacione dhe sponsorime që të parashihen klauzola të detyrueshme antikorruptive në kontratat për donacione, si dhe klauzolë sipas të cilës, gjatë keqpërdorimit të donacionit ose sponsorimit, pranuesi do t'ia kthejë mjetet e keqpërdorura ofruesit të donacionit/sponsorimit, ndërsa shtetit do t'ia kthejë stimulimet e shfrytëzuara tatimore;	Procesi i gjatë për ndryshimin e kornizës ligjore	Shfrytëzimi i përvojave përkatëse nga jashtë	I lartë	Ministria për Drejtësi, KSHPK-ja, odat ekonomike, organizatat e punëdhënësve, shoqatat dhe fondacionet, institucionet	1
	Plotësimi i modeleve të kodeve etike dhe kodeve për sjellje të mirë korporative me dispozita të detajuara për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave gjatë donacioneve dhe sponsorimeve, si dhe dispozita për publikimin e vlerës së donacioneve dhe sponsorimeve që jepen, për çka janë dedikuar dhe pranuesit e tyre.	Interesimi i dobët i subjekteve afariste për pranimin e modeleve Mungesa e mekanizmave për zbatim	Promovimi i kodeve, me përkrahje nga organet shtetërore, dhe futja e sanksioneve të zvogëluara për veprat e kryera kundërligjore Futja e sistemit për mbikëqyrje dhe respektim të kodet, si dhe të standardet minimale për programin organizativ për respektim të ligjeve dhe të dispozitave të tjera	Mesatar	KSHPK-ja, odat ekonomike, organizatat e punëdhënësve, Bursa për letra me vlerë e vendit	
	Definimi dhe publikimi i kriterëve objektive nga ana e organeve shtetërore për përcaktimin e interesit publik të donacioneve dhe të sponsorimeve që u nënshtrohen stimulimeve tatimore	Vështirë për të paraparë kriteret gjithëpërfshirëse në të gjitha fushat	Shfrytëzimi i përvojave nga jashtë	I lartë	Ministria për Drejtësi dhe organet e tjera	

1. Opcionet strategjike mund të jenë edhe komplementare. Për shkak të kufizimeve të hapësirës, ato janë paraqitur në version të shkurtuar. Në formë të plotë janë paraqitur si rekomandime nën çdo pyetje-indikator, si dhe në përmbledhje.

2. Vlerësimi e marr parasysh edhe ndikimin e opcioneve të tjera strategjike – në rastet kur ato janë komplementare.

Qëllimi	Opcionet strategjike ¹	Pengesat	Zgjidhja për tejkalimin e pengesave	Vlerësimi i ndikimit për arritjen e qëllimit ²	Prioriteti
Futja e evidencës adekuate për donacionet dhe sponsorimet që u nënshtrohen stimulumave tatimore	Futja e dispozitës me të cilën do të rregullohet mbajtja e regjistrit të donacioneve dhe sponsorimeve në veprimtaritë publike Të parashihet me ligj publikimi i bazës së të dhënave për donacionet dhe sponsorimet që u janë nënshtruar stimulumave tatimore, që do të përfshijë së paku të dhëna për vlerën e mjeteve të dhëna, vlerën e stimulumave tatimore, si dhe veprimtaritë me interes publik për të cilat janë dhënë ato	Procesi i gjatë për ndryshimin e kornizës ligjore Formularët joadekuatë të DHP-së dhe të Regjistrit qendror	Ndryshimi i formularëve	Mesatar I lartë	Aktorët kryesorë Ministria për Drejtësi DHP-ja, Regjistri qendror, Ministria për Drejtësi

PASQYRA E INDEKSEVE

Edhe pse sipas metodologjisë, kjo analizë bën vlerësim të gjendjes, është bërë edhe vlerësimi numerik me qëllim që të bëhet përmbeldhja numerike e informatave dhe të potencohen anët kryesore të dobëta dhe të fuqishme. Prandaj, në tekstin e mësipërm, për çdo pyetje-indikator është dhënë nota prej 1 deri në 5 – ku 1 është nota më e dobët, ndërsa 5 është më e larta. Në bazë të notave të dhëna prej 1 deri në 5, për çdo pyetje-indikator janë mbledhur notat në nivel të nënkategorive, në nivel të kategorive dhe në nivel të gjithë shtyllës, gjegjësisht sektorit të Programit shtetëror. Me këtë rast, nuk është bërë ponderim (peshim) i notave, por të gjitha notat e mbledhura janë përcaktuar si mes aritmetik. Megjithatë, notat e këtilla duhet të kuptohen vetëm si indikative.

Kategoria	Nënkategoria	Indeksi				
		Dejure	Defacto	Mesatarja e nënkategorisë	Mesatarja e kategorisë	Mesatarja e sektorit
<i>Kapaciteti</i>	Resurset	3	3	3	3,5	2,88
	Pavarësia	5	3	4		
<i>Udhëheqja</i>	Transparenca	3,67	3	3,33	3,15	
	Mekanizmat për integritet	3,67	2,33	3		
<i>Kontributi</i>	Angazhimi në politikën nacionale për antikorrupsion	2		2	2	
	Përkrahja për iniciativat qytetare për antikorrupsion	2		2		

Me qëllim që notat të kuptohen më lehtë, në tabelën e mëposhtme ato janë dhënë në përqindje (prej 0 deri në 100).

Kategoria	Nënkategoria	Indeksi				
		De jure	De facto	Mesatarja e nënkategorisë	Mesatarja e kategorisë	Mesatarja e sektorit
<i>Kapaciteti</i>	Resurset	50%	50%	50%	62,5%	47%
	Pavarësia	100%	50%	75%		
<i>Udhëheqja</i>	Transparenca	66,75%	50%	58,25%	53,75%	
	Mekanizmat për integritet	66,75%	33,25%	50%		
<i>Kontributi</i>	Angazhimi në politikën nacionale për antikorrupsion	25%		25%	25%	
	Përkrahja për iniciativat qytetare për antikorrupsion	25%		25%		

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

Ligje, rregullativa ndërkombëtare dhe akte të tjera ligjore

Council Framework Decision 2003/568/JHA of 22 July 2003 on combating corruption in the private sector

Federal Sentencing Guidelines for Organizations, United States Sentencing Commission, http://www.ussc.gov/Guidelines/2012_Guidelines/index.cfm

G20 compendium of best practices on whistle blower protection legislation: G20 Anti-Corruption Action Plan, Action Point 7: Protection of Whistleblowers, 2010, <http://www.oecd.org/general/48972967.pdf>

http://www.transparency.sk/wp-content/uploads/2010/01/Costs-of-Corruption_Dancikova.pdf

The Bribery Act 2010 – Guidance, UK Ministry of Justice, <http://www.justice.gov.uk/downloads/legislation/bribery-act-2010-guidance.pdf>

UK Bribery Act 2010 (Guidance on 6 implementation principles)

UK Bribery Act 2010, <http://www.legislation.gov.uk/ukpga/2010/23>

UK Public Interest Disclosure Act, <http://www.legislation.gov.uk/ukpga/1998/23/contents>

United Nations Convention Against Corruption

Zuzana Dančíková, Costs of Corruption, Transparency International Slovakia, 2012,

Nevojat antikorruprive të komunitetit afarist të vendit – apel publik deri te autoritetet dhe politikanët, Konfederata e biznesit të vendit, 2013

Programi shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe parandalimin dhe zvogëlimin e konfliktit të interesave 2011–2015

Kodi etik i nëpunësve shtetëror

Kodi etik i nëpunësve publik

Ligji për bankat

Ligji për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike

Ligji për nëpunësit shtetëror

Ligji për mbrojtje të konkurrencës

Ligji për mbrojtje shëndetësore

Ligji për fondet investuese

Ligji për prokurimet publike

Ligji për nëpunësit publik

Ligji për rrogë dhe kompensimet e tjera të deputetëve dhe personave të tjerë të zgjedhur dhe të emëruar

Ligji për kundërvajtje

Ligji për marrëdhënie të punës

Ligji për revizion

Ligji për parandalimin e korrupsionit

Ligji për parandalimin e larjes së parave dhe të ardhurave tjera nga vepra ndëshkuese dhe financimi i terrorizmit

Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave

Ligji për supervizion të sigurimeve

Ligji për shoqatat tregtare

Ligji për letrat me vlerë

Raporti për zbatimin e Memorandumit për bashkëpunim për përkrahje të ndërsjellë për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave me përfaqësues të sektorit privat – periudha: janar-qershor 2013, KSHPK, 2013

<http://www.dksk.org.mk/images/stories/pdf/sorabotka/izvestaj%20-%20ps.pdf>

Kodi penal

Rregullorja për kriteret për financimin e programeve, gjegjësisht projekteve, sipas veprimtarive të veçanta në kulturë (Gazeta zyrtare e vendit, 61/2004).

Rregullorja për programin për realizimin e edukimit për furnizimet publike, programin për realizimin e trajnimit për trajnues për furnizime publike, formën dhe përmbajtjen e vërtetimit për provimin e dhënë për person për furnizime publike dhe për furnizues, si dhe për lartësinë e kompensimit që e paguajnë pjesëmarrësit në edukim, Gazeta zyrtare e vendit, 90/2012

Rregullorja për regjistrimin e pëlqimeve për sponsorime dhe donacione të punëtorëve të shëndetësisë, gjegjësisht bashkëpunëtorëve të shëndetësisë, Gazeta zyrtare e vendit, 60/12.

Raporte dhe analiza

Global Competitiveness Report 2012-2013, World Economic Forum, 2012, http://www3.weforum.org/docs/WEF_GlobalCompetitivenessReport_2012-13.pdf

GLOBAL INTEGRITY REPORT: 2011, Global Integrity, 2012

GRECO Report within the framework of the third round of evaluation for Macedonia (August, 2010)

Implementation of article 12 of the United Nations Convention against Corruption, including the use of public – private partnerships, faqe. 10, Conference of the States Parties to the United Nations Convention against Corruption – Open-ended Intergovernmental Working Group on Prevention, 2012

OECD (2010), Post – Public Employment: Good Practices for Preventing Conflict of Interest, OECD Publishing. <http://dx.doi.org/10.1787/9789264056701-en>.

Recent Slovak Anti-corruption Measures, Transparency International Slovakia, 2012; http://www.transparency.sk/wp-content/uploads/2010/01/Gov-anticorruption-measures_Kurian.pdf

Rules of Conduct and Recommendations on Combating extortion and bribery, International Chamber of Commerce, 2005

The Former Yugoslav Republic Of Macedonia 2012 Progress Report, European Commission, 2012

The identification of beneficial owners in the fight against money laundering, Final Report of Project BOWNET – Identifying the Beneficial Owner of legal entities in the fight against money laundering; <http://www.bownet.eu/materials/BOWNET.pdf>

Towards a Sound Integrity Framework: Instruments, Processes, Structures and Conditions for Implementation, OECD, 2010.

Van der Doesde Willebois, Emile; Halter, Emily M.; Harrison, Robert A.; Park, Ji Won; Sharman, J. C.. 2011. The Puppet Masters : How the Corrupt Use Legal Structures to Hide Stolen Assets and What to Do About It. © World Bank, fq. 17; <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/2363> License: CC BY 3.0 Unported.

Whistle blower protection: encouraging reporting, CleanGovBiz, 2012, <http://www.oecd.org/cleangovbiz/toolkit/50042935.pdf>

World Bank. 2013. Doing Business 2013: Smarter Regulations for Small and Medium – Size Enterprises. Washington, DC: World Bank Group. DOI: 10.1596/978-0-8213-9615-5. License: Creative Commons Attribution CC BY 3.0

Analizë për zbatimin e Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike, 2007 – 2011, Shoqata “Konekt” dhe Qendra evropiane për të drejtën joprofitabile (QEDJ), 2012.

Raporti vjetor i Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit për vitin 2011.

Raporti vjetor i Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit për vitin 2012.

Raporti vjetor i Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës për vitin 2012.

Raporti vjetor i Avokatit të popullit për vitin 2012.

Janka Dimitrova, Përgjegjësia e kontabilistëve, menaxhmentit dhe revizorëve për vërtetësinë, kualitetin dhe kredibilitetin e raporteve financiare

Programi nacional për miratimin e legjislacionit të BE-së, revizioni i vitit 2013.

Resurset e tjera

“Cilat kompani marrin ndihmë shtetërore dhe për çka?!”, magazina Kapital, 20 shtator 2013, http://www.kapital.mk/MK/magazin/96717/koi_kompanii_dobivaat_drzhavna_pomosh_i_za_shto_.aspx

Arcelor Mittal Anti-Corruption Guidelines, <http://www.arcelormittalsa.com/Portals/0/Anti-Corruption%20Guidelines.pdf>

Business Principles for Countering Bribery, Transparency International, 2009, http://files.transparency.org/content/download/109/439/file/2009_BusinessPrinciples_EN.pdf

EU grant recipients and contractors, http://ec.europa.eu/contracts_grants/beneficiaries_en.htm

Kodi etik i këshilltarëve, i promovuar nga Agjencia për përkrahjen e ndërmarrësisë

Good practice guide on internal controls, ethics and compliance, OECD, 2010, <http://www.oecd.org/dataoecd/5/51/44884389.pdf>

International Chamber of Commerce Anti-corruption Clause, <http://www.iccwbo.org/Data/Policies/2012/ICC-Anti-corruption-Clause/>

International Standards On Combating Money Laundering And The Financing Of Terrorism & Proliferation: FATF Recommendations, FATF, 2013, http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/pdfs/FATF_Recommendations.pdf

Partnering against Corruption Initiative: Principles for Countering Bribery, World Economic Forum, http://www.weforum.org/pdf/paci/PACI_Principles.pdf

Principles on Corporate Governance, OECD, 2004, <http://www.oecd.org/daf/ca/corporategovernanceprinciples/31557724.pdf>

Proposal for a Directive on the prevention of the use of the financial system for the purpose of money laundering and terrorist financing“, COM/2013/045 final - 2013/0025 (COD)

Kodi etik afarist, Konfederata e biznesit të vendit, 2012

Kodi etik i ndërmjetësuesve për shitblerje të patundshmërive, i Grupacionit të agjencive për patundshmëri pranë Odës Ekonomike të vendit

Kodi etik i specialistëve për marrëdhënie me publikun (PR), i Asociacionit për marrëdhënie me publikun të vendit

Kodi etik i anëtarëve të Shoqatës për marrëdhënie me publikun të vendit

Kodi për udhëheqje korporative të shoqatave aksionare që janë të listuara në bursë, Bursa për letra me vlerë e vendit, http://www.mse.mk/Repository/UserFiles/File/Misev/Regulativa/Akti%20na%20berza/Kodeks_za_korporativno_uprvuvanje.pdf

Kodi për etikë profesionale të avokatëve, bashkëpunëtorëve profesionalë të avokatëve dhe avokatëve praktikantë, i Odës së avokatëve të vendit

Kodi i etikës dhe sjelljes afariste për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, Transparency international, http://www.transparency.org.mk/images/stories/eticki_kodeks_za_mali_i_sredni_pret-prijatija.pdf

Kodi i etikës dhe sjelljes afariste të shoqatave aksionare, Transparency international, http://www.transparency.org.mk/images/stories/eticki_kodeks_za_akcionerski_drustva.pdf

Lista e shfrytëzuesve që e kanë keqpërdorur ndihmën financiare, Agjencia për përkrahje financiare të bujqësisë dhe të zhvillimit rural, 2013, http://www.pa.gov.mk/Root/mak/_docs/Black_list_15032013.pdf

Zbulimi i manipulimeve në procedurat për ndarjen e furnizimeve publike dhe hapat vijues për kontrollim, Twinning projekt i financuar nga BE-ja, “Përkrahje për sistemin e furnizimeve publike”, Byroja për furnizime publike.

**2. RAPORTI NGA ANALIZA KUALITATIVE TË MASAVE KUNDËR KORRUPSIONIT
DHE IMPLEMENTIMIT TË PROGRAMIT SHTETËRORË PËR PARANDALIM DHE
LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT DHE ZVOGËLIM TË KONFLIKTIT TË INTERESIT
2011-2015 NË SEKTORIN POLITIK**

Përgatitur nga: Biljana Nikolovska Zhagar

PËRMBLEDHJE

Qëllimi i analizës cilësore që është realizuar në kuadër të këtij projekti, ishte të bëhet vlerësimi i faktorëve të rrezikut/problemeve të identifikuar në Sektorin politik, si një nga segmentet që është trajtuar në Programin shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit me Plan aksional për periudhën 2011-2015. Të gjithë sektorët, duke e përfshirë edhe këtë, janë shqyrtuar dhe janë analizuar, si nga aspekti legjislativ ashtu edhe nga aspekti institucional.

Duke pasur parasysh se Programi shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit me Plan aksional për periudhën 2011-2015 është dokument afatmesëm dhe zhvillimor, është e domodoshme të ndiqen dhe të bëhen revizion i masave dhe i aktiviteteve të parapara. Prandaj, nga kjo analizë duhet të dalin dy përfitime kryesore. E para, të konstatohet se cila është shkalla e implementimit të deritanishëm, në prizmën e kategorive të kapacitetit dhe të udhëheqjes dhe më thellë të nënkategorive të resurseve, pavarësisë, transparencës dhe mekanizmave për integritet. E dyta, që është edhe më me rëndësi, është të zbulohen indikatorët e aktivitetit dhe të efektivitetit që nuk janë përcaktuar sa duhet ose që janë përcaktuar në mënyrë jo të plotë. Në fund, rekomandimet e propozuara duhet të paraqesin një udhëzues për atë se në ç'drejtim duhet të shkojë Komisioni Shtetëror për parandalimin e korrupsionit, si institucion kyç për propozimin e politikave për përmirësimin e gjendjes dhe problemet që dalin nga fusha e korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Në Programin shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit me Plan aksional për periudhën 2011-2015, të miratuar në dhjetor të vitit 2011, e që është i bazuar në sistemin e integritetit nacional, nga 11 sektorët e identifikuar, i pari është Sektori politik.

Në këtë sektor, janë zbuluar 5 probleme/faktorë të rrezikut, për tejkalimin e të cilave në Planin aksional janë paraparë gjithsej 9 aktivitete, 13 indikatorë të aktiviteteve dhe 8 indikatorë të efektivitetit.

Si institucione kompetente për realizimin e aktiviteteve të lartëpërmendura janë caktuar: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, Ministria për Financa dhe Kuvendi i vendit.

Analiza cilësore e Sektorit politik është bërë me këtë qasje metodologjike: nga njëra anë, humltimi në zyrë i dispozitave relevante (akteve ligjore dhe nënligjore) si dhe i raporteve dhe i dokumenteve të tjera për gjendjen në sfera të caktuara të organizatave autoritative ndërkombëtare dhe vendore, që janë përfshirë në analizën e këtij sektori, dhe nga ana tjetër, duke zhvilluar intervista me përfaqësues të organeve të pushtetit, partive politike dhe sektorit joqeveritar.

Prandaj, përfundimet dhe rekomandimet që gjenden në këtë analizë janë si rezultat i njohurive të përmbledhura dhe vlerësimit objektiv dhe të lirë për gjendjen në lidhje me masat antikorruprive në Sektorin politik.

Për nevojat e analizës, sa i përket **Problemit 1: Transparencës dhe mbikëqyrjes së pamjaftueshme mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike, sindikatës dhe organizatave qytetare** u parashtruan 11 pyetje. Nga aspekti legjislativ, analiza tregoi se me ndryshimet dhe plotësimet e Kodit zgjedhor dhe Ligjit për financimin e partive politike, të bëra në vitin 2012 dhe 2013, është arritur përparim sa i përket transparencës dhe mbikëqyrjes së punës financiare të partive politike në procesin zgjedhor, e veçanërisht gjatë fushatës zgjedhore. Gjithashtu, është përcaktuar një bazë për bashkëpunim më të fuqishëm ndërmjet resorëve të Komisionit shtetëror të zgjedhjeve, Entit shtetëror për revizion dhe Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit, për këmbim të informatave për parregullsitë e konstatuara në lidhje me raportet e dorëzuara financiare dhe masat e ndërmarra nga ana e tyre ndaj subjektit që i është nënshtruar mbikëqyrjes. Nga aspekti i zbatimit në praktikë, është konstatuar nevoja që: të mundësohen kushte në

të cilat ESHR-ja do t'i zbatojë në mënyrë efektive, efikase dhe në kohë, kompetencat që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e punës financiare të partive politike; të caktohet institucioni që do të bëjë mbikëqyrje të rregullt të punës financiare të partive politike dhe zhvillim të mëtutjeshëm të kapaciteteve të KSHPK-së, me qëllim të inicimit, mbikëqyrjes dhe kontrollit të punës financiare të partive politike, sindikatit dhe organizatave qytetare, si dhe të sigurohen veglat përkatëse për zbatimin e saj praktik.

Problemi 2, Në rregullativën zgjedhore dhe rregullativën tjetër që ka të bëjë me zgjedhjet, ka dobësi që shkaktojnë rrezik për shkeljen e saj të drejtpërdrejtë - është analizuar me 12 pyetje.

Me legjislacionin relevant, me konkretisht me ndryshimet dhe plotësimet e Kodit zgjedhor dhe të Ligjit për financimin e partive politike është bërë një hap përpara në tejkalimin e dobësive aktuale, para së gjithash me futjen e mekanizmave efektivë për ndjekje transparente të financimit të zgjedhjeve. Është miratuar edhe Rregullorja për formularin, formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së raportit financiar vjetor për partitë politike, e cila përmban edhe një Udhëzim për plotësimin e formularit. Praktika tregoi se akoma ka hapësirë për shkeljen e rregullativës, kështu që do të ishte e dobishme të vazhdohet me përmirësimin e rregullativës, edhe atë sa i përket fushatës zgjedhore dhe kohëzgjatjes së saj; subjekteve që janë të lidhura (në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte) me ndonjë parti politike ose që janë nën kontrollin e ndonjë partie politike; të mundësohet që të dhënat për donacionet të jenë të verifikueshme, të rishqyrtohen limitet dhe të përcaktohet periudha e mbledhjes së tyre; si dhe rregullat që kanë të bëjnë me prezantimin mediatik gjatë fushatës zgjedhore.

Problemi 3: Shkalla e lartë e autorizimeve diskrete me dallime të mëdha në intensitetin e tyre ndërmjet funksioneve të ndryshme publike

Problemi 4: Mungesa e efekteve nga zbatimi i Ligjit për lobim

Problemi 5: Përqindja e lartë e sjelljes së ligjeve me procedurë të shkurtuar, gjegjësisht me procedurë urgjente, (edhe pse Rregullorja e Kuvendit parasheh disa faza në përgatitjen e ligjeve), me çka nuk mundësohet përfshirja e subjekteve relevante dhe atyre të interesuara në procesin ligjor

REZULTATET NGA ANALIZAT KUALITATIVE

Problemi/faktori i rrezikut 1:

Transparenca dhe mbikëqyrja e pamjaftueshme mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike, sindikatës dhe organizatave qytetare

Arsyetimi:

Nuk bëhet mbikëqyrje e rregullt mbi punën materiale-financiare të partive politike, sindikatës dhe organizatave qytetare, përkundër kritikave publike se këto subjekte sigurojnë mjete financiare nga marrëveshjet e dyshimta, se ka "firma partiake" që janë të privileguara dhe nëpërmjet të cilave shfrytëzohen mjete publike. Sipas ligjit për parandalimin e korrupsionit, KSHPK-ja ka kompetencë të ngrejë iniciativa për kontroll, mirëpo nuk ka mbështetje adekuate në ligjet e tjera që këtë kompetencë të saj të mund ta kryejë nëpërmjet qasjes së drejtpërdrejtë në punën aktuale materiale-financiare të këtyre subjekteve.

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A mendoni se Ligji për financimin e partive politike ka dispozita me të cilat sigurohet transparencë dhe mbikëqyrje mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike, sindikatës dhe organizatave qytetare?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Ligji për financimin e partive politike si *lex specialis* nuk përmban dispozita për mbikëqyrjen dhe transparencën e punës aktuale materiale-financiare të partive politike, sindikatës dhe organizatave qytetare. Ky ligj parasheh mbikëqyrje vetëm në nivel vjetor. Duhet që puna materiale-financiare e partive politike të ndiqet rregullisht dhe në vazhdimësi, siç është paraparë në Programin shtetëror për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, që të arrihet nivel më i lartë i transparencës për kontroll edhe mbi kontratat afariste dhe donacionet me dhe nga subjektet juridike, të cilat janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte me partinë politike. Duke i marrë parasysh standardet e punës së saj, nuk mund të pritet që këtë detyrë ta kryejë ESHR-ja.

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit

Kategoria: Kapaciteti – resurset

Pyetja-indikator: A mendoni se do të shmangeshin kritikak për transparencë dhe mbikëqyrje të pamjaftueshme dhe se do të përmirësoheshte vlerësimi për punën financiare, në qoftë se përveç kryerjes së mbikëqyrjes mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike, KSHPK-ja do të bënte kontroll edhe në raportet për punën financiare të partive politike?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Sipas nenit 49 paragrafi (1) alineja 4 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit, KSHPK-ja ka kompetencë të ngrëjë iniciativa para organeve kompetente për kontrollin e punës materiale-financiare të partive, sindikatës dhe të shoqatave dhe fondacioneve. Për ushtrimin e këtyre kompetencave nevojiten vegla dhe zgjidhje përkatëse ligjore.

Sipas Ligjit për financimin e partive politike, ato raportin vjetor nuk ia dorëzojnë KSHPK-së, por fakti që ligji i obligon partitë, ESHR-në dhe DHP-në, t'i publikojnë në ueb-faqet e tyre raportet vjetore të partive, KSHPK-së i mundëson të disponojnë me këtë vegël të domosdoshme për ushtrimin e kompetencës së saj.

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A kryhet mbikëqyrje e rregullt mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Mbikëqyrja bëhet në nivel vjetor, mirëpo duhet të bëhet rregullisht, siç është praktikë në disa vende të tjera.

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit

Kategoria: Udhëheqja – transparenca

Pyetja-indikator: A mbahet regjistër i donacioneve?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Është mirë që mbahen regjistrat e donacioneve dhe që mund të ketë qasje publike në to. Megjithatë, nevojiten zgjidhje plotësuese në Ligjin për verifikueshmërinë e burimeve të donacioneve, nga aspekti i nevojës që palët e treta të mos trajtohen si donatorë, si dhe për zbulimin e kontratave me personat juridik që janë në lidhje indirekte me partitë, për shkak të nevojës për kontroll të burimeve të dyshimta dhe të palejueshme për financim të partive. Verifikimi i burimeve të donacioneve duhet të mundësohet edhe për personat fizik – donatorë me qëllim që të konstatohet vërtetësia e burimit të donacionit. Kjo vjen nga Programi shtetëror për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit

Kategoria: Kapaciteti – pavarësia

Pyetja-indikator: A ka KSHPK-ja qasje në ekstraktet bankare nga xhiro-llogaritë e partive politike, për të cilën gjë në Programin shtetëror për parandalimin e korrupsionit është paraparë ndryshim në Ligjin për bankat?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Në Ligjin për banka, KSHPK-ja nuk është përmendur si institucion që mund të kërkojë qasje në ekstraktet bankare nga xhiro-llogaritë e partive, ndërsa vegla e këtillë është më se e domosdoshme për ta realizuar rolin e saj mbikëqyrës sipas Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe që iniciativat e saj në këtë drejtim t'i ndërtojë mbi dokumente, fakte dhe rrethana të verifikueshme.

Në fakt, Ligji për bankat është në kundërshtim me Ligjin për parandalimin e korrupsionit, i cili në Kreun II – Korrupsioni në politikë, në nenin 13, qartë përcakton se verifikimi i hyrjeve dhe daljeve në llogaritë bankare me kërkesë të KSHPK-së nuk paraqet shkelje të fshehtësisë bankare.

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit

Kategoria: Udhëheqja – transparenca

Pyetja-indikator: A konsideroni se zgjidhja aktuale ligjore për t'ia dorëzuar raportin financiar vjetor ESHR-së dhe obligimi për publikimin e tij e pamundëson marrjen e mjeteve financiare nga kontrata të dyshimta biznesi ose nga të ashtuquajturat firma partiake?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Mungesa e mbikëqyrjes në baza të rregullta le hapësirë për dyshime.

Institucioni: Ministria për drejtësi

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A konsideroni se Ligji për financimin e partive politike përmban dispozita me të cilat sigurohet transparenca dhe mbikëqyrje e punës aktuale materiale-financiare të partive politike?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Ligji për financimin e partive politike përmban dispozita me të cilat është paraparë obligimi që partitë politike në ueb-faqet e tyre ta publikojnë raportin financiar vjetor. Partitë politike janë të obliguara që në ueb-faqet e tyre ose në ndonjë mënyrë tjetër, regjistrin e donacioneve ta vënë në dispozicion të publikut. Për mosrespektimin e obligimeve të përmendura janë paraparë dispozita kundërvajtëse për partitë politike. Enti shtetëror për revizion dhe Drejtoria për të hyra publike janë të obliguara që raportet e pranuar, në përputhje me ligjin, t'i publikojnë në ueb-faqet e tyre.

Me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e partive politike të muajit tetor të vitit 2011, roli udhëheqës në kontrollin e raporteve të partive politike i është dhënë Entit shtetëror për revizion, i cili në përputhje me ligjin bën mbikëqyrje të punës aktuale materiale-financiare të partive politike, e që me Raportin e Greko-s për harmonizim për vendin, të miratuar më 23.03.2012, konsiderohet si zhvillim pozitiv.

Institucioni: Ministria për Drejtësi**Kategoria: Kapaciteti – resurset**

Pyetja-indikator: A mendoni se do të evitoheshin kritikrat për transparencë dhe mbikëqyrje të pamjaftueshme dhe do të përmirësohej vlerësimi për punën financiare, në qoftë se përveç kryerjes së mbikëqyrjes mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike nga ana e ESHR-së, edhe KSHPK-ja do të bënte kontroll në raportet për punën financiare të partive politike?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Institucioni i vetëm që disponon me kapacitete profesionale për kryerjen e mbikëqyrjes mbi punën materiale-financiare sipas standardeve ndërkombëtare është Enti shtetëror për revizion.

Institucioni: Ministria për Drejtësi**Kategoria: Udhëheqja – transparencë**

Pyetja-indikator: A mendoni se zgjidhja aktuale ligjore për t'ia dorëzuar raportin financiar vjetor ESHR-së, është mjet i mjaftueshëm efikas për transparencë?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Dispozitat aktuale ligjore për t'ia dorëzuar raportin financiar vjetor ESHR-së, mundësojnë qasje publike te raportet.

Një pjesë e mekanizmit për transparencë është dhe përcaktimi i formularëve adekuatë për raportet financiare.

Më 31.01.2013, Ministria për Financa e miratoi Rregulloren për formularin, formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së raportit financiar vjetor për partitë politike.

Roli i institucionit kryesor për mbikëqyrje të punës financiare-materiale të partive politike, me ndryshimet e Ligjit të miratuar në tetor të vitit 2011, i është dhënë pikërisht Entit shtetëror për revizion, si institucion i vetëm i pavarur, që është në përputhje me rekomandimin V të Raportit të Greko-s nga Rrethi i tretë i evaluimit për vendin, që është miratuar në Mbledhjen e 46-të plenare të Greko-s (22-26 mars të vitit 2010) dhe që është publikuar më 30 gusht të vitit 2010, i cili thotë: "Organit kryesor të pavarur, i cili do të ndihmohet nga organe të tjera në qoftë kjo konsiderohet e nevojshme, t'i jepet mandat dhe autorizime, si dhe resurse adekuate, që të kryejë mbikëqyrje, hetim dhe zbatim proaktiv dhe efektiv të dispozitave për financim politik".

Institucioni: Enti shtetëror për revizion

Kategoria: Kapaciteti – pavarësia

Pyetja-indikator: Për nga aspekti i kompetencave të ESHR-së, a mendoni se Ligji për financimin e partive politike përmban dispozita me të cilat sigurohet transparencë dhe mbikëqyrje mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike, sindikatës dhe organizatave qytetare?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Tani është duke u bërë revizioni i raporteve financiare të të gjitha partive politike që janë të regjistruara në Regjistrin qendror, e më pas do të ndërmerren edhe masa përkatëse në përputhje me ndryshimet e fundit të Ligjit për financimin e partive politike.

Nga revizionet e kryera deri tani është konstatuar dobësi sistemore në pjesën e përcaktimit të regjistrit për donacione.

Institucioni: Enti shtetëror për revizion

Kategoria: Kapaciteti – resurset

Pyetja-indikator: A mendoni se do të evitoheshin kritikrat për transparencë dhe mbikëqyrje të pamjaftueshme dhe do të përmirësohej vlerësimi për punën financiare, në qoftë se përveç kryerjes së mbikëqyrjes mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike nga ana e ESHR-së, edhe KSHPK-ja do të bënte kontroll në raportet për punën financiare të partive politike?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Në Regjistrin qendror të vendit janë regjistruar 51 parti politike, nga të cilat, 12 kanë dorëzuar raport financiar vjetor deri te ESHR-ja. Se cili është shkaku që një numër kaq i vogël i partive politike kanë dorëzuar raporte financiare, ndoshta do të konstatohet gjatë revizionit. Për të gjithë ata që nuk kanë dorëzuar raport vjetor financiar, ESHR-ja do të veprojë në përputhje me Ligjin për financimin e partive politike.

ESHR-ja vazhdimisht thotë se, si institucion suprem i revizionit, punon në përputhje me Metodologjinë për punë, e cila është në përputhje me standardet ndërkombëtare për revizion dhe në bazë të asaj që thuhet, revizioni dallon nga mbikëqyrja, të cilën, në parim, e bëjnë organet e inspektimit.

Institucioni: Enti shtetëror për revizion**Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet**

Pyetja-indikator: A bën ESHR-ja mbikëqyrje mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike pas përfundimit të çdo procesi zgjedhor?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

ESHR-ja bën revizion të të gjitha partive politike që kanë marrë pjesë në procesin zgjedhor. Në parim, bëhet revizion i partive më të mëdha parlamentare.

Për shembull, në Republikën e Kroacisë këtë kompetencë e ka Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, e jo ESHR-ja.

Institucioni: Enti shtetëror për revizion**Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet**

Pyetja-indikator: A i njofton ESHR-ja organet kompetente dhe nëse po, cilat organe, poqese revizori i autorizuar shtetëror gjatë revizionit vlerëson se ndonjë parti politike ka bërë kundërvajtje ose vepër penale?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Në qoftë se revizori i autorizuar shtetëror gjatë revizionit vlerëson se ndonjë parti politike ka bërë kundërvajtje ose vepër penale, ESHR-ja për këtë i njofton organet e pushtetit shtetëror: Prokurorinë publike të vendit, Ministrinë për Punë të Brendshme dhe Komisionin shtetëror për parandalimin e korrupsionit.

Institucioni: Enti shtetëror për revizion

Kategoria: Udhëheqja – transparencja

Pyetja-indikator: A mendoni se zgjidhja aktuale ligjore për t'ia dorëzuar raportet financiare vjetore ESHR-së është mekanizëm i mjaftueshëm efikas për transparencë?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Duhet të ndërmerren masa për harmonizimin e formularit të përmendur, me ç'rast do të bëhet ndarje e qartë dhe prezantim i të dhënave dhe informatave të nevojshme nga aspekti i parimit të ndryshuar të kontabilitetit dhe nga aspekti i parimit të përlogaritjeve.

Institucioni: Drejtoria për të hyra publike

Kategoria: Udhëheqja – transparencja

Pyetja-indikator: A mendoni se Ligji për financimin e partive politike përmban dispozita me të cilat sigurohet transparencë dhe mbikëqyrje mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Ligji për financimin e partive politike përmban dispozita me të cilat sigurohet transparencë dhe mbikëqyrje mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike.

Institucioni: Drejtoria për të hyra publike

Kategoria: Kapaciteti – resurset

Pyetja-indikator: A mendoni se do të evitoheshin kritikak për transparencë dhe mbikëqyrje të pamjaftueshme dhe do të përmirësohej vlerësimi për punën financiare, në qoftë se përveç kryerjes së mbikëqyrjes mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike nga ana e ES-HR-së, edhe KSHPK-ja do të bënte kontroll të raporteve për punën financiare të partive politike?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

KSHPK-ja është organ administrativ, e jo operativ, dhe për këtë arsye duhet të mbetet zgjidhja aktuale ligjore, ndërsa KSHPK-ja t'i zbatojë kompetencat që dalin nga ligjet amë – Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe Ligji për parandalimin e konflikteve të interesit.

Institucioni: Drejtoria për të hyra publike

Kategoria: Kapaciteti – pavarësia

Pyetja-indikator: A duhet KSHPK-ja të ketë qasje në ekstraktet bankare nga xhiro-llogaritë e partive politike, për të cilën gjë në Programin shtetëror për parandalimin e korrupsionit është paraparë ndryshim në Ligjin për bankat?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Në nenet 15 dhe 16 të Ligjit për Drejtorinë për të hyra publike është paraparë që çdo subjekt që mban regjistra dhe baza të tjera, është i obliguar që me kërkesë të DHP-së, t'i ofrojë asaj të dhëna, dhe se me kërkesë të DHP-së, të dhënat për qarkullimin e kryer pagesor dhe pjesëmarrësit në të nuk paraqesin fshehtësi afariste.

Nuk ka nevojë për ndryshimin e Ligjit për banka, për shkak se edhe në tekstin aktual nuk janë theksuar të gjitha organet operative, të cilat gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre kanë nevojë për të dhëna nga llogaritë rrjedhëse. I tillë është edhe shembulli me MPB-në, e cila nuk është përmendur në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë nen të ligjit, por nëpërmjet urdhëresës nga gjykatësi hetues, ajo vjen deri te të dhënat nga xhiro-llogaritë e personave fizik ose juridik, kur është duke u zhvilluar ndonjë procedurë kundër tyre.

Në nenin 112 paragrafi (3) pika 3, është përcaktuar se obligimi për ruajtjen e fshehtësisë bankare nuk vlen edhe në rastet kur ka kërkesë me shkrim nga DHP-ja për zhvillimin e procedurave që janë në kuadër të kompetencave të saj. Në qoftë se KSHPK-ja, duke vepruar në lidhje me ndonjë lëndë korruptive i drejtohet DHP-së, nuk ekziston asnjë pengesë që asaj t'i sigurohen të dhënat nga xhiro-llogaria e partisë politike.

Institucioni: Drejtoria për të hyra publike

Kategoria: Udhëheqja – transparenca

Pyetja-indikator: A mendoni se zgjidhja aktuale ligjore për t'ia dorëzuar DHP-së raportet për donacionet e marra dhe për llogarinë vjetore për punën financiare dhe obligimi për publikimin e tij, e pamundëson sigurimin e mjeteve financiare nga kontrata/burime të dyshimta nga të ashtuquajturat firmat partiake?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Sipas Ligjit për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike, donacioni paraqet ndihmë vullnetare dhe të pakushtëzuar në para, mallra dhe shërbime, që nuk krijon dobi të drejtpërdrejtë për atë që e jep donacionin, e as obligim për kthim të donacionit për pranuesin e tij, dhe e cila mund të jepet për qëllime me interes publik ose për përkrahjen e aktiviteteve të pranuesit.

Ndërsa, sipas Ligjit për tatim në fitim, shpenzimet për donacione tatimohen, kështu që donacionet e dhëna për financimin e partive politike, si dhe për financimin e fushatës zgjedhore nga ana e personave juridik, nuk janë të liruar nga tatimi në vlerën e shtuar dhe tatimi në fitim, ndërsa donacionet e dhëna për financimin e partive politike, si dhe për financimin e fushatës zgjedhore nga ana e personave fizik, nuk i nënshtrohen tatimit me tatim personal në të ardhura, por lartësia e donacionit të tillë është e kufizuar me Ligjin për financimin e partive politike dhe Kodin zgjedhor.

Përveç publikimit të raporteve për donacionet e fituara në ueb-faqen e DHP-së, sipas Ligjit për procedurë tatimore, DHP-ja ka kompetencë të konstatojë se donatorët-persona juridik a i kanë përmbushur obligimet e tyre tatimore, e për donatorët-persona fizik, DHP-ja verifikon se paratë e dhuruara a burojnë nga të ardhurat e tyre që tatimohen.

Për çdo shërbim që e kryen, duke përfshirë edhe për partinë politike, personi juridik është i obliguar që të lëshojë faturë, ta evidentojë qarkullimin pas faturës së lëshuar dhe ta llogarisë tatimin e vlerës së shtuar. Për shkak se shërbimi është pa pagesë, mjetet që nuk i janë paguar partisë politike paraqesin shpenzime të papranuara dhe ato tatimohen me tatimin për fitim, që paraqitet në llogarinë vjetore. Llogaria vjetore e partisë politike përmban: Bilanc të të hyrave dhe të dalave; Strukturë të të hyrave sipas veprimtarive; Shënim për shpërndarjen e rezultatit; Të dhëna të veçanta për evidencën shtetërore për organizatat joprofitabile dhe Bilanc të gjendjes.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A mendoni se Ligji për financimin e partive politike ka dispozita me të cilat sigurohet transparenca dhe mbikëqyrje mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Ligji për financimin e partive politike veçanërisht me ndryshimet e fundit të vitit 2013, përmban dispozita solide me të cilat sigurohet transparencë dhe mbikëqyrje mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike.

Këtë qëndrim e vërtetojnë edhe vlerësimet pozitive nga raportet e OSBE-së dhe të ODIHR-it.

Institucioni: Partia politike**Kategoria: Kapaciteti – resurset**

Pyetja-indikator: A mendoni se do të evitoheshin kritikrat për transparencë dhe mbikëqyrje të pamjaftueshme dhe do të përmirësohej vlerësimi për punën financiare, në qoftë se përveç kryerjes së mbikëqyrjes mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike naga ana e ESHR-së, edhe KSHPK-ja do të bënte kontroll në raportet për punën financiare të partive politike?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Enti shtetëror për revizion si organ i pushtetit shtetëror e ka pavarësinë e nevojshme gjatë kryerjes së mbikëqyrjes mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike, që rezultoi me rejting të lartë të këtij institucioni.

Njëkohësisht, për shkak të vendosjes institucionale dhe kapacitetit, e mirë është zgjidhja që mbikëqyrja të bëhet nga ana e një organi qendror.

Nga ana tjetër, detyrë kryesore e Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit duhet të jetë zbatimi i kompetencave të përcaktuara me Ligjin për parandalimin e korrupsionit.

Institucioni: Partia politike**Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet**

Pyetja-indikator: Në praktikë, a bëhet mbikëqyrje e rregullt mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Në praktikë bëhet mbikëqyrje e rregullt mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – transparencia

Pyetja-indikator: A mbajnë partitë politike regjistër të donacioneve?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Partitë politike kanë obligim ligjor të mbajnë regjistër të donacioneve dhe ky obligim respektohet.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Kapaciteti – pavarësia

Pyetja-indikator: A ka KSHPK-ja qasje në ekstraktet bankare nga xhiro-llogaritë e partive politike, për të cilën gjë në Programin shtetëror për parandalimin e korrupsionit është paraparë ndryshim në Ligjin për bankat?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Edhe tani nuk ekziston pengesë, në qoftë se KSHPK-ja kërkon të ketë qasje në llogaritë bankare të partive politike, që kjo t'i mundësohet asaj.

Në të kundërtën, nëse KSHPK-ja pengohet në ushtrimin e kësaj të drejte, ajo ka mundësi t'i drejtohet Kuvendit të vendit, ku do të debatohej për tejkalimin e këtij problemi.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – transparencia

Pyetja-indikator: A mendoni se zgjidhja aktuale ligjore për t'ia dorëzuar DHP-së raportet për donacionet e marra dhe për llogarinë vjetore për punën financiare dhe obligimi për publikimin

e tij, e pamundëson sigurimin e mjeteve financiare nga kontrata/burime të dyshimta nga të ashtuquajturat firmat partiake?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Ekzistimi i Ligjit për Drejtorinë për të hyra publike dhe i Ligjit për kadastër të patundshmërive në masë të madhe i kufizojnë dhe i pamundësojnë dukuritë e kontratave të dyshimta ose të ashtuquajturave firma partiake si burime për financimin e partive politike.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A mendoni se Ligji për financimin e partive politike ka dispozita me të cilat sigurohet transparencë dhe mbikëqyrje mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Nga aspekti normativ, Ligji për financimin e partive politike ka dispozita me të cilat sigurohet transparencë dhe mbikëqyrje mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike. Po aq i rëndësishëm duhet të jetë edhe implementimi i tij.

Në përgjithësi, mostransparenca e partive politike si dukuri shoqërore është rezultat i koncentrimit të fuqisë në vetë partitë sa i përket burimeve të financimit, si dhe shpërndarjes dhe shpenzimit të tyre.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Kapaciteti – resurset

Pyetja-indikator: A mendoni se do të evitoheshin kritikrat për transparencë dhe mbikëqyrje të pamjaftueshme dhe do të përmirësohej vlerësimi për punën financiare, në qoftë se përveç kryerjes së mbikëqyrjes mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike nga ana e ESHR-së, edhe KSHPK-ja do të bënte kontroll në raportet për punën financiare të partive politike?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Enti shtetëror për revizion duhet të jetë institucioni kryesor në kryerjen e mbikëqyrjes mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike, prandaj duhet të vazhdohet me forcimin e pozitës dhe kapacitetit të saj.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: Në praktikë, a bëhet mbikëqyrje e rregullt mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Në praktikë bëhet mbikëqyrje e vazhdueshme mbi punën aktuale materiale-financiare të katër partive kryesore politike.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – transparenca

Pyetja-indikator: A mbajnë partitë politike regjistër të donacioneve?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Partitë politike e respektojnë obligimin ligjor dhe mbajnë regjistër të donacioneve.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Kapaciteti – pavarësia

Pyetja-indikator: A ka KSHPK-ja qasje në ekstraktet bankare nga xhiro-llogaritë e partive politike, për të cilën gjë në Programin shtetëror për parandalimin e korrupsionit është paraparë ndryshim në Ligjin për bankat?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Duke e pasur parasysh rolin udhëheqës të Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit në parandalimin dhe represionin e korrupsionit si e keqe shoqërore, duhet të mundësohet që ai të ketë qasje në ekstraktet bankare të xhiro-llogarive të partive politike.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – transparenca

Pyetja-indikator: A mendoni se zgjidhja aktuale ligjore për t'ia dorëzuar DHP-së raportet për donacionet e marra dhe për llogarinë vjetore për punën financiare dhe obligimi për publikimin e tij, e pamundëson sigurimin e mjeteve financiare nga kontrata/burime të dyshimta nga të ashtuquajturat firma partiake?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Obligimi për publikimin e raportit vjetor financiar nuk e pamundëson në tërësi sigurimin e mjeteve financiare nga kontrata/burime të dyshimta ose nga të ashtuquajtura firma partiake.

Është e pranishme edhe dukuria e financimit të partive politike nga vetë politikanët dhe bartësit e funksioneve publike.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A mendoni se Ligji për financimin e partive politike ka dispozita me të cilat sigurohet transparenca dhe mbikëqyrje mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Me ndryshimet në Ligjin për financimin e partive politike, por edhe në ligjet për punën bankare është rritur niveli i transparencës së burimeve të financimit të partive politike dhe më e vogël është hapësira për “para të zeza”.

Faktori i parë që ndikon në punën transparente ose jotransparente të një partie politike është se a ka ajo pronë ose jo.

Partitë politike kryesisht financohen nga anëtarësia ose nga donacionet gjatë fushatës zgjedhore, që evidentohen në raportet financiare të partive politike dhe ato janë në dispozicion publik.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Kapaciteti – resurset

Pyetja-indikator: A mendoni se do të evitoheshin kritikrat për transparencë dhe mbikëqyrje të pamjaftueshme dhe do të përmirësohej vlerësimi për punën financiare, në qoftë se përveç kryerjes së mbikëqyrjes mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike naga ana e ESHR-së, edhe KSHPK-ja do të bënte kontroll në raportet për punën financiare të partive politike?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit nuk ka kapacitet të mjaftueshëm administrativ për zgjerimin e kompetencave të tij edhe në këtë segment.

Nga ana tjetër, duke pasur parasysh se raportet për financiare janë dokumente publike që gjenden në ueb-faqet e partive politike dhe të ESHR-së, tani më asgjë nuk e pengon KSHPK-në që të kryejë kontroll në raportet për punën financiare të partive politike.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: Në praktikë, a bëhet mbikëqyrje e rregullt mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Enti shtetëror për revizion bën mbikëqyrje mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike.

Institucioni: Partia politike**Kategoria: Udhëheqja – transparenca**

Pyetja-indikator: A mbajnë partitë politike regjistër të donacioneve?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Partia politike mban regjistër të donacioneve dhe në organet e saja partiake (p.sh. në këshillin mbikëqyrës) ka njerëz që janë të specializuar për punën financiare të partisë.

Institucioni: Partia politike**Kategoria: Kapaciteti – pavarësia**

Pyetja-indikator: A ka KSHPK-ja qasje në ekstraktet bankare nga xhiro-llogaritë e partive politike, për të cilën gjë në Programin shtetëror për parandalimin e korrupsionit është paraparë ndryshim në Ligjin për bankat?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit duhet të ketë qasje në ekstraktet bankare nga xhiro-llogaritë e partive politike me regjim të lartë restriktiv. Në fakt, kjo gjë komisionit duhet t'i mundësohet vetëm në raste konkrete të korrupsionit të madh.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – transparencia

Pyetja-indikator: A mendoni se zgjidhja aktuale ligjore për t'ia dorëzuar DHP-së raportet për donacionet e marra dhe për llogarinë vjetore për punën financiare dhe obligimi për publikimin e tij, e pamundëson sigurimin e mjeteve financiare nga kontrata/burime të dyshimta nga të ashtuquajturat firma partiake?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Një hap pozitiv është zgjidhja ligjore për publikimin e raporteve financiare dhe mundësia që çdokush të ketë qasje në to.

Sigurimi i mjeteve financiare nga kontratat/burimet e dyshimta ose nga të ashtuquajturat firma partiake varet nga qasja ose nga sjellja etike e partisë politike.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A mendoni se Ligji për financimin e partive politike ka dispozita me të cilat sigurohet transparencë dhe mbikëqyrje mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Në vend çështje esenciale nuk janë ligjet, por implementimi i tyre. Reforma e legjislacionit zgjedhor që filloi në vitin 2005/2006 mundësoi një hapërim pozitiv dhe legalizim të disa mungesave në këtë sferë. Akoma ka hapësirë për përmirësimin e kulturës politike, për zvogëlimin e grumbullimit të fuqisë dhe për avancimin e funksionit kontrollues të Kuvendit të vendit.

Ka përparim, por ai është i natyrës formale.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Kapaciteti – resurset

Pyetja-indikator: A mendoni se do të evitoheshin kritikak për transparencë dhe mbikëqyrje të pamjaftueshme dhe do të përmirësohej vlerësimi për punën financiare, në qoftë se përveç kryerjes së mbikëqyrjes mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike nga ana e ESHR-së, edhe KSHPK-ja do të bënte kontroll në raportet për punën financiare të partive politike?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Çdo kontroll dhe mbikëqyrje plotësuese është pozitive, e gjithashtu edhe kryerja e kontrollit në raportet për punën financiare të partive politike, në qoftë se bëhet në mënyrë objektive, profesionale dhe transparente.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: Në praktikë, a bëhet mbikëqyrje e rregullt mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Drejtorja për të hyra publike dhe Enti shtetëror për revizion menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve bëjnë mbikëqyrje të punës materiale-financiare të partive politike.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – transparencja

Pyetja-indikator: A mbajnë partitë politike regjistër të donacioneve?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Partitë politike kanë obligim ligjor për të mbajtur regjistër të donacioneve dhe e bëjnë këtë. Mirëpo, për shkak të nivelit të lartë të formalizmit, ai nuk është pasqyrë e vërtetë për llojin, mënyrën dhe vlerën reale të donacioneve.

Burimi kryesor i donacioneve janë mjetet e mbledhura nga anëtarësia.

Ka hapësirë për përmirësimin e modelit të financimit të partive politike, veçanërisht në pjesën e shpenzimit transparent të mjeteve që sigurohen nga buxheti i vendit.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Kapaciteti – pavarësia

Pyetja-indikator: A ka KSHPK-ja qasje në ekstraktet bankare nga xhiro-llogaritë e partive politike, për të cilën gjë në Programin shtetëror për parandalimin e korrupsionit është paraparë ndryshim në Ligjin për bankat?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit duhet të kujdeset për zbatim objektiv dhe efikas të kompetencave që i janë caktuar tani.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – transparenca

Pyetja-indikator: A mendoni se zgjidhja aktuale ligjore për t'ia dorëzuar DHP-së raportet për donacionet e marra dhe për llogarinë vjetore për punën financiare dhe obligimi për publikimin e tij, e pamundëson sigurimin e mjeteve financiare nga kontrata/burime të dyshimta nga të ashtuquajturat firma partiake?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Njëra nga mënyrat më efektive për ta pamundësuar sigurimin e mjeteve financiare nga kontratat/burimet e dyshimta ose nga të ashtuquajturat firma partiake është përmirësimi ose ndryshimi i modelit të financimit të partive politike, veçanërisht në pjesën e harxhimit të mjeteve për zgjedhje që sigurohen nga buxheti i vendit.

Institucioni: Sektori joqeveritar

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A mendoni se Kodi zgjedhor dhe Ligji për financimin e partive politike kanë dispozita me të cilat sigurohet transparencë dhe mbikëqyrje mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Me ndryshimet e vitit 2012 është bërë një përmirësim i konsiderueshëm, por megjithatë ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm të zgjidhjeve ligjore. Për shembull, sa i përket precizimit të ditës së mbylljes së xhiro-llogarisë së veçantë për zgjedhjet gjatë fushatës zgjedhore ose dallimit sa i përket llojit të limitit për donacione nga personat fizik dhe juridik.

Institucioni: Sektori joqeveritar

Kategoria: Kapaciteti – resurset

Pyetja-indikator: A mendoni se KSHPK-ja duhet të ketë kompetencë që të bëjë mbikëqyrje mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike dhe të ketë qasje në raportet për punën financiare të partive politike?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit duhet ta ushtrojë këtë kompetencë për partitë politike, sindikatin dhe organizatat qytetare që kanë status të organizatave me interes publik, por me përforcimin e kapaciteteve të tij.

Institucioni: Sektori joqeveritar

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A mendoni se është siguruar revizion i punës aktuale materiale financiare të partive politike në të gjitha fazat e procesit zgjedhor?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Nuk sigurohet revizion i punës aktuale materiale-financiare të partive politike në të gjitha fazat e procesit zgjedhor, për shkak se edhe vetë fazat e procesit zgjedhor duhet të precizohen më mirë. Për shembull, çka ndodh në periudhën prej shpalljes së zgjedhjeve e deri te konfirmimi i listave të kandidatëve, periudhë kjo në të cilën partitë padyshim bëjnë aktivitete promovuese, kështu që parashtrohet pyetja se si financohen ato.

E hapur është edhe çështja e mbylljes së xhiro-llogarisë së veçantë për zgjedhjet.

Institucioni: Sektori joqeveritar

Kategoria: Udhëheqja – transparenca

Pyetja-indikator: A mendoni se regjistri për donacione përmban të dhëna të detajuara nga të cilat mund të shihen lidhjet e organizatorit të fushatës me donatorët?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Në regjistrin e donacioneve mund të shihet një pjesë e donatorëve dhe e donacioneve. Megjithatë, shpeshherë partitë politike e përfundojnë fushatën zgjedhore me saldo negative në llogarinë e tyre për fushatën zgjedhore dhe publiku nuk ka qasje në atë se me cilat mjete mbulohet ky minus.

Institucioni: Sektori joqeveritar

Kategoria: Kapaciteti – pavarësia

Pyetja-indikator: A ka KSHPK-ja qasje në ekstraktet bankare nga xhiro-llogaritë e partive politike, për të cilën gjë në Programin shtetëror për parandalimin e korrupsionit është paraparë ndryshim në Ligjin për bankat?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit duhet të ketë qasje në ekstraktet bankare nga xhiro-llogaritë e partive politike.

Institucioni: Sektori joqeveritar

Kategoria: Udhëheqja – transparencja

Pyetja-indikator: A mendoni se zgjidhja aktuale ligjore për t'ia dorëzuar DHP-së raportet për donacionet e marra dhe për llogarinë vjetore për punën financiare dhe obligimi për publikimin e tij, e pamundëson sigurimin e mjeteve financiare nga kontrata/burime të dyshimta nga të ashtuquajturat firmat partiake?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Me dorëzimin e raportit vjetor financiar në ESHR dhe publikimin e tij nuk pengohet dukuria e sigurimit të mjeteve financiare nga kontratat/burimet e dyshimta ose nga të ashtuquajturat firmat partiake.

Arsyetim – de jure:

Ligji për financimin e partive politike ("Gazeta zyrtare e vendit" nr.76/04, 86/08, 161/08, 96/09, 148/11, 142/12 dhe 23/13) ka dispozita me të cilat sigurohet transparencja dhe mbikëqyrja mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike.

Sipas nenit 17 të Ligjit, partitë politike mbajnë regjistër të donacioneve, i cili përmban të dhëna për: emrin, gjegjësisht titullin e çdo donatori veç e veç; llojin dhe vlerën e donacionit dhe datën e marrjes së donacionit. Partitë politike janë të obliguara që në ueb-faqen e tyre çdo gjashtë muaj ta publikojnë regjistrin e donacioneve për periudhën paraprake gjashtëmujore, në afat prej 15 ditësh nga dita e përfundimit të afatit gjashtëmujor, ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshatshme ta vënë atë në dispozicion të publikut.

Në nenin 25, ligji parasheh se partitë politike duhet të përgatisin raport për donacionet që i kanë marrë, i cili do t'i përmbajë të dhënat nga regjistri për donacionet. Partitë politike kanë obligim ligjor që raportin për donacionet që i kanë marrë, ta dorëzojnë te Enti shtetëror për revizion më së voni deri më 31 për vitin paraprak, së bashku me raportin financiar vjetor për vitin paraprak. Raportin për donacionet që i ka marrë, partia politike e dorëzon te Drejtoria për të hyra publike deri më 31 mars për vitin paraprak. Nga ana tjetër, Enti shtetëror për revizion dhe Drejtoria për të hyra publike janë të obliguara që raportet e pranuar t'i publikojnë në ueb-faqet e tyre.

Pastaj, neni 27 i ligjit parasheh që partitë politike, më së voni deri më 31 mars të përgatisin raport financiar vjetor për vitin paraprak në përputhje me ligjin. Raporti e përmban punën financiare të llogarisë së partisë politike, si dhe të nënllogarive të degëve lokale dhe të nënllogarisë së qendrës hulumtuese-analitike të partisë, si dhe të dhëna për: të hyrat e përgjithshme, ku hyjnë të dhënat për shumën e përgjithshme të donacioneve, dhuratave, kontributeve, donacioneve,

parave, mjeteve materiale, pajisjeve, shërbimeve, të hyrave vetanake, anëtarësisë, legatave etj. dhe shpenzimet e përgjithshme. Raporti financiar vjetor i dorëzohet Entit shtetëror për revizion. Në qoftë se Enti shtetëror për revizion, në raportin financiar vjetor të partisë politike konstaton parregullsi që janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, bën kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse ose dorëzon denoncim deri te prokurori kompetent publik në afat prej 30 ditësh nga dita e konstatimit të parregullsive.

Partia politike është e obliguar që, në përputhje me nenin 27-a të ligjit, ta publikojë Raportin financiar vjetor në ueb-faqen e partisë, më së voni deri më 30 prill të vitit aktual për vitin paraprak.

Ligji përmban edhe dispozita kundërvajtëse, kështu që për mosrespektimin e obligimit që partia politike në ueb-faqen e saj në çdo gjashtë muaj ta publikojë regjistrin e donacioneve për periudhën gjashtëmujore paraprake, në afat prej 15 ditësh nga dita e përfundimit të periudhës gjashtëmujore, ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme ta vënë atë në dispozicion të publikut, është paraparë gjobë në vlerë prej 1.000 deri në 2.000 euro në kundërvlerë në denarë. Gjobë në kundërvlerë prej 5.000 deri në 10.000 euro është paraparë në rast se veprohet në kundërshtim me obligimin për përgatitjen, dorëzimin dhe publikimin e raportit për donacionet që i kanë marrë, dorëzimin dhe publikimin e llogarisë vjetore për punën financiare, përgatitjen, dorëzimin dhe publikimin e raportit financiar vjetor.

Sipas nenit 26 të ligjit, mbikëqyrjen mbi punën financiare-materiale të partive politike e bën Enti shtetëror për revizion në përputhje me këtë ligj dhe kjo bëhet çdo vit kalendarik për vitin paraprak. Roli i institucionit kryesor për mbikëqyrje të punës financiare-materiale të partive politike, me ndryshimet e ligjit në tetor të vitit 2011 i është dhënë pikërisht Entit shtetëror për revizion, si institucion i vetëm i pavarur, që është në përputhje me rekomandimin V nga raporti i Greko-s nga Rrethi i i tretë i vlerësimit për vendin, të miratuar në Mbledhjen e 46-të plenare të Greko-s (22-26 mars 2010) dhe që është publikuar më 30 gusht 2010, e që thotë: “Organit kryesor të pavarur, i cili do të ndihmohet nga organe të tjera në qoftë kjo konsiderohet e nevojshme, t’i jepet mandat dhe autorizime, si dhe resurse adekuate, që të kryejë mbikëqyrje, hetim dhe zbatim proaktiv dhe efektiv të dispozitave për financim politik”.

Partitë politike mund të kenë vetëm një xhiro-llogari, ndërsa degët e tyre lokale dhe qendra hulumtuese-analitike e partisë mund të kenë edhe nënlllogari, por ato janë të obliguara që në rast se ekzistojnë këto nënlllogari, të dorëzojnë raporte financiare në formë të përmbledhur – të konsoliduar. Në përputhje me dispozitat ligjore, llogarinë vjetore për punën financiare partitë politike e dorëzojnë te: Drejtoria për të hyra publike, Regjistri qendror dhe Enti shtetëror për revizion, e gjithashtu janë të obliguara që atë ta publikojnë edhe në ueb-faqen e tyre.

Në përputhje me nenin 85 të Kodit zgjedhor, Enti shtetëror për revizion është i obliguar të bëjë revizion në afat prej 60 ditësh nga dorëzimi i raportit financiar. Revizioni bëhet për periudhën prej ditës së hapjes së llogarisë rrjedhëse për fushatën zgjedhore deri në përfundimin e transaksioneve në atë llogari.

Dorëzimi i raportit financiar vjetor në ESHR, publikimi i tyre dhe vënia e tyre në dispozicion publik, përcaktimi i formularëve përkatës për raportet, si dhe përcaktimi i kompetencave të institucioneve për kryerje të mbikëqyrjes, gjegjësisht për ngritje të iniciativave para organeve kompetente për kontroll dhe për ngritje të procedurave kundërvajtëse për mosrespektimin e obligimit për publikim, janë mekanizma për transparencë dhe mbikëqyrje mbi punën aktuale materiale-financiare të partive politike.

Sipas nenit 13 paragrafi (2) dhe (3) të Ligjit për parandalimin e korrupsionit, nëse paraqitet dyshim se ndonjë parti politike ose ndonjë kandidat në zgjedhje kanë shfrytëzuar burime kundërligjore dhe anonime të financimit, KSHPK-ja është kompetente të kërkojë nga organet kompetente të

bëjnë kontroll të të hyrave dhe shfrytëzimit të mjeteve. Kontrolli i hyrjes së mjeteve ose i pagesave të tjera nëpërmjet bankës, që bëhet me kërkesë të KSHPK-së, nuk paraqet shkelje të fshehtësisë bankare.

Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, sipas nenit 49 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit, në mes tjerash, ka kompetencë të ngrejë iniciativë para organeve kompetente për kontroll të punës financiare-materiale të partive politike.

Sipas nenit 112 paragrafi (2) të Ligjit për bankat, fshehtësia bankare (obligimi për ruajtjen dhe moszbulimin e të dhënave dhe informatave që janë fituar gjatë aktiviteteve bankare dhe aktiviteteve të tjera financiare për individë të caktuar dhe transaksioneve me individë të caktuar, si dhe për depozitet e individëve të caktuar) nuk vlen në rast se:

- me ligj është paraparë publikimi i të dhënave dhe informatave dhe
- personi ka dhënë pëlqim me shkrim për zbulimin e të dhënave.

Sipas paragrafit (3) të po këtij ligji, për personat me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta, aksionarët dhe të punësuarit në bankë, obligimi për mbrojtjen dhe ruajtjen e fshehtësisë bankare nuk vlen edhe në këto raste:

- në bazë të kërkesës me shkrim nga gjykata kompetente për procedime që janë në kuadër të kompetencave të tij;
- për nevojat e Bankës Popullore ose ndonjë organi tjetër mbikëqyrës të autorizuar me ligj;
- në bazë të kërkesës me shkrim të Drejtorisë për të hyra publike për procedime që janë në kuadër të kompetencave të saj;
- nëse të dhënat i përcillen Byrosë së Policisë financiare, në përputhje me ligjin;
- në bazë të kërkesës me shkrim të Inspektoratit shtetëror devizor për kontroll të punës devizore;
- në bazë të kërkesës me shkrim të Fondit për sigurimin e depozitave, në përputhje me ligjin;
- nëse të dhënat komunikohen për nevojat e funksionimit të Regjistrimit kreditor të Bankës Popullore dhe
- në bazë të kërkesës me shkrim të personave të autorizuar për ekzekutim në përputhje me ligjin.

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetim - de facto:

Me ndryshimet dhe plotësimet e Kodit zgjedhor dhe Ligjit për financimin e partive politike, të bëra në vitin 2012 dhe 2013, është arritur përparim në aspekt të transparencës dhe të mbikëqyrjes së punës së partive politike në procesin zgjedhor, e veçanërisht gjatë fushatës zgjedhore.

Kështu, janë përcaktuar obligime plotësuese për pjesëmarrësit në procesin zgjedhor (partitë politike, koalicionet ose kandidatët e pavarur) gjatë fushatës zgjedhore, siç është për shembull, hapja e xhiro-llogarisë së veçantë për fushatën zgjedhore.

Pastaj, janë përcaktuar afate të caktuara në mënyrë precize për kryerjen e mbikëqyrjes nga Entit shtetëror për revizion, i cili, padyshim, edhe nga ana e institucioneve të pushtetit, e gjithashtu edhe nga organizatat ndërkombëtare, është i njohur dhe i pranuar si organ i vetëm qendror që është kompetent për revizionin e punës financiare, duke i përfshirë edhe partitë politike, si gjatë proceseve zgjedhore ashtu edhe pas përfundimit të tyre.

Gjithashtu, është përcaktuar një bazë për bashkëpunim më të madh ndërmjet resorëve të Komisionit shtetëror të zgjedhjeve, Entit shtetëror për revizion dhe Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit, në atë mënyrë që ato e kanë obligim ligjor të nënshkruajnë Memorandum për bashkëpunim sa i përket zbatimit të dispozitave për financimin e fushatës zgjedhore, për këmbim të informatave për parregullsitë e konstatuara në lidhje me raportet e dorëzuara financiare dhe masat që janë ndërmarrë nga ana e tyre ndaj subjektit që i është nënshtruar mbikëqyrjes.

Partitë politike kryesisht e respektojnë obligimin për mbajtje transparente të regjistrit të donacioneve dhe publikimin e tij në ueb-faqet e tyre. Megjithatë, si duket formulari i Regjistrit nuk përmban të dhëna të detajuara për shpenzimet gjatë fushatës zgjedhore, por edhe për periudhën para dhe pas përfundimit të procesit zgjedhor.

Me dispozitat e Protokollit për bashkëpunim për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave të datës 25.12.2007, është rregulluar mënyra e bashkëpunimit, koordinimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta me qëllim të parandalimit dhe të represionit më efikas të korrupsionit dhe të parandalimit më efikas të konfliktit të interesave në vend, ndërmjet KSHPK-së, Drejtorisë për të hyra publike, Prokurorisë publike të vendit, Avokaturës së shtetit të vendit, Këshillit gjyqësor të vendit, Ministrisë për Punë të Brendshme, Entit shtetëror për revizion, Drejtorisë doganore, Drejtorisë së policisë financiare, Drejtorisë për zbulim financiar dhe Entit shtetëror për çështje të gjeodezisë. Me nënshkrimin e Protokollit, palët kontraktuese u pajtuan, në përputhje me kompetencat e tyre të përcaktuara me ligj, në mes tjerash, të bashkëpunojnë në këmbimin e të dhënave, ofrimin e ndihmës së ndërsjellë gjatë zbulimit të rasteve dhe ndërmarrjes së masave dhe aktiviteteve të nevojshme dhe koordinimin e aktiviteteve në plan të brendshëm dhe ndërkombëtar me qëllim të parandalimit dhe represionit më efikas të korrupsionit dhe të konfliktit të interesave.

Prandaj, tani nuk ka ndonjë pengesë që, duke iu referuar Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe këtij Protokollit, KSHPK-së t'i mundësohet qasje në ekstraktet bankare nga xhiro-llogaritë e partive politike, sindikateve dhe organizatave qytetare, që janë themeluar për të realizuar interes publik.

Edhe përkundër faktit se KSHPK-ja ka status të organit administrativ e jo operativ, duke e pasur parasysh, para së gjithash, rolin e saj udhëheqës në luftën për parandalimin e korrupsionit, duke e përfshirë edhe korrupsionin në politikë dhe në kryerjen e punëve me interes publik dhe në veprimtaritë e tjera të personave juridik (Kreu i dytë dhe Kreu i gjashtë i Ligjit për parandalimin e korrupsionit), krijohet përshtypja se ajo duhet të përforcohet, me atë që do të plotësohet ekipi i Shërbimit profesional të KSHPK-së, me burime njerëzore të specializuara dhe të profiluara nga fusha e punës financiare.

Nota:

Në masë shumë të vogël	1
Në masë të vogël	2
Në masë të caktuar	3
Në masë të madhe	4
Në masë shumë të madhe	5

Rekomandime

- Të krijohen kushte ligjore dhe institucionale, me çka do të mundësohet që ESHR-ja të mund t'i zbatojë në mënyrë efektive, efikase dhe në kohë, kompetencat që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e punës financiare të partive politike;
- Përveç ESHR-së, që i ushtron kompetencat që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e punës financiare të partive politike në nivel vjetor, të përcaktohet një institucion që do të bëjë mbikëqyrje të rregullt dhe
- Të zhvillohen edhe më shumë kapacitetet e KSHPK-së, me qëllim të ushtrimit të kompetencës së saj në iniciimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e punës financiare të partive politike, sindikatës dhe organizatave qytetare dhe të përmirësohen zgjidhjet ligjore në ligjet e tjera që të sigurohen vegla adekuate për veprimin praktik të KSHPK-së.

Problemi/faktori i rrezikut 2: Në rregullativën zgjedhore dhe rregullativën tjetër që ka të bëjë me zgjedhjet, ka dobësi që shkaktojnë rrezik për shkeljen e saj të drejtpërdrejtë.
Arsyetimi: Raportimi fillestar në procesin zgjedhor është i shoqëruar me formalizëm të lartë, pa qasjen e nevojshme në mjetet reale financiare, burimet e tyre dhe për çka janë të dedikuara, që ndikon në sanskionimin efikas dhe kompetent të shkeljes.

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit

Kategoria: Udhëheqja – transparenca

Pyetja-indikator: A kanë Kodi zgjedhor dhe Ligji për financimin e partive politike mekanizma efektive për ndjekje transparente të financimit të zgjedhjeve?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Ligjet përmbajnë mekanizma për transparencë.

Megjithatë, KSHPK-ja konsideron se raporti përfundimtar financiar duhet deri në fund realisht ta pasqyrojë financimin e zgjedhjeve dhe për këtë arsye xhiro-llogaria e veçantë që është hapur në mënyrë speciale për financimin e fushatës zgjedhore duhet të mbyllet në ditën kur dorëzohet raporti përfundimtar financiar nga ana e organizatorit të fushatës zgjedhore.

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit

Kategoria: Udhëheqja – transparencja

Pyetja-indikator: A e pasqyrojnë raportet që i dorëzojnë partitë politike gjendjen me mjetet financiare, burimet e tyre dhe për çka kanë qenë ato të dedikuara, gjatë fushatës zgjedhore?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Raportet dorëzohen nëpërmjet formularit ku linjat e të hyrave dhe të dalave nuk përgjigjen me regjimin financiar që është paraparë me Kodin zgjedhor, i cili është shumë preciz për atë se nga cilat mjete mund, gjegjësisht nuk mund të financohen zgjedhjet.

Mu për arsye se formulari që është përdorur deri tani e pasqyron financimin e përgjithshëm të partive në aspekt të hyrjeve dhe të daljeve që është përcaktuar në Ligjin për financimin e partive politike dhe për shkak se diapazoni i të hyrave dhe të dalave të mundshme financiare është shumë më i gjerë se sa ai që është përcaktuar në Kodin zgjedhor, KSHPK-ja kërkon që Formulari për raportet financiare për zgjedhjet të harmonizohet rreptësisht me Kodin zgjedhor.

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit

Kategoria: Kapaciteti – resurset

Pyetja-indikator: A ka nevojë që partitë politike të trajnohen nga ana e Ministrisë për Financa për zbatimin konsekuent të Udhëzimit për plotësimin e raporteve, i cili është pjesë përbërëse e Rregullores për ndryshimin e Rregullores për formularin për raportet financiare për të hyrat dhe të dalat e fushatës zgjedhore?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Përgjigja del nga kapaciteti i ndryshëm profesional i partive në këtë fushë, dhe ky trajnim mund të jetë i dobishëm sikurse dhe çdo trajnim tjetër.

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit**Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet**

Pyetja-indikator: A përmban legjislacioni aktual dispozita për sanksionim efikas të shkeljeve nga ana e partive politike që kanë të bëjnë me financimin e zgjedhjeve?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Dispozitat për sanksionimin e gjithmbarshëm janë në rregull, me atë që lartësitë e njëjta të dënimeve dhe të gjobave potenciale kanë intensitet dhe pasoja të ndryshme mbi subjektet e ndryshme politike dhe organizatorët e ndryshëm të fushatës zgjedhore, varësisht nga pozita e tyre materiale.

Institucioni: Ministria për Drejtësi**Kategoria: Udhëheqja – transparenca**

Pyetja-indikator: A kanë Kodi zgjedhor dhe Ligji për financimin e partive politike mekanizma efektive për ndjekje transparente të financimit të zgjedhjeve?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Sipas Kodit zgjedhor, organizatorët e fushatës zgjedhore janë të obliguar që në afatet e përcaktuara ligjore, në formularin e paraparë, të dorëzojnë raport financiar për të hyrat dhe të dalat në xhiro-llogarinë e veçantë për fushatën zgjedhore (edhe atë raport për periudhën deri në ditën e dhjetë të fushatës zgjedhore, raport për gjysmën e dytë të fushatës zgjedhore dhe raport të përgjithshëm pas përfundimit të fushatës zgjedhore).

Radiot, televizionet dhe mediat e shtypura janë të obliguara që në afatin e përcaktuar me ligj, në formularin e paraparë, deri te KSHZ-ja, ESHR-ja dhe KSHPK-ja të dorëzojnë raport për hapësirën reklamuese që është shfrytëzuar nga çdo organizator i fushatës zgjedhore dhe mjetet që janë paguar ose që duhet të paguhen nga ata për këtë qëllim.

Raportet dorëzohen deri te KSHZ-ja, ESHR-ja dhe KSHPK-ja, të cilat janë të obliguara t'i publikojnë ato në ueb-faqet e tyre.

Raportet e revizionit nga revizionet e kryera mbi raportet financiare të organizatorëve të fushatave zgjedhore, ESHR-ja i publikon në ueb-faqen e saj në afatin e përcaktuar me ligj.

Institucioni: Ministria për Drejtësi

Kategoria: Udhëheqja – transparenca

Pyetja-indikator: A e pasqyrojnë raportet që i dorëzojnë partitë politike gjendjen me mjetet financiare, burimet e tyre dhe për çka kanë qenë ato të dedikuara, gjatë fushatës zgjedhore?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Kodi zgjedhore përmban dispozitë për hapje të detyrueshme të xhiro-llogarisë me specifikimin “për fushatë zgjedhore”.

Raportet financiare për të hyrat dhe të dalat e xhiro-llogarisë botohen publikisht.

Është përcaktuar formulari për formën dhe përmbajtjen e raporteve financiare për të hyrat dhe të dalat dhe formulari për hapësirën reklamuese.

Prandaj, raportet të cilat i dorëzojnë partitë politike e pasqyrojnë gjendjen me mjetet financiare, burimet e tyre dhe qëllimet e shfrytëzimit të tyre gjatë fushatës zgjedhore.

Institucioni: Ministria për Drejtësi

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A përmban legjislacioni aktual dispozita për sanksionim efikas të shkeljeve nga ana e partive politike që kanë të bëjnë me financimin e zgjedhjeve dhe nëse jo, çka mendoni se mungon?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Në kapitullin XIV të Kodit zgjedhor janë paraparë dënime dhe sanksione kundërvajtëse, ndërsa pavarësisht nga përgjegjësia kundërvajtëse, është paraparë edhe humbje e pjesërishme e kompensimit të shpenzimeve për fushatën zgjedhore, humbje e plotë e kompensimit të shpenzimeve për fushatën zgjedhore dhe ndalesë për pagesën e kompensimit të shpenzimeve për fushatën zgjedhore.

Kodi zgjedhor përmban dispozita për shqiptimin e ndalesës për shfrytëzimin e mjeteve për financimin e partive politike, si dhe sanksion dytësor – shqiptim të detyrueshëm të dënimit për ndalim të shfrytëzimit të mjeteve nga buxheti i vendit për financimin e partive politike.

Enti shtetëror për revizion ka kompetencë të përcaktuar me ligj që, nëse në raportin financiar të organizatorit të fushatës zgjedhore konstaton se ka parregullsi që janë në kundërshtim me dispozitat e Kodit zgjedhor, të parashtrijë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse ose të bëjë denoncim te prokurori kompetent publik.

Institucioni: Enti shtetëror për revizion

Kategoria: Kapaciteti – pavarësia

Pyetja-indikator: Nga aspekti i kompetencave të ESHR-së, Kodi zgjedhor dhe Ligji për financimin e partive politike a përmbajnë mekanizma efektive për ndjekje transparente të financimit të zgjedhjeve?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Nga aspekti i Kodit zgjedhor, gjatë revizionit të kryer janë konstatuar një numër i madh i dobësive sistemore, për të cilat organet kompetente duhet të ndërmarrin masa për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara.

Dobësitë sistemore e pamundësojnë konstatimin e gjendjeve reale në raportet financiare të partive politike, që normalisht pasqyrohet edhe në raportet e revizionit.

Institucioni: Enti shtetëror për revizion

Kategoria: Udhëheqja – transparencja

Pyetja-indikator: A e pasqyrojnë raportet që i dorëzojnë partitë politike gjendjen me mjetet financiare, burimet e tyre dhe për çka kanë qenë ato të dedikuara gjatë fushatës zgjedhore?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Duhet të ndërmerren masa për harmonizimin e formularit të dhënë, në atë mënyrë që do të bëhet ndarje e qartë dhe prezantim i të dhënave dhe informatave të nevojshme nga aspekti i parimit të modifikuar të kontabilitetit dhe nga aspekti i parimit të përlllogaritjes.

Institucioni: Enti shtetëror për revizion

Kategoria: Kapaciteti – resurset

Pyetja-indikator: A mendoni ju si ESHR, duke pasur parasysh kualitetin e raporteve për punën financiare të partive politike, se nevojitet trajnim nga ana e Ministrisë për Financa për zbatimin konsekuent të Udhëzimit për plotësimin e raporteve, i cili është pjesë përbërëse e Rregullores për ndryshimin e Rregullores për formularin për raportet financiare për të hyrat dhe të dalat për fushatën zgjedhore?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Ka nevojë për trajnime për zbatim të drejtë dhe barabartë të akteve.

Institucioni: Enti shtetëror për revizion

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A përmban legjislacioni aktual dispozita për sanksionim efikas të shkeljeve nga ana e partive politike që kanë të bëjnë me financimin e zgjedhjeve dhe nëse jo, çka mendoni se mungon?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Pjesërisht përmban, por ato duhet të zbatohen nga organet kompetente.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – transparenca

Pyetja-indikator: A kanë Kodi zgjedhor dhe Ligji për financimin e partive politike mekanizma efektive për ndjekje transparente të financimit të zgjedhjeve?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Edhe Kodi zgjedhor edhe Ligji për financimin e partive politike, veçanërisht me ndryshimet e vitit 2012 dhe 2013, përmbajnë mekanizma efektive për ndjekje transparente të financimit të zgjedhjeve.

Institucioni: Partia politike**Kategoria: Udhëheqja – transparenca**

Pyetja-indikator: Raportet, gjegjësisht formulari që e dorëzojnë partitë politike, a e pasqyrojnë gjendjen me mjetet financiare, burimet dhe shpenzimet e tyre gjatë fushatës zgjedhore?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Raportet publikohen në ueb-faqet e partive dhe prej tyre çdo qytetar dhe individ i interesuar mund të ketë qasje në mjetet financiare, të cilat partia i pranon dhe i harxhon gjatë fushatës zgjedhore.

Institucioni: Partia politike**Kategoria: Kapaciteti – resurset**

Pyetja-indikator: A ka nevojë që partitë politike të trajnohen nga ana e Ministrisë për Financa për zbatimin konsekuent të Udhëzimit për plotësimin e raporteve, i cili është pjesë përbërëse e Rregullores për ndryshimin e Rregullores për formularin për raportet financiare për të hyrat dhe të dalat e fushatës zgjedhore?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Partitë më të mëdha ndoshta edhe nuk kanë nevojë për trajnim, por megjithatë për shkak të rrisive nga Udhëzuesi dhe formulari, është e qartë se do të kishte dobi nga trajnimi që do të mbahej nga Ministria e Financave.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A përmban legjislacioni aktual dispozita për sanksionim efikas të shkeljeve nga ana e partive politike që kanë të bëjnë me financimin e zgjedhjeve?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Legjislacioni aktual në vazhdimësi ndryshohet dhe përmirësohet për të përfshirë një numër sa më të madh të sanksioneve për partitë politike të cilat i shkelin rregullat për punë transparente financiare.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – transparenca

Pyetja-indikator: A mendoni se zbritjet që i japin mediat gjatë fushatës zgjedhore duhet të ndalohen ose së paku të jenë të barabarta për të gjithë organizatorët e fushatave zgjedhore?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Është e drejtë e mediave, veçanërisht e atyre private, si organizata që punojnë me profit, të vendosin sipas përcaktimeve të veta dhe politikës redaktuese, se cilës parti çfarë zbritjeje do t'i japin.

Në fakt, kjo nuk ndodh vetëm në vend, por edhe në të gjitha vendet e zhvilluara demokratike, ku janë shumë të qarta lidhjet dhe preferencat e medias ndaj ndonjë opcioni të majtë ose të djathtë politik.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – transparenca

Pyetja-indikator: A kanë Kodi zgjedhor dhe Ligji për financimin e partive politike mekanizma efektive për ndjekje transparente të financimit të zgjedhjeve?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Kodi zgjedhor dhe Ligji për financimin e partive politike me ndryshimet dhe plotësimet e fundit janë më kualitativë. Megjithatë, mbetet përshtypja se ofrohen zgjidhje burokratike, e jo etike, me të cilat do të rritej transparenca në punën e partive politike.

Institucioni: Partia politike**Kategoria: Udhëheqja – transparenca**

Pyetja-indikator: A e pasqyrojnë raportet, gjegjësisht formulari, që i dorëzojnë partitë politike gjendjen me mjetet financiare, burimet dhe harxhimet e tyre gjatë fushatës zgjedhore?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Formulari i raporteve është dokument publik, publikohet në ueb-faqen e partisë politike dhe i përmban të dhënat për mjetet financiare dhe burimet e tyre.

Institucioni: Partia politike**Kategoria: Kapaciteti – resurset**

Pyetja-indikator: A ka nevojë që partitë politike të trajnohen nga ana e Ministrisë për Financa për zbatimin konsekuent të Udhëzimit për plotësimin e raporteve, i cili është pjesë përbërëse e Rregullores për ndryshimin e Rregullores për formularin për raportet financiare për të hyrat dhe të dalat e fushatës zgjedhore?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Edhe përkundër asaj se ekziston udhëzim për plotësimin e formularit për raportet financiare për të hyrat dhe të dalat për fushatën zgjedhore, është e dobishme që Ministria e Financave të

realizojë trajnim për përfaqësuesit e të gjitha partive politike me qëllim të plotësimit dhe të paraqitjes në mënyrë të njëjtë të gjendjeve të raportet.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A përmban legjislacioni aktual dispozita për sanksionimin efikas të shkeljeve nga ana e partive politike që kanë të bëjnë me financimin e zgjedhjeve?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Edhe Kodi zgjedhor edhe Ligji për financimin e partive politike, e bile edhe Kodi penal, përmbajnë sanksione të mjaftueshme për shkeljet që kanë të bëjnë me financimin e zgjedhjeve nga ana e partive politike. Edhe më me rëndësi është që këto dispozita të zbatohen në mënyrë joselektive dhe ndaj të gjithë shkelësve eventuale të rregullave për financimin e zgjedhjeve.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – transparenca

Pyetja-indikator: A mendoni se zbritjet që i japin mediat gjatë fushatës zgjedhore duhet të ndalohen ose së paku të jenë të barabarta për të gjithë organizatorët e fushatave zgjedhore?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Me qëllim të trajtimit dhe të prezantimit të barabartë të partive politike gjatë fushatës zgjedhore, është e pëlqyeshme që zbritjet që i japin mediat ose të shpërndahen në mënyrë të barabartë për të gjithë organizatorët e fushatës zgjedhore ose të ndalohen.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – transparenca

Pyetja-indikator: A kanë Kodi zgjedhor dhe Ligji për financimin e partive politike mekanizma efektive për ndjekje transparente të financimit të zgjedhjeve?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Legjislacioni zgjedhor vazhdimisht ndryshon në drejtim harmonizimit të tij me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare të cilat e ndjekin çështjen e zgjedhjeve dhe ai përmban mekanizma për ndjekje transparente të financimit të zgjedhjeve.

Institucioni: Partia politike**Kategoria: Udhëheqja – transparenca**

Pyetja-indikator: A e pasqyrojnë raportet, gjegjësisht formulari, që i dorëzojnë partitë politike, gjendjen me mjetet financiare, burimet dhe harxhimet e tyre gjatë fushatës zgjedhore ?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Raportet e paraqesin gjendjen me mjetet financiare, por ka nevojë për njëtrajtshmëri metodologjike për plotësimin e tyre nga aspekti i kontabilitetit.

Institucioni: Partia politike**Kategoria: Kapaciteti – resurset**

Pyetja-indikator: A ka nevojë që partitë politike të trajnohen nga ana e Ministrisë për Financa për zbatimin konsekuent të Udhëzimit për plotësimin e raporteve, i cili është pjesë përbërëse e Rregullores për ndryshimin e Rregullores për formularin për raportet financiare për të hyrat dhe të dalat e fushatës zgjedhore?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Ka nevojë për trajnim për plotësimin e raporteve financiare nga Ministria për Financa, por për ato parti politike, të cilat për shkak të mungesës së specialistëve për çështje financiare dhe kontabiliteti në organet e tyre partiake, kanë nevojë për këtë.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A përmban legjislacioni aktual dispozita për sanksionimin efikas të shkeljeve nga ana e partive politike që kanë të bëjnë me financimin e zgjedhjeve?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Legjislacioni aktual përmban sanksione kundërvajtëse, gjegjësisht gjoba për shkeljet e procesit zgjedhor.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – transparenca

Pyetja-indikator: A mendoni se zbritjet që i japin mediat gjatë fushatës zgjedhore duhet të ndalohen ose së paku të jenë të barabarta për të gjithë organizatorët e fushatave zgjedhore?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Personat juridik kanë liri dhe të drejtë të vendosin se për çka dhe për çfarë qëllimi do t'i shfrytëzojnë mjetet e tyre dhe si do ta realizojnë profitin e pritur. Prandaj, mediat e shtypura dhe ato elektronike duhet të kenë mundësi të marrin vendim, se për prezantimin e cilës parti politike do të japin zbritje, e që është në përputhje me politikën redaktuese të medias. Shembull analog për këtë është harxhimi i parave për aksione humanitare, ku çdo person fizik dhe juridik vendos se a do të japë donacion dhe për kë.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – transparenca

Pyetja-indikator: A kanë Kodi zgjedhor dhe Ligji për financimin e partive politike mekanizma efektive për ndjekje transparente të financimit të zgjedhjeve?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Kodi zgjedhor dhe Ligji për financimin e partive politike përmbajnë mekanizma efektive për ndjekjen transparente të financimit të zgjedhjeve.

Ka hapësirë për përmirësimin e rregullativës sa i përket financimit dhe ndjekjes transparente të financimit, veçanërisht në zgjedhjet lokale, për shkak të faktit se ekziston mundësia të ketë disa rrethe zgjedhore për zgjedhjen e kryetarit të komunës.

Mund të mendohet edhe për ndryshimin e modelit të financimit të partive politike, në pjesën e shfrytëzimit dhe të shpërndarjes së mjeteve buxhetore.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – transparenca

Pyetja-indikator: A e pasqyrojnë raportet, gjegjësisht formulari, që i dorëzojnë partitë politike, gjendjen me mjetet financiare, burimet dhe harxhimet e tyre gjatë fushatës zgjedhore ?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Nga aspekti formal, raportet i paraqesin burimet e financimit dhe harxhimet gjatë fushatës zgjedhore, por kjo nuk e ofron pasqyrën e vërtetë për llojin, mënyrën dhe përmasat reale të mjeteve të harxhuara financiare në fushatën zgjedhore.

Nga aspekti i standardeve të kontabilitetit, ka hapësirë për përmirësimin e formularit.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Kapaciteti – resurset

Pyetja-indikator: A ka nevojë që partitë politike të trajnohen nga ana e Ministrisë për Financa për zbatimin konsekuent të Udhëzimit për plotësimin e raporteve, i cili është pjesë përbërëse e Rregullores për ndryshimin e Rregullores për formularin për raportet financiare për të hyrat dhe të dalat e fushatës zgjedhore?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Në parim, çdo trajnim është i mirëseardhur dhe kontribuon në përmirësimin e kapaciteteve të partive politike. Në këtë rast, trajnimi duhet të zbatohet në mënyrë të vazhdueshme, por jo nga

ana e Ministrisë për Financa, por nga ESHR-ja, që është organ kompetent qendror për të kryer mbikëqyrje të punës financiare të organeve shtetërore në vend.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A përmban legjislacioni aktual dispozita për sanksionimin efikas të shkeljeve nga ana e partive politike që kanë të bëjnë me financimin e zgjedhjeve?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Këtu nuk është problem legjislacioni ekzistues dhe mekanizmat efektive për sanksionimin e shkeljeve nga ana e partive politike, por kapaciteti i dobët i institucioneve (prokurorisë publike dhe gjykatave) dhe vendosja e tyre sistemore.

Kjo gjendje ndërlidhet edhe me problemin e qasjes selektive gjatë zbatimit të politikës ndëshkuese.

Institucioni: Partia politike

Kategoria: Udhëheqja – transparencja

Pyetja-indikator: A mendoni se zbritjet që i japin mediat gjatë fushatës zgjedhore duhet të ndalohen ose së paku të jenë të barabarta për të gjithë organizatorët e fushatave zgjedhore?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Mediat paraqesin veprimtari publike ose veprimtari me interes publik, që do të thotë se, pavarësisht se a janë në pronësi shtetërore ose private, ato kanë edhe përgjegjësi publike.

Prandaj, që të evitohet favorizimi dhe prezantimi i pabarabartë i organizatorëve të fushatave zgjedhore, zgjidhja më e mirë është të ndalohen zbritjet që i japin mediat, dhe gjatë fushatës zgjedhore, të gjitha mediat, pa përjashtim, ta respektojnë vendimin për përfaqësim të drejtë dhe korrekt të partive politike.

Institucioni: Sektori joqeveritar

Kategoria: Udhëheqja – transparenca

Pyetja-indikator: A përmbajnë Kodi zgjedhor dhe Ligji për financimin e partive politike, mekanizma efektive për ndjekjen transparente të financimit të zgjedhjeve?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Kodi zgjedhor dhe Ligji për financimin e partive politike përmbajnë mekanizma efektive për ndjekjen transparente të financimit të zgjedhjeve, por akoma ka hapësirë për futjen e dispozitave të reja, të përmirësuara.

Institucioni: Sektori joqeveritar

Kategoria: Kapaciteti – resurset

Pyetja-indikator: A ka nevojë që partitë politike të trajnohen nga ana e Ministrisë për Financa për zbatimin konsekuent të Udhëzimit për plotësimin e raporteve, i cili është pjesë përbërëse e Rregullores për ndryshimin e Rregullores për formularin për raportet financiare për të hyrat dhe të dalat e fushatës zgjedhore?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Nuk mendojmë se ka nevojë për trajnim nga ana e Ministrisë për Financa.

Institucioni: Sektori joqeveritar

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A përmban legjislacioni aktual dispozita për sanksionimin efikas të shkeljeve nga ana e partive politike?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Legjislacioni aktual nuk përmban dispozita për sanksionimin efikas të shkeljeve nga ana e partive politike.

Institucioni: Sektori joqeveritar

Kategoria: Udhëheqja – transparencja

Pyetja-indikator: A mendoni se zbritjet që i japin mediat gjatë fushatës zgjedhore duhet të ndalohen ose së paku të jenë të barabarta për të gjithë organizatorët e fushatave zgjedhore?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Duke mundësuar zbritje nga ana e mediave për reklamimin e paguar politik anashkalohej e drejta e pjesëmarrësve në procesin zgjedhor për qasje të barabartë në reklamimin e paguar politik.

Arsyetim - de jure:

Sipas nenit 84-b të Kodit zgjedhor ("Gazeta zyrtare e vendit" nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13 dhe 34/13), organizatori i fushatës zgjedhore është i obliguar që në ditën e njëmbëdhjetë të fushatës zgjedhore të dorëzojë raport financiar për të hyrat dhe të dalat në xhiro-llogarinë e veçantë për fushatën zgjedhore nga dita e hapjes së saj e deri në fundin e ditës së dhjetë të fushatës zgjedhore. Organizatori i fushatës zgjedhore është i obliguar që një ditë pas përfundimit të fushatës zgjedhore të dorëzojë raport financiar për të hyrat dhe të dalat në xhiro-llogarinë e veçantë për fushatën zgjedhore për gjysmën e dytë të fushatës zgjedhore. Raportet dorëzohen në formularin e përcaktuar nga ministri për financa, ku gjenden të dhënat për: emrin, gjegjësisht titullin e donatorit; llojin dhe vlerën e donacioneve; datën e marrjes së donacioneve dhe harxhimet për çdo donacion, si dhe të hyrat dhe të dalat gjatë fushatës zgjedhore. Raportet i dorëzohen Komisionit shtetëror të zgjedhjeve, Entit shtetëror për revizion dhe Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit, të cilat janë të obliguara që ato t'i publikojnë në ueb-faqet e tyre.

Pastaj, në nenin 85 është paraparë se organizatori i fushatës zgjedhore është i obliguar menjëherë, e më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e përfundimit të fushatës zgjedhore, të dorëzojë raport të përgjithshëm financiar për fushatën zgjedhore. Raporti financiar për fushatën zgjedhore dorëzohet në formularin e përcaktuar nga ministri për financa. Raporti financiar dorëzohet deri te Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, Enti shtetëror për revizion, Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit dhe Kuvendi i vendit, ndërsa për zgjedhjet lokale edhe deri te këshilli i komunës dhe këshilli i qytetit të Shkupit. Raportet financiare për fushatën zgjedhore, Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, Enti shtetëror për revizion dhe Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit i publikojnë në ueb-faqet e tyre.

Sa i përket mediave elektronike dhe atyre të shtypura në vend, sipas nenit 85-a, ato janë të obliguara të dorëzojnë raport për hapërisën reklamuese që e ka shfrytëzuar çdo organizator i fushatës zgjedhore dhe mjetet që janë paguar ose që duhet të paguhet për këtë qëllim. Raporti i këtillë dorëzohet në formularin e përcaktuar nga ministri për financa, më së voni 15 ditë pas përfundimit të fushatës zgjedhore, dhe dorëzohet deri te Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, Enti shtetëror për revizion dhe Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, të cilat janë të obliguara që ato t'i publikojnë në ueb-faqet e tyre

Në nenin 85-b është përcaktuar se Enti shtetëror për revizion, raportet e revizionit nga revizioni i kryer i raporteve financiare të organizatorëve të fushatës zgjedhore, i publikon në ueb-faqen e tij në afatin e përcaktuar me ligj.

Sipas nenit 144 të Kodit, organizatori i fushatës zgjedhore, detyrimisht hap xhiro-llogari me shënimin "për fushatën zgjedhore", në bazë të vërtetimit të dhënë nga Komisioni shtetëror i zgjedhjeve për listën e dorëzuar për kandidat për kryetar të vendit. Raportet financiare për të hyrat dhe të dalat në xhiro-llogarinë e veçantë për fushatën zgjedhore publikohen dhe dorëzohen deri te institucionet që kanë kompetenca, në rast se dyshojnë se janë shfrytëzuar mjete kundërligjore dhe anonime financiare, të kërkojnë të dhëna që ta verifikojnë vërtetësinë e raporteve dhe në rast se konstatohen parregullsi, të inicojnë procedurë gjegjësisht iniciativë për sanksionim. Është përcaktuar formulari për formën, përmbajtjen e raporteve financiare për të hyrat dhe të dalat për fushatën zgjedhore dhe formulari për raportin për hapërisën reklamuese që është shfrytëzuar nga çdo organizator i fushatës zgjedhore dhe mjetet që janë paguar ose pritet të paguen për këtë qëllim, të cilat i përmbajnë elementet e nevojshme për pasqyrimin e gjendjes me mjetet financiare, burimet e tyre dhe për çka kanë qenë të dedikuara gjatë procesit zgjedhor.

Sa i përket ekzistimit të dispozitave për sanksionim efikas të shkeljeve nga ana e partive politike, në kapitullin XIV të Kodit zgjedhor janë paraparë gjopa për kundërvajtje, të kryera nga ndonjë parti politike, koalicion, gjegjësisht bartës i listës së pavarur nga një grup i zgjedhësve dhe organizator i fushatës, edhe atë:

Gjobë në lartësi prej 4.000 deri në 5.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje, partisë politike, koalicionit, bartësit të listës së pavarur nga grupi i zgjedhësve, gjegjësisht personave që kanë pasur për qëllim të kandidohen në qoftë se donacionet e pashpenzuara nuk ua kthejnë në afatin e paraparë ofruesve të donacioneve, proporcionalisht me donacionin e dhënë, në rast të mosdorëzimit gjegjësisht moskonfirmimit të listës së kandidatëve (neni 188).

Gjobë në lartësi prej 4.000 deri në 5.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje, organizatorit të fushatës zgjedhore nëse nuk i dorëzon raportet financiare në afatin e paraparë ligjor (neni 188-a).

Gjobë në lartësi prej 4.000 deri në 5.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje organizatorit të fushatës zgjedhore që nuk do të dorëzojë raport për financimin e fushatës zgjedhore, gjegjësisht kur për financimin e fushatës zgjedhore janë shfrytëzuar mjete me të cilat nuk guxon të financohet fushata zgjedhore, sipas nenit 83 të Kodit zgjedhor. Gjobë në lartësi prej 4.000 deri në 5.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje, partisë politike, koalicionit, gjegjësisht bartësit të listës së pavarur nga grupi i zgjedhësve në qoftë se në fushatën zgjedhore harxhon më tepër mjete financiare se sa që është përcaktuar me Kodin zgjedhor. Gjobë në lartësi prej 4.000 deri në 5.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje, personit përgjegjës të partisë politike për të cilën nuk është dorëzuar raport për financimin e fushatës zgjedhore, gjegjësisht kur për financimin e fushatës zgjedhore janë shfrytëzuar mjete me të cilat nuk guxon të financohet fushata zgjedhore, sipas

nenit 83 të Kodit zgjedhor, gjegjësisht kur janë harxhuar më tepër mjete financiare se sa që është paraparë me Kodin zgjedhor (neni 189).

Sipas nenit 85 paragrafi (7) të Kodit zgjedhor, në qoftë se Enti shtetëror për revizion konstaton parregullsi në raportin financiar të organizatorit të fushatës zgjedhore, bën kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse ose bën denoncim deri te prokurori kompetent publik në afat prej 30 ditësh nga dita e konstatimit të parregullsive.

Sanksione që kanë të bëjnë me financimin e partive politike përmbajnë edhe Kodi penal (“Gazeta zyrtare e vendit” nr. 37/96, 80/99, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/11, 135/11, 185/11, 142/12, 166/12, 55/13 dhe 82/13) dhe Ligji për financimin e partive politike.

Neni 165-c i Kodit penal parasheh se për veprat penale që janë paraparë me nenet 158 deri në 165-a¹³⁰ të këtij Kodi, gjykata do t’i shqiptojë autorit ndalesë për shfrytëzimin e mjeteve për financimin e partive politike nën kushtet e nenit 96-c paragrafi (1) të këtij Kodi¹³¹. Në nenin 96-b të Kodit penal është shtuar edhe një sanksion i ri detyësor, shqiptim i detyrueshëm i ndalesës për shfrytëzimin e mjeteve nga buxheti i vendit për financimin e partive politike.

Neni 27 i Ligjit për financimin e partive politike parasheh kompetencë që Enti shtetëror për revizion të dorëzojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse ose të bëjë denoncim deri te prokurori kompetent publik në qoftë se has në parregullsi në raportin vjetor financiar që është dorëzuar nga ndonjë parti politike, në afat prej 30 ditësh nga zbulimi i tyre.

Në Ligjin për financimin e partive politike është paraparë edhe suspendimi i pagesës së mjeteve për financim të rregullt vjetor nga buxheti i vendit, për partinë politike e cila deri te Enti shtetëror për revizion nuk do të dorëzojë raport vjetor në afatin e paraparë dhe për partinë politike e cila nuk do t’i publikojë të dhënat për donacionet e pranuar gjatë vitit:

Pavarësisht nga përgjegjësia kundërvajtëse, pezullohet (suspendohet) pagesa e mjeteve për financim të rregullt vjetor nga buxheti i vendit, për partinë politike e cila deri te Enti shtetëror për revizion nuk do të dorëzojë raport vjetor në afatin e paraparë. Pagesa e mjeteve për financim të rregullt financiar nga buxheti i vendit pezullohet (suspendohet) edhe për partinë politike e cila nuk do t’i publikojë të dhënat për donacionet e pranuar gjatë vitit. Pezullimi (suspendimi) i pagesës zgjat deri në plotësimin e duhur të obligimeve për partitë politike, të përcaktuara në Ligjin për financimin e partive politike. Vendimin për pezullimin (suspendimin) e pagesës së mjeteve për financim të rregullt financiar nga buxheti i vendit me propozim të Entit shtetëror për revizion e sjell ministri për drejtësi. Vendimi është përfundimtar, ai publikohet në “Gazetën zyrtare të vendit” dhe kundër tij mund të inicohet kontest administrativ.

Pavarësisht nga përgjegjësia kundërvajtëse, partia politike e cila në afatin e paraparë nuk do ta publikojë raportin financiar vjetor e humb të drejtën për financim të rregullt vjetor nga buxheti i vendit, për periudhë prej tre muajsh. Vendimin për humbje të të drejtës për financim të rregullt nga buxheti i vendit për periudhë prej tre muajsh, me propozim të Entit shtetëror për revizion, e sjell ministri për drejtësi. Vendimi është përfundimtar, ai publikohet në “Gazetën zyrtare të vendit” dhe kundër tij mund të inicohet kontest administrativ.

Suspendimi i pagesës së mjeteve për organizatorët e fushatës zgjedhore është rregulluar edhe me ndryshimet e Kodit zgjedhor, ku thuhet:

¹³⁰ Vepra penale kundër zgjedhjeve dhe votimit

¹³¹ Neni 96-c – Kushtet për shqiptimin e dënimeve detyësore

Pavarësisht nga përgjegjësia kundërvajtëse për mosrespektimin e dispozitave të këtij Kodi zgjedhor që kanë të bëjnë me kufizimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore dhe dorëzimin e raporteve financiare për financimin e fushatës zgjedhore të organizatorit të fushatës zgjedhore, parashihet: humbje e pjesërishtme e kompensimit të harxhimeve për fushatën zgjedhore; humbje e plotë e kompensimit të harxhimeve për fushatën zgjedhore; ose ndalesë për pagesën e kompensimit për shpenzimet për fushatën zgjedhore. Organizatorëve të fushatës zgjedhore do t'u përcaktohet humbje e pjesërishtme e kompensimit për shpenzimet për fushatën zgjedhore atëherë kur do ta tejkalojnë shumën e lejuar të shpenzimeve për fushatën zgjedhore. Humbja e pjesërishtme e kompensimit për shpenzimet për fushatën zgjedhore përbëhet nga zvogëlimi i shumës për kompensim të shpenzimeve për fushatën zgjedhore për aq sa është tejkaluar kufiri i lejuar për shpenzim në fushatën zgjedhore. Në qoftë se lartësia e shumës së mjeteve me të cilat është tejkaluar kufiri i lejuar për shpenzime në fushatën zgjedhore është më e madhe se sa shuma për kompensimin e shpenzimeve në fushatën zgjedhore, do të caktohet humbje e plotë e kompensimit të shpenzimeve për fushatën zgjedhore. Organizatorëve të fushatës zgjedhore do t'u caktohet ndalesë për pagesën e kompensimit të shpenzimeve për fushatën zgjedhore në rastet kur në afatin dhe në formën e paraparë nuk do t'i dorëzojnë raportet financiare në përputhje me Kodin zgjedhor. Ndalesa për pagesën e kompensimit për shpenzimet për fushatën zgjedhore zgjat deri në plotësimin e rregullt të obligimit. Vendimin për humbjen e pjesërishtme gjegjësisht të plotë të kompensimit të shpenzimeve për fushatën zgjedhore nga paragrafet e përmendura, si dhe vendimin për pezullimin e pagesës, e sjell Komisioni shtetëror i zgjedhjeve me propozim të Entit shtetëror për revizion. Vendimi është përfundimtar, ai publikohet në "Gazetën zyrtare të vendit" dhe kundër tij mund të inicohet kontest administrativ.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e partive politike ("Gazeta zyrtare e vendit" nr.142/2012), në drejtim të ngritjes së vetëdijes së partive politike për obligimet e tyre të parapara me rregullativat që zbatohen për financim politik, përcaktoi se mënyra e plotësimit të përmbajtjes së formularit për raportin financiar do të rregullohet me Udhëzim, që do të jetë pjesë përbërëse e formularit, ndërsa Ministria për Financa, së paku një herë vit do të realizojë trajnime për partitë politike për punën materiale-financiare dhe mënyrën e mbajtjes së raportit financiar.

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetim - de facto:

Me ndryshimet dhe plotësimet e Kodit zgjedhor dhe Ligjit për financimin e partive politike është bërë një hap përpara për tejkalimin e dobësive aktuale, para së gjithash me futjen e mekanizmeve për ndjekje transparente të financimit të zgjedhjeve.

Ministri për financa, më 31.01.2013 e solli edhe Rregulloren për formularin, formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së raportit financiar vjetor për partitë politike ("Gazeta zyrtare e vendit" nr. 21/2013). Kjo Rregullore përmban edhe Udhëzim për plotësimin e formularit. Edhe përkundër asaj që Formulari për raportin financiar për të hyrat dhe të dalat në xhiro-llogarinë e posaçme për fushatën zgjedhore, nga dita e hapjes së saj e deri në fund të ditës së dhjetë të fushatës zgjedhore është i standardizuar dhe i përcaktuar nga ministri për financa (duke i theksuar elementet e përmbajtjes së tij), nga ajo që ka mundur të shihet te formularet, evidente është se mënyra e plotësimit të tyre dallon prej një partie politike në tjetrën.

Në praktikë ka mundësi të verifikohet lidhshmëria e donacioneve për fushatën zgjedhore me shpenzimet e personave juridik, por i tillë nuk është rasti edhe me donacionet për fushatën zgjedhore me shpenzimet e personave fizik.

Në nenin 83 të Kodit zgjedhor janë paraparë burimet edhe kufizimet për financimin e fushatës zgjedhore, por mungojnë dispozita për veprimet që duhet të ndërmerren në rastet e detyrimeve të tjera të pashlyera pas mbylljes së xhiro-llogarisë së posaçme për fushatën zgjedhore.

Në nenin 83 paragrafi (2) alineja 3 të Kodit zgjedhor është përcaktuar se fushata zgjedhore mund të financohet nga personat juridik në lartësi deri në 5% të të ardhurave të përgjithshme gjatë vitit kaluar. Nga kjo dispozitë nuk është e qartë se ky kufizim a vlen për shumën e përgjithshme për donacion nga personat juridik për partitë politike në fushatën zgjedhore ose ka të bëjë me pjesëmarrësit e veçantë në fushatën zgjedhore.

Me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit zgjedhor, shuma maksimale e mjeteve të lejuara për financimin e fushatës zgjedhore për çdo zgjedhës të regjistruar në njësinë zgjedhore, gjegjësisht komunën për të cilën ka paraqitur listë me kandidatë, gjegjësisht listë të kandidatit, nga „60“ denarët aktualë u rrit në „180“ denarë. Ka dallim ndërmjet shumës së mjeteve të siguruar për fushatën zgjedhore dhe detyrimeve të krijuara gjatë fushatës zgjedhore dhe për këtë arsye ka hapësirë për rishqyrtim të kornizës së përcaktuar maksimale pre 180 denarësh për çdo zgjedhës të regjistruar dhe zvogëlim të saj eventual. Neni 84 i Kodit zgjedhor nuk është i qartë në lidhje me atë se kufiri i përcaktuar maksimal i mjeteve për financimin e fushatës zgjedhore a i përfshin edhe zbritjet që ofrohen nga personat juridik ose jo.

Dispozitat që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e fushatës zgjedhore (para së gjithash fushatës zgjedhore në kushte kur ka anulim të votimit në disa vendvotime dhe kur ka rivotim) vështirë mund të zbatohen në praktikë. Prandaj, ka nevojë që të përcaktohet një kornizë precize për atë se kur fillon dhe kur saktësisht mbaron fushata zgjedhore, varësisht nga ajo se sa zgjat procesi zgjedhor.

Në praktikë ndodh që xhiro-llogaria e posaçme për fushatën zgjedhore të mbyllet pas dorëzimit të raportit, dhe për këtë arsye në raportin vjetor financiar, jo gjithmonë janë të përfshira transaksionet që realizohen nga dita e përgatitjes së raportit deri në ditën e mbylljes së xhiro-llogarisë së posaçme për fushatën zgjedhore.

Nota:

Në masë shumë të vogël	1
Në masë të vogël	2
Në masë të caktuar	3
Në masë të madhe	4
Në masë shumë të madhe	5

Rekomandime

Të vazhdohet me përmirësimin e legjislacionit zgjedhor dhe legjislacionit tjetër relevant, në drejtim të zvogëlimit të hapësirës për shkeljen e tij, edhe atë nëpërmjet këtyre masave dhe aktiviteteve:

- Të riformulohet definicioni dhe kohëzgjatja e fushatës zgjedhore;
- Të eliminohet paqartësia në lidhje me subjektet që janë të lidhura (në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte) me ndonjë parti politike ose janë nën kontrollin e saj;

- Të përgatitet formulari i posaçëm për specifikim të detajuar të shpenzimeve të kryera gjatë fushatës zgjedhore;
- Të precizohet dita e mbylljes së xhiro-llogarisë së veçantë **për fushatën zgjedhore**;
- Të sigurohet verifikueshmëri e **të dhënave për donacionet**;
- Të rishqyrtohen kufizimet **për donacionet, me qëllim të parandalimit të pabarazisë ndërmjet donatorëve**;
- Të **përcaktohet** periudha e saktë kur do të mblidhen donacionet;
- Të rregullohen në mënyrë plotësuese ligjore, rregulla precize për prezantim mediatik gjatë fushatës zgjedhore;
- Të sqarohet në mënyrë plotësuese formulimi “qasje e barabartë në prezantimin mediatik” dhe
- Në financimin e prezantimit mediatik, të pamundësohet ofrimi i zbritjeve të cilat nuk mund të kontrollohen, dhe me të cilat tejkalohen kufizimet ligjore për donacione.

Problemi/faktori i rrezikut 3:

Shkalla e lartë e autorizimeve diskrete me dallime të mëdha në intensitetin e tyre ndërmjet funksioneve të ndryshme publike.

Arsyetimi:

Ka rrezik të lartë nga autorizimet diskrete që i kanë pozitativ ose individët e caktuar, të cilat në praktikë vështirë kontrollohen, e që ndikon mbi veprimin efikas të organeve mbikëqyrëse kompetente.

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A ka bërë KSHPK-ja ka koncept të Analizës për autorizime diskrete në të gjitha segmentet e pushtetit?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

KSHPK-ja ka skicuar elemente të një analize të këtillë që dalin nga perceptimet aktuale gjatë shqyrtimit të rasteve dhe lëndëve konkrete. Duhet potencuar se ky aktivitet i Programit shtetëror duhe të realizohet në vitin 2014.

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit

Kategoria: Kapaciteti – pavarësia

Pyetja-indikator: A mendoni se autorizimet diskrete janë më të shprehura te bartësit e funksioneve publike në pushtetin ekzekutiv?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Jo më pak të rëndësishme janë autorizimet diskrete te bartësit e pushtetit në nivel lokal, autorizimet e të cilëve me procesin e decentralizimit janë theksuar në mënyrë të veçantë, e nuk janë të parëndësishme edhe ato në ndërmarrjet dhe institucionet publike, si dhe te llojet e tjera të pushtetit.

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit

Kategoria: Kapaciteti – pavarësia

Pyetja-indikator: A do të zvogëloheshin autorizimet diskrete në qoftë se zvogëlohet numri i akteve nënligjore të cilat i miratojnë bartësit e funksioneve publike, edhe përkundër perceptimit se ka rregullim të tepruar në ligje?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Nga aspekti i korrupsionit, problemi me shkallën tepër të lartë të autorizimeve diskrete shprehet nëpërmjet akteve nënligjore dhe mekanizmave të tjera, që nuk janë të sinkronizuara ose madje janë në kundërshtim me frymën e ligjeve, me ç'rast aktet nënligjore mund të shfrytëzohen si mbulesë për arbitraritetin personal në ushtrimin e autorizimeve publike.

Arsyetim - de jure:

Autorizimet diskrete të bartësve të funksioneve publike kanë bazë në ligjet dhe aktet nënligjore. Zvogëlimi i diapazonit të autorizimeve diskrete ose pamundësimi i tejkallimit të tyre varet, para së gjithash, nga qasja objektive dhe e përgjegjshme gjatë praktikimit të tyre. Nga ana tjetër, realizimi vetëm i interesit publik nga ana e bartësve të funksioneve publike duhet të rezultojë me ushtrim real dhe optimal të autorizimeve diskrete.

Rolin e korrigjuesit për shkallën e lartë të autorizimeve diskrete e kanë organet e inspektimit dhe, nënkuptohet, Gjykata Kushtetuese e vendit.

Ushtrimi i autorizimeve diskrete si formulim ligjor është theksuar vetëm te Ligji për parandalimin e korrupsionit („Gazeta zyrtare e vendit” nr. 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008 dhe 145/2010).

Në fakt, në nenin 43 të këtij ligji është përcaktuar se çdo funksionar i zgjedhur ose i emëruar dhe çdo person zyrtar, është i obliguar që vendimet t’i marrë në mënyrë të përgjegjshme, duke mbajtur llogari për të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit konkret dhe për parimin e ligjshmërisë dhe të drejtësisë. Në këtë dispozitë është rregulluar edhe mbrojtja e qytetarëve ose personave juridik në rast të tejkalimit të autorizimeve diskrete nga ana e bartësve të funksioneve publike, ashtu që çdo qytetar ose person juridik që nuk është i kënaqur me vendimin e marrë në bazë të autorizimit diskret, dhe kur mendon se ai është marrë për shkak të korrupsionit, mund të dorëzojë ankesë para Komisionit shtetëror. Nga ana tjetër, Komisioni shtetëror është i obliguar ta shqyrtojë ankesën dhe në afat prej 30 ditësh nga pranimi i saj ta njoftojë personin fizik ose juridik për veprimin që e ka ndërmarrë në lidhje me ankesën.

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetim - de facto:

Në të kaluarën, në vend janë bërë përpjekje për kufizimin e autorizimeve diskrete të ministrave dhe të bartësve të tjerë të autorizimeve publike.

Kështu, Qeveria e vendit, më 26 dhjetor 2004 formoi Grup pune të përbërë nga ekspertë, ministra dhe përfaqësues të zyrës së kryetarit të qeverisë, me detyrë që të përgatisin projekt qeveritar për autorizimet diskrete të ministrave. Në mbledhjen e mbajtur më 11 prill 2005, qeveria e shqyrtoi dhe e miratoi Informatën e grupit ekspert, e cila përmban: Fjalor të termeve ku janë sqaruar dhe janë definuar aktet e përgjithshme të administratës, aktet konkrete të administratës dhe autorizimet diskrete; Udhëzime për tejkalimin e autorizimeve diskrete dhe Dinamikë të aktiviteteve. Aktivitetet duhej të zhvillohen në tre faza, të cilat përfshinin:

1. Dhënien e vërejtjeve të përgjithshme për autorizimet diskrete, si dhe udhëzime për zvogëlimin e tyre;
2. Shqyrtimin e zgjidhjeve të mundshme për tejkalimin e autorizimeve të konstatuara diskrete dhe
3. Ndryshime dhe plotësime konkrete në aktet ligjore dhe nënligjore, që do të mundësojnë zvogëlim të autorizimeve diskrete dhe transparencë të tyre.

Sipas udhëzimeve për tejkalimin e autorizimeve diskrete që janë përfshirë në këtë material dhe fushat për të cilat ka nevojë për veprim urgjent, në mes tjerash, janë ndërmarrë këto aktivitete:

- Është përgatitur Propozim për sjelljen e Ligjit për punë të jashtme, me qëllim të rregullimit të kësaj sfere me akt ligjor.
- Në tërësi janë pranuar ndryshimet e propozuara nga ekipi i ekspertëve në Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative.
- Janë pranuar propozimet e grupit të ekspertëve për ndryshime në Ligjin për ndërtim.
- Janë dhënë propozime për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për verë, i cili është duke u përgatitur.
- Është ndryshuar Dekreti për mënyrën dhe procedurën e tëhuajësimit, dhënien me qira dhe lartësinë e shpenzimeve të veçanta të procedurave për tëhuajësimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore.¹³²

Është fakt se deri tani, në vend nuk është bërë një analizë e plotë dhe gjithëpërfshirëse për autorizimet diskrete në të gjitha segmentet e pushtetit.

Nota:

Në masë shumë të vogël	1
Në masë të vogël	2
Në masë të caktuar	3
Në masë të madhe	4
Në masë shumë të madhe	5

Rekomandime

- Duke pasur parasysh ekzistimin e një “deti” me dispozita nga të cilat mund të dalin autorizime diskrete, është shumë me rëndësi që t’i qaset përgatitjes së, para së gjithash, Pasqyrës së dispozitave pozitive në të cilat ka bazë për të sjellë vendime në bazë të autorizimeve diskrete dhe të mundësive për korrupsion eventuale, e pastaj edhe të Analizës së autorizimeve diskrete dhe
- Nëse dihet se numri më i madh i ligjeve sillen me propozim të Qeverisë së vendit, dhe se numrin më të madh të akteve nënligjore i përcaktojnë ministrat, do të ishte mirë që në fazën e parë, Pasqyra dhe Analiza e autorizimeve diskrete të bëhen së pari për bartësit e funksioneve publike në pushtetin qendror, në fazën e dytë për bartësit e funksioneve në pushtetin lokal, që përfundimisht, në fazën e tretë të përfshihen bartësit e funksioneve publike në pushtetin legjislativ dhe atë gjyqësor.

132 <http://www.pressonline.com.mk/?ItemID=9A687CD5CCEE7642A915A68C1BBC6637>

Problemi/faktori i rrezikut 4:

Mungesa e efekteve nga zbatimi i Ligjit për lobim

Arsyetimi:

Jokonsekuenca dhe njohja e pamjaftueshme e termit dhe e përmbajtjes, si në rrethet politike, ashtu edhe në ato shoqërore, kundrejt lobimit të përhapur gjerësisht, jashtë kornizës ligjore. Rreziku nga korrupsioni ekziston në rast të mosdenoncimit të rasteve të lobimit dhe lobimit të palejuar dhe përdorimit të tij për interesa të fshehta, jolegjitime dhe të palegjitimuar, të financuara nga burime të panjohura dhe të pakontrolluara, me çka pamundësohet mbikëqyrja efikase.

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit**Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet**

Pyetja-indikator: A ka KSHPK-ja njohuri për shkaqet e zbatimit të pamjaftueshëm të Ligjit për lobim?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

KSHPK-ja ka mbajtur punëtori ndërkombëtare për lobim, me pjesëmarrës referentë dhe janë fituar përvoja të caktuara krahasuese.

Shkaqet për zbatimin e pamjaftueshëm të ligjit vendor janë se ai është i dobët dhe i paqartë, lobimi nuk është definuar në mënyrë adekuate, procedurat për regjistrim dhe mbikëqyrje janë joadekuate, kështu që ligji nuk mund të shfrytëzohet në tërësi për sensibilizimin e nevojshëm edhe të institucioneve edhe të publikut, për ta dalluar lobimin si veprimtari që është e dobishme me arsye, nga përdorimi i tij keq dhe dimensionin e mundshëm korruptiv.

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit**Kategoria: Kapaciteti – pavarësia**

Pyetja-indikator: A mendoni se definicioni ekzistues është i qartë sa duhet dhe se i shpreh të gjitha aspektet e lobimit?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Duhet të bëhet ridefinimi i lobimit si veprimtari, e jo vetëm si “aktivitet”. Edhe pse problemi ka edhe dimensione etike, dhe për këtë arsye për dikë nuk është i arsyeshëm deri në fund përcaktimi për ta rregulluar lobimin në mënyrë ligjore, megjithatë përcaktimi i qartë për atë se çka paraqet lobimi do të mundësojë zbatim të tij më të gjerë dhe ligjor.

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit

Kategoria: Kapaciteti – resurset

Pyetja-indikator: A planifikon KSHPK-ja të realizojë fushatë për ngritjen e vetëdijes publike për rëndësinë e lobimit?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Aktiviteti i këtillë është planifikuar në Programin shtetëror për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, pasi të bëhen ndryshime në Ligjin për lobim.

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A mundësojnë dispozitat e Ligjit për lobim mbikëqyrje efikase dhe të zbatueshme?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Është paraparë dorëzimi i raportit vetëm nga lobistët e regjistruar, por fakti që ka shumë lobistë “të egër”, të cilët këtë veprimtari e ushtrojnë duke u fshehur pas cilësive dhe pozitive të tyre të tjera, nuk mundëson që të bëhet mbikëqyrje e mirëfilltë e lobimit. Mu për këtë arsye, ligji duhet të përmirësohet në pjesën e mbikëqyrjes.

Institucioni: Ministria për Drejtësi

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A ka bërë Ministria e Drejtësisë analizë të zbatimit të deritanishëm të Ligjit për lobim?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Aktivitetet për analizë të zbatimit të deritanishëm të Ligjit për lobim janë duke u zhvilluar.

Institucioni: Ministria për Drejtësi

Kategoria: Kapaciteti – pavarësia

Pyetja-indikator: A mendoni se definicioni aktual për lobim është i qartë sa duhet dhe se i shpreh të gjitha aspektet e tij?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Vlerësimi i Ligjit për lobim dhe analiza e zbatimit të tij akoma nuk kanë përfunduar. Aktivitetet janë duke u zhvilluar.

Institucioni: Ministria për Drejtësi

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A mundësojnë dispozitat e Ligjit për lobim mbikëqyrje efikase dhe të zbatueshme?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Vlerësimi i Ligjit për lobim dhe analiza e zbatimit të tij akoma nuk kanë përfunduar. Aktivitetet janë duke u zhvilluar.

Institucioni: Ministria për Drejtësi

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A ka përgatitur ose a ka planifikuar Ministria e Drejtësisë Kod etik për lobistët?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Vlerësimi i Ligjit për lobim dhe analiza e zbatimit të tij akoma nuk kanë përfunduar. Pas këtij aktiviteti do të planifikohet përgatitja e Kodit etik për lobistët.

Institucioni: Lobist

Kategoria: Kapaciteti – pavarësia

Pyetja-indikator: A mendoni se ka nevojë për ndryshime thelbësore në Ligjin për lobim?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Ligji aktual për lobim i vendit është miratuar më 16.08.2008. Duke pasur parasysh nga njëra anë se që atëherë kanë kaluar pesë vite, si dhe përvojën e fituar nga praktikimi i lobimit legal në vendin tonë gjatë kësaj periudhe, nga ana tjetër, definitivisht ka nevojë për ndryshime thelbësore në këtë ligj. E para, në aspekt të definimit të termit lobim. E dyta, në aspekt të palëve të involvuara në procesin e lobimit. E treta, në aspekt të kompetencave të institucioneve dhe të organeve shtetërore që janë të involvuara. E katërta, në aspekt të harmonizimit me legjislacionin e BE-së në këtë fushë. E pesta, në aspekt të rregullativës nënligjore. E gjashta, në aspekt të evidencës, raportimit, preventivës, mbrojtjes së lobistëve, kontrollit dhe sanksionimit të dukurve të (pa)definuara në kontekst të lobimit. E shtata, nga aspekti i zgjerimit të qëllimeve, metodave, parimeve dhe mënyrës së lobimit, në aspekt të përfshirjes së shtetit (si porosites, ndërmjetësues dhe lobist në procesin e lobimit legal) me implementimin e të ashtuquajturës shkallë kategorizuese të lëndëve.

Institucioni: Lobist

Kategoria: Kapaciteti – pavarësia

Pyetja-indikator: A mendoni se definicioni aktual për lobim është i qartë sa duhet dhe se i shpreh të gjitha aspektet e tij?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Ajo që në Ligjin tonë aktual për lobim nënkuptohet me definicionin për lobim, është vetëm një segment i definicionit për lobimin në vendet e zhvilluara (BE, Britani të Madhe, SHBA, Australi etj.).

Ligji për lobim i vendit nuk është preciz në pjesën e relacionit “ndaj dhe prej” asociacioneve tregtare, sindikateve, shoqatave, OJQ-ve etj., veçanërisht duke e pasur parasysh mënyrën e përgatitjes së disa “propozim-zgjidhjeve formale ligjore”, në një situatë kur si përpilues i ligjit paraqitet ndonjë ministri e vendit.

Gjendja e këtillë çon në pakënaqësi të palët e involvuara, gjegjësisht e bën të pamundshme që në tërësi të përmbushen kërkesat e qytetarëve në fusha të caktuara, ndërsa nuk ekziston kundërmasë për shkak se nevojitet shumë kohë, energji, resurse dhe mjete që të realizohen ndryshimet në zgjidhjen aktuale ligjore.

Institucioni: Lobist

Kategoria: Kapaciteti – pavarësia

Pyetja-indikator: A duhet të lobimi të udhëhiqet në Regjistrin qendror si veprimtari me shifër të veçantë?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Vendi tashmë ngec në implementimin e shifrës së veçantë të veprimtarisë – “lobim”, e cila është paraparë në Klasifikimin nacional të veprimtarive.

Kompetente për këtë çështje është Ministria e Ekonomisë, por atje ka mosinteresim dhe/ose mosnjohuri për obligimin e tyre tashmë tre vite të plota.

Institucioni: Lobist

Kategoria: Kapaciteti – pavarësia

Pyetja-indikator: A është Kuvendi vendi i vërtetë ku duhet të mbahet Regjistri i lobistëve?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Kuvendi është vend i mirë vetëm sa i përket debateve nëpër komisione dhe mbledhjeve plenare dhe/ose në raportet e lobistit, individualisht me deputetët ose me grupet parlamentare.

Sa i përket çështjeve të tjera të kategorizuara të interesit, në vendet anëtare të BE-së, regjistrin e lobistëve e mbajnë: agjencitë shtetërore për luftë kundër korrupsionit, ministritë për punë të brendshme, ministritë për punë të jashtme, ministritë për vetëqeverisje lokale (për çështje të lobimit që janë me rëndësi lokale) etj.

Institucioni: Lobist

Kategoria: Udhëheqja – transparenca

Pyetja-indikator: Sa ndikon i ashtuquajturit “lobim i egër” ose i palejuar në paraqitjen e rrezikut për korrupsion?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Termi “lobim i egër” përdoret kur ka ndonjë lobist të paregjistruar ose kompani të paregjistruar për lobim. Por, kjo nuk paraqet lobim në kuptimin e vërtetë të termit, i cili nga ana tjetër, shumë shpesh përdoret gabimisht ose pa nevojë.

Definitivisht, në një situatë kur ka vetëm një lobist dhe kur nuk ka çështje formale ligjore për lobim, gjithçka është e mundur, bile edhe paraqitja e “shoqatave të qytetarëve”, si shoqata jo-profitabile, të cilat mund të paraqiten si lobistë.

Gjithsesi, kjo dukuri dhe dukuri të tjera të ngjashme mundësojnë sjellje korruptive.

Arsyetim - de jure:

Sipas Ligjit për lobim (“Gazeta zyrtare e vendit” nr. 106/08 dhe 135/11), lobimi është aktivitet i orientuar kah pushteti ligjdhënës dhe ekzekutiv në nivel qendror, si dhe kah pushteti lokal, me qëllim të realizimit të interesave të caktuara në procesin e sjelljes së ligjeve dhe dispozitave të tjera, ndërsa lobisti është person fizik që bën lobim për një kompensim të caktuar parash, i cili është regjistruar për të bërë lobim në përputhje me këtë ligj, ose është i punësuar te ndonjë person juridik që është regjistruar për të bërë lobim, me të cilin ka nënshkruar marrëveshje për lobim.

Lobisti mund të jetë person fizik i vendit që i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe i cili është i regjistruar në Regjistër ose është i punësuar te ndonjë person juridik me të cilin ka nënshkruar marrëveshje për lobistë, ndërsa Regjistrin e mban Sekretari gjeneral i Kuvendit të vendit. Procedura për regjistrim, reregjistrim ose fshirja nga Regjistri i lobistëve fillon në Kuvendin e vendit dhe realizohet në këtë mënyrë: Sekretari gjeneral i Kuvendit të vendit është i obliguar që në afat prej pesë ditë pune pas pranimit të kërkesës, të sjellë vendim me të cilin kërkesa për lëshimin e vërtetimit për regjistrim, reregjistrim ose fshirje nga Regjistri, pranohet ose refuzohet. Në qoftë se Sekretari gjeneral i Kuvendit të vendit nuk sjell vendim në afatin e përmendur më lartë, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin shtetëror administrativ në afat prej pesë ditësh, e pastaj Inspektorati shtetëror administrativ në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit, është i obliguar të bëjë mbikëqyrje të punës së Sekretarit gjeneral të Kuvendit të vendit dhe të kontrollojë se a është zbatuar procedura në përputhje me ligjin dhe pastaj në afat prej tre ditë pune nga dita e kryerjes së kontrollit, ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra. Pas mbikëqyrjes së kryer, inspektori i Inspektoratit shtetëror administrativ sjell vendim me të cilin e obligon Sekretarin gjeneral të Kuvendit të vendit, që në afat prej dhjetë ditësh ta pranojë ose ta refuzojë kërkesën dhe për masat e ndërmarra ta njoftojë inspektorin dhe njëkohësisht t’i dorëzojë edhe një kopje të aktit. Në qoftë se Sekretari gjeneral i Kuvendit të vendit nuk sjell vendim brenda afatit, inspektori do të bëjë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar me Ligjin për inspektimin administrativ dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditë pune, brenda të cilit Sekretari gjeneral i Kuvendit të vendit duhet të sjellë vendim për kërkesën e parashtruar, dhe për këtë, brenda këtij afati, do ta njoftojë inspektorin për aktin e sjellë dhe do t’i dorëzojë kopje të tij. Inspektori në afat prej tre ditësh do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra. Në qoftë se Sekretari gjeneral i Kuvendit të vendit nuk sjell vendim edhe në afatin plotësues, inspektori në afat prej tre ditë pune do ta denoncojë rastin te prokurori kompetent publik dhe brenda atij afati do ta informojë

parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarrë. Në qoftë se inspektori nuk ndërmerr asnjë veprim pas njoftimit të marrë, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditë pune ka të drejtë të dërgojë ankesë deri te arkivi i drejtorit të Inspektoratit shtetëror administrativ. Drejtori i Inspektoratit shtetëror administrativ është i obliguar që në afat prej tre ditë pune ta shqyrtojë ankesën dhe në qoftë se konstaton se inspektori nuk ka ndërmarrë asgjë pas njoftimit nga parashtruesi i kërkesës dhe/ose nuk e ka denoncuar rastin, drejtori i Inspektoratit shtetëror administrativ do të bëjë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje ndaj inspektorit, të përcaktuar me Ligjin për inspektim administrativ, dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditë pune. Në qoftë se inspektori nuk ndërmerr asgjë edhe në afatin plotësues, drejtori i Inspektoratit shtetëror administrativ do të ngrejë padi te prokurori kompetent publik kundër inspektorit dhe në afat prej tre ditë pune do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarrë. Në rast se inspektori nuk ndërmerr asgjë edhe në afatin plotësues, drejtori i Inspektoratit shtetëror administrativ menjëherë, e më së voni brenda një ditë pune, do të autorizojë inspektor tjetër të kryejë mbikëqyrje menjëherë. Në të dyja rastet, drejtori i Inspektoratit shtetëror administrativ në afat prej tre ditë pune do ta informojë parashtruesin e kërkesës. Në qoftë se drejtori i Inspektoratit shtetëror administrativ nuk ndërmerr asgjë, parashtruesi i kërkesës mund të ngrejë padi deri te prokurori kompetent publik, në afat prej tetë ditë pune. Në qoftë se Sekretari gjeneral i Kuvendit të vendit nuk sjell vendim në afatin e paraparë, parashtruesi i kërkesës mund të inicojë kontest administrativ para Gjykatës administrative dhe kjo procedurë është urgjente. Në qoftë se formulari për regjistrim në Regjistrin e lobistëve nuk i përmban të dhënat e parapara në formular, Sekretari gjeneral i Kuvendit të vendit do ta thërrasë kërkuesin, që në afat prej tre ditësh t'i eliminojë mungesat në formular, dhe nëse ai e bën këtë, do të regjistrohet në Regjistër dhe do t'i lëshohet legjitimacion, e nëse nuk e bën atë, Sekretari gjeneral i Kuvendit të vendit do të sjellë vendim me të cilin do ta refuzojë kërkesën e dorëzuar për regjistrim në Regjistër. Kundër këtij vendimi, kërkuesi ka të drejtë të inicojë kontest administrativ para gjykatës kompetente. Pas regjistrimit në Regjistër, lobistit i lëshohet legjitimacion. Nëse lobisti fshihet nga Regjistri, pa marrë parasysh shkakun e fshirjes, është i obliguar që në afat prej tre ditë pune, ta kthejë legjitimacionin. Regjistrimi i lobistit bëhet për afat prej një viti, me mundësi të vazhdimit të tij. Lobisti mund të kërkojë që para kalimit të këtij afati të regjistrimit të fshihet nga Regjistri.

Ky ligj përcakton kompetenca edhe për Ministrinë për Drejtësi. Kështu, ministri për drejtësi e përcakton: formën dhe përmbajtjen e formularit për regjistrim në Regjistër dhe mënyrën e mbajtjes së tij; formën dhe përmbajtjen e formularit për regjistrim, reregjistrim dhe fshirje nga Regjistri dhe formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit që i lëshohet lobistit, si dhe mënyrën e lëshimit të legjitimacionit.

Sa i përket të drejtave dhe obligimeve të lobistit, ato janë të përcaktuara në këtë mënyrë:

Lobisti ka të drejtë që nga organet te të cilët lobon, të marrë informata dhe dokumente që kanë të bëjnë me çështjen për të cilën lobon, në mënyrë, me procedurë dhe në masë të përcaktuara në përputhje me Ligjin për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik. Lobisti mund: të realizojë takime dhe mbledhje të drejtpërdrejta me funksionarët e organeve të pushtetit ligdhënës dhe atij ekzekutiv, si dhe me funksionarët e pushtetit lokal, në përputhje me rregullat për punë të këtyre organeve, dhe për këtë është i obliguar që funksionarit t'ia paraqesë të dhënat që janë të rëndësishme për lobimin, e veçanërisht për atë se për kë lobon dhe cili është qëllimi i lobimit, ndërsa të gjitha takimet e realizuara me funksionarët e pushtetit ligdhënës, ekzekutiv dhe lokal duhet t'i prezantojë në raportin për punën e tij.

Lobisti mund të kërkojë që qëndrimet dhe mendimet e tij për çështjen për të cilën lobon t'i prezantojë në organet e punës së pushtetit ligdhënës dhe ekzekutiv në nivel qendror, si dhe para organeve të punës së pushtetit lokal te të cilat lobon. Nga ana tjetër, edhe organet e punës së pushtetit ligdhënës dhe ekzekutiv në nivel qendror, si dhe organet e punës së pushtetit lokal,

munden me iniciativë të tyre ta ftojnë lobistin që ta paraqesë mendimin e tij në lidhje me çështjen për të cilën ai lobon.

Lobisti është i obliguar që funksionarin, që është përfaqësues i pushtetit ligjdhënës ose atij ekzekutiv në nivel qendror, si dhe funksionarin, që është përfaqësues i pushtetit lokal, t'i ofrojë të dhëna të sakta. Kërkesa e lobistit për takim me ndonjë funksionar të pushtetit ligjdhënës, ekzekutiv dhe atij lokal, mund të refuzohet duke dhënë arsyetim për këtë.

Lobisti mund të organizojë dhe të marrë pjesë në debate publike, që kanë të bëjnë me çështjen për të cilën ai lobon, dhe mund japë deklarata dhe të publikojë materiale për çështjen për të cilën lobon, në mjetet e informimit publik.

Gjatë lobimit, lobisti është i obliguar të sillet në përputhje me dispozitat që kanë të bëjnë me parandalimin e konfliktit të interesave dhe parandalimin e korrupsionit.

Lobisti i regjistruar është i obliguar që deri te Sekretari gjeneral i Kuvendit të vendit dhe deri te Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit të dorëzojë raport me shkrim për punë e tij më së voni deri më 31 janar të vitit aktual, për vitin paraprak dhe më së voni 30 ditë nga dita e fshirjes nga Regjistri, pa marrë parasysh shkaqet e fshirjes. Raporti i lobistit përmban: informatë/vërtetim se është i regjistruar si lobist në përputhje me këtë ligj, të dhëna për atë se për kë ka lobuar, për çka dhe kur ka lobuar, të dhënat për atë se te kush dhe nëpërmjet cilave aktivitete ka lobuar dhe të dhëna për mjetet financiare që i ka marrë për lobimin e kryer.

Sipas ligjit, mbikëqyrjen e lobimit e bën KSHPK-ja, e cila duke vepruar pas paraqitjes së rastit nga ndonjë funksionar, ku thuhet se lobisti sillet në kundërshtim me ligjin, së pari do të kërkojë nga lobisti, si dhe nga personi juridik te i cili është i punësuar lobisti, të japë përgjigje për pretendimet e theksuara. Lobisti dhe personi juridik te i cili është i punësuar lobisti, përgjigjen e japin në afat prej pesë ditë pune. Në qoftë se pas kontrollimit të pretendimeve konstatohet se ato janë të sakta, lobistit dhe personit juridik te i cili është i punësuar lobisti, KSHPK-ja mund t'u shqiptojë: vërejtje ose të ngrejë iniciativë deri te Sekretari gjeneral i Kuvendit të vendit për fshirjen e lobistit nga Regjistri (nëse lobistit i është shqiptuar masa e vërejtjes dy herë radhazi). Për personin juridik, KSHPK-ja do të fillojë iniciativë te Regjistri qendror për fshirjen e veprimtarisë lobim. Për masat e shqiptuara, KSHPK-ja e njofton me shkrim Sekretarin gjeneral të Kuvendit të vendit.

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetim - de facto:

Edhe pse Ligji për lobim është sjellë para pesë vitesh, vlerësimi është se ai aspak nuk zbatohet.

Shkaku kryesor për gjendjen e këtillë duhet të kërkohej në prezantimin e pamjaftueshëm dhe të vonuar të konceptit dhe të përfitimevenga ky ligj, si te publiku i gjerë ashtu edhe te ai i veçantë. Duke pasur parasysh se lobimi është risi në sistemin tonë juridik, nuk duhet mohuar rezistenca që zakonisht pritet ndaj ndryshimeve dhe mosbesimi ndaj futjes dhe implementimit të institucioneve të panjohura deri atëherë.

Pastaj, problem kyç për moszbatimin e ligjit paraqesin termet e paqarta dhe procedurat e ndërlikuara dhe të papërpunuara deri në fund, që janë të përfshira në Ligjin për lobim.

Në vend të parë, problematike janë definicionet e lobimit dhe të lobistit, që rezultojnë me faktin se deri më sot në vend ka të regjistruar vetëm një lobist.

Në fakt, definicioni për lobim është tepër i gjerë dhe jopreciz: lobimi përfshin çdo aktivitet që është i orientuar kah pushteti qendror dhe ai lokal në procesin e sjelljes së ligjeve dhe të dispozitave të tjera. Pastaj, përveç personit fizik, që është regjistruar për të kryer lobim, lobist mund të jetë edhe personi që është i punësuar te personi juridik që është regjistruar për të kryer lobim, me të cilin ka të nënshkruar marrëveshje për lobim. Prandaj, kur bëhet fjalë për person juridik, që gjithsesi duhet të jetë i regjistruar në Regjistrin qendror të vendit, është e tepërt nevoja për regjistrimin e tij në Kuvendin e vendit, si organ i pushtetit shtetëror (aq më tepër, në qoftë se bëhet fjalë për aktivitete lobuese të orientuara kah pushteti lokal).

Me heqjen e një pjese të dispozitave të nenit 7 paragrafi (2), si duket kushtet për fitimin e statusit të lobistit janë tepër të përgjithësuara dhe se mungon plotësimi i tyre sa i përket: moshës; angazhimit momental dhe paraprak të punës; kufizimeve që kanë të bëjnë me ushtrimin e profesionit ose të veprimtarisë etj.

Procedura për regjistrim, reregjistrim ose fshirje nga Regjistri i lobistëve është tepër e ndërlikuar dhe përfshin disa akte dhe organe të degëve të ndryshme të pushtetit, që nuk është në përputhje sistemin juridik të vendit, e as me standardet ndërkombëtare dhe përvojat e vendeve të tjera evropiane (Hungarisë, Polonisë dhe Lituanisë). Në fakt, në ligjin ekzistues nuk është bërë shpërndarja adekuate e roleve dhe e përgjegjësive të organeve shtetërore të përcaktuara në ligj – Kuvendit të vendit, Inspektoratit shtetëror administrativ (prej 1 janarit 2011, ai nuk është më organ në përbërje të Ministrisë për Drejtësi, por të Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratë) dhe Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit.

Sa i përket të drejtave dhe obligimeve të lobistit, edhe këtu ka paqartësi, veçanërisht në aspekt të të drejtës për mbrojtjen e lobistit dhe rregullimit të pabarabartë (kryesisht, janë rregulluar obligimet e lobistit).

Në fund, mbetet e hapur edhe çështja për rishqyrtimin e veprimeve hetuese kundër lobistëve, që do të punojnë kundër ligjit.

Nota:

Në masë shumë të vogël	1
Në masë të vogël	2
Në masë të caktuar	3
Në masë të madhe	4
Në masë shumë të madhe	5

Rekomandime

- Ministria për Drejtësi të vazhdojë me përgatitjen e Analizës së Ligjit për lobim, në përputhje me Metodologjinë për vlerësimin e zbatimit të rregullativës,¹³³
- Në bazë të konstatimeve nga ex-post Analiza, një grup pune i udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë të bëjë përgatitje për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lobim në përputhje me Metodologjinë për vlerësimin e ndikimit të rregullativës dhe Udhëzimin për mënyrën e veprimit në punën e ministrive gjatë procesit të zbatimit të vlerësimit të ndikimit të rregullativës;

133 http://www.mioa.gov.mk/files/pdf/Ex_post_Metodologjia.pdf

- Në ndryshimet dhe plotësimet e ligjit ose në Ligjin e ri për lobim duhet të bëhen përpjekje për tejkalimin e dobësive në tekstin aktual të ligjit, që kanë të bëjnë me këto çështje: definimin e qartë të termit lobist, por edhe të personave që nuk mund të jenë lobistë; dallimin e qartë ndërmjet aktiviteteve që konsiderohen si lobim dhe atyre që nuk konsiderohen si të tilla; caktimin e diapazonit të personave fizik dhe juridik të cilët (me kompensim ose pa të) do të kryenin aktivitete të lobimit; dallimin ndërmjet lobimit të organet e pushtetit qendror dhe lobimit të organet e pushtetit lokal, dhe në përputhje me këtë edhe përcaktimin e institucioneve të ndryshme që janë kompetente për lobimin; rishqyrtimin dhe thjeshtësimin e procedurës për regjistrimin dhe fshirjen nga Regjistri i lobistëve; rregullimin e detajuar të procedurës për kryerje të mbikëqyrjes efektive mbi punën e lobistëve, të harmonizuar me dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese;
- Pas miratimit të Ligjit, të silltet Kod etik për lobistë dhe
- Në drejtim të ngritjes së vetëdijes publike dhe perceptimit për lobimin, KSHPK-ja duhet të bëjë organizimin e ngjarjeve promovuese në temën e lobimit, ku në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë do të shpjegohet rëndësia e lobimit, por edhe dallimi ndërmjet lobimit dhe përfshirjes së palëve të interesuara në procedurën për miratimin e dispozitave.

Problemi/faktori i rrezikut 5:

Përqindja e lartë e sjelljes së ligjeve me procedurë të shkurtuar, gjegjësisht me procedurë urgjente, (edhe pse Rregullorja e Kuvendit parasheh disa faza në përgatitjen e ligjeve), me çka nuk mundësohet përfshirja e subjekteve relevante shoqërore dhe atyre të interesuara në procesin ligjor.

Arsyetimi:

Pamundësia për përfshirjen e të gjitha subjekteve të interesuara dhe atyre me relevancë shoqërore.

Institucioni: Kuvendi i vendit

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A mendoni se duhet të bëhen ndryshime në Rregulloren e Kuvendit të vendit që të zvogëlohet përqindja e sjelljes së ligjeve me procedurë të shkurtër, gjegjësisht urgjente?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Rregullorja e Kuvendit të vendit dhe Ligji për Kuvendin e vendit (miratimi i të cilave është vlerësuar si shembull i rrallë dhe pozitiv) paraqesin kornizë solide ligjore për procesin e sjelljes së ligjeve nga aspekti i kompetencave të organit më të lartë të pushtetit ligjdhënës.

Duke pasur parasysh se Qeveria e vendit e koordinon procesin e përfshirjes së palëve të interesuara, nuk ka nevojë për ndryshimin e Rregullores së Kuvendit të vendit, por duhet të ndërmerren masa dhe aktivitete adekuate nga ana e pushtetit ekzekutiv, të cilat, gjithsesi duhet të jenë në koordinim me pushtetin ligjdhënës.

Institucioni: Kuvendi i vendit

Kategoria: Kapaciteti – resurset

Pyetja-indikator: A ndërmerr Kuvendi i vendit masa dhe aktivitete për përfshirje më të madhe të palëve të interesuara në procedurën për sjelljen e ligjeve?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Në përputhje me Rregulloren aktuale të Kuvendit të vendit, në Kuvendin e vendit mbahen debate publike për propozim-ligjet, në të cilat, me ftesë të kryesuesit të organit punues, mund të marrin pjesë përfaqësuesit e palëve të interesuara.

Themelimi i Institutit parlamentar dhe ekipimi i tij adekuat, gjithashtu duhet të kontribuojë për përmirësimin e gjendjes.

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit

Kategoria: Udhëheqja – Mekanizmat për integritet

Pyetja-indikator: A mendoni se Kuvendi i vendit duhet të propozojë ndryshime në Rregulloren e Kuvendit të vendit që të zvogëlohet përqindja e sjelljes së ligjeve me procedurë të shkurtër, gjegjësisht urgjente?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Rregullorja e Kuvendit të vendit duhet të jetë më precize në lidhje me përdorimin e procedurës së shkurtuar, e cila më shpesh zbatohet me arsyetimin se bëhet fjalë për ligj “jo të ndërlikuar dhe jo të madh”. Përfshirja e subjekteve reprezentative të interesuara në punën e organeve kuvendore, nënkuptohet pa të drejtë vote, duhet të jetë rregull, e jo vetëm mundësi. Në këtë mënyrë do të ngritet niveli i kualitetit të ligjeve dhe zbatueshmëria e tyre.

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit

Kategoria: Udhëheqja – transparencja

Pyetja-indikator: A mendoni se me krijimin e obligimit për publikimin e propozim-ligjeve në Regjistrin e vetëm elektronik nacional të dispozitave (RVEN) të vendit do të përmirësohet gjendja dhe do të zvogëlohet përqindja e ligjeve që do të miratohen me procedurë të shkurtuar dhe urgjente?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Edhe përkundër përmirësimit, duhet të tentohet që edhe ligjet e miratuara me procedurë urgjente të publikohen në RVEN dhe në internet. Gjithashtu, publikimi i ndryshimeve të teksteve ligjore para miratimit të tyre duhet të azhurnohet për çdo ditë.

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit

Kategoria: Udhëheqja – transparencja

Pyetja-indikator: A është i mjaftueshëm afati prej minimum 10 ditësh për publikimin në RVEN të propozim-ligjeve të propozuara nga ministrinë, që të përfshihet publiku?

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Edhe pse kjo varet nga përmbajtja dhe madhësia e ligjit, duhet të rritet dyfish afati për organizimin dhe përfshirjen cilësore të subjekteve të interesuara, e gjithashtu edhe të publikut.

Arsyetim - de jure:

Procedura për sjelljen e ligjeve është e rregulluar në Kapitullin IX SJELLJA E LIGJEVE DHE AKTEVE TË TJERA të Rregullores së Kuvendit të vendit (“Gazeta zyrtare e vendit”, nr. 91/2008, 119/20110 dhe 23/2013), në Kapitullin IX SJELLJA E LIGJEVE DHE AKTEVE TË TJERA.

Procedura e shkurtuar për sjelljen e ligjeve është e rregulluar me nenet 170 dhe 171. Këtu janë theksuar rastet kur propozuesi i propozim-ligjit mund t’i propozojë Kuvendit të debatohet për propozimin-ligjin me procedurë të shkurtuar edhe atë atëherë kur: nuk bëhet fjalë për ligj të ndërlikuar dhe të madh; kur bëhet fjalë për ndërprerje të vlefshmërisë së ndonjë ligji ose të dispozitave të caktuara të ndonjë ligji ose kur nuk janë në pyetje harmonizime të ndërlikuara ose të mëdha të ligjit me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Nëse Kuvendi vendos të debatohet që propozim-ligji të silltet me procedurë të shkurtuar, kryetari i Kuvendit menjëherë e obligon organin amë të punës dhe Komisionin ligjdhënës-juridik të debatohet për propozim-ligjin për ta miratuar atë, ndërsa Kuvendi mban diskutim të përgjithshëm. Në situatën e këtillë, leximi i dytë dhe i tretë mbahen në mbledhjen e njëjtë. Leximi i dytë fillon me diskutim për propozim-ligjin në përputhje

me dispozitat e kësaj rregulloreje për lexim të dytë, ndërsa amandamente mund të parashtrohen në mbledhje, deri në fillim të leximit të tretë të propozim-ligjit.

Procedura urgjente për sjelljen e ligjeve është rregulluar me nenet 167, 168 dhe 169. Prandaj, me përjashtim, ligji mund të sillet edhe me procedurë urgjente, kur kjo është e nevojshme me qëllim të parandalimit dhe të eliminimit të çrregullimeve më të mëdha në ekonomi ose kur këtë e kërkojnë interesat e sigurisë dhe të mbrojtjes së Republikës ose në raste të fatkeqësive të mëdha natyrore, epidemive ose nevojave të tjera të jashtëzakonshme dhe urgjente. Që një ligj të sillet me procedurë urgjente, propozuesi është i obliguar ta arsyetojë propozimin. Propozimit për sjellje të ligjit me procedurë urgjente i bashkangjitet edhe propozim-ligji që propozohet të miratohet. Për arsyeshmërinë e propozimit që ligji të sillet me procedurë urgjente vendos Kuvendi pa diskutim. Nëse Kuvendi vendosë të diskutojë për propozimin që ligji të sillet me procedurë urgjente, e obligon organin amë të punës dhe Komisionin ligjdhënës-juridik të debatojnë për propozim-ligjin. Kur propozim-ligji shqyrtohet me procedurë urgjente, nuk mbahet diskutim i përgjithshëm. Leximi i dytë dhe i tretë mbahen në mbledhje urgjente, ashtu që leximi i dytë fillon me diskutim për propozim-ligjin në përputhje me dispozitat e Rregullores për leximin e dytë. Kur për propozim-ligjin diskutohet me procedurë urgjente nuk vlejnjë kufizimet kohore të përcaktuara me Rregulloren.

Në nenin 122 paragrafi (2) të Rregullores është përcaktuar se organi i punës së Kuvendit mund në mbledhje të ftojë punëtorë shkencorë, profesionalë dhe publikë, si dhe përfaqësues të komunnave, të qytetit të Shkupit, të ndërmarrjeve publike, sindikatave dhe të organizatave të tjera, të institucioneve dhe të shoqatave, me qëllim të prezantimit të mendimeve për çështjet që shqyrtohen në mbledhjen e organit.

Duke pasur parasysh se numri më i madh i ligjeve të miratura në Kuvendin e vendit bëhen me propozim të Qeverisë së vendit, jo më pak i rëndësishëm është edhe rregullimi i përfshirjes së palëve të interesuara në aktet që kanë të bëjnë me punën e organeve të administratës shtetërore dhe të Qeverisë së vendit.

Në fakt, korniza ligjore për këtë çështje, që ka të bëjë me pushtetin ekzekutiv, i përfshin këto dispozita: Ligjin për organizim dhe punë të organeve të administratës shtetërore ("Gazeta zyrtare e vendit" numër 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11); Rregullorja për punën e Qeverisë së vendit 8/01, 98/02, 9/03, 47/03, 64/03, 67/03, 51/06, 5/07, 15/07, 26/07,30/07, 58/07, 105/07, 116/07, 129/07, 157/07, 29/08, 51/08, 86/08, 114/08, 42/09, 62/09, 141/09,162/09, 40/10, 83/10, 166/10, 172/10, 95/11, 151/11, 170/11 dhe 67/13); Metodologjia për vlerësimin e ndikimit të rregullativës ("Gazeta zyrtare e vendit" numër 107/2013) dhe Udhëzimi për mënyrën e veprimit në punën e ministrive në procesin e zbatimit të vlerësimit të ndikimit të rregullativës ("Gazeta zyrtare e vendit " numër 106/2013).

Në nenin 10 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore është përcaktuar se organet e administratës shtetërore gjatë përgatitjes së ligjeve dhe dispozitave të tjera që janë në kompetencë të tyre, sigurojnë konsultime me qytetarët nëpërmjet: publikimit të llojit, përmbajtjes dhe afateve për sjelljen e ligjeve dhe të dispozitave të tjera; organizimit të tribunave publike dhe marrjes së mendimit nga shoqatat e interesuara të qytetarëve dhe subjektet e tjera juridike, etj.

Në nenin 68-a të Rregullores për punë të Qeverisë së vendit parashihet se propozimet për sjelljen e ligjeve, propozim-ligjeve, ministria përkatëse i publikon në ueb-faqen e saj dhe në Regjistrin e vetëm elektronik nacional (RVEN), ku mbeten të publikuara një vjet nga dita e hyrjes në fuqi të ligjit. Kur me propozim-ligjin ndryshohet së paku një e pesta e dispozitave të ligjit ekzistues, ministria përkatëse e publikon edhe tekstin e ligjit ku janë të integruara ndryshimet e propozuara.

Përfundim nga kjo rregull bëjnë pikërisht ligjet që sillen me procedurë urgjente, të cilat ministria përkatëse nuk i publikon në ueb-faqen e saj dhe në RVEN. Çdo palë e interesuar, në RVEN mund të japë mendim, vërejtje dhe propozime në lidhje me propozimet e publikuara për sjellje të ligjeve, propozim-ligjeve në afat prej 10 ditësh nga dita e publikimit.

Metodologjia për vlerësimin e ndikimit të rregullativës përmban një Kapitull të veçantë 4, që i kushtohet qëllimit dhe mënyrës së realizimit të konsultimeve me palët e interesuara. Në përputhje me Metodologjinë, konsultimet me palët e interesuara paraqesin mekanizëm për përmirësimin e kualitetit të rregullativës dhe avancimin e efikasitetit dhe efektivitetit në realizimin e masave të parapara dhe kontribuojnë për transparencë më të madhe në punën e qeverisë dhe në procesin e vendimmarrjes. Ministritë duhet të sigurojnë përfshirje të palëve të interesuara gjatë gjithë procesit të vlerësimit të ndikimit të rregullativës, e veçanërisht në: fazën e analizës së gjendjeve, definimit të problemit dhe përcaktimit të nevojës për miratimin e rregullativës; fazën e përcaktimit të zgjidhjeve (opcioneve) të mundshme dhe zbatimin e tyre në fazën e vlerësimit të ndikimeve të mundshme nga zgjidhjet (opcionet) e mundshme të propozuara. Metodologjia i pranon dy grupe të palëve të interesuara edhe atë: palë “të brendshme” të interesuara, ku bëjnë pjesë ministritë dhe organet e tjera të administratës shtetërore, organizatat administrative dhe organet e tjera shtetërore që mund të kenë kompetencë ose interes të ndarë në rregullativën e propozuar. Varësisht nga ajo se cili grup i palës së interesuar është përfshirë në konsultime dhe nga faza e vlerësimit të ndikimit të rregullativës, zbatohen mënyra të ndryshme të përfshirjes dhe të marrjes së mendimeve, sugjerimeve dhe propozimeve nga palët e interesuara.

Në udhëzimin për mënyrën e veprimit në punën e ministrive në procesin e realizimit të vlerësimit të ndikimit të rregullativës, në Kapitullin 4 trajtohet konsultimi me palët e interesuara. Varësisht nga përmbajtja e propozim-ligjit dhe ndikimet e mundshme (ekonomike, sociale dhe mbi mjedisin jetësor) nga ana e ministrive përcaktohen palët e interesuara që duhet të përfshihen ose të konsultohen në procesin e realizimit të vlerësimit të ndikimit të rregullativës dhe në përgatitjen e propozim-ligjit, dhe varësisht nga ndikimet e pritura të propozim-ligjit, përcaktohen një ose më tepër mënyra për përfshirjen dhe konsultimin me palët e interesuara. Në përputhje me Udhëzimin, konsultimet me palët e interesuara mund të bëhen në njërin nga këto mënyra: shikimi publik i propozim-ligjit, diskutimet publike; kërkimi i mendimeve me shkrim, vërejtjeve dhe sugjerimeve nga palët e interesuara; pjesëmarrja në grupet e formuara të punës nga ana e ministrisë ose Qeverisë së vendit; mbledhje me palët e interesuara; dhe debate publike për çështje të caktuara duke i shfrytëzuar veglat interaktive elektronike që gjenden në portalet RVEN dhe “E-demokratija”. Për procesin e realizuar të konsultimeve me palët e interesuara, në Raportin për vlerësimin e ndikimit, ministritë fusin: informata për mënyrën e përfshirjes së palëve të interesuara; të dhënat për palët e interesuara që kanë marrë pjesë në proces; qëndrimet që janë shprehur gjatë diskutimeve publike, gjegjësisht mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet që janë marrë në formë të shkruar ose që janë publikuar në RVEN dhe në portalin “E-demokratija”; mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet që kanë qenë të përfshira në propozim-ligj dhe mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet që nuk kanë qenë të pranuar nga ana e ministrisë dhe arsyetim për këtë.

Nota:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetim - de facto:

Në Raportin për punën e Kuvendit të vendit për vitin 2011¹³⁴ theksohet se nga gjithsej 130 ligje të miratuara, 46 janë miratuar me procedurë të shkurtuar. Në vitin 2012 gjendja është përmirësuar me atë që nga gjithsej 186 ligje, 43 janë miratuar me procedurë të shkurtuar.¹³⁵ Duke pasur parasysh se për mbi 97% të ligjeve që i miraton Kuvendi i vendit, në rolin e propozuesit paraqitet Qeveria e vendit, me rëndësi të veçantë janë masat që i ndërmerren ajo për tejkalimin e këtij problemi.

Njëra nga veglat për përfshirjen e palëve të interesuara në procesin e miratimit të ligjeve, duke dhënë komente dhe propozime drejtpërdrejt deri te ministritë (që i kanë përgatitur ligjet, në emër të Qeverisë së vendit si propozues i tyre) **është Regjistri i vetëm elektronik nacional i dispozitave** (www.ener.gov.mk) - që është sistem elektronik, i cili, përveç dispozitave aktuale, i përmban edhe propozim-ligjet e ministrive që janë në fazë të përgatitjes.

“Ky sistem është paramenduar si vegël që është e dedikuar për informimin elektronik të qytetarëve të vendit, organizatave joqeveritare, odave ekonomike, asociacioneve të biznesit dhe personave juridik, në lidhje me dispozitat ekzistuese, propozim-ligjet e ministrive që janë në fazën e përgatitjes dhe në lidhje me vlerësimin e realizuar të ndikimit të rregullativës që ka të bëjë me këto propozim-ligje. Mu për këtë arsye, në kuadër të procesit të vlerësimit të ndikimit të rregullativës, RVEN-ja shërben dhe ndihmon në realizimin e konsultimeve adekuate dhe të koordinuara në aspekt kohës me publikun, me çka arrihet transparencë edhe më e madhe e gjithë procesit, e njëkohësisht mundësohet edhe shfrytëzimi i teknologjive bashkëkohore të TIK-ut që i kemi në dispozicion.”¹³⁶

Edhe përkundër përpjekjeve të shumta, të cilat në vazhdimësi i bën Qeveria e vendit, si në aspekt të miratimit të legjislacionit relevant, ku theks i veçantë i është dhënë përfshirjes së palëve të interesuara, ashtu edhe në aspekt të vendosjes së kornizës përkatëse institucionale për përkrahjen e procesit të reformës rregullatore, ka hapësirë për përmirësimin e transparencës dhe pjesëmarrjes në procedurën për sjelljen e ligjeve në vend dhe për zvogëlimin e numrit të ligjeve që miratohen me procedurë të shkurtuar, gjegjësisht, urgjente.

Për tejkalimin e këtij problemi, përpjekjet dhe përgjegjësia janë të përbashkëta, si te organet e pushtetit ekzekutiv dhe atij ligjdhënës, ashtu edhe te përfaqësuesit e palëve të interesuara (personat fizik, sindikatet, odat, shoqatat e qytetarëve dhe personat e tjerë juridik).

Nota:

Në masë shumë të vogël	1
Në masë të vogël	2
Në masë të caktuar	3
Në masë të madhe	4
Në masë shumë të madhe	5

134 <http://www.sobranie.mk/WBStorage/Files/IZVESTAJ25062011311220110.pdf>

135 <http://www.sobranie.mk/WBStorage/Files/IZVESTAJ2012.pdf>

136 <http://kapital.mk/mk/magazin.aspx?iid=2969&pdf=1>.

Rekomandime

- Publikimi transparent dhe në kohë i Programit vjetor për punë të Qeverisë së vendit;
- Respektimi konsekuent i rregullave për konsultime dhe përfshirja e palëve të interesuara, si nga ana e organeve të pushtetit ekzekutiv, ashtu edhe nga ato të pushtetit ligdhënës, dhe vendosja e mekanizmave për ndjekjen e zbatimit të tyre;
- Promovimi i mundësive dhe i përfitimeve nga RVEN-ja, portali “E-demokratija” dhe përmirësimi i tyre i vazhdueshëm, ashtu që të jenë sa më të thjeshtë dhe sa më praktikë për shfrytëzim nga ana e palëve të interesuara;
- Sjellja e Kodit për pjesëmarrje të publikut në procesin e sjelljes së ligjeve nga ana e Kuvendit të vendit;
- Realizimi i aktiviteteve që kanë për qëllim rritjen e pjesëmarrjes së publikut nëpërmjet formave të ndryshme të pjesëmarrjes (dialogut, debateve, analizave etj.) për çdo propozim-ligj në të gjitha fazat (prej fillimit të përgatitjes, duke vazhduar me miratimin, e deri te ndjekja e implementimit) dhe dokumentimi i procesit të konsultimeve;
- Përfshirja e detyrueshme, në vend të përfshirjes opcionale të palëve të interesuara në punën e organeve kuvendore, sipas përmbajtjes së ligjit, nga njëra anë dhe ekspertizës dhe përfaqësimit të palëve të interesuara, nga ana tjetër;
- Krijimi i Regjistrit të subjekteve të interesuara, që do të sistematizohet sipas fushave të caktuara të jetës shoqërore, i cili vazhdimisht do të përditësohet;
- Përforcimi i kapaciteteve dhe i kompetencës së përfaqësuesve të palëve të interesuara (sindikatave, odave, shoqatave të qytetarëve etj.) që do të kontribuojë për mbajtjen e debateve konstruktive në vend të atyre kritikuese dhe propozimin e zgjidhjeve të qëndrueshme ligjore;
- Shfrytëzimi edhe i mundësive të tjera për pjesëmarrje, nëpërmjet bashkëpunimit dhe raporteve të partneritetit.

PASQYRA E INDEKSEVE

Kategoria	Nënkategoria	Indeksi			
		De jure	De facto	Mesatarja – Nënkategoria	Mesatarja – kategoria
Kapaciteti	Resurset	3,5	2,8	3,1	3,0
	Pavarësia	3,3	2,7	3,0	
Udhëheqja	Transparenca	4,0	3,3	3,6	3,4
	Mekanizmat për integritet	3,7	3,0	3,3	
Gjithsej		3,6	2,9	3,2	3,2

Nënkategoria	De jure		De facto		Gjithsej	
	Indeksi	Shkalla në të cilën është përmbushur standardi – <i>në aspekt juridik</i> -	Indeksi	Shkalla në të cilën është përmbushur standardi – <i>në praktikë</i> -	Indeksi	Shkalla në të cilën është përmbushur standardi
Resurset	3,5	70%	2,8	56%	3,1	62%
Pavarësia	3,3	66%	2,7	54%	3,0	60%
Transparenca	4,0	80%	3,3	66%	3,6	72%
Mekanizmat për integritet	3,7	74%	3,0	60%	3,3	66%
Gjithsej	3,6	72,5%	2,9	59%	3,2	65%

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- ✓ Kodi zgjedhor
- ✓ Ligji për financimin e partive politike
- ✓ Rregullorja për formularin, formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së raportit vjetor financiar për partitë politike
- ✓ Kodi penal
- ✓ Ligji për parandalimin e korrupsionit
- ✓ Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave
- ✓ Ligji për lobim
- ✓ Ligji për bankat
- ✓ Ligji për Drejtorinë për të hyra publike
- ✓ Rregullorja e Kuvendit të vendit
- ✓ Ligji për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore
- ✓ Rregullorja për punë e Qeverisë së vendit
- ✓ Metodologjia për vlerësimin e ndikimit të rregullativës
- ✓ Udhëzimi për mënyrën e veprimit të ministrive gjatë procesit të zbatimit të vlerësimit të ndikimit të rregullativës
- ✓ Mendimi i përbashkët nr.700/2012 i datës 17 qershor 2013, i Komisionit Evropian për demokraci nëpërmjet ligjit (Komisioni i Venedikut) dhe Zyrës për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut të OSBE-së (OSBE/ODIHR) për Kodin zgjedhor

- ✓ Mendimi i përbashkët nr.640/2011 i datës 17 tetor 2011 i Komisionit Evropian për demokraci nëpërmjet ligjit (Komisioni i Venedikut) dhe Zyrës për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut të OSBE-së (OSBE/ODIHR) për Kodin e ndryshuar zgjedhor
- ✓ Raporti për përparimin e vendit për vitin 2012
- ✓ Raporti i Komisionit deri te Parlamenti Evropian dhe Këshilli, për vendin: zbatimi i reformave në kuadër të dialogut për anëtarësim në nivel të lartë dhe nxitja e marrëdhënieve ndërfqinjësore
- ✓ Përfundime nga Dialogu për para-anëtarësim në nivel të lartë
- ✓ Raporti i Greko-s nga Rrethi i tretë i vlerësimit për vendin, i miratuar në Mbledhjen e 46-të plenare të Greko-s (22-26 mars 2010) dhe i publikuar më 30 gusht 2010
- ✓ Raporti vjetor për punën e ESHR-së për vitin 2011
- ✓ Vërejtjet e FISHHM për Ligjin për lobim

Shtojca 1. Lista e bashkëbiseduesve të hulumtimit

Z-nj. Mirjana Dimovska, anëtare e KSHPK-së

Z. Ilija Ristovski, sekretar shtetëror në Ministrinë për Drejtësi

Z-nj. Snezhana Mojsova, udhëheqëse e sektorit për bashkëpunim ndërkombëtar-juridik në Ministrinë për Drejtësi

Z-nj. Elena Dimovska, bashkëpunëtore e re për koordinim të aktiviteteve kundër korrupsionit në Ministrinë për Drejtësi

Z-nj. Biljana Tanovska, udhëheqëse e revizionit në ESHR

Z-nj. Desa Anastasova, ndihmës-inspektor kryesor i përgjithshëm për parandalimin e korrupsionit në DHP

Z. Darko Aleksov, asociacioni qytetar MOST

Z. Zlatko Dimitrioski, asociacioni qytetar MOST

Z. Marjan Maxhovski, shef i kabinetit të Kryetarit të Kuvendit të vendit

Z. Aleksandar Drakulevski, lobues

Z-nj. Sillvana Boneva, Koordinatore e grupit parlamentar të VMRO-DPMNE-së

Z-nj. Suzana Saliu, Nënkryetare e Kuvendit të vendit nga BDI-ja

Z-nj. Vlladanka Aviroviq, Kryetare e Komsionit për çështje ekonomike nga PSM-ja

Z. Igor Ivanovski, Koordinator i grupit parlamentar të LSDM-së

Shtojca 2. Lista e shkurtesave

KSHPK – Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit

KSHZ – Komisioni shtetëror i zgjedhjeve

MD – Ministria e Drejtësisë

ESHR – Entri shtetëror për revizion

DHP – Drejtoria për të hyra publike

MF – Ministria e Financave

**3. RAPORTI NGA ANALIZA KUALITATIVE TË MASAVE KUNDËR KORRUPSIONIT
DHE IMPLEMENTIMIT TË PROGRAMIT SHTETËRORË PËR PARANDALIM DHE
LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT DHE ZVOGËLIM TË KONFLIKTIT TË INTERESIT
2011-2015 NË SEKTORIN E VETËQEVERISJES LOKALE**

Përgatiti: Maksim Acevski,CFE

HYRJE

Misioni i OSBE-së në Shkup zbaton aktivitete disavjeçare për përkrahjen e implementimit të “Programit shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe për zvogëlimin e konfliktit të interesave për periudhën 2011–2015” (Programi shtetëror). Në vitin 2012, Misioni ndihmoi në zhvillimin e metodologjisë për vlerësimin kualitativ të aktiviteteve dhe të indikatorëve nga Programi shtetëror, me pilot analizë kualitative për sektorin e arsimit dhe të sportit, me vlerësimin e perceptimit të publikut për tre sektorë nga Programi shtetëror, si dhe me përforsimin e kapaciteteve të Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit (KSHPK) për zhvillimin e konceptit të integritetit dhe evidentimit elektronik të të dhënave.

Në vitin 2013, Misioni i OSBE-së e vazhdoi bashkëpunimin me KSHPK-në duke dhënë përkrahje për përgatitjen e analizës kualitative dhe zbatimin e hulumtimit të mendimit publik për tre sektorë të rinj nga Programi shtetëror – sektori privat, sektori politik dhe vetëqeverisja lokale. Në këtë dokument gjendet analiza që ka të bëjë me vetëqeverisjen lokale. Ajo i trajton problemet e identifikuara në Programin shtetëror, me ç’rast nëpërmjet një sërë indikatorësh i vlerëson masat antikorruptive dhe zbatimin e Programit shtetëror, i konstaton anët e fuqishme dhe të dobëta të asaj që është bërë deri tani dhe jep rekomandime për avancimin e luftës kundër korrupsionit në vetëqeverisjen lokale. Qëllimi kryesor i kësaj analize është ta ndihmojë KSHPK-në për ta ndjekur zbatimin e Programit shtetëror, për t’i përmirësuar indikatorët dhe për të propozuar aktivitete të reja/të ndryshuara.

METODOLOGJIA

Metodologjia e analizës është e bazuar në konceptin e Sistemit nacional për integritet të “Transparency International”. Problemet që janë shqyrtuar janë marrë nga Programi shtetëror. Nën çdo problem janë përcaktuar indikatorë për gjendjen dhe përparimin, si dhe janë dhënë rekomandime për përmirësimin e rezultateve.

Si burime të të dhënave u shfrytëzuan:

- Analiza juridike – analiza e ligjeve relevante, akteve nënligjore dhe dokumente dhe raporte të tjera zyrtare.
- Intervista me burime kyçe të informatave, edhe atë me Ministrinë për Financa, Ministrinë për Transport dhe Lidhje, njësitë e vetëqeverisjes lokale: Aerodrom; Gjevgjeli; Kumanovë; Strugë; Sveti Nikollë; Strumicë; Veles dhe në qytetin e Shkupit

Në bazë të të dhënave të mbledhura, hulumtuesi përgatiti propozim-vlerësime për secilin indikator, edhe atë nga dy aspekte – de jure, sa i përket kornizës ligjore, dhe de facto, gjegjësisht gjendjes në praktikë. Gjatë vlerësimit të indikatorëve, për kornizën ligjore është përdorur shkalla në tre nivele prej 1 deri në 5, me ç’rast: 1 = jo, 3 = pjesërisht, 5 = po. Për vlerësimin e gjendjes në praktikë është përdorur shkalla në pesë nivele prej 1 deri në 5, me ç’rast: 1 = në masë shumë të vogël, 2 = në masë të vogël, 3 = në masë të caktuar, 4 = në masë të madhe, 5 = në masë shumë të madhe.

Pastaj, notat e veçanta janë mbledhur, dhe janë paraqitur si mesatare e notës së përgjithshme për çdo nënkategori dhe kategori. Për të dhënë një pasqyrë më të qartë, në fund të këtij dokumenti notat janë paraqitur në formë të shumës dhe janë shprehur edhe si përqindje e notës maksimale të mundshme.

Rezultatet u prezantuan para faktorëve relevantë dhe u verifikuan prej tyre, të cilët diskutuan për konstatimet dhe për vlerësimet në lidhje me pyetjet e indikatorëve, me qëllim që të verifikohen, të konfirmohen ose të plotësohen të dhënat dhe rezultatet. Pas këtij verifikimi, u bë edhe finalizimi i analizës.

PËRMBLEDHJE

Analiza kualitative që u realizua në kuadër të këtij projekti kishte për qëllim t'i vlerësojë faktorët kryesorë të rrezikut/problemet që janë identifikuar nga Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit (KSHPK) në **vetëqeverisjen lokale**. Problemet kryesore që janë theksuar nga KSHPK-ja u shqyrtuan nga aspekti i legjislacionit dhe implementimit praktik, me qëllim që të potencohen dobësitë kryesore në këtë sektor në vend nga aspekti i mbikëqyrjes dhe kontrollit, transparencës, integritetit, llogaridhënies, resurseve dhe kapacitetit.

Qëllimi i hulumtimit është të kontribuojë në përpjekjet e përgjithshme në luftën kundër korrupsionit në vetëqeverisjen lokale, duke i theksuar mangësitë kryesore dhe duke propozuar rekomandime përkatëse për përmirësim të gjendjes. Është me rëndësi të theksohet se problemet/faktorët e rrezikut që janë identifikuar nga ana e KSHPK-së nëpërmjet Programit shtetëror, në mënyrë të saktë i paraqesin fushat më të vështira ku nevojitet veprim i mëtutjeshëm. Me këtë rast, me rëndësi është të pranohet fakti se Komisioni shtetëror luan rol kyç në luftën kundër korrupsionit, si institucion që në mënyrë shumë korrekte i konstaton mangësitë dhe fushat e rrezikshme ku nevojitet angazhim i mëtutjeshëm.

Në lidhje me Problemin 1 – Procedura të ndërlikuara dhe të paqarta dhe probleme serioze në zbatimin e tyre në fushën e urbanizmit – ekziston rregullativë adekuate ligjore, por do të ishte mirë të ndërmerren aktivitete të caktuara në pjesën e rishqyrtimit të zgjidhjes aktuale ligjore në pjesën e miratimit të dokumentacionit të planeve lokale urbanistike për ndërtime me qëllim të caktuar – industri e lehtë dhe që nuk e ndot ambientin.

Megjithatë, implementimi praktik tregon se ka disa dobësi, gjë që e potencon nevojën për miratimin e politikave dhe ndërmarrjen e aktiviteteve për të siguruar pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në shqyrtimin e dokumenteve të planeve; lehtësimin e mënyrës së zbatimit të procedurës për marrjen e lejes për ndërtim (nëpërmjet sistemit “e-leje për ndërtim”); punësimin e numrit të nevojshëm të burimeve njerëzore dhe sigurimin e mbikëqyrjes së vazhdueshme mbi ndërtimet që janë në kompetencë të NJVL-ve.

Në lidhje me Problemin 2 – Devijime në menaxhimin me financat dhe pronën e vetëqeverisjes lokale, edhe përkundër ekzistimit ligjeve dhe të akteve nënligjore që e rregullojnë fushën e përmendur, në praktikë ka dukuri devijuese, për të cilat, në periudhën e ardhshme duhet të ndërmerren aktivitete korigjuese e njëkohësisht të iniciohen edhe ndryshime dhe plotësime në Ligjin për buxhetet dhe në Ligjin për financimin e NJVL-ve në pjesën e përcaktimit të kriterëve për planifikim real të buxheteve të NJVL-ve. Në fakt, duhet të sigurohet: kontroll më i madh dhe ndjekje e planit dhe programeve për zhvillimin e NJVL-ve; planifikim real dhe objektiv i buxhetit të NJVL-ve; aplikacion i licencuar softuerik për përgatitjen e buxheteve të NJVL-ve; numër i shtuar i të punësuarve në njësitë për revizion të brendshëm; publikim adekuat i Planit për furnizime publike në ueb-faqet e NJVL-ve dhe miratimi i Programit përkatës vjetor për edukim të të punësuarve të NJVL-ve.

Por, njëkohësisht, Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit në periudhën e ardhshme duhet të ndërmarrë masa me të cilat **do të ndiqet numri i llogarive të bllokuara të NJVL-ve dhe do të bëhet zbatimi konsekuent i dispozitave për financimin e NJVL-ve, si dhe do të bëhet shpallja në kohë e jo-stabilitetit financiar të komunës.**

Në lidhje me Problemin 3 – Mungesa e garancive për zbatimin e rreptë të procedurave për punë. Dispozitat aktuale ligjore nuk ofrojnë siguri të mjaftueshme se në të gjitha NJVL-të janë formuar NJRB (njësi për revizion të brendshëm), gjë që e thekson nevojën për rishqyrtimin e dispozitave ligjore në pjesën e kritereve të përcaktuara për formimin e NJRB-ve në NJVL-të. Implementimi praktik i dispozitave të LKBPF-së në pjesën e revizionit të brendshëm është i shoqëruar me një numër të madh të mangësive të cilat në periudhën e ardhshme duhet të tejkalohen. Në fakt, numri i revizorëve të brendshëm në NJVL nuk është i kënaqshëm; duhet të vazhdohet me aktivitetet për të siguruar edukim adekuat dhe certifikim të revizorëve të brendshëm.

Në lidhje me Problemin 4 – Mungesa e vlerësimit të rrezikut nga paraqitja e korrupsionit në komuna. Zgjidhja aktuale ligjore, edhe përkundër asaj se ka të përcaktuar obligim që subjektet nga sektori publik, duke i përfshirë edhe NJVL-të, të përgatisin dhe të miratojnë strategji për menaxhim me rreziqet, në pjesën më të madhe ky obligim nuk respektohet, ndërsa për këtë mos-respektim nuk janë përcaktuar sanksione përkatëse. Kjo gjendje çon në konstatimin se ka nevojë të ndërmerren masa përkatëse për ndryshimin dhe plotësimin e LKBPF-së. Praktimi i LKBPF-së në pjesën e menaxhimit me rreziqet çon në konstatimin se: nuk është siguruar veprim adekuat dhe miratim i strategjive për menaxhim me rreziqet dhe nuk është vendosur sistem përkatës i menaxhimit dhe kontrollit financiar, që do të jetë në funksion të ndjekjes dhe të përditësimit të vazhdueshëm të kontroleve që kanë të bëjnë me minimizimin e rreziqeve.

Për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara në fushën e Njësive të vetëqeverisjes lokale, në analizë janë dhënë një numër i madh rekomandimesh që janë në funksion të tejkalimit të dobësive të konstatuara.

REZULTATE NA ANALIZA KUALITATIVE

Problemi/faktori i rrezikut 1:

Procedura të ndërlikuara dhe të paqarta dhe probleme serioze në zbatimin e tyre në fushën e urbanizmit

Arsyetimi:

Disa nga procedurat më të shpeshta që i zbaton vetëqeverisja lokale janë ato nga fusha e urbanizmit, të cilat, për shkak të rëndësisë për qytetarët dhe mënyrën e zbatimit, kanë potencial serioz për korrupsion. Përveç kësaj, këto procedura nuk janë të thjeshta për një qytetar të arsimuar mesatarisht, që le hapësirë të mjaftueshme për t'i detyruar ata të paguajnë mitë ose të ofrojnë shërbime të tjera në këmbim të zbatimit arbitrar të procedurës, apo për interpretim fleksibël dhe për manipulim të dispozitave nga ana e administratës.

Institucioni: NJVL-të e anketuara: Aerodromi; Gjevgjelia; Kumanova; Struga; Sveti Nikollë; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit, si dhe Ministria për Transport dhe Lidhje

Kategoria: Transparenca

Pyetja - indikator: A mendoni se zgjidhja aktuale ligjore në pjesën e përgatitjes, miratimit dhe plotësimit të planeve urbanistike është adekuate dhe siguron transparencë dhe pjesëmarrje në procedurë?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Përgatitja, miratimi dhe plotësimi i planeve detale urbanistike është rregulluar me dispozitat e Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik. Me dispozitat e nenit 11 të ligjit të lartë-përmendur rregullohet përmbajtja e planit detal urbanistik, ndërsa procedura për përgatitjen dhe miratimin e planeve është rregulluar me pikën 2 të ligjit të përmendur. Me dispozitat e nenit 17, paragrafi 6, të ligjit të lartë përmendur, është rregulluar obligimi i komunave që të sigurojnë që procesi i planifikimit hapësinor dhe urbanistik të jetë profesional dhe i hapur. Për këtë qëllim, këshilli i komunës përkatëse dhe Këshilli i qytetit të Shkupit formon organ pjesëmarrës, i cili i përcjell qëndrimet, mendimet dhe nevojat e qytetarëve dhe të personave juridikë, i ndjek gjendjet e planifikimit duke dhënë iniciativa, udhëzime dhe sugjerime për përgatitjen e zgjidhjeve në formë të planeve për komunën përkatëse dhe qytetin e Shkupit. Organi pjesëmarrës përbëhet nga: përfaqësues të këshillit, person profesional nga administrata komunale, persona të dalluar profesionalë nga fusha e planifikimit urbanistik, përfaqësues nga shoqatat e qytetarëve dhe qytetarë nga territori i komunës. Numri i përfaqësuesve caktohet me statutin e komunës dhe Statutin e qytetit të Shkupit dhe nuk mund të jetë më i madh se dhjetë anëtarë.

Nga ana tjetër, me dispozitat e nenit 24 të ligjit të lartë-përmendur është rregulluar procedura për realizimin e prezantimit publik dhe anketës publike për planin detal urbanistik. Në fakt, organizimin e prezantimit publik dhe të anketës publike për planet, e bën kryetari i komunës, pas miratimit të propozim-planit nga ana e këshillit të komunës. Gjithashtu, me dispozitat e përmendura është rregulluar edhe mënyra e njoftimit dhe korniza kohore për anketën publike.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Procedura për miratimin e planeve urbanistike sipas Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik parasheh anketë publike dhe prezantim publik të planeve që janë përgatitur si zgjidhje. Anketa publike zgjat më së paku dhjetë ditë pune, afat ky gjatë të cilit, subjektet nga neni 29 i ligjit të lartë-përmendur, si dhe të gjithë personat fizikë dhe juridikë, mund të japin vërejtje dhe propozime për planin e propozuar, në fleta anketuese. Prezantimi publik dhe anketa publike realizohet duke e vendosur planin në vend publik që gjendet në afërsi të vetëqeverisjes vendore. Koha dhe vendi ku do të ekspozohet plani dhe realizimi i prezantimit publik dhe i anketës publike, detyrimisht publikohet në një njoftim, në së paku dy mjete të informimit publik, ndërsa njoftimi detyrimisht i përmban të dhënat, vendin dhe sipërfaqen e përfshirjes së planit.

Sipas përgjigjeve të fituara nga njësitë e anketuara të vetëqeverisjes lokale, nuk janë konstatuar lëshime më serioze në pjesën e miratimit të planeve urbanistike.

Rregullativa e përmendur ligjore shpeshherë i nënshtrohet ndryshimit dhe plotësimit, e me këtë paraqitet nevoja për përgatitjen e tekstit të përmirësuar të ligjit të përmendur.

Rekomandime

Komisioni ligjdhënës-juridik në kuadër të Kuvendit të vendit t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme për miratimin e tekstit të përmirësuar të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik.

Institucioni: NJVL-të e anketuara: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikollë; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit, si dhe Ministria për Transport dhe Lidhje

Kategoria: Transparenca

Pyetja - indikator: A janë paraparë në kuadër të komunës politika për promovimin e transparencës dhe për sigurimin e pjesëmarrjes në procedurën për miratimin/plotësimin e planeve detale urbanistike?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Me dispozitat e nenit 24 paragrafi 4 të ligjit të lartë-përmendur është rregulluar se për organizimin e prezantimit publik dhe anketës publike, komuna është e obliguar t'i njoftojë me shkrim subjektet kompetente. Anketa publike zgjat më së paku dhjetë ditë pune, afat ky gjatë të cilit, subjektet kompetente, si dhe të gjithë personat e interesuar fizikë dhe juridikë, mund të japin vërejtje dhe propozime për planin e propozuar, në fleta anketuese.

Me paragrafin 11 të ligjit të lartë-përmendur është paraparë obligimi për publikimin e kohës dhe vendit ku do të mbahet prezantimi publik dhe anketa publike, në së paku dy mjete të informimit publik, gjegjësisht "koha dhe vendi ku do të ekspozohet plani dhe realizimi i prezantimit publik dhe anketës publike, detyrimisht publikohet me njoftim në së paku dy mjete të informimit publik. Njoftimi, detyrimisht i përmban të dhënat, vendin dhe sipërfaqen e përfshirjes së planit."

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Edhe përkundër asaj se ka dispozita të përcaktuara në mënyrë të qartë për mënyrën e veprimit NJVL-ve në pjesën e prezantimit publik dhe anketës publike për miratimin e planeve detale urbanistike dhe se ekzistojnë udhëzime të caktuara nga ana e komunave sa i përket lehtësimit të mënyrës së njohjes së të drejtave të palëve të interesuara, ndjehet nevoja për miratimin e politikave dhe të udhëzimeve nga ana e atyre komunave që nuk kanë politika dhe udhëzime të kësaj natyre.

Rekomandime

Komunat t'i ndërmarrin veprimet e nevojshme për miratimin dhe praktikimin e politikave dhe të udhëzimeve me të cilat do të lehtësohet njohja e të drejtave të palëve të interesuara në pjesën e shqyrtimit të planeve të propozuar dhe do të nxisin pjesëmarrje më të madhe në debatet dhe anketat publike.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikollë; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit, si dhe Ministria për Transport dhe Lidhje

Kategoria: Transparenca/Ilogaridhënia

Pyetja - indikator: Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik a bëhet saktësimi i mundësive për shfrytëzimin e dokumentacionit të planeve urbanistike lokale dhe kufizimi i prezantimit publik dhe anketës publik për të?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Dokumentacioni i planeve urbanistike lokale është dokumentacion planifikues me të cilin mund të bëhet rregullimi dhe shfrytëzimi i hapësirës duke përcaktuar parcelë për ndërtim, jashtë përfshirjes së planit të ndërtimeve të përcaktuara me ligj si ndërtime të kategorisë së dytë. Me dispozitat e nenit 50-a të ligjit të lartë-përmendur është rregulluar se me dokumentacionin e planeve urbanistike lokale mund të bëhet rregullimi i hapësirës duke përcaktuar një parcelë për ndërtim jashtë përfshirjes së planit për ndërtime të kategorisë së dytë të përcaktuara me Ligjin për ndërtim. Me nenin e njëjtë, në paragrafët 6 dhe 7 të ligjit të lartë-përmendur është rregulluar procedura për mbajtjen e anketës publike dhe prezantimit publik, gjegjësisht rregullohen kushtet se kur nuk realizohet anketë publike dhe prezantim publik, edhe atë “në qoftë se komuna ka nevojë për përgatitjen e dokumentacionit të planeve urbanistike lokale, për përgatitjen e këtij dokumentacioni të planeve urbanistike lokale vendim sjell këshilli i komunës. Personat e interesuar fizikë dhe juridikë mund të dorëzojnë në komunë dokumentacion të planeve urbanistike lokale. Komuna realizon prezantim publik dhe anketë publike në mënyrë dhe me procedurë që është në përputhje me dispozitat e nenit 24 të këtij ligji, me ç’rast anketa publike duhet të zgjasë së paku pesë ditë pune. Me përjashtim, prezantim publik dhe anketë publike nuk organizohen, në qoftë se me dokumentacionin e planit urbanistik lokal parashihen ndërtime me qëllim të caktuar – industri e lehtë dhe që nuk e ndot ambientin”. Duke mos i kontestuar aktivitetet që janë ndërmarrë në këtë drejtim, të cilat para së gjithash kanë motive ekonomike, shpeshherë në miratimin e dokumentacionit të planit urbanistik lokal, ku parashihet ndërtimi i ndërtimeve me qëllim të caktuar – industri e lehtë dhe që nuk e ndot ambientin, pa anketë publike dhe prezantim publik, mund të krijohen sjellje korruptive.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Dokumentacioni lokal urbanistik është dokumentacion planifikues me të cilin mund të bëhet rregullimi dhe shfrytëzimi i hapësirës duke përcaktuar parcelë ndërtimore, përfshirje jashtë planit, për ndërtime të përcaktuara me ligj si ndërtime të kategorisë së dytë, me çka në mënyrë precize është definuar mundësia për shfrytëzimin e tij në procesin e planifikimit urbanistik.

Dispozitat e ligjit të lartë-përmendur qartë bëjnë me dije se cilat janë gjendjet kur bëhet kufizimi i transparencës gjatë procedurës së miratimit të dokumentacionit planifikues urbanistik lokal, edhe atë në rastet kur bëhet fjalë vetëm për ndërtime me qëllim të caktuar – industri e lehtë dhe që nuk e ndot ambientin. Një pjesë e NJVL-ve të anketuara e theksojnë nevojën për përfshirje më të madhe të NJVL-ve në procesin e ndryshimit dhe të plotësimit të rregullativës ligjore.

Rekomandime

Edhe përkundër definimit të qartë të kushteve kur bëhet kufizimi i prezantimit publik dhe i anketës publike për miratimin e dokumentacionit planifikues urbanistik lokal për ndërtime me qëllim të caktuar – industri e lehtë dhe që nuk e ndot ambientin, duhet të bëhet rishqyrtimi i zgjidhjes aktuale ligjore dhe të sigurohet që kjo procedurë të jetë e hapur dhe transparente.

Duhet të sigurohet transparencë dhe pjesëmarrje më e madhe e të gjitha palëve të interesuara në procedurën për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve nga kjo fushë.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikollë; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit, si dhe Ministria për Transport dhe Lidhje

Kategoria: Transparenca

Pyetja - indikator: A sigurojnë ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për ndërtim, mënyrë të lehtë dhe të shpejtë për marrjen e lejes për ndërtim, në aspekt të futjes së obligimit për dorëzimin e kërkesave në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ “e-leje për ndërtim”?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Procedura për dhënien e lejes për ndërtim është e rregulluar me dispozitat e Ligjit për ndërtim dhe me Rregulloren për mënyrën e realizimit të procedurës për marrjen e lejes për ndërtim në mënyrë elektronike. Në fakt, në përputhje me dispozitat e nenit 59 të ligjit të lartë-përmendur është rregulluar se procedura për dhënien e lejes për ndërtim zhvillohet në përputhje me

dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, në qoftë se me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe. Në mënyrë analoge, me nenin e përmendur përcaktohet se për marrjen e lejes për ndërtim duhet të bëhet kërkesë në formë elektronike deri te organi kompetent. Në dispozitat e rregullores së lartë-përmendur, në mënyrë të detajuar është trajtuar procedura për marrjen e lejes së lartë-përmendur.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Me futjen në përdorim të sistemit informativ “e-leje për ndërtim”, e gjithë procedura për dhënien e lejes për ndërtim kryhet në formë elektronike. Në fakt, investitori gjithë dokumentacionin e dorëzon në formë elektronike, me ç’rast komunikimi ndërmjet organeve kompetente, investitorëve dhe subjekteve të tjera që janë të përfshirë në këtë procedurë për dhënien e mendimit për dokumentacionin e projektit bëhet në mënyrë elektronike në sistem. Të gjitha aktet administrative, duke përfshirë edhe lejen për ndërtim, jepen në formë elektronike. Sipas të dhënave dhe informatave që i thekson ministria përkatëse, afati për dhënien e lejes për ndërtim ka trend të rënies.

Duke mos i kontestuar aktivitetet dhe përparimin që është arritur me futjen në përdorim të këtij sistemi, si dhe duke e pasur parasysh edhe gjendjen se vendi është vendi i parë në mesin e vendeve të rajonit që e ka futur në përdorim këtë sistem, megjithatë NJVL-të e anketuara përmendin gjendje të caktuara në drejtim të përmirësimit të funksionalitetit të tij dhe njohjes së shfrytëzuesve të tij, si dhe përfshirjes së administratës komunale në ndryshimin dhe plotësimin e akteve ligjore dhe nënligjore në këtë fushë.

Gjithashtu, vlen të përmendet edhe gjendja që ndërlidhet me atë se disa palë të interesuara nuk kanë certifikatë me nënshkrim digjital që e kufizon mundësinë për shfrytëzim të sistemit nga ana e tyre.

Promovimi i nënshkrimit elektronik (certifikata për nënshkrim digjital), mundësia për qasje të papenguar në internet dhe praktikimi i papenguar nga të gjitha palët e interesuara do të sigurojë shfrytëzim të papenguar të zgjidhjes së lartë-përmendur softuerike dhe dorëzim të kërkesës për marrje të lejes për ndërtim nëpërmjet sistemit informativ “e-leje për ndërtim”.

Rekomandime

Organet kompetente të bëjnë anketim të palëve të involvuara, t’i detektojnë gjendjet për të cilat duhet të ndërmerren veprime korigjuese dhe të bëhet avancimi i vazhdueshëm i tij.

Organet kompetente ta rishqyrtojnë gjendjen në pjesën e praktikimit të sistemit duke përdorur në mënyrë të detyrueshme certifikatën për nënshkrim digjital/elektronik.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit, si dhe Ministria për Transport dhe Lidhje

Kategoria: Kapaciteti

Pyetja - indikator: A kanë ndërmarrë shërbimet kompetente të komunës, aktivitete për përgatitjen e materialeve plotësuese edukative për mënyrën e praktikimit të sistemit informativ “e-leje për ndërtim”?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Me dispozitat e Rregullores për mënyrën e realizimit të procedurës për marrjen e lejes për ndërtim në mënyrë elektronike është sqaruar mënyra e shfrytëzimit të sistemit të lartë-përmendur.

Edhe përkundër asaj se në ueb-faqen e Ministrisë për Transport dhe Lidhje të vendit dhe në ueb-faqen e Bashkësisë së njësive të vetëqeverisjes lokale janë publikuar materiale përkatëse edukative për mënyrën e praktikimit të zgjidhjes së përmendur softuerike, edhe më tej ka nevojë të ndërmerren masa plotësuese për t’ua bërë atë më të afërt shfrytëzuesve të fundit.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në ueb-faqen e Ministrisë për Transport dhe Lidhje dhe në ueb-faqen e Bashkësisë së njësive të vetëqeverisjes lokale janë vendosur udhëzime konkrete për mënyrën e shfrytëzimit dhe të praktikimit të sistemit të përmendur nga ana e palëve të interesuara.

Por, edhe përkundër gjendjes së përmendur, përgjigjet e fituara nga NJVL-të e anketuara e potencojnë faktin se ato nuk disponojnë me udhëzime konkrete me shkrim për mënyrën e shfrytëzimit të sistemit të përmendur, por i gjithë udhëzimi bëhet në mënyrë gojore.

Rekomandime

Në bashkëpunim me organet kompetente dhe BNJVL-në, NJVL-të të bëjnë shtypjen e materialeve edukative me të cilat do të lehtësohet mënyra e praktikimit të sistemit të përmendur

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit, si dhe Ministria për Transport dhe Lidhje

Kategoria: Mbikëqyrja/kontrolli

Pyetja - indikator: A ka paraparë komuna, politika dhe procedura për kontroll të vazhdueshëm dhe në kohë, në vendin e ndërtimit, për çdo leje të dhënë për ndërtim dhe për përgatitje të procesverbalit për kontrollin e realizuar?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Mbikëqyrja inspektuese për ndërtimet e kategorisë së dytë është rregulluar me dispozitat e Ligjit për ndërtim. Gjegjesisht, kompetencat për veprimin e inspektorëve komunalë për ndërtim janë përfshirë në pikat prej 1 deri në 7 të kreut **X. MBIKËQYRJA**, të ligjit të lartë-përmendur.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Gjatë realizimit të mbikëqyrjes inspektuese, sipas dispozitave të nenit 146 të Ligjit për ndërtim, inspektori për ndërtim është i obliguar të kontrollojë se aktet administrative që janë miratuar në bazë të këtij ligji a janë në përputhje me të dhe në qoftë se konstaton se aktet administrative janë dhënë në kundërshtim me këtë ligj, është i obliguar të bëjë propozim me shkrim për anulimin e atyre akteve administrative, me procesverbal për gjendjen e konstatuar.

Të dhënat që janë fituar nga NJVL-të e anketuara dhe nga ministria përkatëse, flasin se në pjesën më të madhe, inspektori për ndërtim, kontrollin për lejen që është dhënë e bën me vetë-iniciativë ose pas denoncimit, pa ekzistuar gjatë kësaj procedura dhe politika të caktuara për kontroll të vazhdueshëm në vendin e ndërtimit për çdo leje të dhënë për ndërtim dhe për përgatitje të procesverbalit për kontrollin e realizuar.

Gjithashtu, është konstatuar mungesë e burimeve njerëzore te një pjesë e NJVL-ve të anketuara.

Rekomandime

Të ndërmerren masa dhe aktivitete për punësimin e numrit të nevojshëm të burimeve njerëzore te NJVL-të.

Të ndërmerren masa dhe aktivitete për përgatitjen e politikave dhe të procedurave të cilat do të sigurojnë kontroll të vazhdueshëm në vendin e ndërtimit për çdo leje të dhënë për ndërtim dhe përgatitje të procesverbalit për kontrollin e realizuar.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit, si dhe Ministria për Transport dhe Lidhje

Kategoria: Mbikëqyrja/kontrolli

Pyetja - indikator: A ka paraparë komuna, politika dhe procedura për ta shqyrtuar çdo denoncim të bërë, për të bërë kontroll në vendin e ndërtimit për çdo denoncim, për të përgatitur procesverbal për kontrollin e realizuar dhe për ta njoftuar denoncuesin?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Veprimi i inspektorit për ndërtim për denoncimet e bëra nga ana e palëve të interesuara është rregulluar me dispozitat e Ligjit për ndërtim dhe Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

NJVL-të e anketuara theksojnë se shqyrtimi i denoncimeve të bëra bëhet me tempo të ngadalësuar, ndërsa si shkaqe kryesore për këtë gjendje përmenden burimet e kufizuara njerëzore dhe numri i madh i lëndëve për shqyrtim nga fusha e legalizimit të objekteve të ndërtuara në mënyrë të paligjshme.

Në vijë të njëjtë janë edhe informatat nga ministria përkatëse, të cilat bëjnë me dije se është zvogëluar numri i ankesave dhe i denoncimeve të dërguara deri te ministria përkatëse për shkak të veprimit joadekuat të administratës kompetente komunale, por ky zvogëlim nuk është në masë të madhe.

Rekomandime

Organet kompetente të komunës duhet të ndërmarrin masa që të parashohin dhe të implementojnë politika dhe procedura për ta shqyrtuar çdo denoncim të paraqitur, për të kryer kontroll në vendin e ndërtimit për çdo denoncim, për të përgatitur procesverbal për kontrollin e realizuar dhe për ta njoftuar denoncuesin.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit, si dhe Ministria për Transport dhe Lidhje

Kategoria: Mbikëqyrja/kontrolli

Pyetja - indikator: A ka punësuar dhe edukuar komuna, burime të mjaftueshme njerëzore për kontroll të vazhdueshëm dhe në kohë, në vendin e ndërtimit, për çdo leje të dhënë për ndërtim, me çka do të sigurohej që çdo ndërtim të realizohet në përputhje me kushtet?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Veprimi i inspektorit për ndërtim për kontroll të vazhdueshëm dhe në kohë, në vendin e ngjarjes, për çdo leje të dhënë për ndërtim është e rregulluar me dispozitat e Ligjit për ndërtim dhe Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Informatat e fituara nga NJVL-të e anketuara e potencojnë faktin se NJVL-të nuk disponojnë me burime të mjaftueshme njerëzore për kontroll të vazhdueshëm dhe në kohë, në vendin e ndërtimit, për çdo leje të dhënë për ndërtim. Nga gjithsej 5 njësi të anketuara të vetëqeverisjes lokale, dy NJVL theksojnë se nuk kanë burime të mjaftueshme njerëzore për praktikim konsekuent të dispozitave të lartë-përmendura.

Rekomandime

Njësitë e vetëqeverisjes lokale të ndërmarrin masa dhe aktivitete për ta siguruar numrin e mjaftueshëm të burimeve njerëzore.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit, si dhe Ministria për Transport dhe Lidhje

Kategoria: Mbikëqyrja/kontrolli

Pyetja - indikator: A mundësojnë burimet njerëzore që janë në dispozicion të komunës, kontroll në kohë, në vendin e ndërtimit, për çdo leje të dhënë për ndërtim, me çka do të sigurohej që në kuadër të komunës të mos ekzistojnë kushte për të dhënë vendime për rrënimin ose korigjimin e ndërtimeve?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Veprimi i inspektorit për ndërtim për kontroll të vazhdueshëm dhe në kohë, në vendin e ngjarjes, për çdo leje të dhënë për ndërtim është e rregulluar me dispozitat e Ligjit për ndërtim dhe Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Informatat e fituara nga NJVL-të e anketuara e potencojnë faktin se NJVL-të nuk disponojnë me burime të mjaftueshme njerëzore për kontroll të vazhdueshëm dhe në kohë, në vendin e ndërtimit, për çdo leje të dhënë për ndërtim, me çka do të sigurohej që në kuadër të komunës të mos ekzistojnë kushte për të dhënë vendime për rrënimin ose korrigjimin e ndërtimeve.

Rekomandime

Njësitë e vetëqeverisjes lokale të ndërmarrin masa dhe aktivitete për ta siguruar numrin e mjaftueshëm të burimeve njerëzore.

Problemi/faktori i rrezikut 2

Devijime në menaxhimin me financat dhe pronën e vetëqeverisje lokale

Arsyetimi:

Ngjashëm sikurse te administrata publike, menaxhimi me financat dhe pronën e vetëqeverisjes lokale ka potencial serioz korruptiv për shkak të mundësisë për keqpërdorim të mjeteve buxhetore ose të pronës së komunës. Nëse menaxhimi me financat dhe pronën e komunës nuk është i rregulluar dhe i mbrojtur sa duhet, kjo paraqet mundësi për keqpërdorim nga ana e funksionarëve dhe të të punësuarve në administratën lokale.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit

Kategoria: Transparenca

Pyetja - indikator: A konsideroni se zgjidhja aktuale ligjore në pjesën e përgatitjes së planit të programeve për zhvillim, si pjesë përbërëse e propozim-buxhetit të komunës, i jep rezultatet e pritura?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Dispozitat e nenit 21-b të Ligjit për buxhetet e rregullojnë mënyrën e përgatitjes së planit të programeve për zhvillim, harmonizimin e tij me qarkoren e ministrit për financa dhe dorëzimin e tyre për miratim nga ana e këshillit të komunës. Në fakt, kryetari i komunës përgatit propozim-plan të programeve për zhvillim në përputhje me udhëzimet e Qarkores dhe atë e dorëzon për miratim deri te këshilli i komunës, më së voni deri më 20 tetor të vitit aktual.

Këshilli i komunës e miraton propozim-planin e programeve për zhvillim më së voni deri më 15 nëntor të vitit aktual.

Plani i miratuar i programeve për zhvillim është pjesë përbërëse e propozim-buxhetit të komunës.

Gjithashtu, me dispozitat e nenit 23 të Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale është rregulluar përmbajtja e buxhetit të komunës, me të cilin është rregulluar se buxheti i komunës e përmban edhe pjesën zhvillimore, e cila është pjesë përbërëse e planit të programeve për zhvillim, të cilin komuna e ka për detyrë ta shqyrtojë çdo vit.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në bazë të përgjigjeve të fituara nga hulumtimi i kryer, mund të konstatohet se rregullativa aktuale ligjore i jep rezultatet e pritura. Dispozitat aktuale ligjore dhe udhëzimet që gjenden në letrën qarkore të ministrit për financa deri te njësitë për vetëqeverisje lokale i japin udhëzimet kryesore për përgatitjen e planit të programeve për zhvillim. Mirëpo, shpeshherë në praktikë kemi përjashtime të caktuara që kanë të bëjnë me kualitetin dhe miratimin në kohë të planit të programeve për zhvillim, e poashtu ka edhe mungesë të mbikëqyrjes adekuate.

Rekomandime

Të sigurohet mbikëqyrje adekuate për kualitetin e planit të përgatitur të programeve për zhvillim dhe ndjekje e realizimit të tyre nga ana e administratës komunale dhe këshilli i komunës.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit

Kategoria: Transparenca

Pyetja - indikator: A është vendosur praktikë në kuadër të komunës që plani i programeve për zhvillim të propozohet rregullisht nga kryetari i komunës dhe miratimi i tij të bëhet nga ana e këshillit të komunës më së voni deri më 15 nëntor të vitit aktual?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Kryetari i komunës ka obligim që më së voni deri më 20 tetor të vitit aktual ta dorëzojë për miratim planin e programeve për zhvillim deri te këshilli i komunës, me ç’rast këshilli i komunës ka për obligim që planin e programeve për zhvillim ta miratojë më së voni deri më 15 nëntor të vitit aktual.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Informatat që gjenden në përgjigjet e komunave të anketuara çojnë në konstatimin se në NJVL-të e anketuara respektohet obligimi i caktuar ligjor për dorëzimin dhe miratimin në kohë të planit të programeve për zhvillim. Por, informatat për gjendjen e përgjithshme në pjesën e miratimit të planit të programeve për zhvillim bëjnë me dije se ka përjashtime të caktuara në pjesën e miratimit në kohë të planit të programeve për zhvillim të komunave.

Rekomandime

Në periudhën e ardhshme duhet të sigurohet miratimi në kohë i planit të programeve për zhvillimin e NJVL-ve ,si parakusht kryesor për miratimin e buxhetit të NJVL-së.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit

Kategoria: Transparenca/Ilogaridhënia

Pyetja - indikator: A është siguruar në komunën tuaj që buxheti i komunës të jetë i harmonizuar me planin e programeve për zhvillim?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Me dispozitat e nenit 23 të Ligjit për financimin e NJVL-ve, paragrafi 6, është rregulluar se plani i programeve për zhvillim i përmban projektimet afatmesme të mjeteve të miratuara sipas:

- programeve dhe nën programeve të veçanta buxhetore,
- viteve kur do të realizohen ato dhe
- burimeve të financimit, gjegjësisht buxheteve.

Dispozita e lartë-përmendur jep udhëzime të qarta se plani i programeve për zhvillim është pjesë përbërëse e buxhetit të NJVL-së.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Përgjigjet e dhëna e NJVL-ve të anketuara çojnë në konstatimin se buxheti i NJVL-ve është i harmonizuar me planin e programeve për zhvillim. Edhe përkundër përgjigjeve të dhëna për harmonizimin e ndërsjellë të planit të programeve për zhvillim me buxhetin e NJVL-së, informatat për shkallën e realizimit të të ardhurave të NJVL-së dhe numri vazhdimisht në rritje i NJVL-ve që kanë llogari të bllokuara, çojnë në konstatimin se ka nevojë që në periudhën e ardhshme të ndiqet planifikimi real dhe objektiv i buxheteve të NJVL-ve dhe të planeve të tyre të programeve për zhvillim. Në periudhën e deritanishme, shpeshherë paraqiten situata në të cilat planifikimi i buxheteve të NJVL-ve është joreal dhe paraqet bazë për shpenzime (krijim të detyrimeve) për të cilat nuk janë siguruar mjete për t'i paguar.

Rekomandime

Në periudhën e ardhshme të ndërmerren aktivitete me të cilat NJVL-të do ta ndjekin planifikimin real dhe objektiv të buxheteve të NJVL-ve, shkallën e realizimit të të ardhurave dhe të inicohen ndryshime dhe plotësime të Ligjit për buxhetet dhe të Ligjit për financimin e NJVL-ve, në pjesën e përcaktimit të kriterëve për planifikimin real të buxheteve të NJVL-ve.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit

Kategoria: Mbikëqyrja-kontroli

Pyetja - indikator: A është krijuar në kuadër të komunës zgjidhje aplikative softuerike që mundëson ndjekje të vazhdueshme të realizimit të buxhetit të komunës?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Evidentimi i transaksioneve në librat afariste është rregulluar me dispozitat e Ligjit për kontabilitet të buxheteve dhe shfrytëzuesit buxhetorë dhe me Rregulloren për kontabilitet të buxheteve dhe shfrytëzuesit buxhetorë. Me dispozitat e nenit 11 të ligjit të lartë-përmendur është rregulluar se përpunimi i të dhënave dhe futja e tyre në librat afariste mund të bëhet me ndihmën e kompjuterit, në mënyrë gjysmë të automatizuar ose me dorë.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Udhëheqja e librave afariste bëhet me ndihmën e kompjuterëve, të cilët shfrytëzojnë aplikacione të ndryshme softuerike. Në periudhën e deritanishme, nga ana e disa donatorëve dhe OJQ-ve janë bërë përpjekje për të siguruar aplikacione të ndryshme softuerike për udhëheqjen e librave afariste, për përgatitjen e buxheteve të komunave dhe për ndjekjen e realizimit të buxheteve. Hulumtimet e kryera në këtë fushë flasin se disa NJVL kanë siguruar zgjidhje përkatëse softuerike që mundëson ndjekje adekuate të realizimit të buxhetit të komunës, por ka edhe NJVL që kanë nevojë për këtë lloj aplikacioni.

Gjendja në këtë fushë flet për atë se ekzistojnë aplikacione të ndryshme softuerike për ndjekjen e realizimit të buxhetit të komunës, të cilat jo gjithmonë janë të integruara si një tërësi. Në pjesën më të madhe të periudhës së deritanishme, procesi i planifikimit të buxhetit bëhet me anë të aplikacionit softuerik, të zhvilluar nga ndonjë subjekt juridik privat. Nuk ka dispozita me të cilat do të parashihej nevoja për licencimin e aplikacioneve të përmendura.

Rekomandime

Të iniciohet zhvillimi i aplikacionit të unifikuar dhe të licencuar (të miratuar nga Ministria për Financa) softuerik, i cili do të përfshijë disa nën-programe, duke e përfshirë edhe ndjekjen e realizimit të buxhetit.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit

Kategoria: Mbikëqyrja-kontroli

Pyetja - indikator: A është bërë revizion i llogarisë përfundimtare të buxhetit të komunës nga ana e Entit shtetëror për revizion, gjegjësisht nga ana e revizorit të brendshëm, gjatë periudhës 2011-2013 dhe a janë konstatuar devijime në mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve dhe të kompetencave të transferuara (decentralizimi fiskal)?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Obligimi për të bërë revizion të raporteve financiare të NJVL-ve është rregulluar me dispozitat e nenit 38 të Ligjit për financimin e NJVL-ve. Gjithashtu, me nenin 22 të Ligjit për revizion shtetëror është rregulluar se revizion shtetëror bëhet edhe në buxhetet e komunave, në bazë të programit vjetor të miratuar nga Revizori kryesor shtetëror (neni 23).

Revizioni i brendshëm në NJVL është rregulluar me dispozitat e Ligjit për kontroll të brendshëm publik financiar. Me dispozitat e ligjit të përmendur janë përcaktuar kriteret për atë se cilat subjekte janë të obliguara të formojnë njësi për revizion të brendshëm dhe me çfarë numri të revizorëve të brendshëm.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në periudhën e deritanishme, revizion shtetëror bëhet vetëm në një numër të caktuar të NJVL-ve, gjegjësisht numri i NJVL-ve që janë përfshirë me revizionin shtetëror është 10% e numrit të përgjithshëm të NJVL-ve në nivel vjetor. Por, edhe përkundër numrit të vogël të NJVL-ve të përfshira me revizionin shtetëror, nga revizionet e kryera në raportet financiare të NJVL-ve dhe raportet e përgatitura revizore mund të vihet në përfundimin se janë konstatuar një numër i madh i parregullsive.

Praktikimi i revizionit të brendshëm nëpër NJVL nuk është në nivelin e dëshiruar. Sipas të dhënave të Ministrisë për Financa, në lidhje me gjendjen e revizionit të brendshëm në nivel lokal, arrihet në konstatimin se 43% e njësive të vetëqeverisjes lokale nuk kanë revizorë të brendshëm dhe se 44% e njësive për revizion të brendshëm kanë nga një revizor të brendshëm. Në të njëjtën kohë, duhet theksuar se gjatë kryerjes së revizionit të brendshëm, jo gjithmonë revizorët e brendshëm kanë pavarësi, gjegjësisht jo gjithmonë puna e tyre është e lirë nga ndikimi i udhëheqësit të subjektit.

Rekomandime

Të sigurohet përfshirje më e madhe e raporteve financiare të NJVL-ve me revizionin shtetëror.

Të sigurohet rritje e numrit të njësive të formuara për revizion të brendshëm në NJVL.

Të sigurohet rritje e numrit të revizorëve të brendshëm në njësitë për revizion të brendshëm në nivel lokal.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit

Kategoria: Transparenca

Pyetja - indikator: A ka paraparë komuna, politika dhe procedura për buxhetim pjesëmarrës dhe për sigurim të pjesëmarrjes së publikut dhe të palëve të interesuara në fazën e përgatitjes dhe miratimit të planit të programeve për zhvillim dhe planit për furnizime publike?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Një nga parimet buxhetore që kanë të bëjnë me mënyrën e përgatitjes, miratimit dhe të ekzekutimit të buxhetit të NJVL-ve është edhe transparenca e këtij procesi, që nënkupton vënien në dispozicion të të dhënave për publikun, në të gjitha fazat e përgatitjes dhe të ekzekutimit të buxhetit. Të gjitha parimet buxhetore janë të përcaktuara me dispozitat e nenit 3 të Ligjit për buxhetet.

Procedura për miratimin e planit për furnizime publike është rregulluar me dispozitat e Ligjit për furnizime publike. Në fakt, sipas dispozitave aktuale ligjore, NJVL-të kanë obligim që planin për furnizime publike ta miratojnë deri në fund të muajit janar.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Sigurimi i nivelit të lartë të transparencës në procesin e përgatitjes dhe të miratimit të buxhetit të komunës, e me të edhe të planit të programeve për zhvillim dhe të planit për furnizimet publike, paraqet një nga prioritetet kryesore të NJVL-së. Që të sigurohet veprim adekuat në këtë aktivitet, duhet të ekzistojë rregullim përkatës i kësaj procedure në dispozitat statutore të NJVL-së, e gjithashtu duhet të ekzistojnë edhe procedura të caktuara me shkrim.

Nëse me të drejtë mund të themi se në praktikë është siguruar shkallë adekuate e transparencës gjatë përgatitjes dhe miratimit të buxhetit të komunës, duke e përfshirë edhe planin e programeve për zhvillim, në pjesën e planit furnizimeve publike ka nevojë të sigurohet shkallë më e lartë e transparencës dhe ky plan duhet të publikohet në ueb-faqen e NJVL-së.

Rekomandime

Të iniciohet që NJVL-të të ndërmarrin aktivitete për miratimin e politikave dhe të procedurave që do të sigurojnë rritje të pjesëmarrjes së publikut dhe të palëve të interesuara në fazën e përgatitjes dhe të miratimit të planit për furnizime publike.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit

Kategoria: Transparenca

Pyetja - indikator: A ka paraparë komuna, politika dhe procedura për publikimin e planit të programeve për zhvillim dhe të planit për furnizime publike në ueb-faqen e komunës, para miratimit të tyre?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Siç u theksua më lartë, miratimi i planit të programeve për zhvillim dhe i planit për furnizime publike është i rregulluar me Ligjin për buxhetet, Ligjin për financimin e NJVL-ve dhe Ligjin për furnizimet publike. Mirëpo, në ligjet e përmendura, nuk është rregulluar obligimi për publikimin e tyre në ueb-faqen e komunës.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Informatat që gjenden në përgjigjet e NJVL-ve të anketuara dhe vlerësimet që janë dhënë nga ana e tyre, flasin për gjendjen brengosëse në këtë pjesë. Në fakt, për gjendjen e përmendur nuk ka obligim ligjor, përveç njërit nga parimet buxhetore që kërkon transparencë në këtë proces, me ç'rast i gjithë aktiviteti varet nga aktet, politikat dhe praktikat interne të vendosura nga ana e NJVL-së.

Rekomandim

Të ndërmerren aktivitete me të cilat do të sigurohet që të parashihen politika dhe procedura të caktuara për mënyrën e përgatitjes, miratimit dhe të publikimit të planit të programeve për zhvillim dhe të planit për furnizime publike në ueb-faqen e NJVL-së, para dhe pas miratimit të tyre.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit

Kategoria: Integriteti

Pyetja - indikator: A ka miratuar komuna Program vjetor për aftësim profesional të administratës komunale dhe a ka marrë mendim përkatës për të nga ministria përkatëse?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Me dispozitat e nenit 24 të Ligjit për nëpunësit shtetërorë është rregulluar se përveç subjekteve të tjera edhe NJVL-të kanë obligim që të miratojnë Program vjetor për aftësim dhe avancim profesional të nëpunësve shtetërorë gjatë vitit aktual për vitin e ardhshëm. Miratimi i programit është i kushtëzuar me marrjen e mendimit nga ministria përkatëse (MSHIA).

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në pjesën më të madhe, NJVL-të e anketuara theksojnë se NJVL-ja e tyre ka miratuar Program vjetor për edukim dhe ka marrë mendim nga ministria përkatëse. Mirëpo, në të njëjtën kohë, ka edhe NJVL që nuk e respektojnë obligimin e përmendur ligjor, gjegjësisht nuk përgatisin program adekuat për aftësim dhe avancim profesional të nëpunësve shtetërorë.

Rekomandim

Të ndërmerren masa dhe aktivitete për përgatitjen, sigurimin e mendimit nga ministria përkatëse dhe miratimin e Programit vjetor për aftësim dhe avancim profesional të administratës komunale.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit

Kategoria: Integriteti

Pyetja - indikator: A ndërmerr komuna masa dhe aktivitete të vazhdueshme për edukimin e të punësuarve për ushtrimin e suksesshëm të kompetencave nga fusha e decentralizimit fiskal?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Avancimi profesional i administratës komunale është rregulluar me dispozitat e Ligjit për nëpunësit shtetërorë dhe me Programin vjetor të miratuar në kuadër të çdo NJVL-je. Njëri nga obligimet e nëpunësit shtetëror është edhe avancimi dhe aftësimi i vazhdueshëm i tij. Në qoftë se ai e refuzon ta ndjekë aftësimin dhe avancimin profesional, kjo paraqet pa-dëgjueshmëri disiplinore.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në periudhën e deritanishme janë mbajtur një numër i madh edukimesh, në të cilat kanë marrë pjesë nëpunësit shtetërorë nga NJVL-të. Por, duke e marrë parasysh faktin se vendi e ka për obligim ta bëjë përshtatjen e legjislacionit të saj me legjislacionin e Bashkimit Evropian nga njëra

anë dhe dukurinë e shpeshtë, nëse jo edhe të vazhdueshme, të ndryshimit të akteve ligjore dhe atyre nënligjore që kanë të bëjnë me ushtrimin e kompetencave të NJVL-ve nga ana tjetër, ka nevojë të vazhdueshme për avancimin e administratës komunale.

Rekomandim

Të ndërmerren masa dhe aktivitete me të cilat do të sigurohet edukim i vazhdueshëm i administratës komunale.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit

Kategoria: Mbikëqyrja dhe kontrolli

Pyetja - indikator: A ka marrë komuna në periudhën e deritanishme të implementimit të kompetencave nga fusha e decentralizimit fiskal, ndonjë vërejtje ose konstatime nga ana e Ministrisë për Financa për veprim joadekuat?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Organ kompetent për ndjekjen e decentralizimit fiskal sipas dispozitave të Ligjit për financimin e NJVL-ve është Ministria për Financa dhe Qeveria e vendit.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Vetëm një NJVL nga ato që u anketuan thekson se në periudhën e deritanishme i janë nënshtruar observimit nga Ministria për Financa në pjesën e mjeteve të transferuara nëpërmjet bllok-dotacioneve për ushtrimin e kompetencave të transferuara. Për këtë gjendje nuk janë marrë të dhëna nga ministria përkatëse. Edhe përkundër asaj se nuk ka të dhëna për lëshime ose shkelje serioze gjatë ushtrimit të kompetencave të transferuara, Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit në periudhën e ardhshme duhet ta analizojë dhe ta ndjekë respektimin e dispozitave të Ligjit për financimin e NJVL-ve, në pjesën e shpalljes së jo-stabilitetit financiar të komunës.

Edhe përkundër asaj se në periudhën e deritanishme, disa NJVL janë të bllokuara vazhdimisht, nuk janë ndërmarrë masa për shpalljen e jo-stabilitetit financiar. Gjendja e këtyre komunave punën e tyre, gjegjësisht pagesën, ta bëjnë me cesione, kompensime dhe akreditiv, etj. që krijon mundësi për sjellje korruptive.

Rekomandim

Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit të vendosë politika me të cilat do ta ndjekë shkallën e NJVL-ve të bllokuara dhe respektimin konsekuent të dispozitave të Ligjit për financimin e NJVL-ve dhe shpalljen në kohë të jostabilitetit financiar të komunës.

Problemi/faktori i rrezikut 3:

Mungesa e garancive për zbatimin e rreptë të procedurave për punë

Arsyetimi:

Respektimi dhe zbatimi i rreptë i procedurave për punë varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ndihma profesionale që do t’u ofrohet funksionarëve dhe të punësuarve në administratën lokale. Në këtë proces, roli i revizionit të brendshëm të komunave është kyç, dhe ai duhet të forcohet edhe më shumë. Me këtë rast, duhet të eliminohet rezistenca ndaj revizionit të brendshëm dhe të vendoset revizor i licencuar i brendshëm.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit

Kategoria: Kapaciteti-resurset

Pyetja - indikator: A mendoni se zgjidhja aktuale ligjore në pjesën e kriterëve¹³⁷ për formimin dhe ekipimin e revizionit të brendshëm në njësitë e vetëqeverisjes lokale i jep rezultatet e pritura?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Kriteret për formimin dhe ekipimin e revizionit të brendshëm në NJVL janë përcaktuar me dispozitat e Ligjit për kontroll të brendshëm publik financiar. Në fakt, sipas nenit 30 të ligjit të përmendur, në mes tjerash, është përcaktuar se çdo subjekt nga sektori publik, buxheti/plani financiar mesatar vjetor i të cilit në tre vitet e fundit e tejkalon vlerën e 50 milionë denarë, ka obligim të formojë NJRB.

Ndërsa te subjektet nga sektori publik, buxheti/plani financiar mesatar vjetor i të cilave në tre vitet e fundit nuk e tejkalon vlerën e 50 milionë denarë, revizioni i brendshëm organizohet duke angazhuar:

- revizor/ë të brendshëm nga njësia për revizion të brendshëm nga ndonjë subjekt tjetër nga sektori publik, në bazë të marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet udhëheqësve të të dyja subjekteve nga sektori publik ose

- revizor/ë të shënuar në regjistrin e revizorëve të brendshëm.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Gjendja e përgjithshme në pjesën e NJRB-ve të formuara dhe revizorëve të brendshëm që janë emëruar në NJVL, nuk kënaq. Përveç asaj se ka disa vërejtje në pjesën e kriterëve për nevojën e formimit të NJRB-ve, ka nevojë që të ndërmerren edhe masa dhe aktivitete sa i përket promovimit të këtij obligimi dhe dobisë së njësisë për revizion të brendshëm.

137 Neni 29, 30 dhe 31 i Ligjit për kontroll të brendshëm publik financiar.

Rekomandim

Organet kompetente të ndërmarrin aktivitete për rishqyrtimin e dispozitave aktuale të Ligjit për kontroll të brendshëm publik financiar dhe ta promovojnë obligimin dhe dobinë nga formimi i NJRB-ve dhe të emërojnë revizorë të brendshëm.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit

Kategoria: Kapaciteti-resurset

Pyetja - indikator: A është formuar (organizuar) revizion i brendshëm në kuadër të komunës dhe a është punësuar numri i nevojshëm i revizorëve të brendshëm sipas kriterëve të përcaktuara në LKBPF¹³⁸?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Me dispozitat e nenit 31 të Ligjit për kontroll të brendshëm publik financiar janë përcaktuar kriteret për numrin e revizorëve të brendshëm që duhet ta përbëjnë NJRB-në në një subjekt të caktuar në sektorin publik. Gjegjësisht, është përcaktuar se duhet të ketë:

- së paku një revizor të brendshëm dhe një udhëheqës të njësisë për revizion të brendshëm, në qoftë se buxheti/plani financiar mesatar vjetor i subjektit nga sektori publik në tre vitet e fundit ka qenë së paku 50 milionë denarë, duke i përfshirë edhe fondet dhe programet e financuara nga BE-ja;

- së paku tre revizorë të brendshëm dhe një udhëheqës të njësisë për revizion të brendshëm, në qoftë se buxheti/plani financiar mesatar vjetor i subjektit nga sektori publik në tre vitet e fundit ka qenë së paku 500 milionë denarë, duke i përfshirë edhe fondet dhe programet e financuara nga BE-ja;

- së paku katër revizorë të brendshëm dhe një udhëheqës të njësisë për revizion të brendshëm, në qoftë se buxheti/plani financiar mesatar vjetor i subjektit nga sektori publik në tre vitet e fundit ka qenë së paku 2 miliardë denarë, duke i përfshirë edhe fondet dhe programet e financuara nga BE-ja dhe

- së paku një revizor të brendshëm në çdo pesë shfrytëzues individualë buxhetorë.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Për fat të keq, gjendja faktike me revizorët e brendshëm të emëruar në NJVL as për së afërmi nuk i plotëson kriteret e përcaktuara. Sipas të dhënave të Ministrisë për Financa u konstatua se 43% e njësive të formuara për revizion të brendshëm nuk kanë revizorë të brendshëm, ndërsa 44% e NJRB-ve kanë nga një revizor të brendshëm. Gjendja e konstatuar nuk ofron garanci të mjaftueshme se është siguruar bindje dhe këshillë adekuate, e pavarur, e arsyeshme dhe objektive nga kryetari i komunës, me qëllim të përmirësimit të punës së subjektit dhe rritjes së efektivitetit të sistemeve për kontroll të brendshëm.

Rekomandim

Të ndërmerren masa dhe aktivitete për rritjen e numrit të revizorëve të brendshëm në NJVL.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit

Kategoria: Kapaciteti-resurset

Pyetja - indikator: A është adekuate me mundësitë dhe nevojat e revizorëve të brendshëm të komunave, mënyra e përcaktuar për marrjen e certifikatës për revizor të brendshëm të autorizuar?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Nevoja për trajnim dhe certifikim të revizorëve të brendshëm në sektorin publik në vendit është rregulluar me dispozitat e nenit 36 të Ligjit për kontroll të brendshëm publik financiar dhe me Rregulloren për programin dhe mënyrën e dhënies së provimit për revizorë të brendshëm të autorizuar në sektorin publik ("Gazeta zyrtare e vendit" numër 136/10). Në fakt, me dispozitat e ligjit të përmendur është rregulluar se si revizorë të brendshëm të autorizuar në sektorin publik mund të emërohen persona të cilët përveç kushteve të tjera, duhet ta kenë ndjekur trajnimin dhe ta kenë dhënë provimin për revizor të brendshëm të autorizuar në sektorin publik sipas Programit për dhënien e provimit për revizor të brendshëm të autorizuar ose të posedojnë certifikatë për revizor që është e pranuar ndërkombëtarisht". Në periudhën e deritanishme, sipas kësaj zgjidhjeje ligjore nuk është realizuar procedurë për marrjen e certifikatës/dhënien e provimit për RBA.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Edhe përkundër asaj se sipas dispozitave të ligjit të përmendur u miratua akti nënligjor me të cilin u rregullua mënyra e dhënies së provimit dhe e marrjes së vërtetimit për provimin e dhënë për revizor të brendshëm të autorizuar në sektorin publik, në periudhën e deritanishme nuk është organizuar mbajtja e këtij provimi.

Për dallim nga gjendja e përmendur më lartë, Ministria për financa e vendit, në bashkëpunim me CEF nga Sllovenia dhe CIPFA nga Britania e Madhe, nga fundi i qershorit të vitit 2012 filloi me realizimin e projektit “Trajnimi i revizorëve të brendshëm në sektorin publik”. Me këtë projekt, në vend për herë të parë u bë certifikimi ndërkombëtar i revizorëve të brendshëm në sektorin publik.

Në projekt janë përfshirë 65 revizorë të brendshëm nga sektori publik (50 revizorë nga niveli qendror dhe 15 revizorë nga niveli lokal), të cilët i ndjekin trajnimet të ndarë në dy grupe.

Për tejkalimin e gjendjes së përmendur¹³⁹ është formuar një grup pune për kryerjen e punëve për lokalizim (trajnimet të zbatohen nga edukatorë nga vendi dhe i gjithë procesi të realizohet nga ana e Ministrisë për Financa) të trajnimeve për certifikim të kontabilistëve dhe të revizorëve të brendshëm në sektorin publik në vend, të regjistruar me numrin 03-28823/1.

Gjatë muajit tetor të vitit 2013, në Kuvendin e vendit u dorëzua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontroll të brendshëm publik financiar.

Me ndryshimet e propozuara bëhet rregullimi i kushteve dhe i mënyrës së realizimit të trajnimit dhe i dhënies së provimit për revizor të brendshëm të autorizuar në sektorin publik.

Rekomandime

Të vazhdohet me aktivitetet e ndërmarra në pjesën e lokalizimit të trajnimeve për certifikimin e revizorëve të brendshëm të autorizuar në vend.

Të bëhet rregullim plotësues i ndryshimeve dhe i plotësimeve të Ligjit për kontroll të brendshëm publik financiar me çka do të sigurohet certifikim dhe edukim i vazhdueshëm i revizorëve të brendshëm, por në të njëjtën kohë do të sigurohet edhe certifikatë e pranuar ndërkombëtarisht.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit

Kategoria: Kapaciteti-resurset

Pyetja - indikator: Sipas mendimit tuaj, a është e zbatueshme mënyra e paraparë për dhënien e provimit¹⁴⁰ për revizor të brendshëm të autorizuar?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Mënyra e certifikimit të revizorëve të brendshëm në sektorin publik në vend është rregulluar me dispozitat e nenit 36 të Ligjit për kontroll të brendshëm publik financiar dhe me Rregulloren për programin dhe mënyrën e dhënies së provimit për revizor të brendshëm të autorizuar në sektorin publik (“Gazeta zyrtare e vendit” numër 136/10).

¹³⁹ Vendimi zëvendëskryeministrit të Qeverisë së vendit dhe ministër për financa, z. Zoran Stavreski, më 13.09.2013

¹⁴⁰ Rregullorja për programin dhe mënyrën e dhënies së provimit për revizor të brendshëm të autorizuar në sektorin publik.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Edhe përkundër asaj se në periudhën e deritanishme ekzistonte mënyrë e përcaktuar për dhënien e provimit për revizor të brendshëm të autorizuar, deri në këtë moment nuk është organizuar dhënia e provimit për revizor të brendshëm të autorizuar dhe marrja e vërtetimit.

Rekomandim

Të vazhdohen aktivitetet e ndërmarra për lokalizimin e certifikimit të revizorëve të brendshëm të autorizuar, të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i rregullativës aktuale ligjore dhe të mundësohet marrja e certifikatës së pranuar ndërkombëtarisht.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit

Kategoria: Kapaciteti-resurset

Pyetja - indikator: A mendoni se janë adekuate kushtet e përcaktuara¹⁴¹ për emërimin e revizorëve të brendshëm në pjesën e posedimit të certifikatës/provimit të dhënë për revizor të brendshëm të autorizuar?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Me dispozitat e neneve 35 dhe 36 të Ligjit për kontroll të brendshëm publik financiar rregullohet procedura për emërimin e udhëheqësit të njësisë për revizion të brendshëm, revizorëve të brendshëm të autorizuar dhe revizorëve të brendshëm, si dhe kushtet që ata duhet t'i plotësojnë.

Udhëheqësi i njësisë për revizion të brendshëm duhet të jetë revizor i brendshëm i autorizuar dhe duhet të ketë së paku tre vjet përvojë punë në fushën e revizionit të brendshëm ose atë të jashtëm. Kufizimet në ligj kanë të bëjnë me atë se si udhëheqës i njësisë për revizion të brendshëm nuk mund të emërohet personi, bashkëshorti/bashkëshortja e të cilit, farefisi në vijë të drejtë pa kufizim, në vijë anësore deri në brezin e katërt ose në bazë të martesës deri në shkallë të katërt, janë ose kanë qenë të punësuar në pozitë udhëheqëse në subjektin e sektorit publik gjatë dy viteve të kaluara.

Për **revizor të brendshëm të autorizuar** mund të emërohet personi i cili përveç kushteve të përgjithshme të parapara me ligj, i plotëson edhe këto kushte të veçanta:

- të ketë të kryer arsim të lartë,

¹⁴¹ Neni 36 i Ligjit për kontroll të brendshëm publik financiar.

- ta ketë të ndjekur trajnimin dhe ta ketë dhënë provimin për revizor të brendshëm të autorizuar në sektorin publik sipas Programit për dhënien e provimit për revizor të brendshëm të autorizuar ose të posedojë certifikatë për revizor që është e pranuar ndërkombëtarisht,
- të ketë së paku dy vjet përvojë pune në revizionin e brendshëm ose atë të jashtëm dhe
- me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar masë për ndalimin e kryerjes së veprimtarisë ose të profesionit përderisa zgjat ndalesa.

Për **revizor të brendshëm** mund të emërohet personi i cili përveç kushteve të përgjithshme të parapara me ligj, i plotëson edhe këto kushte të veçanta:

- të ketë të kryer arsim të lartë,
- të ketë së paku dy vjet përvojë pune në revizionin e brendshëm ose atë të jashtëm dhe
- me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar masë për ndalimin e kryerjes së veprimtarisë ose të profesionit përderisa zgjat ndalesa.

Për **revizor të brendshëm në trajnim** mund të emërohet personi i cili përveç kushteve të përgjithshme të parapara me ligj, i plotëson edhe këto kushte të veçanta:

- të ketë të kryer arsim të lartë,
- me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar masë për ndalimin e kryerjes së veprimtarisë ose të profesionit përderisa zgjat ndalesa.

Pas kalimit të periudhës prej dy viteve, revizori në trajnim emërohet si revizor i brendshëm.

Pasqyrë tabelore e kushteve që duhet t'i plotësojnë UNJRB-të, RBA-të, RB-të dhe RB-të në trajnim

	Udhëheqësi i NJRB-së	Revizori i brendshëm i autorizuar	Revizori i brendshëm	Revizori i brendshëm në trajnim
1. Të ketë të kryer arsim të lartë	X	X	X	X
2. Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar masë për ndalimin e kryerjes së veprimtarisë ose të profesionit përderisa zgjat ndalesa	X	X	X	X
3. Ta ketë të ndjekur trajnimin dhe ta ketë dhënë provimin për revizor të brendshëm të autorizuar në sektorin publik sipas Programit për dhënien e provimit për revizor të brendshëm të autorizuar ose të posedojë certifikatë për revizor që është e pranuar ndërkombëtarisht	X	X		
4. Të ketë së paku tre vjet përvojë pune në revizionin e brendshëm ose atë të jashtëm	X			
5. Të ketë së paku tre vjet përvojë pune në revizionin e brendshëm ose atë të jashtëm		X	X	

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Duke pasur parasysh se në periudhën e deritanishme nuk është organizuar provim për marrjen e vërtetimit për provimin e dhënë për revizor të brendshëm të autorizuar, kjo dispozitë e ligjit nuk ka mundur të zbatohet, që vetë-vetiu ndikon në profesionalizmin e revizorëve të brendshëm të NJVL-ve.

Rekomandim

Njësia për harmonizim në kuadër të Ministrisë për Financa dhe Komiteti për revizion të përgatitshin letër qarkore me të cilën do t'i informojnë NJVL-të dhe subjektet e tjera për nevojën për certifikim të revizorëve të brendshëm dhe për shpërndarjen/emërimin e tyre adekuat.

Problemi/faktori i rrezikut 4:

Mungesa e vlerësimit të rrezikut nga paraqitja e korrupsionit në komuna

Arsyetimi:

Mundësitë për parandalimin e korrupsionit në komuna dukshëm rriten nëse paraprakisht është bërë vlerësimi dhe identifikimi i vendeve dhe i procedurave ku është e mundshme paraqitja e tij. Vlerësimi paraprak i këtij lloji mundëson përqëndrim të parandalimit dhe të zbulimit të korrupsionit në të ashtuquajturat pika neuralgjike, si dhe përfundim plotësues të procedurave në drejtim të mbrojtjes nga korrupsioni.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit

Kategoria: Integriteti

Pyetja - indikator: A mendoni se zgjidhja aktuale ligjore në pjesën e menaxhimit me rreziqet, duke e përfshirë edhe obligimin për përgatitjen e strategjisë për menaxhim me rreziqet në njësitë e vetëqeverisjes lokale, i jep rezultatet e pritura?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për kontroll të brendshëm publik financiar është përcaktuar mënyra e menaxhimit me rreziqet. Në fakt, sipas dispozitave të përmendura, subjektet e sektorit publik, duke i përfshirë edhe NJVL-të, kanë obligim që të miratojnë strategji për menaxhimin me rreziqet, e cila përditësohet çdo tre vjet, ndërsa kontrollet që kanë të bëjnë me minimizimin e rrezikut duhet të analizohen dhe të përditësohen së paku një herë në vit.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Miratimi i strategjisë për menaxhim me rreziqet është aktivitet i ndërlikuar dhe shumë i dobishëm për NJVL-të. Mirëpo, edhe përkundër faktit se trajton një temë që është me rëndësi shumë të madhe, ky aktivitet nuk është implementuar nga pjesa më e madhe e NJVL-ve. Mungesa e dispozitës ndëshkuese dhe e aktivitetit më të gjerë shoqëror për rritjen e nivelit të njohjes së nevojës për ekzistimin e dokumentit të lartë-përmendur, çon në mungesën e këtij dokumenti strategjik.

Rekomandim

Të ndërmerren aktivitete dhe masa me të cilat do të bëhet promovimi i nevojës për miratimin e strategjisë për menaxhim me rreziqet.

Të ndërmerren aktivitete dhe masa me të cilat do të përcaktohet gjobë në Ligjin për kontroll të brendshëm publik financiar për mosrespektimin e obligimit të përmendur.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit

Kategoria: Integriteti

Pyetja - indikator: A është përgatitur në kuadër të komunës, strategji për menaxhim me rreziqet, në përputhje me dispozitat e LKBPF-së¹⁴² dhe Doracakun për menaxhim dhe kontroll financiar¹⁴³?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Obligimi për përgatitjen e Strategjisë për menaxhim me rreziqet dhe përditësimi i saj është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për kontroll të brendshëm publik financiar, ndërsa mënyra e përgatitjes është përshkruar në Doracakun për menaxhim dhe kontroll financiar. Por, edhe përkundër zgjidhjes së përmendur ligjore dhe Doracakut për menaxhim dhe kontroll financiar, ka nevojë të ndërmerren masa plotësuese për mënyrën e përgatitjes së këtij dokumenti.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

142 Ligji për kontroll të brendshëm publik financiar

143 Ministria për Financa e Republikës së vendit, dhjetor 2010.

Arsyetimi:

Në pjesën më të madhe të NJVL-ve në vend nuk është miratuar strategjia për menaxhim me rreziqet. Vetëm në një pjesë të vogël të NJVL-ve në vend, edhe atë në qytetin e Shkupit, në Strumicë, Qendër, Karposh, Gazi Babë dhe në Ilinden janë miratuar strategji për menaxhim me rreziqet. Por, edhe në këto NJVL, sikur nuk i është kushtuar vëmendje e mjaftueshme përditësimit të rregullt të tyre dhe veprimit në përputhje me to.

Rekomandim

Njësia për harmonizim në kuadër të Ministrisë për Financa dhe Komiteti për menaxhim dhe kontroll financiar të përgatisin një letër qarkore dhe t'ua dërgojnë atë subjekteve nga sektori publik, duke i përfshirë edhe NJVL-të, ku do të theksohet nevoja dhe rëndësia për miratimin e strategjisë së përmendur dhe për praktikimin e saj konsekuent.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit

Kategoria: Integriteti

Pyetja - indikator: A është përgatitur regjistri për rreziqe në kuadër të komunës?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Në përputhje me udhëzimet metodologjike, në kuadër të strategjisë për menaxhim me rreziqet duhet të ekzistojë edhe regjistri për rreziqe.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Siç u theksua më lartë, vetëm një numër i vogël i NJVL-ve në vend kanë përgatitur startegji për menaxhim me rreziqet, e me këtë edhe regjistër të rreziqeve.

Rekomandim

Të ndërmerren masa dhe aktivitete me të cilat do të ndiqet shkalla e përgatitjes së strategjive për menaxhim me rreziqet, si dhe do të bëhet ndjekja dhe përditësimi i vazhdueshëm i rreziqeve.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit

Kategoria: Integriteti

Pyetja - indikator: A bëhet përditësimi i strategjisë për menaxhim me rreziqet një herë në tre vjet, gjegjësisht në mënyrë të vazhdueshme, në kushte kur rreziqet ndryshojnë?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Obligimi për përditësimin e strategjisë për menaxhim me rreziqet është rregulluar me nenin 15 të Ligjit për kontroll të brendshëm publik financiar. Dispozitat e përmendura e parashohin obligimin që në çdo tre vjet të bëhet përditësimi i strategjisë së miratuar, ndërsa kontrollet që kanë të bëjnë me minimizimin e rrezikut duhet të analizohen dhe të përditësohen së paku një herë në vit.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Duke pasur parasysh faktin se ka një numër të vogël të strategjive për miratuara për menaxhim me rreziqet, si dhe përgjigjet e fituara nga NJVL-të e anketuara, mund të përfundohet se nuk i kushtohet vëmendje e mjaftueshme përditësimit të strategjive për menaxhim me rreziqet.

Rekomandim

Të ndërmerren masa dhe aktivitete me të cilat do të bëhet ndjekja e shkallës së përgatitjes së strategjive për menaxhim me rreziqet, si dhe do të bëhet ndjekja dhe përditësimi i vazhdueshëm i saj.

Institucioni: Njësia e vetëqeverisjes lokale: Aerodromi; Gjevgjelia, Kumanova; Struga; Sveti Nikole; Strumica, Velesi dhe qyteti Shkupit

Kategoria: Integriteti

Pyetja - indikator: A bëhet ndjekja dhe analizimi i vazhdueshëm i kontrolleve që kanë të bëjnë me minimizimin e rreziqeve?

Nota - de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për kontroll të brendshëm publik financiar është rregulluar obligimi që së paku një herë në vit të bëhet analizimi dhe përditësimi i kontrolleve që kanë të bëjnë me minimizimin e rreziqeve.

Nota - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Te disa NJVL është e pranishme dukuria që të përgatisin politika dhe procedura të caktuara për vendosjen e sistemit për menaxhim dhe kontroll financiar ose për standardizimin e punës së tyre duke fituar ISO standarde, mirëpo gjendjet në këtë pjesë akoma nuk janë të kënaqshme. Gjendja e përmendur është vërtetuar edhe me anketimin e NJVL-ve. Për futjen e standardeve ISO, duhet theksuar se Qeveria e vendit ka miratuar disa përfundime, me të cilat i obligon subjektet e sektorit publik për të futur standarde ISO me dinamikë të caktuar, e gjithashtu me rëndësi janë dhe dispozitat e Ligjit për futjen në përdorim të sistemit për menaxhim me kualitetin dhe korniza e përbashkët për vlerësim të punës dhe për ofrimin e shërbimeve në shërbimin civil.

Rekomandim

NJVL-ve t'u bëhet me dije nevoja për të pasur qëndrim pozitiv të menaxhmentit për rolin dhe rëndësinë e menaxhimit dhe kontrollit financiar dhe për miratimin e politikave dhe të procedurave për vendosjen e sistemit adekuat për menaxhim dhe kontroll financiar dhe të sigurohet ndjekje dhe përditësim i vazhdueshëm i kontrolleve që kanë të bëjnë me minimizimin e rreziqeve.

PASQURA E INDEKSEVE

Edhe pse metodologjia bën vlerësim kualitativ të gjendjes, është bërë edhe vlerësimi numerik, me qëllim që të bëhet përmbledhja numerike e informatave dhe të potencohen anët kryesore të dobëta dhe të fuqishme. Prandaj, në tekstin e mësipërm, për çdo pyetje-indikator është dhënë nota prej 1 deri në 5 – ku 1 është nota më e dobët, ndërsa 5 është më e larta.

Në bazë të notave të dhëna prej 1 deri në 5, për çdo pyetje-indikator janë mbledhur notat në nivel të nënkategorive, në nivel të kategorive dhe në nivel të gjithë shtyllës. Me këtë rast, nuk është bërë ponderim (peshim) i notave, por të gjitha notat e mbledhura janë përcaktuar si mes aritmetik.

Problemi	Nënkategoria	Indeksi				
		De jure	De facto	Mesatarja – nënkategoria	Mesatarja – kategoria	Mesatarja – sektori
<i>Problemi 1</i>	transparenca	4	4	4	3,67	3,63
	kapaciteti	3	3	3		
	mbikëqyrja	5	3	4		
<i>Problemi 2</i>	transparenca	3,5	3,75	3,62	4,17	
	mbikëqyrja	5	3,66	4,33		
	llogaridhënia	5	5	5		
	integriteti	4	3,5	3,75		
<i>Problemi 3</i>	kapaciteti	3,8	2,8	3,3	3,3	
<i>Problemi 4</i>	integriteti	4,6	2,2	3,4	3,4	

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

Ligji për parandalimin e korrupsionit

Kodi Penal

Ligji për ndërtim

Ligji për planifikim hapësinor dhe planifikim urbanistik

Ligji për kontroll të brendshëm publik financiar

Ligji për kontabilitet për buxhetet dhe shfrytëzuesit buxhetor

Ligji për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale

Ligji për buxhetet

Ligji për marrëdhënie pune

Ligji për nëpunësit shtetërorë

Ligji për nëpunësit publikë

Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave

www.finance.gov.mk

www.mtc.gov.mk

www.zels.org.mk

**4. RAPORTI NGA ANALIZA KUALITATIVE TË MASAVE KUNDËR KORRUPSIONIT
DHE IMPLEMENTIMIT TË PROGRAMIT SHTETËRORË PËR PARANDALIM DHE
LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT DHE ZVOGËLIM TË KONFLIKTIT TË INTERESIT
2011-2015 NË SEKTORIN E ADMINISTRATËS PUBLIKE**

Përgatitur nga: Gorica Atanasova-Gjorevska

HYRJE

Misioni i OSBE-së në Shkup zbaton aktivitete disavjeçare për përkrahjen e implementimit të “Programit shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe për zvogëlimin e konfliktit të interesave për periudhën 2011–2015” (Programi shtetëror). Në vitin 2012, Misioni ndihmoi në zhvillimin e metodologjisë për vlerësimin kualitativ të aktiviteteve dhe të indikatorëve nga Programi shtetëror, me pilot analizë kualitative për sektorin e arsimit dhe të sportit, me vlerësimin e perceptimit të publikut për tre sektorë nga Programi shtetëror, si dhe me përfortimin e kapaciteteve të Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit (KSHPK) për zhvillimin e konceptit të integritetit dhe evidentimit elektronik të të dhënave. Misioni i OSBE-së e vazhdoi bashkëpunimin me KSHPK-në edhe në vitin 2013 dhe 2014, duke dhënë përkrahje për përgatitjen e analizës kualitative dhe zbatimin e hulumtimit të mendimit publik për pesë sektorë të rinj nga Programi shtetëror – sektori privat, sektori politik, vetëqeverisja lokale administrata publike dhe mediat dhe shoqëria civile.

Në këtë dokument gjendet analiza kualitative që ka të bëjë me sektorin e administratës publike.

Ajo i trajton problemet e identifikuara në Programin shtetëror, me ç’rast nëpërmjet një sërë indikatorësh i vlerëson masat antikorruptive dhe zbatimin e Programit shtetëror, i konstaton anët e fuqishme dhe të dobëta të asaj që është bërë deri tani dhe jep rekomandime për avancimin e luftës kundër korrupsionit në vetëqeverisjen lokale. Qëllimi kryesor i kësaj analize është ta ndihmojë KSHPK-në për ta ndjekur zbatimin e Programit shtetëror, për t’i përmirësuar indikatorët dhe për të propozuar aktivitete të reja/të ndryshuara.

METODOLOGJIA

Metodologjia e analizës është e bazuar në konceptin e Sistemit nacional për integritet të “Transparency International”. Problemet që janë shqyrtuar janë marrë nga Programi shtetëror. Nën çdo problem janë përcaktuar indikatorë për gjendjen dhe përparimin, si dhe janë dhënë rekomandime për përmirësimin e rezultateve.

Si burime të të dhënave u shfrytëzuan:

- Analiza kualitative – analiza e literaturës primare - ligjeve relevante, akteve nënligjore dhe dokumente dhe raporte të tjera zyrtare, si dhe analiza e literaturës sekondare – artikuj, shkrime, etj.
- Intervista me burime kyçe të informatave, edhe atë me Ministrinë për Financa, Ministrinë për Shoqëri Informatike dhe Administratë, Entin shtetëror për revizion, Komisionin shtetëror për parandalimin e korrupsionit.

Në bazë të të dhënave të mbledhura, hulumtuesi përgatiti propozim-vlerësime për secilin indikator, edhe atë nga dy aspekte – de jure, sa i përket kornizës ligjore, dhe de facto, gjegjësisht gjendjes në praktikë. Gjatë vlerësimit të indikatorëve, për kornizën ligjore është përdorur shkalla në tre nivele prej 1 deri në 5, me ç’rast: 1 = jo, 3 = pjesërisht, 5 = po.

Për vlerësimin e gjendjes në praktikë është përdorur shkalla në pesë nivele prej 1 deri në 5, me ç’rast: 1 = në masë shumë të vogël, 2 = në masë të vogël, 3 = në masë të caktuar, 4 = në masë të madhe, 5 = në masë shumë të madhe.

Pastaj, notat e veçanta janë mbledhur dhe janë paraqitur si mesatare e notës së përgjithshme për çdo nënkategori dhe kategori. Për të dhënë një pasqyrë më të qartë, në fund të këtij dokumenti notat janë paraqitur në formë të shumës dhe janë shprehur edhe si përqindje e notës maksimale të mundshme.

Rezultatet u prezantuan para faktorëve relevantë dhe u verifikuan prej tyre, të cilët diskutuan për konstatimet dhe për vlerësimet në lidhje me pyetjet e indikatorëve, me qëllim që të verifikohen, të konfirmohen ose të plotësohen të dhënat dhe rezultatet. Pas këtij verifikimi, u bë edhe finalizimi i analizës.

PËRMBLEDHJE

Analiza kualitative që u realizua në kuadër të këtij projekti kishte për qëllim t'i vlerësojë faktorët kryesorë të rrezikut/problemet që janë identifikuar nga Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit (KSHPK) në fushën e **administratës publike**, të cilat janë shënuar në Programin shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit për periudhën 2011-2015. Problemet kryesore që janë theksuar nga KSHPK-ja u shqyrtuan nga aspekti i legjislacionit dhe implementimit praktik, me qëllim që të bëhet një pasqyrë e arritjeve, si dhe të potencohen dobësitë kryesore në këtë sektor nga aspekti i mbikëqyrjes dhe kontrollit, transparencës, integritetit, llogaridhënies, resurseve dhe kapacitetit.

Qëllimi i hulumtimit është të kontribuojë në përpjekjet e përgjithshme në luftën kundër korrupsionit në fushën e administratës publike në vend, dhe duke i evidentuar dobësitë, të japë edhe rekomandime për tejkalimin e tyre.

Në sektorin e Administratës publike, KSHPK-ja konstatoi pesë probleme që kanë të bëjnë me korrupsionin në kuadër të të cilave ka nevojë për përparim plotësues për parandalimin dhe represionin e korrupsionit. Ato përfshijnë – 1) Vendosja jo e plotë e sistemit të decentralizuar për menaxhim me mjetet publike dhe procedurat e pabarmonizuara sa duhet për menaxhim dhe kontroll financiar; 2) Mungesa e garancave për zbatim të rreptë të procedurave për punë; 3) Mungesa e vlerësimit të rrezikut nga paraqitja e korrupsionit në institucionet e administratës publike; 4) Mungesa e masave të sistematizuara për parandalimin e korrupsionit (koncepti i integritetit) dhe 5) Mungesa e kontrollit publik mbi punën e administratës publike.

Në pasqyrën e përgatitur para do kohësh për realizimin e aktiviteteve për periudhën dhjetor 2011 – nëntor 2013, nga gjithsej 15 aktivitetet e parapara, KSHPK-ja thekson se janë duke u realizuar 12 ose 80%, ndërsa 3 ose 20% e aktiviteteve janë të parealizuaras.¹⁴⁴

Përfundim i përgjithshëm është se është arritur përparim i konsiderueshëm në pjesën e miratimit të rregullativës – ligjet e përgatitura, numri i madh i akteve nënligjore, si dhe strategjitë dhe dokumentet në përputhje me të cilat rregullohen dhe planifikohen aktivitetet e mëtutjeshme në këtë fushë. Megjithatë, te një pjesë e problemeve/rreziqeve mungon edhe vetë rregullativa dhe/ose strategjitë që duhet të miratohen, e ato duhet t'i paraprijnë implementimit praktik të aktiviteteve. Prandaj, pjesa e implementimit paraqet sfida më të madhe në kuadër të të gjitha problemeve dhe aktiviteteve të detektuara dhe këtu ka hapësirë dhe nevojë për veprim të mëtutjeshëm.

Sa i përket **Problemit 1 - Vendosja jo e plotë e sistemit të decentralizuar për menaxhim me mjetet publike dhe procedurat e pabarmonizuara sa duhet për menaxhim dhe kontroll financiar**, përfundimi i përgjithshëm është se vendosja e plotë të sistemit të decentralizuar për menaxhim me financat është në rrugë të mirë, edhe pse evidentohen dobësi që duhet të tejkalohen në të ardhmen. Sa i përket rregullativës, esenca e vendosjes së sistemit të decentralizuar për menaxhim me mjetet publike është futja e përgjegjesisë udhëheqëse, e cila është futur deri në një masë të caktuar. Janë krijuar dhe funksionojnë Njësitë për çështje financiare në një numër të madh të institucioneve. Institucionet në masë të madhe kanë sjellë vendime për shpërndarje

¹⁴⁴ Sektori III – Administrata publike, Pasqyrë e realizimit të aktiviteteve të Programit shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe të Programit shtetëror për parandalimin dhe zvogëlimin e paraqitjes së konfliktit të interesave me Plan aksional 2011-2015, dhjetor 2011 - nëntor 2013

të brendshme të buxhetit të përgjithshëm të miratuar. Nga ana tjetër, është theksuar ekipimi i pamjaftueshëm i NJÇF-ve, si dhe trajnimi i pamjaftueshëm i kuadrit. Në praktikë mund të vlerësohet se sistemi i decentralizuar për menaxhim me financat akoma nuk është implementuar në tërësi. Megjithatë, përgjegjësia kryesore për menaxhimin financiar në institucione, në përputhje me kornizën e paraparë me Ligjin për KBFP, bie mbi udhëheqësin e subjektit.

Në lidhje me **Problemin 2 - Mungesa a garancive për zbatim të rreptë të procedurave për punë**, mund të konstatohet se është bërë një përparim i konsiderueshëm në pjesën e rregullativës me miratimin e dispozitave përkatëse ligjore me të cilat rregullohen materiet nga kjo fushë. Njëkohësisht, praktika tregon se janë duke u realizuar edhe një numër i madh i aktiviteteve që kanë të bëjnë me krijimin dhe ekipimin e Njësive për revizion të brendshëm, bëhet certifikimi ndërkombëtar për revizorë të autorizuar, u miratuan ndryshime ligjore me të cilat parashihet lokalizimi i certifikimit të revizorëve të brendshëm që do të hyjë në fuqi prej janarit të vitit 2015. Si dobësi të evidentuara në këtë segment mund të theksohen profesionalizmi i pamjaftueshëm i revizorëve, nevoja për trajnime të mëtutjeshme dhe për licencim, si dhe mungesa e organizimit të provimit për revizorë të autorizuar, edhe pse kjo ishte paraparë edhe më parë, si dhe vërehen disa mangësi në sistemin e ri për trajnim dhe certifikim që është paraparë. Sa i përket Njësive për çështje financiare, në masë të madhe ato janë formuar dhe ekipuar, por nevojiten ndryshime ligjore, në bazë të të cilave do të ndryshohet obligimi për krijimin e tyre të detyrueshëm edhe në komunat më të vogla (të zëvendësohet vetëm me vendosjen e personave përgjegjës, në përputhje me madhësinë e komunës).

Në pjesën **Problemi 3 - Mungesa e vlerësimit të rrezikut nga paraqitja e korrupsionit në institucionet e administratës publike**, mund të konstatohet se është bërë përparim i vogël si nga aspekti i përgatitjes së dokumentacionit të nevojshëm – Strategjisë për menaxhim me rreziqet, Regjistrin për rreziqe – ashtu edhe nga aspekti i zbatimit praktik dhe implementimit të aktiviteteve. Mungon zbatimi i vetë-vlerësimeve vjetore nga ana e institucioneve, edhe pse kjo është paraparë me rregullativë.

Sa i përket **Problemit 4 - Mungesa e masave të sistematizuara për parandalimin e korrupsionit (koncepti i integritetit)**, përfundim i përgjithshëm është se aktivitetet që janë paraparë për trajtimin e tij nuk janë realizuar. Në fakt, janë përgatitur ndryshime në Propozim-ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për korrupsion, sipas të cilave, duhet të vendoset sistemi i integritetit në sektorin publik dhe atë privat, e me këtë të përcaktohet veprimi i mëtutjeshëm në këtë fushë. Realizimi i trajnimeve dhe përgatitja e planeve për integritet, që janë paraparë nga ana e KSHPK-së si aktivitete, do të pasonin dhe do të përcaktoheshin pas miratimit të ligjit të paraparë, gjë që ka gëcur në krahasim me afatin e paraparë paraprakisht.

Në fund, me aktivitetet e parapara në kuadër të **Problemit 5 - Mungesa e kontrollit publik mbi punën e administratës publike**, është paraparë përforcimi i sistemit për parandalimin, zbulimin, raportimin dhe shqyrtimin e parregullive, si dhe për ndërmarrjen e masave për parandalimin e parregullive dhe mashtrimeve për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së në vend. Aktivitetet e parapara në kuadër të kësaj pjese janë duke u zhvilluar, por ka vonesë në përgatitjen dhe miratimin e dokumenteve iniciale ose rregullativës (Strategjisë nacionale për ndërmarrjen e masave për parandalimin e parregullive dhe mashtrimeve për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së në vend, ndryshimet e Ligjit për parandalimin e korrupsionit duke futur dispozita për personat që e denoncojnë korrupsionin - whistleblowers), që çon edhe në ngecjen e implementimit praktik – realizimin e trajnimeve, përforcimin e sistemit për denoncimin e parregullive dhe sigurimin e mbrojtjes për denoncuesit, etj.

REKOMANDIME

- Futja e sistemit plotësisht të centralizuar për menaxhim me mjetet publike duke u dhënë përgjegjësi më të madhe strukturave udhëheqëse
- Ndryshimi i rregullativës ekzistuese me qëllim të delegimit më të madh të kompetencave për menaxhim financiar
- Ekipimi dhe trajnimi i mëtutjeshëm i kuadrit që merret me çështjet financiare në NJÇF
- Rrumbullakësimi i plotë i procesit të formimit dhe ekipimit të NJRB-ve në nivel nacional, e posaçërisht në nivel lokal, të të gjithë shfrytëzuesit buxhetorë
- Marrja parasysh e dobësive të evidentuara në ndryshimet ligjore nga ana e grupit të punës që është krijuar nga MF-ja, me të cilat janë paraparë dispozita për certifikim lokal të revizorëve të autorizuar, para hyrjes në fuqi të këtyre dispozitave
- Përgatitja e modelit të Strategjisë për menaxhim me rreziqet me udhëzime konkrete për përgatitjen e saj nga ana e të gjithë palëve të interesuara, bashkë me Regjistrin për rreziqe
- Futja e obligimit të rregullt vjetor për zbatimin e vetë-vlerësimeve në sistemin për menaxhim dhe kontroll financiar
- Miratimi i dhe zbatimi i ndryshimeve në Ligjin për parandalimin e korrupsionit me të cilat futet sistemi i integritetit
- Zhvillimi i metodologjisë për përgatitjen e planeve për identitet nga ana e KSHPK-së dhe MF-së, me qëllim që të shërbejnë si udhëzime për të gjitha institucionet që duhet t'i përgatisin ato
- Futja e trajnimeve për integritet si pjesë e trajnimeve gjenerike për luftë kundër korrupsionit që zbatohen nga ana e MSHIA-së në bashkëpunime me KSHPK-në, në nivel të administratës publike
- Futja e trajnimeve për menaxhim financiar dhe kontroll në sistemin e trajnimeve gjenerike në nivel të administratës publike
- Gjatë revizionit të Programit shtetëror, KSHPK-ja të mendojë ta rrisë diapazonin e aktiviteteve dhe ngushticave potenciale në fushën e administratës publike (në programin aktualë pjesa më e madhe janë) dhe të adaptohet sistemi i reviduar për nëpunësit administrativë dhe të punësuarit në sektorin privat.
- Të miratohen udhëzime konkrete për implementimin e sistemit për integritet në nivel të administratës publike, në përputhje me ndryshimet ligjore
- Të sigurohet mbrojtje e vërtetë e denoncuesve të korrupsionit (whistleblowers) duke implementuar dispozita të reja ligjore

REZULTATET NGA ANALIZA KUALITATIVE

Problemi / faktori i rrezikut 1:

Vendosja jo e plotë e sistemit të decentralizuar për menaxhim me mjetet publike dhe procedurat e pabarmonizuara sa duhet për menaxhim dhe kontroll financiar

Arsyetimi:

Sistemi i centralizuar për menaxhim me mjetet publike, ku udhëheqësi i subjektit është personi i autorizuar për marrjen përsipër të obligimeve dhe personi i autorizuar për të kryer pagesa, mundëson keqpërdorimin e mjeteve dhe le hapësirë për korrupsion. Njëkohësisht ai pamundëson përgjegjësi të deleguar menaxheriale për të gjithë udhëheqësit në shpenzimin e mjeteve publike. Procedurat për marrjen përsipër të obligimeve financiare dhe procedurat për pagesë janë të padefinuara, që poashtu mundëson forma të ndryshme të keqpërdorimit të mjeteve.

Aktiviteti 1: Vendosja e sistemit plotësisht të decentralizuar për menaxhim me mjetet financiare

Institucioni: Ministria për Financa

Kategoria: Mbikëqyrja dhe kontrolli

Pyetja-indikator: A parashih rregullativa ekzistuese ligjore vendosjen e sistemit plotësisht të decentralizuar për menaxhim me mjetet financiare dhe në çfarë mase është vendosur ai?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Njëra nga fushat kryesore të sistemit për KBFP është përgjegjësia e udhëheqësisë. Ajo është e definuar në Ligjin për KBFP, i cili në nenin 8 në mënyrë të detajuar e sqaron përgjegjësinë dhe dhënien e autorizimit. Me qëllim të përforcimit të përgjegjësive së udhëheqësisë është miratuar dhe ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2011, *Rregullorja për mënyrën e zbatimit të proceseve të përgjithshme financiare*, e cila e rregullon sistemin e decentralizuar për menaxhim me mjetet publike. Sipas kësaj rregulloreje, siç është theksuar në Strategjinë për KBFP, udhëheqësi i subjektit bën shpërndarje të brendshme të buxhetit të përgjithshëm të miratuar për vitin aktual. “Udhëheqësit të cilëve u është ndarë buxhet, janë përgjegjës për realizimin e tij para udhëheqësit të subjektit. Ata janë persona përgjegjës për marrjen përsipër të obligimeve financiare dhe për shpenzimin e rregullt, efikas, efektiv dhe ekonomik të buxheteve të tyre.”¹⁴⁵

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

¹⁴⁵ Strategjia për zhvillimin e kontrollit të brendshëm financiar publik në vend prej vitit 2013 deri në vitin 2016, propozim. faqe 18

Arsyetimi:

Në rrugë të mirë është vendosja e sistemit plotësisht të decentralizuar për menaxhim me mjetet financiare. Në nivel qendror, 59% e shfrytëzuesve të drejtpërdrejtë buxhetorë sollën vendime për autorizime të përgjithshme, ndërsa në nivel lokal kjo përqindje është 40%, që mund të konsiderohet edhe si tregues për nivelin e vendosjes së sistemit të decentralizuar.¹⁴⁶

Nga ana tjetër, në Raportin e KE-së për përparimin e vendit për vitin 2013 thuhet se “në përgjithësi, ka mungesë të delegimit të përgjegjësive, që e pengon ecjen drejt përgjegjësisë së mirëfilltë menaxheriale.”¹⁴⁷ Në të njëjtën kohë, Raporti i SIGMA-s për vendin për vitin 2013, në pjesën e KBFP-së thekson se menaxhimi dhe kontrolli financiar realizohen duke kontrolluar se a janë harxhimet në përputhje me dispozitat ligjore dhe në kuadër të buxhetit të ndarë, mirëpo menaxherët akoma nuk janë në pozitë të kenë kontroll mbi rezultatet ose efikasitetin dhe efektivitetin.¹⁴⁸

Në Strategjinë për KBFP theksohet nevoja për avancimin dhe përf forcimin e sistemit për menaxhim të decentralizuar me buxhetin e institucionit duke dhënë autorizime të përgjithshme për marrjen përsipër të obligimeve financiare nga e udhëheqësit, për shfrytëzimin e mjeteve publike për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara.¹⁴⁹

Me këtë rast, në funksion të përforcimit të mëtutjeshëm të përgjegjësisë menaxheriale dhe vetëdijes për konceptin e KBFP-së, Ministria për Financa, Sektori për KBFP, do ta informojë Qeverinë e vendit, duke përgatitur informacion për përparimin në përforcimin e përgjegjësisë menaxheriale duke vendosur sistem të decentralizuar për menaxhim me mjetet publike te shfrytëzuesit buxhetorë në pushtetin qendror, fondet dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale.¹⁵⁰

Institucioni: Ministria për Financa

Kategoria: Mbikëqyrja dhe kontrolli

Pyetja-indikator: A janë paraparë dhe a janë përgatitur vendime për shpërndarjen e brendshme të buxhetit të përgjithshëm të miratuar?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Ligji për KBFP, sipas nenit 8 - Përgjegjësia dhe dhënia e autorizimit, si një nga elementet e tij kyçe e parasheh përgjegjësinë e udhëheqësisë dhe delegimin e kompetencave.

146 Intervistë me përfaqësuesin e Ministrisë për Financa, realizuar në maj të vitit 2014

147 Raporti i KE-së për përparimin e vendit për vitin 2013, Kapitulli 32: Kontrolli financiar

148 SIGMA Assessment on the host country, 2013, Public Internal Financial Control, faqe 28

149 Strategjia për zhvillimin e kontrollit të brendshëm financiar publik në vend prej vitit 2013 deri në vitin 2016, propozim, faqe 12

150 Strategjia për zhvillimin e kontrollit të brendshëm financiar publik në vend prej vitit 2013 deri në vitin 2016, propozim, faqe 18-19

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Kjo informatë ndryshon për çdo vit, mirëpo në vitin 2014 duke filluar nga 01.01.2014 e deri tani, 65 shfrytëzues buxhetorë ose 85,5% kanë sjellë vendime për shpërndarje të brendshme të buxhetit të përgjithshëm të miratuar, ndërsa 59% kanë sjellë vendime për autorizime të përgjithshme. Në nivel lokal, 75% e shfrytëzuesve të drejtpërdrejtë buxhetorë kanë sjellë vendime për shpërndarje të brendshme të buxhetit të përgjithshëm të miratuar, ndërsa 40% kanë sjellë vendime për autorizime të përgjithshme.

Në Strategjinë për KBFP është theksuar dobësia se në sistemin aktual ka shkallë të pamjaftueshme të kuptimit të konceptit për sistem të decentralizuar për menaxhim me mjetet publike nga ana e udhëheqësve të subjekteve dhe në të janë paraparë aktivitete për përmirësimin e sistemit dhe tejkalimin e kësaj dobësie në të ardhmen.

Institucioni: Ministria për Financa, institucionet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale,

Kategoria: Llogaridhënia

Pyetja-indikator: Në praktikë, në çfarë mase zbatohen revizionet e brendshme për punën financiare?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Funksioni i revizionit të brendshëm është vendosur pothuajse në të gjitha ministritë, fondet dhe shfrytëzuesit më të mëdhenj buxhetorë të linjës së parë, si dhe te njësitë e vetëqeverisjes lokale. Revizioni i brendshëm zbatohet nëpërmjet njësive për revizion të brendshëm (departamenteve/ sektorëve), të cilat për punën e tyre kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë para udhëheqësit të subjektit.

Subjektet të cilat sipas Ligjit për KBFP, në 3 vitet e fundit kanë buxhet mesatar më të madh se 50 milionë denarë kanë obligim të krijojnë njësi për revizion të brendshëm. Subjektet më të vogla, gjegjësisht subjektet të cilat buxheti mesatar në tre vitet e fundit është më i vogël se 50 milionë denarë, kanë mundësi ta krijojnë funksionin e revizionit të brendshëm duke angazhuar revizor të brendshëm/dhe nga ndonjë njësi për revizion të brendshëm nga ndonjë subjekt tjetër i sektorit publik, në bazë të marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet udhëheqësve të dy subjekteve të sektorit publik.

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në praktikë, revizionet e brendshme mbi punën financiare realizohen në përputhje me planet strategjike dhe vjetore për revizion të brendshëm dhe në përputhje me planet e miratuara revizore të çdo institucioni veç e veç¹⁵¹, siç është përcaktuar dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

Njësia qendrore harmonizuese në Ministrinë për Financa i përfundoi aktivitetet e nevojshme për publikimin e standardeve të përditësuara ndërkombëtare për kryerjen profesionale të revizionit të brendshëm e më pas do të organizohen edhe trajnime adekuate dhe takime pune për implementimin e tyre nga NJRB-të, thuhet në Kontributin për Raportin e KE-së për vendin për vitin 2013.

Institucioni: Ministria për Financa, institucionet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale

Kategoria: Resurset dhe kapaciteti

Pyetja-indikator: A bëhet trajnimi i kuadrit kompetent për zbatimin e sistemit të decentralizuar për menaxhime me mjetet financiare?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Sipas Ligjit për KBFP, edhe atë sipas nenit 48 – Njësia qendrore për harmonizim – NJQH është kompetente për "koordinimin e trajnimeve për udhëheqësit dhe të punësuarit e kyçur në menaxhimin dhe kontrollin financiar dhe revizionin e brendshëm"¹⁵². Strategjia për KBFP thekson se për periudhën e cila është përfshirë në Strategji, prej vitit 2013 deri në vitin 2016, NJQH-ja kryesisht do të fokusohet edhe në organizimin e trajnimeve për subjektet, me qëllim të implementimit sa më të mirë të sistemit të KBFP-së në praktikë.¹⁵³ Në Strategji thuhet se NJQH-ja duhet të marrë pjesë në përgatitjen e Strategjisë për trajnimin e nëpunësve shtetërorë në nivelin më të lartë udhëheqës, me afat deri më 31.12.2013¹⁵⁴, por nuk ka të dhëna për atë se a është realizuar ky aktivitet apo jo.

151 Ligji për Kontrollin e brendshëm financiar publik, ("Gazeta zyrtare" nr. 90/09, 12/11, 188/13), neni 24

152 Ligji për Kontrollin e brendshëm financiar publik, ("Gazeta zyrtare" nr. 90/09, 12/11, 188/13), neni 48

153 Strategjia për zhvillimin e kontrollit të brendshëm financiar publik në vend prej vitit 2013 deri në vitin 2016, propozim, faqe 23

154 Strategjia për zhvillimin e kontrollit të brendshëm financiar publik në vend prej vitit 2013 deri në vitin 2016, propozim, faqe 51

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në Strategjinë për KBFP është theksuar se të punësuarit në NJRB nuk kanë shkathtësi të mjaftueshme praktike për përgatitjen e procedurave me shkrim për proceset e përgjithshme financiare (përgatitja e vendimit për shpërndarjen e buxhetit të përgjithshëm të miratuar, marrja përsipër e obligimeve financiare dhe pagesa)

Aktiviteti 1.2: Përgatitja e procedurave për marrjen përsipër të obligimeve financiare dhe procedurat për kryerjen e pagesave

Institucioni: Ministria për Financa

Kategoria: Mbikëqyrja dhe kontrolli

Pyetja-indikator: Në çfarë mase kompetencat e deleguara për marrjen përsipër të obligimeve financiare dhe kryerjen e pagesave çojnë drejt përforsimit të sistemit të KBFP?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Në këtë moment, sipas rregullativës ka dy aspekte të sistemit të decentralizuar për menaxhim me mjetete financiare – njëra janë mënyrat për delegimin e buxheteve dhe tjetra janë mënyrat për delegimin e kompetencës për marrjen e vendimeve nga ana e menaxherëve.

Mënyra për delegimin e buxheteve është definuar me Rregulloren për mënyrën e realizimit të proceseve të përgjithshme financiare, e cila është miratuar dhe zbatohet prej vitit 2011. Në përputhje me këtë Rregullore, “procesi për shpërndarjen e brendshme të buxhetit të përgjithshëm të miratuar përfshin: pjesën e pashpërndarë të buxhetit, buxhetin e dedikuar për shpenzimet e përbashkëta të subjektit (rrogat, rryma elektrike, ngrohja, uji, mirëmbajtja aktuale dhe investuese, mallrat dhe shërbimet etj.) dhe buxheti i dedikuar për realizimin e politikave dhe projekteve.”¹⁵⁵ Në lidhje me delegimin e vendimmarrjes, në nenin 8 të Ligjit për KBFP përmendet autorizimi dhe mënyra e delegimit të tij. Megjithatë, ligji e kufizon udhëheqësin e njësisë së ai/ ajo nuk mund të sjellë vendime “me ndikim të theksuar politik ose financiar, pa miratimin paraprak nga ana e udhëheqësit të subjektit.”¹⁵⁶

Në vendimin për shpërndarjen e brendshme – përcaktohet buxheti për çdo sektor/njësi.

155 Rregullorja për mënyrën e zbatimit të proceseve të përgjithshme financiare, neni 3

156 Ligji për Kontrollin e brendshëm financiar publik, neni 8, paragrafi 4

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në praktikë mund të vlerësohet se sistemi i decentralizuar për menaxhim me mjetet financiare akoma nuk është implementuar në tërësi. Në qoftë se zbatohet procedura ashtu siç është paraparë me ligj, atëherë sistemi do të përforcohet edhe në realitet.¹⁵⁷ Nga ana tjetër, duhet theksuar se sipas kornizës së paraparë me Ligjin për KBFP-në, te sistemi i decentralizuar i menaxhimit, përgjegjësia megjithatë bie mbi udhëheqësin e subjektit edhe përkundër dhënies së autorizimeve për udhëheqësit e njësive, gjë që ndikon në mënyrë demotivuese te udhëheqësi i subjektit për t'i deleguar autorizimet e tij.

Institucioni: Ministria për Financa, institucionet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale

Kategoria: Mbikëqyrja dhe kontrolli

Pyetja-indikator: A janë të definuara mirë dhe plotësisht të harmonizuara procedurat për rregullim dhe kontroll financiar?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Doracakut për menaxhim dhe kontroll financiar parasheh se subjekti duhet të ketë procedurë të parapara për çdo aktivitet dhe/ose ngjarje të rëndësishme dhe ato duhet të jenë në dispozicion për të gjithë të punësuarit.¹⁵⁸

Procedura i përshkruan hapat për atë se ç'duhet bërë, si duhet bërë, kush e bën dhe si e bën, por në praktikë ka situata të ndryshme të zbatimit të saj. Shumë pak institucione kanë procedurë të parapara në përputhje me rekomandimet e Ministrisë për Financa, për shkak se kjo është paksa e vështirë për t'u realizuar. Më me rëndësi është që në mënyrë qartë të parashihen hapat, që të mund të zbatohen procedurat.

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

157 Intervistë me përfaqësuesin e Entit Shtetëror për Revizion, realizuar në prill të vitit 2014.

158 Doracak për Menaxhimin dhe kontrollin financiar, Ministria për Financa, Shkup, dhjetor 2010, faqe23

Arsyetimi:

Poashtu, shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti qendror, fondet dhe komunat, do të miratojnë procedura me shkrim për proceset e përgjithshme financiare (përgatitja e vendimit për shpërndarjen e brendshme të buxhetit të përgjithshëm të miratuar, marrja përsipër e obligimeve financiare dhe kryerja e pagesave). Njësia qendrore për harmonizim, si institucion kompetent për zhvillimin e sistemit për KBFP, do t'i promovojë institucionet që janë shembull i mirë për zbatimin e këtij sistemi duke organizuar takime pune dhe punëtori sipas parimit "praktikat më të mira", për të cilën gjë do të përgatisë plan aksional në kuadër të të cilit do të përfshihen institucionet e nivelit qendror dhe lokal, si dhe shembuj të "liderëve" në këtë fushë, të cilët në këto punëtori do t'i prezantojnë praktiket e tyre dhe përfitimet nga zbatimi i këtij sistemi, me qëllim të ngritjes së vetëdijes së udhëheqësisë për nevojën për ta zbatuar këtë sistem. Mirëpo, edhe përkundër të gjitha reformave dhe përpjekjeve, megjithatë procedurat asnjëherë nuk mund të jenë plotësisht të harmonizuara.¹⁵⁹

Problemi /faktori i rrezikut 2:

Mungesa a garancive për zbatim të rreptë të procedurave për punë

Arsyetimi:

Respektimi dhe zbatimi i rreptë i procedurave për punë në mënyrë të drejtpërdrejtë varet nga ndihma profesionale që do t'u ofrohet funksionarëve dhe të punësuarve në administratën publike. Në atë proces, kyç është roli i revizionit të brendshëm në institucionet e administratës publike, i cili duhet të përforcohet. Me këtë rast, duhet të eliminohet rezistenca ndaj revizionit të brendshëm dhe të vendoset një revizor i brendshëm i licencuar.

Aktiviteti 1. Themelimi dhe ekipimi i njësive për revizion të brendshëm (NJR) te të gjithë shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti ligjdhënës, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe fondet

Institucioni: Ministria për Financa, institucionet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale,

Kategoria: Mbikëqyrja dhe kontrolli

Pyetja-indikator: A i jep rezultatet e dëshiruara rregullativa ekzistuese që ka të bëjë me kriteret për krijimin dhe ekipimin e NJR-ve te të gjithë shfrytëzuesit buxhetorë?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Me dispozitat e nenit 30 të Ligjit për kontroll të brendshëm financiar publik është rregulluar se cilat subjekte nga sektori publik kanë obligim të detyrueshëm për të themeluar njësi për revizion të brendshëm. Me dispozitat e nenit të lartpërmendur janë përcaktuar edhe kriteret kryesore për nevojën për të themeluar njësi për revizion të brendshëm te subjektet e sektorit publik, duke e përfshirë edhe mundësinë që Qeveria e vendit, me propozim të ministrit për financa, të mund të caktojë obligim për

¹⁵⁹ Intervistë me përfaqësuesin e Ministrisë për Financa të vendit, realizuar në maj të vitit 2014.

themelimi të njësisë për revizion të brendshëm edhe të subjektet e tjera të sektorit publik.

Në fakt, të gjitha subjektet e sektorit publik, buxheti mesatar vjetor/plani financiar i të cilave në tre vitet e fundit e tejkalojnë vlerën prej 50 milionë denarësh janë të detyruara që të themelojnë njësi për revizion të brendshëm. Ndërsa subjektet e sektorit publik buxheti mesatar vjetor/plani financiar i të cilave në tre vitet e fundit nuk e tejkalojnë vlerën prej 50 milionë denarësh, revizioni i brendshëm mund të organizohet me: Nënshkrimin e kontratës me ndonjë subjekt tjetër të sektorit publik; Nënshkrimin e kontratës për angazhim të revizorëve nga regjistri i revizorëve të sektorit publik.... regjistër ky të cilin e mban Njësia qendrore për harmonizim pranë Ministrisë për Financa.

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Udhëheqësia në disa institucione ndonjëherë revizionin e kupton si dhënie të sigurisë dhe nuk i pranon sa duhet përfitimet të cilat mund t'i ofrojnë revizorët duke dhënë këshilla. Për shkak të kësaj, një pjesë e funksionit të revizionit nuk është shfrytëzuar në tërësi. Poashtu, ka institucione, veçanërisht në nivel lokal, që kanë ekipim më të dobët të vendeve të sistematizuara në njësitë për revizion të brendshëm, me çka nuk sigurohet punë ekipore dhe kualitet adekuat gjatë kryerjes së revizioneve.¹⁶⁰

Institucioni: Ministria për Financa, institucionet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale

Kategoria: Mbikëqyrja dhe kontrolli

Pyetja-indikator: Sa është numri i NJRB-ve të themeluara në nivel të administratës publike dhe a përkon ai me kriteret e përcaktuara në LKBFP?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Subjektet të cilat sipas LKBFP-së në tre vitet e fundit kanë buxhet mesatar më të lartë se 50 milionë denarë kanë obligim që të themelojnë njësi për revizion të brendshëm. Subjektet më të vogla, gjegjësisht subjektet të cilat buxheti mesatar në tre vitet e fundit ka qenë më i vogël se 50 milionë denarë, kanë mundësi që ta rregullojnë funksionin e revizionit të brendshëm duke angazhuar revizor/ë të brendshëm nga njësia për revizion të brendshëm e ndonjë subjekti tjetër, në bazë të kontratës së nënshkruar ndërmjet udhëheqësve të dy subjekteve të sektorit publik.

¹⁶⁰ Strategjia për zhvillimin e kontrollit të brendshëm financiar publik në vend prej vitit 2013 deri në vitin 2016, propozim, faqe 20.

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Gjendja e revizionit të brendshëm në nivel qendror

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	janar 2013	maj 2013	gusht 2013	shtator 2013	dhjetor 2013	janar 2014	shkurt 2014
Njësi të themeluara për revizion të brendshëm	24	35	46	58	64	71	73	74	74	75	75	76	76	76
Revizorë të brendshëm	52	68	81	90	111	120	133	135	136	135	137	137	136	135
Udhëheqës të njësive për revizion të brendshëm	/	/	27	34	34	35	44	45	46	47	47	47	47	47
Raporte të revizionit të brendshëm	142	204	222	252	245	241	242							
Rekomandime	1472	1502	1262	1672	1688	1534	2011							
Përqindja e rekomandimeve të implementuara	39	44	47	54	56	53	56							

Gjendja e revizionit të brendshëm në nivel lokal

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	janar 2013	maj 2013	gusht 2013	shtator 2013	dhjetor 2013	janar 2014	shkurt 2014
Njësi të themeluara për revizion të brendshëm	0	17	32	40	49	59	64	64	63	64	64	65	65	66
Revizorë të brendshëm	15	27	33	35	44	52	60	59	61	62	62	64	64	64
Udhëheqës të njësive për revizion të brendshëm	/	/	15	18	19	18	22	21	21	21	21	21	21	22
Raporte të revizionit të brendshëm	88	107	134	132	172	176	147							
Rekomandime	455	626	707	815	1033	1355	905							
Përqindja e rekomandimeve të implementuara	60	68	69	58	72	49	61							

Në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligj për krijimin e njësive për revizion të brendshëm (NJR), deri në fund të muajit prill të vitit 2013, 96% e shfrytëzuesve të drejtpërdrejtë buxhetorë në nivel qendror kanë themeluar njësi të veta për revizion të brendshëm, ndërsa në 61% të NJR-ve të themeluara ka të emëruar udhëheqës. Në nivel lokal, 79% e komunave kanë themeluar njësi të veta për revizion të brendshëm, ndërsa vetëm një e treta prej tyre kanë emëruar udhëheqës. Poashtu, në praktikë, 5 njësi të vetëqeverisjes lokale dhe 7 subjekte në nivel qendror, funksionin e revizionit të brendshëm e kryejnë në bazë të kontratës së nënshkruar me ndonjë NJVL, gjegjësisht ndonjë institucion tjetër. Mundësi për krijimin e administratës së përbashkët jep edhe Ligji për vetëqeverisje lokale.¹⁶¹ Me këtë rast, mund të përfundohet se është bërë përparim i konsiderueshëm sa i përket themelimit të NJR-ve në nivel qendror dhe atë lokal, në përputhje me kriteret e përcaktuara me Ligjin për KBFP.

Institucioni: Ministria për Financa, institucionet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale,

Kategoria: Resurset dhe kapaciteti

Pyetja-indikator: A janë NJR-të të organizuara dhe të ekipuara në mënyrë përkatëse, në përputhje me obligimet ligjore të parapara në LKBFP?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Sipas nenit 29, paragrafi 2, të Ligjit për KBFP – Njësia për revizion të brendshëm themelohet si njësi me së paku dy revizorë të brendshëm, duke e përfshirë edhe udhëheqësin e njësisë për revizion të brendshëm, gjegjësisht si sektor me së paku pesë revizorë të brendshëm, duke e përfshirë edhe udhëheqësinë e sektorin për revizion të brendshëm.

Në nenin 31 të Ligjit për KBFP, udhëheqësi i subjektit të sektorit publik themelon njësi për revizion të brendshëm në përputhje me këto kriteret:

- me së paku një revizor të brendshëm dhe një udhëheqës të njësisë për revizion të brendshëm, në qoftë se buxheti/plani financiar i subjektit të sektorit publik në tre vitet e fundit ka qenë së paku 50 milionë denarë, duke i përfshirë edhe fondet dhe programet e financuara nga BE-ja,

- me së paku tre revizorë të brendshëm dhe një udhëheqës të njësisë për revizion të brendshëm, në qoftë se buxheti/plani financiar i subjektit të sektorit publik në tre vitet e fundit ka qenë së paku 500 milionë denarë, duke i përfshirë edhe fondet dhe programet e financuara nga BE-ja,

- me së paku katër revizorë të brendshëm dhe një udhëheqës të njësisë për revizion të brendshëm, në qoftë se buxheti/plani financiar i subjektit të sektorit publik në tre vitet e fundit ka qenë së paku 2 miliardë denarë, duke i përfshirë edhe fondet dhe programet e financuara nga BE-ja dhe

- me së paku një revizor të brendshëm në çdo pesë entitete shfrytëzues buxhetorë.

¹⁶¹ Strategjia për zhvillimin e kontrollit të brendshëm financiar publik në vend prej vitit 2013 deri në vitin 2016, propozim, faqe 20

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në nivel qendror, 96% e shfrytëzuesve të drejtpërdrejtë buxhetorë kanë themeluar njësi të veta për revizion të brendshëm (NJR). Në këto NJR, mesatarisht ka nga 2 të punësuar (udhëheqës dhe/ose revizor). 61% e NJR-ve të themeluara kanë udhëheqës. Në nivel lokal, 79% e komunave kanë themeluar njësi të veta për revizion të brendshëm (NJR). Në këto NJR, mesatarisht ka nga 1 të punësuar (udhëheqës dhe/ose revizor). 30% e NJR-ve të themeluara kanë udhëheqës.¹⁶²

Aktiviteti 2. Ndryshimi i Ligjit për kontroll të brendshëm financiar publik në drejtim të futjes së licencës për revizorë të brendshëm

Institucioni: Ministria për Financa, institucionet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale

Kategoria: Mbikëqyrja dhe kontrolli

Pyetja-indikator: Me zgjidhjen aktuale ligjore në LKBFP, a është paraparë procedurë për licencimin e revizorëve të brendshëm, e cila është e zbatueshme?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Nevoja për trajnimin dhe certifikimin e revizorëve të brendshëm në sektorin publik në vend është rregulluar me dispozitat e nenit 36 të Ligjit për kontroll të brendshëm financiar publik dhe me Rregulloren për programin dhe mënyrën e dhënies së provimit për revizor të brendshëm të autorizuar në sektorin publik (“Gazeta zyrtare” numër 136/10). Në fakt, me dispozitat e ligjit të përmendur është rregulluar se revizorët e brendshëm të autorizuar në sektorin publik mund të jenë persona të emëruar, të cilët përveç kushteve të tjera, patjetër duhet “të kenë ndjekur trajnim dhe ta kenë dhënë provimin për revizor të brendshëm të autorizuar në sektorin publik, sipas Programit për dhënien e provimit për revizor të brendshëm të autorizuar ose të posedojnë certifikatë për revizor që është e njohur ndërkombëtarisht”.¹⁶³

Në vitin 2013 u miratua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontroll të brendshëm financiar publik. Me ndryshimet e miratuara bëhet rregullimi i kushteve dhe mënyra e zbatimit të trajnimit dhe e dhënies së provimit për revizor të brendshëm të autorizuar në sektorin publik, neni 35 dhe 36 i LKBFP. Nenet e ndryshuara në mënyrë të detajuar i përshkruajnë kushtet dhe mënyrën e zbatimit të trajnimit dhe të provimit për revizor të brendshëm të autorizuar në sektorin publik.

¹⁶² Strategjia për zhvillimin e kontrollit të brendshëm financiar publik në vend prej vitit 2013 deri në vitin 2016, propozim, faqe 20

¹⁶³ Ligji për Kontrollin e brendshëm financiar publik dhe Rregullorja për programin dhe mënyrën e dhënies së provimit për revizor të brendshëm të autorizuar në sektorin publik (“Gazeta zyrtare” numër 136/10)

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në praktikë, edhe përkundër asaj se sipas dispozitave ekzistuese në LKBFP u miratua akti nënligjor me të cilin u rregullua mënyra e dhënies së provimit dhe marrja e vërtetimit për provim të dhënë për revizor të brendshëm të autorizuar në sektorin publik, deri tani, e poashtu edhe para miratimit të ndryshimeve të fundit të ligjit në vitin 2013, nuk është organizuar dhënia e këtij provimi.

Procedura e re që është paraparë, me të cilën lokalizohet certifikimi, do të zbatohet një vit pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të LKBFP (08.01.2015)

Edhe pse procedura e re është definuar në mënyrë të detajuar, Raporti i përgatitur nga ana e Grupit për lokalizimin e trajnimeve për certifikimin e kontabilistëve dhe revizorëve të brendshëm në sektorin publik, që është krijuar me vendimin e ministrit për financa, në punëtorinë SWOT të mbajtur më 1 mars 2014, konstaton disa dobësi dhe kërcënime për sistemin e ri të definuar për trajnim dhe certifikim.¹⁶⁴

Institucioni: Ministria për Financa, institucionet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale

Kategoria: Mbikëqyrja dhe kontrolli

Pyetja-indikator: A janë modalitetet për licencim ndërkombëtar të revizorëve të brendshëm, adekuate me nevojat e revizorëve të brendshëm në sektorin publik?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Revizionin e brendshëm të subjektet e sektorit publik e kryejnë revizorët e brendshëm, në përputhje me standardet e pranuar profesionale, të cilat janë të bazuara në standardet ndërkombëtare për kryerjen profesionale të revizionit të brendshëm¹⁶⁵.

Standardi 1210 nga Standardet ndërkombëtare për kryerjen profesionale të revizionit të brendshëm e rregullon nevojën që revizorët e brendshëm të sektorit publik të kenë njohuri, shkathtësi dhe kualifikime të tjera që janë të nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre.

Sipas nenit 36-a, paragrafi 6 i LKBFP, gjegjësisht me ndryshimet e LKBFP të vitit 2013, kandidatët të cilët me sukses e kanë kaluar trajnimin dhe e kanë dhënë një pjesë të moduleve përkatëse në kuadër të provimit për certifikatën CIPFA (e cila është e pranuar ndërkombëtarisht) për revizor

¹⁶⁴ Raport i punëtorisë SWOT për lokalizimin e trajnimeve për certifikimin e kontabilistëve dhe të revizorëve të brendshëm në sektorin publik në vend, mbajtur më 5 mars 2014

¹⁶⁵ Standardet ndërkombëtare për kryerjen profesionale të revizionit të brendshëm, "Gazeta zyrtare" nr. 136/10

të brendshëm të autorizuar në sektorin publik, u pranohen modulet që i kanë dhënë, dhe në kuadër të këtij provimi hyjnë vetëm në modulet që nuk i kanë dhënë dhe pasi t'i japin ato, u jepet certifikatë sipas nenit 36-n të ligjit.

Nenet¹⁶⁶ të cilat detajisht e përshkruajnë procedurën e trajnimit dhe të dhënies së provimit për revizor të brendshëm të autorizuar, do të fillojnë të zbatohen një vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji (08.01.2015)

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në mungesë të një sistemi të lokalizuar për certifikim, në vitin 2012, Ministria për Financa, në bashkëpunim me CEF nga Sllovenia dhe CIPFA nga Britania e Madhe, filluan me realizimin e projektit “Trajnimi i revizorëve të brendshëm në sektorin publik”.¹⁶⁷ Me këtë projekt, për herë të parë në vend u bë certifikimi ndërkombëtar i revizorëve të brendshëm në sektorin publik.

Projekti përfshin 65 revizorë të brendshëm nga sektori publik (50 revizorë nga niveli qendror dhe 15 revizorë nga niveli lokal), të cilët i kanë ndjekur trajnimet të ndarë në dy grupe dhe të cilët e kanë përfunduar procedurën e certifikimit.

Strategjia për KBFP parasheh aktivitete me të cilat në periudhën e ardhshme (2014/2015) duhet të vazhdohet zbatimi i aktiviteteve për realizimin e ciklit të ri të trajnimeve për marrjen e certifikatës ndërkombëtare, si dhe të vazhdohet me trajnimet CIPFA në sektorin publik.¹⁶⁸

Institucioni: Ministria për Financa

Kategoria: Resurset dhe kapaciteti

Pyetja-indikator: A parasheh sistemi për KBFP lokalizim të trajnimeve për certifikim të revizorëve të brendshëm në sektorin publik në vend?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Në vitin 2013 u miratua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontroll të brendshëm financiar publik. Me ndryshimet e miratuara bëhet rregullimi i kushteve dhe mënyra e realizimit lokal të trajnimeve dhe të dhënies së provimit për revizor të brendshëm të autorizuar në

166 Nenet 36-a, 36-b, 36-v, 36-g, 36-d, 36-gj, 36-e, 36-zh, 36-z, 36-x, 36-i, 36-j, 36-k, 36-l, 36-lj, 36-m, 36-n, 36-nj, 36-o dhe 36-p

167 Ministria për Financa, Kontrolli i brendshëm financiar publik < <http://finance.gov.mk/node/92>>

168 Strategjia për zhvillimin e kontrollit të brendshëm financiar publik në vend prej vitit 2013 deri në vitin 2016, propozim, faqe 44

sektorin publik, neni 35 dhe 36 i LKBF-së. Nenet e ndryshuara detajisht i përshkruajnë kushtet dhe mënyrën e realizimit të trajnimit dhe të provimit për revizor të brendshëm të autorizuar në sektorin publik.

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në praktikë, më parë nuk kishte sistem të lokalizuar të trajnimeve për revizorët e brendshëm të licencuar, por ato zbatoheshin nëpërmjet projekteve siç ishte projekti Twinning “Trajnimi i revizorëve të brendshëm në sektorin publik”, që u realizua në vitin 2012 ndërmjet Ministrisë për Financa, në bashkëpunim me CEF nga Sllovenia dhe CIPFA nga Britania e Madhe.

Zëvendëskryetari i Qeverisë dhe ministër për financa, z. Zoran Stavreski, më 13.09.2013 solli Vendim për formimin e grupit të punës për kryerjen e punëve për lokalizimin e trajnimeve për certifikimin e kontabilistëve dhe të revizorëve të brendshëm në sektorin publik.¹⁶⁹ Anëtarët e grupit të punës kanë për obligim/detyrë: të bëjnë SWOT analizë për lokalizimin e trajnimeve për certifikimin e kontabilistëve dhe të revizorëve të brendshëm në sektorin publik; të përgatisin plan strategjik për të dhe të përgatisin një pasqyrë të rregullativës dhe të japin propozime për ndryshimin eventual të saj, me qëllim të lokalizimit të trajnimeve.

Në lidhje me mënyrën e lokalizimit të programeve për trajnim dhe certifikim – fushat për vendosje, u miratuan disa përfundime, në mesin e të cilave edhe ajo se Ministria për Financa në periudhën e ardhshme duhet të sjellë vendim për¹⁷⁰:

- Institucionin-bartës të trajnimeve;
- njohjen e provimeve në kuadër të dy programeve për trajnim të revizorëve të brendshëm dhe kontabilistëve në sektorin publik dhe dhënien e provimeve diferenciale;
- kufizimin e obligimit për posedimin e detyrueshëm të certifikatës në aspekt të numrit të viteve deri në pensionim të revizorit, gjegjësisht kontabilistit të brendshëm;
- titujt e revizorëve, gjegjësisht kontabilistëve të brendshëm, në përputhje me certifikatat e marra;
- zgjedhje ndërmjet tre modeleve për zbatimin e programit për trajnim dhe certifikim:
 - o modeli nacional, i cili nënkupton organizimin dhe realizimin e pavarur të gjithë procesit të trajnimit dhe të certifikimit;
 - o anëtarësimi në CIPFA, që nënkupton pagesën e anëtarësisë vjetore, përditësimin vjetor të materialeve për mësim, sigurim të trajnuesve ose
 - o bashkëpunimi me CEF-in (i cili është i lidhur me CIPFA-n) – modeli i kombinuar.

¹⁶⁹ Vendimi për formimin e grupit të punës për kryerjen e punëve për lokalizimin e trajnimeve për certifikimin e kontabilistëve dhe të revizorëve të brendshëm në sektorin publik, miratuar më 13.09.2013

¹⁷⁰ Vendimi për formimin e grupit të punës për kryerjen e punëve për lokalizimin e trajnimeve për certifikimin e kontabilistëve dhe revizorëve të brendshëm në sektorin publik në vend i miratuar më 13.09.2013

Institucioni: Ministria për Financa

Kategoria: Resurset dhe kapaciteti

Pyetja-indikator: A mendoni se janë adekuate mënyra dhe kushtet e parapara për certifikimin e revizorëve të brendshëm?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

- Në përputhje me dispozitat e Ligjit për KBFP të vitit 2009, u miratua Rregullorja për programin dhe mënyrën e dhënies së provimit për revizor të brendshëm të autorizuar në sektorin publik. Pastaj, nenet 35 dhe 36 nga ndryshimet e LKBFP-së, të miratuara në vitin 2013, në mënyrë të detajuar i përcaktojnë procedurat për emërimin e udhëheqësve të njësive për revizion të brendshëm, revizorëve të brendshëm të autorizuar, revizorëve të brendshëm dhe revizorëve të brendshëm që janë në trajnim.

Për **udhëheqës të njësisë për revizion të brendshëm** mund të emërohet: revizori i brendshëm i autorizuar që i plotëson kushtet e nenit 36, paragrafi (2) alinetë 1, 2 dhe 4 të këtij ligji dhe^{171*} ka së paku tre vjet përvojë pune në fushën e revizionit të brendshëm ose të jashtëm.

Neni 36, paragrafi 2 thekson se për **revizorë të brendshëm të autorizuar** mund të emërohen personat të cilët përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, i plotësojnë edhe këto kushte të veçanta: - të kenë të kryer arsim të lartë, ta kenë ndjekur trajnimin dhe ta kenë dhënë provimin për revizor të brendshëm të autorizuar në sektorin publik sipas Programit për dhënie e provimit për revizor të brendshëm të autorizuar ose të posedojnë certifikatë për revizor që është e njohur ndërkombëtarisht; të kenë së paku dy vjet përvojë punë në revizionin e brendshëm ose të jashtëm dhe me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar masa e ndalesës për kryerjen e veprimtarisë ose profesionit përderisa zgjat ndalesa;

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në praktikë, edhe pse më parë dhe me miratimin e ndryshimeve në LKBFP në vitin 2013 (zbatimi i të cilave do të fillojë në vitin 2015) u miratua akti nënligjor me të cilin rregullohej mënyra e dhënies provimit dhe e marrjes së vërtetimit për provimin e dhënë për revizor të brendshëm të autorizuar në sektorin publik, deri më tani nuk është organizuar dhënia e këtij provimi, me çka kjo dispozitë e ligjit nuk është e zbatueshme. Me këtë rast, mund të konsatohet se moszbatimi i këtyre dispozitave në praktikë ka ndikim në profesionalizmin e revizorëve të brendshëm në sektorin publik në vend.

171 * Do të zbatohet prej 1 janarit të vitit 2017

Institucioni: Ministria për Financa

Kategoria:

Pyetja-indikator: Sa është numri dhe çfarë lloj trajnimesh për revizorë të brendshëm janë realizuar?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Neni 36-b paragrafi 1, Qeveria me propozim të Ministrisë për Financa për çdo vit fiskal miraton program për realizimin e trajnimit dhe provimit për revizorë të brendshëm të autorizuar në sektorin publik, ku definohen elementet kryesore të programit, e në mes tjerash veçanërisht numri i kandidatëve, financimi nga buxheti i vendit dhe financimi kandidatëve pjesëmarrës.

Mënyra e realizimit të trajnimit zhvillohet duke angazhuar revizorë të brendshëm të autorizuar në sektorin publik – edukatorë dhe Komisioni për verifikim, ndërsa provimi realizohet nga ana e Ministrisë për Financa në mënyrë transparente (inçizohet drejtpërdrejt dhe emitohet në ueb-faqen e Ministrisë për Financa, neni 36-z, paragrafi 3.)

Neni 36-g parasheh se trajnimi dhe provimi realizohen sipas programit për përmbajtjen e moduleve dhe afateve në të cilat realizohen trajnimet dhe provimet, ndërsa neni 36-d i përcakton modulet dhe mënyrën e dhënies së tyre. Në nenin 36-a, paragrafi 6 theksohet se kandidatëve të cilët i kanë dhënë modulet për certifikatën e njohur ndërkombëtarisht për revizorë CIPFA, ato u pranohen si të dhëna.

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në periudhën e kaluar, që nga futja e sistemit për kontroll të brendshëm financiar publik, janë realizuar një numër i madh trajnimesh për përforcimin e funksionit të revizorit të brendshëm. Këtu, me rëndësi të veçantë është trajnimi i realizuar në bashkëpunim me CEF-in nga Sllovenia, projekt ky në kuadër të të cilit janë certifikuar 65 revizorë të brendshëm.

Në Strategjinë për KBFP thuhet se në periudhën 2008-2011, 25 nëpunës shtetërorë e morën certifikatën ndërkombëtare, ndërsa 23 prej tyre e përfunduan edhe pjesën e dytë të trajnimit dhe morën diplomë ndërkombëtare të lëshuar nga CIPFA. Vitin e parë, në kuadër të programit dyvjeçar ndërkombëtar për certifikimin e kontabilistëve në sektorin publik për periudhën prej marsit të vitit 2012 deri në muajin mars të vitit 2013, atë e përfunduan 24 nëpunës shtetërorë dhe morën certifikatë ndërkombëtare të lëshuar nga CIPFA. Nga gjithsej 49 nëpunës shtetërorë që morën certifikatë, vetëm një numër i vogël janë në vendin e punës kontabilist përgjegjës.

Në Strategji është detektuar nevoja për organizimin e trajnimeve (të vazhdueshme) për revizorët, llojet e specializuara të revizionit, organizimin e provimeve për revizor të brendshëm të autorizuar në sektorin publik, realizimin e revizioneve vertikale dhe horizontale, si dhe realizimin

e analizave të përvojave të vendeve të tjera për pranimin e modelit për kryerjen e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të kualitetit të funksionit të revizorit të brendshëm. Me këtë rast, Strategjia për KBFP parasheh Aktivitetin – Integrimi i trajnimeve nga fusha e financimit publik në Akademinë ekzistuese tashmë, e cila do t'i zbatojë trajnimet nga fusha e financave publike, duke e përfshirë edhe menaxhimin dhe kontrollin financiar, revizionin e brendshëm, kontabilitetin dhe politikën tashmë, në kompetencë të Ministrisë për Financa, me afat deri në vitin 2014.¹⁷² Poashtu, edhe Strategjia për reforma në administratën publike për periudhën 2011-2015, parasheh zbatim të trajnimit dhe certifikim të 80 revizorëve të rinj të brendshëm, në Planin e saj aksional me afat deri në vitin 2013. Ky afat është zhvendosur dhe tani është deri në vitin 2014.¹⁷³

Aktiviteti 3. Krijimi dhe ekipimi i njësive për çështje financiare (NJÇF) të të gjithë shfrytëzuesit buxhetorë nga pushteti ligdhënës, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe fondet

Institucioni: Ministria për Financa, institucionet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale

Kategoria: Mbikëqyrja dhe kontrolli

Pyetja-indikator: A mendoni se zgjidhje ekzistuese ligjore për krijimin e NJÇF-ve të të gjithë shfrytëzuesit buxhetorë nga administrata publike i jep rezultatet e pritura?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Në përputhje me nenin 9 të Ligjit për KBFP, udhëheqësi i subjektit është i obliguar që të themelojë njësi të veçantë organizative për çështje financiare, udhëheqësi i së cilës në mënyrë të drejtpërdrejtë i përgjigjet udhëheqësit të subjektit dhe nëpunësit më të lartë udhëheqës shtetëror.

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi: Deri në fund të muajit prill të vitit 2013, 64% e institucioneve të pushtetit qendror dhe e fondeve dhe 48% e komunave, themeluan njësi të veçanta për çështje financiare, ndërsa 49% e institucioneve të pushtetit qendror dhe fondeve dhe 42% e komunave, emëruan udhëheqës të këtyre njësive.

Komunat dhe shfrytëzuesit më të vegjël të drejtpërdrejtë buxhetorë, për shkak të mungesave të kuadrove, gjegjësisht numrit të vogël të të punësarve dhe mjeteve të kufizuara financiare për shkak të buxhetit të vogël, u ballafaquan me vështirësi gjatë themelimit të njësive të veçanta për çështje financiare. Kjo e imponon nevojën për vendosjen e sistemit, në përputhje me të cilin do të mundësohet që njësitë për çështje financiare të punojnë në mënyrë më efektive dhe më efektive.

Të dhënat e fundit që janë vendosur në ueb-faqen e MF-së, e tregojnë gjendjen e mëposhtme:

¹⁷² Strategjia për zhvillimin e kontrollit të brendshëm financiar publik në vend prej vitit 2013 deri në vitin 2016, propozim, faqe 45

¹⁷³ Intervistë me përfaqësuesin e Ministrisë për Financa, e realizuar në maj të vitit 2014

	2009	2010	2011	2012	prill 2013	qershor 2013	shtator 2013	dhjetor 2013	prill 2014
Numri i institucioneve që kanë themeluar <i>njësi për çështje financiare</i>	14	32	39	46	49	49	66	66	66
Numri i <i>udhëheqësve</i> të emëruar të njësive për çështje financiare	0	20	30	36	37	36	42	42	42

Institucioni: Ministria për Financa, institucionet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale

Kategoria: Resurset dhe kapaciteti

Pyetja-indikator: A janë NJÇF-të të ekipuara sa duhet, në përputhje me zgjidhjet e parapara ligjore në LKBFP?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Ligji për KBFP parasheh obligim për themelimin e NJÇF-ve të të gjithë shfrytëzuesit buxhetorë, mirëpo me këtë rast nuk përcakton kritere për ekipim të Njësive për çështje financiare. Çështja e ekipimit të NJÇF-së nuk trajtohet as në Rregulloren për mënyrën e kryerjes së punëve që janë në kompetencë të njësive për çështje financiare.

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Edhe pse rregullativa ligjore nuk përmban kritere për ekipimin e NJÇF-ve, mund të konstatohet se ato as nuk janë themeluar në kuadër të të gjithë shfrytëzuesve buxhetorë, në përputhje me obligimin ligjor, e as që janë të ekipuara në mënyrë adekuate.

Strategjia për KBFP detekton se komunat dhe shfrytëzuesit më të vegjël të drejtpërdrejtë buxhetorë, për shkak të mungesës së kuadrove, gjegjësisht për shkak të numrit të vogël të të punësuarve dhe mjeteve të kufizuara financiare për shkak të buxhetit të vogël, u ballafaquan me vështirësi gjatë themelimit të njësive të veçanta organizative për çështje financiare.¹⁷⁴ Me qëllim të tejkalimit të vështirësive në funksionimin e NJÇF-ve të subjektet e vogla, Programi nacional për miratimin e legjislacionit të BE-së – NPAA, në Kreun 23, Kontrolli financiar, parasheh miratimin e ndryshimeve dhe plotësimeve në Ligjin për KBFP gjatë vitit 2014 (nëntor)¹⁷⁵, sipas të cilave, komunat më të vogla do të lirohen nga obligimi për formimin e NJÇF-së.¹⁷⁶

¹⁷⁴ Strategjia për zhvillimin e kontrollit të brendshëm financiar publik në vend prej vitit 2013 deri në vitin 2016, propozim, faqe 29

¹⁷⁵ Programi nacional për miratimin e legjislacionit të BE-së – NPAA pjesa narrative, Kreu 3.32, Kontrolli financiar

¹⁷⁶ Strategjia për zhvillimin e kontrollit të brendshëm financiar publik në vend prej vitit 2013 deri në vitin 2016, propozim, faqe 30 dhe SIGMA Assessment on the Republic of Macedonia, 2013, Public Internal Financial Control, faqe 30

Institucioni: Ministria për Financa, institucionet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale

Kategoria: Mbikëqyrja dhe kontrolli

Pyetja - indikator: A kontribuon futja e formave të reja institucionale në sistemin e KBFP-së për forcimin e tij real?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Procesi i përforcimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik në vend ka filluar në vitin 2000¹⁷⁷ dhe ai e përfshin futjen e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar nëpërmjet LKBFP-së, akteve të ndryshme nënligjore, doracakëve, metodologjive dhe dokumenteve të tjera. Qëllimi është të ndërtohet sistem, i harmonizuar me kërkesat e acquis, i cili garanton shfrytëzim të arsyeshëm të mjeteve publike duke i zbatuar parimet e përgjegjësisë së decentralizuar të udhëheqësisë dhe vendosje të revizionit të brendshëm të pavarur dhe funksional.¹⁷⁸ Njësitë për çështje financiare janë pjesë qendrore e sistemit për KBFP, kompetencat e të cilit janë definuar në Rregulloren për mënyrën e kryerjes së punëve që janë në kompetencë të njësisë për çështje financiare (“Gazeta zyrtare” nr. 147/10, 34/11). Strategjia për Reforma në administratën publike thekson se funksioni kryesor i NJÇF-së është “zbatimi i proceseve financiare për planifikim, ekzekutim, mbikëqyrje dhe njoftim për: mbledhjen e të hyrave të parapara në buxhet; menaxhim dhe kontroll për ekzekutimin e shpenzimeve të miratuara në buxhet; dhe mbrojtja e mjeteve dhe e obligimeve, vlera e të cilave është evidentuar në bilancin e gjendjes.”¹⁷⁹

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në praktikë ka probleme rreth formimit, ekipimit dhe funksionimit të njërive për çështje financiare. Nëse janë formuar, ekipuar dhe funksionojnë ashtu siç është paraparë – Po, duhet të kontribuojnë për forcimin e sistemit.¹⁸⁰

177 Sektori për Kontroll të brendshëm financiar publik , <<http://www.finance.gov.mk/node/92>>

178 Sektori për Kontroll të brendshëm financiar publik, <<http://www.finance.gov.mk/node/92>>

179 Strategjia për Reformën e administratës publike 2010-2015, dhjetor 2010, faqe 58

180 Intervistë me përfaqësues të Entit shtetëror për revizion, realizuar në prill të vitit 2014

Institucioni: Ministria për Financa, institucionet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale, administrata publike

Kategoria: Resurset dhe kapaciteti

Pyetja-indikator: A është trajnuar në mënyrë adekuate kuadri që është i angazhuar në këto njësi?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Strategjia për KBFP për periudhën 2013-2016 parasheh futjen e trajnimeve gjenerike për menaxhim dhe kontroll financiar nga ana e MSHIA-së, në koordinim me Ministrinë për Financa, në përputhje me aktivitetet e parapara për periudhën e ardhshme, në nivel të administratës publike.¹⁸¹ Strategjia për Administratën publike për periudhën 2011-2015, parasheh aktivitet për Realizimin e aktiviteve për forcim të kapaciteteve për revizion të brendshëm në komuna për vitin 2013, në përputhje me Planin e saj aksional.

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Gjatë viteve të kaluara, udhëheqësit dhe të punësuarit në njësitë për çështje financiare, në organizim të NJQH-së dhe partnerëve-twinning, u trajnuan për fushat kryesore të sistemit të KBFP, si dhe për përfitimet nga zbatimi i këtij sistemi. Kjo praktikë e promovimit dhe e zhvillimit të sistemit për KBFP do të vazhdojë edhe në periudhën e ardhshme, nëpërmjet koordinimit dhe bashkëpunimit të NJQH-së dhe Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratë (MSHIA).¹⁸² Mirëpo, edhe pse më parë në MSHIA ka ekzistuar praktika e realizimit të trajnimeve për punën financiare, kjo nuk bëhet tani, për shkak të faktit se MSHIA-ja nuk e ka pranuar kërkesën e Ministrisë për Financa për përfshirjen e trajnimeve për punën financiare dhe menaxhimin me rreziqet në pjesën e trajnimeve gjenerike.¹⁸³

181 Strategjia për zhvillimin e kontrollit të brendshëm financiar publik në vend prej vitit 2013 deri në vitin 2016, propozim, faqe 50

182 Strategjia për zhvillimin e kontrollit të brendshëm financiar publik në vend prej vitit 2013 deri në vitin 2016, propozim, faqe 29

183 Intervistë me përfaqësues të MSHIA-së, realizuar në vitin 2014

Problemi/Faktori i rrezikut 3:

Mungesa e vlerësimit të rrezikut nga paraqitja e korrupsionit në institucionet e administratës publike

Arsyetimi:

Mundësitë për parandalimin e korrupsionit në administratën publike rriten dukshëm në qoftë se paraprakisht është bërë vlerësimi dhe identifikimi i vendeve dhe i procedurave ku është e mundshme paraqitja e tij. Vlerësimi paraprak i këtij lloji mundëson koncentrim të parandalimi dhe zbulimi i korrupsionit në të ashtuqajturat pika neuralgjike, si dhe përforsim plotësues të procedurave me qëllim të mbrojtjes nga korrupsioni.

Aktiviteti 1. Përgatitja e Strategjisë për menaxhim me rreziqet dhe e Regjistrit për rreziqe të shfrytëzuesit e drejtpërdrejtë buxhetorë dhe të fondet

Institucioni: Ministria për Financa

Kategoria: Mbikëqyrja dhe kontrolli

Pyetja-indikator: A është përgatitur Strategjia për menaxhim me rreziqet të shfrytëzuesit e drejtpërdrejtë buxhetorë dhe të fondet, që paraqet obligim ligjor sipas rregullativës?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Ligji për KBFP e përcakton obligimin në nenin 15, paragrafi 2, për miratimin e detyrueshëm të Strategjisë për menaxhim me rreziqet nga ana e udhëheqësit të subjektit, e cila duhet të përditësohet çdo tre vjet.¹⁸⁴ Procedura dhe mënyra e përgatitjes së Strategjisë është përshkruar në mënyrë të detajuar në Doracakun për menaxhim dhe kontroll financiar. Programi nacional për miratimin e legjislacionit të BE-së – NPAA, në Kreun 3.23, Kontrolli financiar, si masë për vitin 2014 e thekson miratimin e Udhëzimeve për zbatimin e procesit të menaxhimit me rreziqet si dhe Udhëzimit për përgatitjen e Strategjisë për menaxhim me rreziqet.

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Njësia qendrore për harmonizim në Ministrinë për Financa, në janar të vitit 2014 i përgatiti Udhëzimet për zbatimin e procesit të menaxhimit me rreziqet dhe Udhëzimin për përgatitjen e Strategjisë për menaxhim me rreziqet, të dyja me qëllim të vendosjes së mënyrës sistemore për menaxhim me rreziqet. Megjithatë, në praktikë, i vogël është numri i institucioneve që kanë përgatitur Strategji për menaxhim me rreziqet ose që i kanë përditësuar ato.¹⁸⁵ Në dokumentin

¹⁸⁴ Ligji për Kontrollin e brendshëm financiar publik, ("Gazeta zyrtare" nr. 90/09, 12/11, 188/13), neni 15, paragrafi 2.

¹⁸⁵ Acevski, Maksim. ANALIZA KUALITATIVE e masave antikorrupive dhe zbatimi i Programit shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit/parandalimin dhe zvogëlimin e dukurisë së konfliktit të interesave në vetëveqeverisjen lokale, fq. 38

Udhëzime për zbatimin e procesit të menaxhimit me rreziqet thuhet se “pasi të vendoset procesi për menaxhim me rreziqet dhe të përforcohet vetëdija për rëndësinë e menaxhimit me rreziqet, udhëheqësi i shfrytëzuesit buxhetor duhet të miratojë Strategji për menaxhim me rreziqet, që është edhe obligim i tij ligjor”¹⁸⁶, pa përmendur me këtë rast ndonjë afat kohor për miratimin e saj. Udhëzimi duhet t’i nënshtrohet debatit publik në periudhën e ardhshme, dhe pas harmonizimit të tij, ai duhet të shfrytëzohet si bazë për përgatitjen e Strategjisë për menaxhim me rreziqet nga ana e të gjitha organeve kompetente.¹⁸⁷ Nga ana tjetër, KSHPK-ja në këtë moment bashkëpunon me UNDP-në në një projekt, sipas të cilit duhet të ndërtohet koncept për qasje metodologjike sa i përket vlerësimit të rreziqeve (risk assessment) në nivel të administratës publike, duke e pasur parasysh punën e Sektorit për KBFP dhe përgatitjen e Strategjisë së tyre.¹⁸⁸

Institucioni: Ministria për Financa, institucionet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale

Kategoria: Transparenca/Llogaridhënia

Pyetja-indikator: A është përgatitur dhe a zbatohet Regjistri për rreziqet të shfrytëzuesit e drejtpërdrejtë buxhetorë dhe të fondet?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Doracaku për menaxhim dhe kontroll financiar parasheh krijimin e ‘regjistrit të rreziqeve’ në nivel të njësisë organizative dhe përmban edhe formular për atë se çka duhet të përmbajë regjistri i rreziqeve. Në fakt, regjistri i rreziqeve duhet ta “përmbajë emrin e njësisë organizative, emrin e rrezikut, vlerësimin e efekteve dhe gjasave, personat përgjegjës – pronarin e rrezikut, aktivitetet që duhet të ndërmerren me qëllim të zvogëlimit të rrezikut, personat që do t’i realizojnë ato aktivitete dhe afati i realizimit, si dhe data për shqyrtimin e ardhshëm të atij rreziku.”¹⁸⁹ Udhëzimi për përgatitjen e Strategjisë për menaxhim me rreziqet parasheh nevojën e ekzistimit edhe të Regjistrit të rreziqeve në çdo institucion kompetent. Udhëzime më konkrete për krijimin e regjistrit të rreziqeve janë dhënë në Udhëzimet për zbatimin e procesit të menaxhimit me rreziqet, ku parashihet marrja e vendimit për krijimin e Regjistrit dhe sqarohen nivelet në të cilat do të krijohet ai.¹⁹⁰

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

186 Udhëzime për zbatimin e procesit të menaxhimit me rreziqet, Ministria për Financa, Shkup 2014, fq. 34

187 Intervistë Ministria për Financa, realizuar në maj të vitit 2014 dhe Kontributi për Raportin e përparimit të vendit tonë, i datës, 02.05.2014, fq. 289

188 Intervistë për përfaqësuesit e Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit, realizuar në prill të vitit 2014

189 Doracak për menaxhimin dhe kontrollin financiar, Ministria për Financa, dhjetor 2010, fq. 73

190 Udhëzimet për zbatimin e procesit të menaxhimit me rreziqet, Ministria për Financa, janar 2014, fq. 12

Arsyetimi:

Në përputhje me mungesën e lartëpërmendur të Strategjive për menaxhim me rreziqet në nivel të administratës publike, mund të përfundohet se mungojnë edhe Regjistrat e rreziqeve.

Institucioni: Ministria për Financa, institucionet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale

Kategoria: Llogaridhënia

Pyetja-indikator: Në praktikë, a bëhet vlerësimi i rreziqeve dhe a detektohen mangësitë që duhet të trajtohen në Strategji?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Doracaku për planifikim strategjik, i botuar nga Sekretariati gjeneral i Qeverisë në vitin 2007, përcakton obligim për shfrytëzuesit buxhetorë që të miratojnë plane strategjike për punë, të cilat duhet të përmbajnë edhe informata për trajtimin e rreziqeve që mund të ndikojnë mbi realizimin e qëllimeve. Në nivel lokal, menaxhimi me rreziqet gjendet në strategjitë komunale, ndërsa institucionet që zbatojnë programe të BE-së, menaxhimin me rreziqet nga zbatimi i fondeve të BE-së duhet ta integrojnë në strategjitë për menaxhim me rreziqet.

Me këtë rast, u përgatit Udhëzimi për përgatitjen e Strategjisë për menaxhim me rreziqet ku janë identifikuar të gjitha elementet përbërëse që u përmendën më lartë, e cila do të paraqesë “kornizë sistemore dhe qasje strukturore për përcaktimin dhe menaxhimin me rreziqet te subjektet.”¹⁹¹

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Edhe pse Ligji për KBFP dhe Doracaku për menaxhim financiar dhe kontroll parashohin procese për vlerësimin e rreziqeve në nivel të njërive organizative, në praktikë mungon vlerësimi real i rreziqeve dhe ballafaqimi me to. Një qasje më e sistematizuar për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve do të duhej të kishte pas miratimit të Strategjive për menaxhim me rreziqet dhe Regjistrave të rreziqeve, të cilat ka vonesë në krahasim me atë që është paraparë në NPAA, në Kreun për Kontrollin financiar. “Pritet që këto aktivitete të përforcohen dhe efektet e implementimit të tyre të jenë më të dukshme në të ardhmen.”¹⁹²

Aktiviteti 2. Realizimi i vetë-vlerësimeve vjetore për proceset e veçanta me rrezik të lartë të sistemit për financim dhe kontroll financiar

191 Udhëzim për përgatitjen e Strategjisë për menaxhim me rreziqet, Ministria për Financa, janar 2014, fq. 4

192 Kontribut për Raportin për përparimin e vendit tonë nga KE-ja për vitin 2013, fq. 289

Institucioni: Ministria për Financa, institucionet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale

Kategoria: Llogaridhënia

Pyetja-indikator: A parasheh rregullativa ligjore realizim të vetë-vlerësimeve¹⁹³ për proceset e veçanta me rrezik të lartë të sistemit për financim dhe kontroll financiar?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Ligji për KBFP, në nenin 18, paragrafi 3 parasheh se “Udhëheqësi i subjektit, nëpërmjet njësisë për çështje financiare, gjatë vitit bën vetë-vlerësim të proceseve të veçanta të sistemit për menaxhim dhe kontroll financiar në subjektin me të cilin udhëheq, ndërsa njëherë në pesë vjet bën vetë-vlerësim të strukturës dhe të financimit të gjithë sistemit për menaxhim dhe kontroll financiar.”¹⁹⁴ Pastaj, në paragrafin 8 të po të njëjti nen, thuhet se “Udhëheqësi i subjektit në raportin vjetor financiar, sipas nenit 47 të këtij ligji, jep mendim për menaxhimin dhe kontrollin financiar.”¹⁹⁵ Në Doracakun për menaxhim dhe kontroll financiar thuhet se raporti financiar vjetor përmban edhe raport për vetë-vlerësimet e realizuara sipas nenit 18, paragrafi (3) dhe (8) të këtij ligji (rezulate nga vetë-vlerësimet që nuk janë plotësisht pozitive, komente të udhëheqësit të subjektit që kanë të bëjnë me rekomandimet nga vetë-vlerësimet dhe mendim për menaxhimin dhe kontrollin financiar).¹⁹⁶

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në praktikë, edhe pse zbatimi i vetë-vlerësimeve është obligim i revizionit të brendshëm, që në fund të vitit të bëjë vlerësim të fushave ose proceseve të rrezikshme dhe të japë rekomandim për përmirësim, që të shohë se si funksionojnë kontrollet dhe të japë rekomandim për përmirësim, kjo mundon të numri më i madh i shfrytëzuesve buxhetorë.¹⁹⁷ Nga ana tjetër, Ministria për Financa konsideron se vlerësime të tilla bëhen vetëm nga ana e një numri të caktuar institucionesh, përveç raporteve që bëhen nga revizioni i brendshëm dhe revizioni që bëhet nga Enti shtetëror për revizion.

¹⁹³ Doracak për Menaxhimin dhe kontrollin financiar, Ministria për Financa, Shkup, dhjetor 2010, fq. 84 dhe Ligji për Kontroll të brendshëm financiar publik, (“Gazeta zyrtare” nr. 90/09, 12/11, 188/13), neni 18, paragrafi (3) dhe (8))

¹⁹⁴ Ligji për Kontroll të brendshëm financiar publik, (“Gazeta zyrtare” nr. 90/09, 12/11, 188/13), neni 18, paragrafi 3.

¹⁹⁵ Ligji për Kontroll të brendshëm financiar publik, (“Gazeta zyrtare” nr. 90/09, 12/11, 188/13), neni 18, paragrafi 8.

¹⁹⁶ Doracak për Menaxhimin dhe kontrollin financiar, Ministria për Financa, Shkup, dhjetor 2010, fq. , Ministria për Financa, Shkup, dhjetor 2010, fq. 84

¹⁹⁷ Intervistë me përfaqësues të Entit shtetëror për revizion, realizuar në prill të vitit 2014

Institucioni: Ministria për Financa, institucionet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale

Kategoria: Llogaridhënia

Pyetja-indikator: A ekziston procedurë që është paraparë për realizimin e vetë-vlerësimeve?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Nuk ekziston procedurë ose metodologji e paraparë për realizimin e vetë-vlerësimeve. Vetëm është përcaktuar nevoja dhe obligimi për realizimin e vetë-vlerësimeve, në përputhje me nenin 18 të Ligjit për KBFP.

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Vetë institucioni e zgjedh temën ose një fushë, ndërsa vlerësimi përmban vlerësim të përpunimit të procesit ose të procedurës dhe vlerësim të asaj se a janë në rregull apo jo, ai proces apo ajo procedurë.

Problemi/faktori i rrezikut 4:

Mungesa e masave të sistematizuara për parandalimin e korrupsionit (planet për integritet)

Arsyetimi:

Parandalimi i korrupsionit në institucionet e administratës publike do të ishte shumë më efikas në qoftë se që më parë do të përgatitej sistem me masa për parandalimin e tij, në bazë të vlerësimit për brishtësinë dhe rrezikun nga paraqitja e tij. “Planet e tilla për integritet” duhet t’i përgatisë çdo institucion i administratës publike dhe duhet të parashohë masa konkrete për parandalimin e korrupsionit në secilën nga pikat e identifikuara neuralgjike.

Aktiviteti 1. Ndryshimi i Ligjit për parandalimin e korrupsionit me futjen e obligimit ligjor për miratimin e planeve për integritet

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, Ministria e Drejtësisë

Kategoria: Integriteti

Pyetja-indikator: A janë përgatitur propozim-ndryshime të LPK-së me qëllim të futjes së obligimit ligjor për miratimin e planeve për integritet?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Në dhjetor të vitit 2013 janë përgatitur ndryshime dhe plotësime të Ligjit për parandalimin e korrupsionit në pjesën e futjes së Sistemit për integritet. Futja e sistemit për integritet është bërë obligim sipas Strategjisë për reforma në administratën publike 2010-2015, programit shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit 2011-2015, NPAA-së dhe Programit vjetor për punë të Qeverisë për vitin 2013. Qëllimi i miratimit të sistemit për integritet është futja e mbrojtjes sistemore të denoncuesve (whistleblowers), të cilët kanë alarmuar se është bërë ose do të bëhet ndonjë veprë penale kundër detyrës zyrtare ose ndonjë veprim tjetër joligjor ose i palejueshëm. Qëllimi gjithëpërfshirës i ndryshimit ligjor është zhvillimi i luftës më efektive kundër korrupsionit dhe mbrojtja e njerëzve që janë të gatshëm në interes të përgjithshëm ta ndihmojnë këtë luftë.

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në praktikë, për shkak të vonimit të miratimit të ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për parandalimin e korrupsionit, të cilat ishin paraparë të bëhen në vitin 2013, në përputhje me të cilat futet sistemi për integritet, ka ngecur edhe realizimi i obligimit ligjor për miratimin e planeve për integritet. Megjithatë, me miratimin e këtij ligji, do të fillohet me futjen e sistemit, i cili do të kontribuojë për forcimin e luftës së gjithëmbarshme kundër korrupsionit.

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit

Kategoria: Integriteti

Pyetja-indikator: A ekziston koncept për integritet që do të zhvillohej nga ana e KSHPK-së e që do të aplikohet në nivel të administratës publike?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, në vitin 2013 përgatiti Doracakun për integritet dhe konflikt të interesave, me përkrahje të UNDP-së. Qëllimi i këtij doracaku është pikërisht sqarimi i nevojës për futjen e konceptit të sistemit të integritetit në nivel të të gjitha subjekteve në sektorin publik dhe atë privat. “Koncepti i integritetit është pjesë përbërëse e sistemit të qeverisjes së mirë, [... me të cilin] nënkuptohet ndërtimi dhe kultivimi i frymës së integritetit në nivel personal dhe institucional, me çka do të nxitet edhe do të sigurohet pavarësia, profesio-

nalizmi dhe llogaridhënia në kryerjen e kompetencave të përcaktuara me ligjet dhe dispozitat tjera.”¹⁹⁸ Më tej, në Doracak janë theksuar elementet kryesore që do të duhej t’i përmbante sistemi për integritet edhe atë: 1. Politika e qartë dhe e qasshme antikorruptive, 2. Standardet dhe procedurat për fushat e veçanta, 3. Metodologjia për vlerësimin e rrezikut, 4. Përditësimi dhe përshtatja, 5. Përforsimi i kontrolleve të brendshme ekzistuese, 6. Trajnimi, 7. Kanalet e brendshme për denoncim dhe mbrojtja e denoncuesve të korrupsionit; 8. Procedurat dicyplimore; 9. Kontrolli i rregullt dhe revizioni i sistemit për integritet.¹⁹⁹

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në praktikë, Doracaku paraqet një vegël të dobishme, i cili, në qoftë se zbatohet do të kontribuonte për përforsimin e sistemit për integritet dhe luftës kundër korrupsionit. Mirëpo, ky doracak nuk ka natyrë obliguese ligjore dhe me këtë rast është vështirë për t’u vlerësuar se sa është implementuar ai në praktikë, veçanërisht rregullat që kanë të bëjnë me konfliktin e interesave, përgatitjen e doracaktut për politikatat dhe procedurat, përcaktimin e masave përkatëse dicyplimore, etj. në mungesë të rregullativës ligjore e cila do ta rregullonte këtë materie. Ky doracak tani është shpërndarë në nivel të komunave, ndërsa në nivel të institucioneve shtetërore duhet të shpërndahet në të ardhmen.²⁰⁰ Sa i përket zbatimit, veçanërisht në pjesën e procedurës së paraparë për denoncimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave në komunë (denoncimi i brendshëm), kjo tashmë zbatohet në disa komuna pilot.

Institucioni: Ministria për Financa, institucionet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale

Kategoria: Integriteti

Pyetja-indikator: A janë paraparë masa për parandalimin e korrupsionit (plane për integritet) dhe e kundërta në sistemin për KBFP?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Doracaku për menaxhim dhe kontroll financiar e përmend integritetin si një këshillë të dobishme për komponentet e menaxhimit dhe të kontrollit financiar. Me këtë rast, në kuadër, të këtyre këshillave janë dhënë edhe udhëzime për atë se çka duhet të përmbajë integriteti si p.sh. Kodin e sjelljes, rregullat që kanë të bëjnë me konfliktin e interesave, doracak për politikatat dhe proce-

198 Doracak për integritetin dhe konfliktin e interesave, Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, Shkup, 2013, fq. 7

199 Doracak për integritetin dhe konfliktin e interesave, Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, Shkup, 2013, fq. 11-13

200 Intervistë me përfaqësues të Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit, realizuar në prill të vitit 2014

durat, përcaktimin e procedurave përkatëse dicitinore, etj.²⁰¹ Njëkohësisht, edhe Doracaku për integritet dhe konflikt të interesave, gjatë definimit të elementeve kryesore të sistemit për integritet, e përmend Kontrollin e brendshëm financiar publik.²⁰² Poashtu, në përputhje me Ligjin për nëpunës publikë, i cili paraprakisht ishte në fuqi, është miratuar dhe është në fuqi Kodi etik për nëpunësit publikë, me të cilin deri diku rregullohen masat të cilat duhet të kontribuojnë për një sistem të integritetit.

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në praktikë, zhvillimi i sistemit të kontrollit të brendshëm publik nga njëra anë, si dhe përparimi i procesit të reformës së administratës publike nga ana tjetër, bëhen gjithnjë e më të lidhura, që dëshmohet edhe në praktikë, e jo vetëm nga ajo që është vënë në letër.²⁰³

Aktiviteti 2. Trajnimi për përgatitjen e planeve për integritet

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, administrata publike

Kategoria: Integriteti

Pyetja-indikator: A janë përgatitur programe për realizimin e trajnimeve për përgatitjen e planeve për integritet në administratën publike?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Në rrjedhë e sipër është miratimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e korrupsionit, sipas të cilave do të futej sistemi për integritet, dhe më pas do të ndërmerren aktivitete për realizimin e trajnimeve për sistemin për integritet në administratën publike.²⁰⁴

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

201 Doracak për Menaxhimin dhe kontrollin financiar, Ministria për Financa, Shkup, dhjetor 2010, fq. 107,

202 Doracak për integritetin dhe konfliktin e interesave, Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, Shkup, 2013, fq. 11

203 SIGMA Assessment on the Republic of Macedonia, 2013, Public Internal Financial Control, стр. 32.

204 Doracak për integritetin dhe konfliktin e interesave, Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, Shkup, 2013, fq. 11

Arsyetimi:

Doracaku për integritet dhe konflikt të interesave i përgatitur nga KSHPK-ja me përkrahje të UNDP-së, e përmend trajnimin si një nga elementet kryesore të politikës për integritet. Trajnimi, sipas asaj që është theksuar në Doracak, duhet: të kontribuojë për rritjen e vetëdijes të punësuarit për rreziqet konkrete dhe për qasjet në evitimin dhe zvogëlimin e rrezikut nga korrupsioni; të fokusohet më tepër në respektimin e politikave ekzistuese të organizatës se sa në vetë ligjin dhe t'i kushtojë kujdes qasjes në trajnimet për etikë, gjegjësisht trajnimin për kompetenca, që të garantohet se personeli do të dijë si të reagojë në situata të caktuara.²⁰⁵

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit

Kategoria: Resurset dhe kapaciteti

Pyetja-indikator: A janë paraparë dhe a realizohen trajnimet për planet për integritet?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Ligji për parandalimin e korrupsionit parasheh “ndërmarrjen e aktiviteteve në planin e edukimit të organeve që janë kompetente për zbulimin dhe ndjekjen e korrupsionit dhe llojet e tjera të krimit”, në përputhje me të cilin parashesh trajnime në nenin 49 të ligjit.²⁰⁶

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Aktualisht, programet në pjesën e luftës kundër korrupsionit janë pjesë e trajnimeve gjenerike të cilat i realizon MSHIA-ja. Ato janë paraparë edhe në Strategjinë e reviduar për reforma në administratën publike, dhe duhet të realizohen gjatë vitit 2014.

Në Pasqyrën e realizimit të aktiviteteve të Programit shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit 2011-2015, për periudhën dhjetor 2011 – nëntor 2013, është theksuar se në qoftë se trajnimet parashihen në udhëzimet për futjen e sistemit për integritet në sektorin publik dhe atë privat, të cilat KSHPK-ja duhet t'i miratojë në përputhje me ndryshimet ligjore, realizimi

205 Intervistë me përfaqësues të Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit, realizuar në prill të vitit 2014

206 Ligji për parandalimin e korrupsionit (Gazeta zyrtare nr. 28/2008), neni 49

i trajnimeve do të planifikohet për periudhën 2014-2015.²⁰⁷ “Pas specifikimit të trajnimit dhe përcaktimit se a bëhet fjalë për trajnim gjenerik apo special, në qoftë se konstatohet se trajnimi është gjenerik, MSHIA-ja do ta marrë parasysht trajnimin e planifikuar dhe do ta parashohë në programin vjetor për trajnime gjenerike të nëpunësve shtetërorë.”²⁰⁸

Aktiviteti 3. Përgatitja dhe miratimi i planeve për integritet

Institucioni: Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, Ministria e Drejtësisë

Kategoria: Integriteti

Pyetja-indikator: A e parasheh rregullativa ekzistuese përgatitjen dhe miratimin e planeve për integritet?²⁰⁹

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Për momentin nuk ka, e poashtu as rregullativa ekzistuese nuk e parasheh këtë. Në propozim-ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e korrupsionit është paraparë edhe miratimi i udhëzimeve për futjen e sistemit për integritet.

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Përvoja nga disa vende fqinje që kanë futur plane për integritet, tregon se bëhet fjalë për një zgjidhje shumë burokratike.²¹⁰ Në periudhën 2012-2014 u shqyrtuan modele të ndryshme të sistemit për integritet që zbatohen në disa vende të rajonit, si për shembull në Serbi, Slloveni, Moldavi, Rumani dhe Bullgari.²¹¹ Në bazë të analizës së këtyre modeleve, KSHPK-ja, u përcaktuar që të përgatisë një koncept që bazohet në përvojat pozitive rajonale, mirëpo i harmonizuar me kushtet e vendit. Sipas modelit të propozuar, vetë institucionet do t’i përforconin kapacitetet e

²⁰⁷ Pasqyrë e realizimit të aktivitetve të Programit shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe Programit shtetëror për parandalimin dhe zvogëlimin e dukurisë së konfliktit të interesave me Plan aksional 2011-2015. Kjo pasqyrë është fragment nga Raporti për realizimin e Programit shtetëror 2011-2015, për periudhën dhjetor 2011 – nëntor 2013, që është përgatitur nga Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit.

²⁰⁸ Pasqyrë e realizimit të aktivitetve të Programit shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe Programit shtetëror për parandalimin dhe zvogëlimin e dukurisë së konfliktit të interesave me Plan aksional 2011-2015. Kjo pasqyrë është fragment nga Raporti për realizimin e Programit shtetëror 2011-2015, për periudhën dhjetor 2011 – nëntor 2013, që është përgatitur nga Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit.

²⁰⁹ Raporti i BE-së, Programi nacional për miratimin e legjislacionit të BE-së – NPAA Pjesa narrative, Kreu 3.32, Kontrolli financiar.

²¹⁰ Intervistë me përfaqësues të Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit, realizuar në prill të vitit 2014

²¹¹ “Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies në institucionet publike”, dhjetor 2012, <<http://www.dksk.org.mk/images/kniga%20mkd-final%20%283%29.pdf>> fq.9-44

tyre për ballafaqim me rreziqet dhe zbatimin e sistemit për integritet, për të cilën gjë do të ishin të obliguar me ndryshimet ligjore, e me përkrahje të KSHPK-së.²¹²

Problemi/faktori i rrezikut 5:

Mungesa kontrollit publik mbi punën e administratës publike

Arsyetimi:

Kontrolli mbi punën e administratës nga ana e revizionit të brendshëm është i kufizuar dhe nuk mund të jetë i lirë nga dobësitë subjektive. Mundësimi i kushteve për kontroll plotësues publik mbi institucionet e administratës publike në mënyrë plotësuese do t'i rrisë mundësitë për parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit në to.

Aktiviteti 1: Përgatitja e udhëzimeve për parandalimin, zbulimin, raportimin dhe trajtimin e parregullsive

Institucioni: Ministria për Financa, institucionet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale

Kategoria: Mbikëqyrja dhe kontrolli

Pyetja-indikator: A përmban korniza ligjore e sistemit për KBFP udhëzime për parandalimin, zbulimin, raportimin dhe trajtimin e parregullsive?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Procesi i përforcimit të kontrollit financiar në vend ka filluar të zbatohet duke i zhvilluar dhe duke i zbatuar parimet e përgjegjësisë së decentralizuar të udhëheqësisë dhe duke vendosur revizion të brendshëm që është funksionalisht i pavarur. Qëllimi i këtij procesi është ndërtimi i sistemit, i cili do të garantojë shfrytëzim të arsyeshëm të mjeteve publike, si dhe parandalim të parregullsive, dyshimeve për mashtrime dhe korrupsion.²¹³

Ligji për KBFP e rregullon mënyrën për marrjen e masave kundër parregullsive dhe mashtrimeve në kreun e njëjtë VII, neni 50. Në përputhje me Ligjin për KBFP, u miratua Dekretligji për procedurën për parregullsi, mënyrën e bashkëpunimit të ndërsjellë, formën, përmbajtjen, afatet dhe mënyrën për raportimin e parregullsive, që është publikuar në “Gazetën zyrtare” nr. 63/11 të datës 09.05. 2011.²¹⁴ Me ligjin dhe dekretligjin rregullohet obligimi i udhëheqësve të subjekteve të sektorit publik të ndërmarrin aktivitete kundër parregullsive dhe mashtrimeve dhe të emërojnë person që është i obliguar me parregullsitë, i cili do t'i pranojë raportet për parregullsitë dhe mashtrimet dhe në mënyrë të pavarur do të ndërmarrë veprime për parandalimin e tyre.

212 Intervistë me përfaqësues të Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit, realizuar në prill të vitit 2014

213 Strategjia për zhvillimin e kontrollit të brendshëm financiar publik në vend prej vitit 2013 deri në vitin 2016, propozim, faqe 5

214 Strategjia për zhvillimin e kontrollit të brendshëm financiar publik në vend prej vitit 2013 deri në vitin 2016, propozim, faqe 15

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Obligimin për emërimin e personit që është i obliguar me parregullsitë, e kanë përmbushur 61 institucione të nivelit qendror (80%) dhe 60 njësi të vetëqeverisjes lokale (74%).²¹⁵

Institucioni: Ministria për Financa, institucionet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale

Kategoria: Mbikëqyrja dhe kontrolli

Pyetja-indikator: Në praktikë, a konstatohen dhe a trajtohen parregullsitë e detektuar nga organet kompetente në sistemin për KBFP?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Ligji për KBFP dhe Dekretligji për procedurën për parandalimin e parregullsive, mënyrën e bashkëpunimit të ndërsjellë, formën, përmbajtjen, afatet dhe mënyrën e raportimit për parregullsitë, e rregullojnë parandalimin e parregullsive.

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në praktikë, në vitin 2013, Koordinatorin nacional për autorizim në Ministrinë për Financa, deri te Drejtoria e policisë financiare dorëzoi 9 raporte për parregullsi gjatë shfrytëzimit të mjeteve nga ndihma për para-anëtarësim e BE-së në komponentën e pestë, e cila është e dedikuar për përkrahjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural në vend.²¹⁶

Aktiviteti 2: Realizimi i trajnimeve për aftësim profesional të personave që janë të obliguar për denoncimin e parregullsive në përputhje me Programin për trajnim të AFKOS-it

215 Programi nacional për miratimin e legjislacionit të BE-së - NPAA, Pjesa narrative, Kreu 3.32, Kontrolli financiar
 216 Programi nacional për miratimin e legjislacionit të BE-së - NPAA, Pjesa narrative, Kreu 3.32, Kontrolli financiar

Institucioni: Ministria për Financa, Drejtoria e policisë financiare

Kategoria: Resurset dhe kapaciteti

Pyetja-indikator: A ekziston plan/program për trajnime për aftësim profesional për personat që janë të obliguar për denoncimin e parregullsive?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Kompetencat e Njësisë qendrore për harmonizim në kuadër të Ministrisë për Financa janë definiuar në Ligjin për KBFP, sipas të cilit NJQH-ja është kompetente për koordinimin e trajnimeve për udhëheqësit dhe të punësuarit që janë të përfshirë në menaxhimin dhe kontrollin financiar dhe revizionin e brendshëm, ajo e udhëheq bazën e të dhënave për njësitë për revizion të brendshëm dhe njësitë për çështjet financiare dhe bashkëpunon me institucionet që janë përgjegjëse për çështje të KBFP në vend dhe jashtë vendit, me qëllim të këmbimit të përvojave më të mira dhe implementimit të tyre në sistemin e KBFP.²¹⁷

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në praktikë, në përputhje me Strategjinë nacionale për parandalimin e mashtrimeve dhe mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Evropian në vend, përgatitja e së cilës është në fazë të avancuar, deri në fund të vitit 2014 parashihet të fillojnë trajnimet për personat që janë të obliguar me parregullsitë, për parandalimin e parregullsive gjatë shfrytëzimit të fondeve evropiane, për shqyrtimin e denoncimeve të pranuar për parregullsi dhe mënyrën e raportimit, me ndihmën e instrumentit TAEX.²¹⁸ Në këtë moment, edhe përkundër obligimit që institucionet të përcaktojnë persona që do të jenë përgjegjës për denoncimin e parregullsive, nuk ka tregues për atë se si funksionon ky modalitet në praktikë.

Aktiviteti 3: Përgatitja e Strategjisë nacionale për parandalimin e parregullsive dhe mashtrimeve për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së në vend

217 Ligji për kontrollin e brendshëm financiar publik, neni 48 и Strategjia për zhvillimin e kontrollit të brendshëm financiar publik në vend prej vitit 2013 deri në vitin 2016, propozim, faqe 13

218 Pasqyrë e realizimit të aktiviteteve të Programit shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe Programit shtetëror për parandalimin dhe zvogëlimin e dukurisë së konfliktit të interesave me Plan aksional, 2011-2015, fq. 7

Institucioni: Ministria për Financa

Kategoria: Llogaridhënia

Pyetja-indikator: A është përgatitur Strategjia nacionale?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Strategjia nacionale për parandalimin e parregullsive dhe mashtrimeve për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së në vend, sipas Programit nacional për miratimin e legjislacionit të BE-së–NPAA, është paraparë të miratohet gjatë vitit 2014²¹⁹, dhe do të vlejë për periudhën 2014-2016.

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në praktikë, përgatitja e Strategjisë nacionale për parandalimin e parregullsive dhe mashtrimeve për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së në vend është në fazë të avancuar dhe miratimi i saj është paraparë të bëhet deri në fund të vitit 2014.

Institucioni: Ministria për Financa, institucionet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale

Kategoria: Mbikëqyrja dhe kontrolli

Pyetja-indikator: A përmban rregullativa ekzistuese dispozita dhe sa në praktikë sigurohet parandalimi i parregullsive dhe i mashtrimeve për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së në vend?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Ligji për KBFP në Kreun IX, Kontrolli i shfrytëzimit të mjeteve të fondeve të BE-së, në nenin 52 parasheh se “Subjektet që shfrytëzojnë mjete nga fondet e Bashkimit Evropian janë të obliguara [...] t’i zbatojnë kushtet e veçanta për menaxhim financiar, kontrole të brendshme dhe revizion të brendshëm, të përcaktuara nga Komisioni Evropian.” Në paragrafin 2 të po këtij neni thuhet se “Të gjithë shfrytëzuesit e mjeteve nga fondet e Bashkimit Evropian duhet t’u mundësojnë personave të autorizuar zyrtarë të Ministrisë për Financa, inspektorëve të Komisionit Evropian dhe Gjykatës evropiane të revizorëve, qasje të lirë deri te i gjithë dokumentacioni, zyrat, mjetet dhe

219 Programi nacional për miratimin e legjislacionit të BE-së - NPAA, Pjesa narrative, Kreu 3.32, Kontrolli financiar

personeli, duke i pasur parasysh rregullat për siguri dhe sjellje të mirë.” Sipas NPAA-së, ishte papaparë që deri në fund të vitit 2013 të hyjë në fuqi Ligji i ri për policinë financiare, sipas të cilit, në kompetencat e Drejtorisë së policisë financiare parashihet edhe mbrojtja e interesave financiare të BE-së.²²⁰ Në fillim të vitit 2014 u soll Ligji i ri për policinë financiare, në nenin 2 të të cilit thuhet se “sigurohet edhe mbrojtja e interesave financiare të Bashkimit Evropian nëpërmjet zbulimit dhe hetimit kriminalistik të veprave penale që lidhen me shfrytëzimin e mjeteve nga programet e Bashkimit Evropian, të cilat vendi i merr nga buxheti i Bashkimit Evropian.”²²¹

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në praktikë, në vitin 2013, Koordinatorin nacional për autorizim në Ministrinë për Financa, deri te Drejtoria e policisë financiare dorëzoi 9 raporte për parregullsi gjatë shfrytëzimit të mjeteve nga ndihma për para-anëtarësim e BE-së në komponentën e pestë, e cila është e dedikuar për përkrahjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural në vend.²²²

Poashtu, në mars të vitit 2013 u nënshkrua Marrëveshje për bashkëpunim ndërmjet Organit revizor dhe Drejtorisë së policisë financiare në kuadër të Ministrisë për Financa, me qëllim të sigurimit të sistemit stabil për menaxhim dhe kontroll gjatë implementimit të IPA-s, si dhe parandalimit dhe zbulimit të parregullsive, mashtrimeve ose aktiviteteve të tjera joligjore në dëm të interesave financiare të BE-së në vend.²²³

Aktiviteti 4: Rregullimi ligjor me qëllim të sigurimit të mbrojtjes sistematike dhe institucionale të personave që e denoncojnë korrupsionin (whistle blowers)

Institucioni: Administrata publike

Kategoria: Integriteti

Pyetja-indikator: A parasheh Ligji për parandalimin e korrupsionit mbrojtje ligjore për nëpunësit publikë që e denoncojnë korrupsionin te strukturat udhëheqëse ose de organet gjyqësore?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Sipas Propozim-ligjit të përgatitur për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e korrupsionit planfikohet futja e sistemit për integritet dhe mbrojtja e personave që denoncojnë raste të korrupsionit dhe veprime të tjera joligjore dhe të palejueshme. Me nenin 3 të propozim-ligjit futet kapitulli i ri, Sistemi për integritet, dhe në të rregullohet sistemi për integritet, sistemi i

220 Programi nacional për miratimin e legjislacionit të BE-së - NPAA, Pjesa narrative, Kreu 3.32, Kontrolli financiar

221 Ligji për policinë financiare, Gazeta zyrtare, nr.12 e datës 22.01.2104

222 Programi nacional për miratimin e legjislacionit të BE-së - NPAA, Pjesa narrative, Kreu 3.32, Kontrolli financiar

223 Programi nacional për miratimin e legjislacionit të BE-së - NPAA, Pjesa narrative, Kreu 3.32, Kontrolli financiar

denoncimit nga ana e denoncuesit dhe mbrojta e tij/saj. Me nenin 54-b bëhet definimi i denoncuesit, me nenin 54-c janë përcaktuar mënyrat e denoncimit, si të brendshme dhe të jashtme, dhe institucionet ku bëhet kjo. Me nenin 54-d është përcaktuar veprimi i organit kompetent i cili bën mbikëqyrje të zbatimit të ligjit pas njoftimit nga ana e KSHPK-së për veprimin e denoncuar joligjor dhe të palejueshëm. Në nenin 54-e është përcaktuar sigurimi i mbrojtjes së denoncuesit dhe i anëtarëve të familjes së tij nga çdo lloj i shkeljes së të drejtave për shkak të denoncimit të bërë.

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Ligji akoma nuk është miratuar, kështu që në këtë fazë është herët të flitet për efektet e zbatimit të tij praktik.

Institucioni: Ministria për Financa, institucionet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale

Kategoria: Mbikëqyrja dhe kontrolli

Pyetja-indikator: A denoncohen në praktikë raste të korrupsionit nga ana e denoncuesve (whistleblowers) dhe sa janë ata të mbrojtur?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Në vend, është vendosur sistemi i denoncimit të korrupsionit sipas të cilit çdo individ apo institucion mund në mënyrë të hapur ose anonime të denoncojë dyshim apo rast të korrupsionit deri te KSHPK-ja ose organet e tjera kompetente. Poashtu, disa institucione, mirëpo edhe organizata civile kanë vendosur sistem të denoncimit nëpërmjet linjave telefonike (hotlines) për denoncimin e dyshimeve për veprime korruptive. Megjithatë, duhet kuptuar se duhet bërë dallim ndërmjet sistemit të denoncimit dhe sistemit të denoncimit antikorraptiv.²²⁴ Duhet kuptuar se sistemi i denoncimit, edhe pse ka ngjashmë me sistemin e denoncimit antikorraptiv, megjithatë përmban edhe një numër të madh të aspekteve të ndryshme. Kjo veçanërisht ka të bëjë me faktin se denoncimi fokusohet në raste që kanë të bëjnë me një organizatë (gjegjësisht bëhet nga ana e të punësuarve të saj), si dhe me faktin se korniza nuk është e kufizuar në aktivitete kriminale, por në fusha që janë me interes më të gjerë publik.²²⁵

224 Udhërrëfyes për implementimin e sistemit të denoncuesve, fq. 3

225 Udhërrëfyes për implementimin e sistemit të denoncuesve, fq. 3

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Sipas asaj që u tha më lartë, në këtë moment denoncimi funksionon nëpërmjet denoncuesve të, në masë të madhe, parashtrësve anonime. Kjo bëhet bërë denoncim me shkrim në KSHPK, duke e shënuar në mënyrë të qartë se për cilin person bëhet fjalë. KSHPK-ja i shqyrton të gjitha parashtrësit. Parashtrësit anonime kanë trajtim të njëjtë sikurse edhe ato të tjerat. Me këtë rast, mund të nxirret përfundimi se tashmë funksionon denoncimi në njëfarë mënyre, mirëpo ligji duhet të kontribuojë për përfundimin e mbrojtjes së denoncuesve.²²⁶

Aktiviteti 5: Realizimi i trajnimeve për administratën dhe sektorin privat për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e personave që kanë denoncuar korrupsion

Institucioni: Administrata publike, sektori privat

Kategoria: Resurset dhe kapaciteti

Pyetja-indikator: A janë përgatitur dhe a janë realizuar planet/programet për trajnim për administratën dhe sektorin privat për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e personave që kanë bërë denoncim të korrupsionit?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Që nga miratimi i Programit shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit në vitin 2011 e deri më sot, nuk është realizuar ky aktivitet. Në pasqyrën e realizimit të aktiviteteve të Programit shtetëror theksohet se me miratimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e korrupsionit pritet të përcaktohet plani dhe dinamika e realizimit të trajnimeve të planifikuara.²²⁷

Vlerësimi – de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

226 Intervistë me përfaqësues të Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit, realizuar në prill të vitit 2014

227 Pasqyrë e realizimit të aktiviteteve të Programit shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe Programit shtetëror për parandalimin dhe zvogëlimin e dukurisë së konfliktit të interesave me Plan aksional 2011-2015. Kjo pasqyrë është fragment nga Raporti për realizimin e Programit shtetëror 2011-2015, për periudhën dhjetor 2011 – nëntor 2013, që është përgatitur nga Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit.

Arsyetimi:

Në qoftë se trajnimet e këtilla parashihen në udhëzimet që duhet t'i miratojë KSHPK-ja në përputhje me ndryshimet e ligjit, trajnimet mund të realizohen në periudhën 2014-2015.²²⁸ "Pas specifikimit të trajnimit dhe përcaktimit se a bëhet fjalë për trajnim gjenerik apo special, në qoftë se konstatohet se trajnimi është gjenerik, MSHIA-ja do ta marrë parasysh trajnimin e planifikuar dhe do ta parashohë në programin vjetor për trajnime gjenerike të nëpunësve shtetërorë."²²⁹

PASQURA E INDEKSEVE

Edhe pse metodologjia bën vlerësim kualitativ të gjendjes, është bërë edhe vlerësimi numerik, me qëllim që të bëhet përmbledhja numerike e informatave dhe të potencohen anët kryesore të dobëta dhe të fuqishme. Prandaj, në tekstin e mësipërm, për çdo pyetje-indikator është dhënë nota prej 1 deri në 5 – ku 1 është nota më e dobët, ndërsa 5 është më e larta.

Në bazë të notave të dhëna prej 1 deri në 5, për çdo pyetje-indikator janë mbledhur notat në nivel të nënkategorive, në nivel të kategorive dhe në nivel të gjithë shtyllës. Me këtë rast, nuk është bërë ponderim (peshim) i notave, por të gjitha notat e mbledhura janë përcaktuar si mes aritmetik.

Problemi	Nënkategoria	Indeksi								
		De jure	De facto	Mesatarja – nënkategoria	Mesatarja – kategoria	Mesatarja – sektori				
Problemi 1	Mbikëqyrja dhe kontrolli	3,5	3,25	3,37	3,29	2,87				
	Llogaridhënia	5	3	4						
	Resurset dhe kapaciteti	3	2	2,5						
Problemi 2	Mbikëqyrja dhe Kontrolli	4,67	3,5	4,08			2,87			
	Resurset dhe kapaciteti	3,33	3,16	3,24						
Problemi 3	Mbikëqyrja dhe kontrolli	5	3	4	3,1			2,87		
	Transparenca	5	1	3						
	Llogaridhënia	3,67	1	2,3						
Problemi 4	Integriteti	3	1,6	2,3	2,4				2,87	
	Resurset dhe kapaciteti	3	2	2,5						
Problemi 5	Mbikëqyrja dhe kontrolli	4,5	3,75	4,12	1,90					2,87
	Llogaridhënia	1	1	1						
	Integriteti	1	1	1						
	Resurset dhe kapaciteti	2	1	1,5						

228 Pasqyrë e realizimit të aktiviteteve të Programit shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe Programit shtetëror për parandalimin dhe zvogëlimin e dukurisë së konfliktit të interesave me Plan aksional 2011-2015. Kjo pasqyrë është fragment nga Raporti për realizimin e Programit shtetëror 2011-2015, për periudhën dhjetor 2011 – nëntor 2013, që është përgatitur nga Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit.

229 Pasqyrë e realizimit të aktiviteteve të Programit shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe Programit shtetëror për parandalimin dhe zvogëlimin e dukurisë së konfliktit të interesave me Plan aksional 2011-2015. Kjo pasqyrë është fragment nga Raporti për realizimin e Programit shtetëror 2011-2015, për periudhën dhjetor 2011 – nëntor 2013, që është përgatitur nga Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- Acevski, Maksim. ANALIZA KUALITATIVE e masave antikorruptive dhe zbatimi i Programit shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit/parandalimin dhe zvogëlimin e dukurisë së konfliktit të interesave në vetëveqevrisjen lokale
- Ligji për kontroll të brendshëm publik financiar, (“Gazeta zyrtare”, nr. 90/09, 12/11, 188/13)
- Ligji për policinë financiare, Gazeta zyrtare, nr. 12 e datës 22.01.2014
- Raporti nga punëtorja SWOT për lokalizimin e trajnimeve për certifikimin e kontabilistëve dhe të revizorëve të brendshëm në sektorin publik në vend që është mbajtur me 5 mars 2014
- Raporti i KE-së për përparimin e vendit për vitin 2013, Kapitulli 32: Kontrolli financiar
- Raporti i BE-së, Programi nacional për miratimin e legjislacionit të BE-së – NPAA Pjesa narrative, Kapitulli 3.32 Kontrolli financiar
- Standardet ndërkombëtare për kryerjen profesionale të revizionit të brendshëm, “Gazeta zyrtare” nr. 136/10
- Programi nacional për miratimin e legjislacionit të BE-së – NPAA Pjesa narrative, Kapitulli 3.32 Kontrolli financiar
- Udhëzime për zbatimin e procesit të menaxhimit me rreziqet, Ministria për Financa, Shkup 2014
- Programi nacional për miratimin e legjislacionit të BE-së – NPAA Pjesa narrative, Kapitulli 3.32 Kontrolli financiar
- Udhërrëfyes për implementimin e sistemit të denoncuesve
- Doracak për mënyrën e zbatimit të proceseve të përgjithshme financiare
- Doracak për menaxhimin dhe kontrollin financiar, Ministria për Financa, Shkup, dhjetor 2010
- Rregullorja për programin dhe mënyrën e dhënies së provimit për revizor të brendshëm të autorizuar në sektorin publik (“Gazeta zyrtare”, numër 136/10)
- Kontributi për Raportin e KE-së për përparimin e vendit për vitin 2013
- Doracak për integritetin dhe konfliktin e interesave, Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, Shkup 2013
- Pasqyrë e realizimit të aktiviteteve të Programit shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe Programit shtetëror për parandalimin dhe zvogëlimin e dukurisë së konfliktit të interesave me Plan aksional për periudhën 2011-2015
- Sektori për Kontroll të brendshëm financiar publik, <<http://www.finance.gov.mk/node/92>>
- Sektori III – Administrata publike, Pasqyrë e realizimit të aktiviteteve të Programit shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe Programit shtetëror për parandalimin dhe zvogëlimin e dukurisë së konfliktit të interesave me Plan aksional për periudhën 2011-2015, dhjetor 2011 – nëntor 2013
- Strategjia për Reformën e Administratës publike në vend 2010-2015, dhejtor 2010
- Strategjia për zhvillimin e kontrollit të brendshëm publik financiar në vend prej vitit 2013 deri në vitin 2016, propozim
- SIGMA Assessment on the Republic of Macedonia, 2013, Public Internal Financial Control,
- Udhëzim për përgatitjen e Strategjisë për menaxhim me rreziqet, Ministria për Financa, janar 2014

**5.RAPORTI NGA ANALIZA KUALITATIVE TË MASAVE KUNDËR KORRUPSIONIT DHE
IMPLEMENTIMIT TË PROGRAMIT SHTETËRORË PËR PARANDALIM DHE LUFTË
KUNDËR KORRUPSIONIT DHE ZVOGËLIM TË KONFLIKTIT TË INTERESIT 2011-
2015 NË SEKTORIN E SHOQËRISË CIVILE**

Përgatitur nga: Maksim Acevski, CFE

HYRJE

Misioni i OSBE-së në Shkup zbaton aktivitete disavjeçare për përkrahjen e implementimit të “Programit shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe për zvogëlimin e konfliktit të interesave për periudhën 2011–2015” (Programi shtetëror). Në vitin 2012, Misioni ndihmoi në zhvillimin e metodologjisë për vlerësimin kualitativ të aktiviteteve dhe të indikatorëve nga Programi shtetëror, me pilot analizë kualitative për sektorin e arsimit dhe të sportit, me vlerësimin e perceptimit të publikut për tre sektorë nga Programi shtetëror, si dhe me përforsimin e kapaciteteve të Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit (KSHPK) për zhvillimin e konceptit të integritetit dhe evidentimit elektronik të të dhënave. Misioni i OSBE-së e vazhdoi bashkëpunimin me KSHPK-në edhe në vitin 2013 dhe 2014, duke dhënë përkrahje për përgatitjen e analizës kualitative dhe zbatimin e hulumtimit të mendimit publik për pesë sektorë të rinj nga Programi shtetëror – sektori privat, sektori politik, vetëqeverisja lokale administrata publike dhe mediat dhe shoqëria civile.

Në këtë dokument gjendet analiza kualitative që ka të bëjë me sektorin e mediave dhe shoqërisë civile.

Ajo i trajton problemet e identifikuara në Programin shtetëror, me ç’rast nëpërmjet një sërë indikatorësh i vlerëson masat antikorruptive dhe zbatimin e Programit shtetëror, i konstaton anët e fuqishme dhe të dobëta të asaj që është bërë deri tani dhe jep rekomandime për avancimin e luftës kundër korrupsionit në fushën e mediave dhe të shoqërisë civile. Qëllimi kryesor i kësaj analize është ta ndihmojë KSHPK-në për ta ndjekur zbatimin e Programit shtetëror, për t’i përmirësuar indikatorët dhe për të propozuar aktivitete të reja/të ndryshuara.

METODOLOGJIA

Metodologjia e analizës është e bazuar në konceptin e Sistemit nacional për integritet të “Transparency International”. Problemet që janë shqyrtuar janë marrë nga Programi shtetëror. Nën çdo problem janë përcaktuar indikatorë për gjendjen dhe përparimin, si dhe janë dhënë rekomandime për përmirësimin e rezultateve.

Si burime të të dhënave u shfrytëzuan:

- Analiza kualitative – analiza e literaturës primare - ligjeve relevante, akteve nënligjore dhe dokumente dhe raporte të tjera zyrtare, si dhe analiza e literaturës sekondare – artikuj, shkrime, etj.
- Intervista me burime kyçe të informatave, edhe atë me:
 - o Komisionin shtetëror për parandalimin e korrupsionit,
 - o Qeverinë - Sekretariatit gjeneral;
 - o Njësinë për vetëqeverisje lokale Veles;
 - o Njësinë për vetëqeverisje lokale Gostivar;
 - o Njësinë për vetëqeverisje lokale Ohër;
 - o Njësinë për vetëqeverisje lokale Strumicë;
 - o Njësinë për vetëqeverisje lokale Prilep;

- o Njësinë për vetëqeverisje lokale Shtip;
- o Asociacioni i gazetarëve të Maqedonisë – AGM,
- o Organizata qytetare - Qendra maqedonase për bashkëpunim ndërkombëtar - QMBN,
- o Qendra për komunikime civile dhe të tjerë.

Në bazë të të dhënave të mbledhura, hulumtuesi përgatiti propozim-vlerësime për secilin indikator, edhe atë nga dy aspekte – de jure, sa i përket kornizës ligjore, dhe de facto, gjegjësisht gjendjes në praktikë. Gjatë vlerësimit të indikatorëve, për kornizën ligjore është përdorur shkalla në tre nivele prej 1 deri në 5, me ç’rast: 1 = jo, 3 = pjesërisht, 5 = po.

Për vlerësimin e gjendjes në praktikë është përdorur shkalla në pesë nivele prej 1 deri në 5, me ç’rast: 1 = në masë shumë të vogël, 2 = në masë të vogël, 3 = në masë të caktuar, 4 = në masë të madhe, 5 = në masë shumë të madhe.

Pastaj, notat e veçanta janë mbledhur, dhe janë paraqitur si mesatare e notës së përgjithshme për çdo nënkategori dhe kategori. Për të dhënë një pasqyrë më të qartë, në fund të këtij dokumenti notat janë paraqitur në formë të shumës dhe janë shprehur edhe si përqindje e notës maksimale të mundshme.

Rezultatet u prezantuan para faktorëve relevantë dhe u verifikuan prej tyre, të cilët diskutuan për konstatimet dhe për vlerësimet në lidhje me pyetjet e indikatorëve, me qëllim që të verifikohen, të konfirmohen ose të plotësohen të dhënat dhe rezultatet. Pas këtij verifikimi, u bë edhe finalizimi i analizës.

PËRMBLEDHJE

Analiza kualitative që u realizua në kuadër të këtij projekti kishte për qëllim t’i vlerësojë faktorët kryesorë të rrezikut/problemet që janë identifikuar nga Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit (KSHPK) në fushën e shoqërisë civile, të cilat janë shënuar në Programin shtetëror për parandalimin dhe represionin e korrupsionit për periudhën 2011-2015. Problemet kryesore që janë theksuar nga KSHPK-ja u shqyrtuan nga aspekti i legjislacionit dhe i implementimit praktik, me qëllim që të bëhet një pasqyrë e arritjeve, si dhe të potencohen dobësitë kryesore në këtë sektor nga aspekti i mbikëqyrjes dhe i kontrollit, transparencës, integritetit, llogaridhënies, resurseve dhe kapacitetit.

Qëllimi i hulumtimit është të kontribuojë në përpjekjet e përgjithshme në luftën kundër korrupsionit në fushën e administratës publike në vend, dhe duke i evidentuar dobësitë, të japë edhe rekomandime për tejkalimin e tyre.

Në sektorin e mediave dhe shoqërisë civile, janë konstatuar gjashtë probleme, më saktësisht faktorë të rrezikut në kuadër të cilave janë realizuar 14 aktivitete për parandalimin dhe represionin e korrupsionit. Ato përfshijnë – 1) Jotransparencë gjatë ndarjes së mjeteve financiare për shoqatat dhe fondacionet; 2) Marrja e statusit të organizatës me interes publik; 3) Ndarja e mjeteve publike për shoqatat e themeluara me qëllim të caktuar që krijon mundësi për harxhim korruptiv dhe joproduktiv të mjeteve publike; 4) Harxhimi i mjeteve publike dhe atyre buxhetore në media; 5) Koncentrimi i pronësisë së mediave dhe fshehja e pronësisë së mediave, dhe 6) Lidhja e mediave me qendrat politike të fuqisë.

Segmenti i medimeve nga Sektori i Medimeve dhe Shoqërisë Civile nuk ka qenë lëndë e kësaj analize kualitative duke pasur parasysh faktin se në periudhën e përgatitjes së analizës në procedurë kanë qenë ndryshime të rregullativës ligjore ku janë përfshirë çështje të lidhura me problemet dhe rreziqet të referuara në atë segment.

Në raportin e përgatitur rishtas për realizimin e aktiviteteve për periudhën dhjetor 2011 deri nëntor 2013, gjithsejtë nga 14 aktivitetet e parapara, KSHPK konstaton se në proces janë 2 ose 14% përderisa 12 ose 86% janë aktivitete të përcaktuara.²³⁰

Përfundim i përgjithshëm është se në pjesën e problemeve/faktorët e rrezikut 1, 2 dhe 3 që kanë të bëjnë me shoqërinë civile, ende ekzistojnë fyte të ngushtë, gjegjësisht kontrolli dhe veprimi nga ana e organeve përgjegjëse nuk është nivelin e duhur.

Në lidhje me **Problemin 1 - Jotransparencë gjatë ndarjes së mjeteve financiare publike për shoqatat dhe fondacionet**, përfundim i përgjithshëm është se mungojnë aktivitete të cilat kanë për qëllim përcaktimin e kriterëve për ndarjen e mjeteve financiare publike në Ligjin për shoqata dhe fondacione dhe sigurimin e zbatimit të tyre përkatës. Edhe përkundër faktit se kjo fushë është rregulluar me një numër të madh të akteve nënligjore, prapë se prapë, në praktikë nuk është siguruar zbatimi i tyre i duhur.

Në lidhje me **Problemin 2 - Marrja e statusit të organizatës me interes publik**, nuk janë konstatuar ndryshime të ky faktor i rrezikut dhe nuk janë ndërmarrë aktivitete për përcaktimin e kriterëve ligjore që janë të adekuata për qëllimet, veprimtarinë, kapacitetin dhe integritetin e SHC, me çka statusi i shoqatës me interes publik do të fitohej duke i plotësuar kriteret ligjore dhe si e tillë do ishte regjistruar në Regjistrin qendror. Tani i gjithë aktiviteti është në kompetencë të komisionit qeveritar, me çka krijohet mundësia për politizim, arsyetim të pamjaftueshëm, dhe transparencë të pamjaftueshme për këtë çështje vitale.

Në lidhje me **Problemin 3 - Ndarja e mjeteve publike për shoqatat e themeluara me qëllim të caktuar që krijon mundësi për harxhim korruptiv dhe joproduktiv të mjeteve publike**. Informatat e marra nga hulumtimi i realizuar bëjnë me dije se në vend pothuajse nuk është jetësuar koncepti për partneritet funksional me organet kompetente, përveç në disa segmente të caktuara, ku beshoet realizimi i punëve nga sfera e autorizimeve publike.

REKOMANDIME

- Në kuadër të mënyrës ekzistuese të financimit, Qeveria të sigurojë miratim në kohë të aktit për shpërndarje të mjeteve nga buxheti, me çka do të sigurojë dhe do të krijojë kushte për realizimin në kohë të aktiviteteve të projekteve dhe dorëzimin e raporteve për to në afatin e paraparë.
- Qeveria të ndërmarrë aktivitete me të cilat do të bëhet përcaktimi i kriterëve të qarta, transparente dhe të zbatueshme për qëllimet dhe mënyrën e shpërndarjes së mjeteve nga buxheti, buxhetet e komunave, buxhetet e komunave në qytetin e Shkupit dhe buxheti i qytetit të Shkupit, në Ligjin për shoqata dhe fondacione. Kjo do të siguronte qasje të barabartë për të gjithë OJQ-të dhe fondacionet deri te mjetet e buxhetit, buxhetet e komunave, buxhetet e komunave në qytetin e Shkupit dhe buxheti i qytetit të Shkupit, arsyeshmëri në harxhim, transparencë, joselektivitet dhe llogaridhënie.
- Qeveria dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale të ndërmarrin masa dhe aktivitete në kuadër të përgjegjësisë të veta me çka do të bëhen ndryshime dhe plotësime të akteve (Ligjit

230 Sektor XI – Mediat dhe shoqëria civile, dhjetor 2011- nëntor 2013

për shoqata dhe fondacione dhe akteve nënligjore të cilat e rregullojnë këtë fushë) me çka do të sigurohet:

- mundësi për OJQ-të dhe fondacionet e pakënaqura të dorëzojnë kundërshtime/ ankesa,
- dyshkallësi në procedurën për shqyrtim të kundërshtimeve/ankesave.
- Organet kompetente në periudhën e ardhshme të ndërmarrin aktivitete me të cilat do të sigurojnë respektim konsekuent të afateve për dorëzimin e raporteve për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve nga ana e OJQ-ve dhe fondacioneve.
- Qeveria të përcaktojë obligim në Ligjin për shoqata dhe fondacione, me të cilin dhënësit e mjeteve (Qeveria, komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit) raporti i përgatitur për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve të ndara dhe projektet e realizuara dhe rezultatet e arritura të jenë në dispozicion publik dhe të publikohen në mënyrë përkatëse në ueb-faqet e dhënësve të mjeteve.
- Qeveria duhet të ndërmarrë aktivitete me të cilat kriteret për përcaktimin e statusit me interes publik të organizatës do t'i përcaktojë në Ligjin për shoqata dhe fondacione, kurse akti i marrjes së statusit të përmendur të realizohet me plotësimin e kriterëve të përcaktuara që konstatohet në fazën e regjistrimit të regjistruar kompetent.
- Qeveria të ndërmarrë aktivitete për ndryshimin e akteve ligjore (Ligjit për shoqata dhe fondacione, Ligjit për Qeverinë dhe ligjet e tjera), të cilat e rregullojnë mënyrën dhe mundësinë e për ndarjen e mjeteve nga buxheti dhe buxhetet e komunave, duke futur mundësi që shoqatat të paraqiten si partnerë funksionalë të organeve shtetërore dhe të organeve të tjera dhe të reflektojnë në mbështetjen buxhetore për realizimin e projekteve publike nëpërmjet aktiviteteve të cilat u përgjigjen atyre sipas definicionit, siç janë fushatat, trajnimet, anketat, debatet etj.

REZULTATET NGA ANALIZA KUALITATIVE

SHOQËRIA CIVILE

Problemi/faktori i rrezikut 1:

Jotransparencë gjatë ndarjes së mjeteve financiare publike për shoqatat dhe fondacionet

Arsyetimi:

Kriteret për financimin e shoqatave dhe të fondacioneve nga ana e Qeverisë me mjete nga Buxheti, buxheti i komunave, ndërmarrjet publike dhe fondet publike si dhe me mjete nga fondet të huaja, nuk janë të definuara qartë, kurse procedura për financim nuk është transparente sa duhet.

Institucioni: Qeveria-Sekretariati gjeneral;

Njësia për vetëqeverisje lokale Veles;

Njësia për vetëqeverisje lokale Gostivar;

Njësia për vetëqeverisje lokale Ohër;

Njësia për vetëqeverisje lokale Strumicë;

Njësia për vetëqeverisje lokale Prilep;

Njësia për vetëqeverisje lokale Shtip;

Asociacioni i gazetarëve të Maqedonisë – AGM,

Organizata qytetare - Qendra maqedonase për bashkëpunim ndërkombëtar - QMBN,

Qendra për komunikime civile

Kategoria: Transparenca

Pyetja - indikator: A mendoni se aktet ekzistuese ligjore dhe nënligjore (Ligji për shoqata dhe fondacione, “Gazeta zyrtare” numër 52/10 dhe 135/11, Programet për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe të fondacioneve dhe Vendimi për kriteret dhe procedurën për shpërndarjen e mjeteve për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve nga buxheti, “Gazeta zyrtare” numër 23/2009) në pjesën e përcaktimit të kriterëve, rregullave, procedurave dhe dyshkallësisë së procedurës, janë adekuate dhe sigurojnë transparencë, joselektivitet dhe pozitë të barabartë për të gjitha OJQ-të dhe fondacionet?

Vlerësimi:

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Financimi i Organizatave joqeveritare dhe dhënia e mjeteve për to nga buxheti, buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale, ndërmarrjeve publike dhe fondeve publike, janë rregulluar me shumë ligje, akte nënligjore dhe akte interne të miratuara në Parlament, Qeveri, udhëheqësit e subjekteve të cilët japin mjete të caktuara, Këshillat komunalë dhe organet e tjera kompetente.

Në mesin e akteve kryesore ligjore dhe nënligjore me të cilat rregullohet financimi i organizatave joqeveritare dhe kriteret për dhënin e mjeteve për këtë qëllim, janë dispozitat e:

- Ligjit për shoqata dhe fondacione ("Gazeta zyrtare", numër 52/10 dhe 135/11);
- Ligji për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike ("Gazeta zyrtare" numër 47/06, 86/08, 51/11, 28/14);
- Ligji për ekzekutimin e buxhetit ("Gazeta zyrtare", numër 180/2013);
- Kodi për praktika të mira për përkrahje financiare të shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve ("Gazeta zyrtare", numër 130/2007);
- Vendimi për kriteret dhe procedurën për shpërndarje të mjeteve për financimin e aktiviteteve programore shoqatave të qytetarëve dhe të fondacioneve nga buxheti ("Gazeta zyrtare", numër 23/2009);
- Programi për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe të fondacioneve për vitin 2013 ("Gazeta zyrtare", numër 4/2013);
- Programi për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe të fondacioneve për vitin 2014 ("Gazeta zyrtare", numër 8/2014);
- Rregullorja për mënyrën dhe procedurën e shpërndarjes së mjeteve për shoqatat e qytetarëve për realizimin e punëve të caktuara nga fusha e sigurimit social ("Gazeta zyrtare", numër 24/2005 dhe 38/2007).

Dispozitat e nenit 49 të Ligjit për shoqata dhe fondacione japin vetëm udhëzime të përgjithshme për mënyrën e shpërndarjes së mjeteve nga buxheti, buxhetet e komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit, gjegjësisht udhëzojnë dhe japin mundësi që:

- "Qeveria dhe këshillat e komunave, këshillat e komunave në qytetin e Shkupit dhe Këshilli i qytetit të Shkupit, më për së afërmi t'i rregullojnë kushtet për shpërndarjen dhe shfrytëzimin e mjeteve për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe të fondacioneve.
- Qeveria, gjegjësisht organet kompetente të shtetit dhe komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit, miratojnë plane dhe programe vjetore për shpërndarjen e mjeteve të dedikuara për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe të fondacioneve".

Këto autorizime të përgjithshme (e drejta diskrete e Qeverisë dhe e këshillave të komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit) në vetë ligjin, pa i përcaktuar paraprakisht në vetë ligjin kriteret dhe kushtet për mënyrën e shpërndarjes së mjeteve në vetë krijon fenomenin e favorizimit të disa OJQ-ve dhe fondacioneve të caktuara dhe krijimin e kushteve për jotransparencë dhe qasje selektive gjatë shpërndarjes së mjeteve nga buxheti dhe buxhetet e komunave, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit.

Dispozitat nga Ligji për ekzekutimin e buxhetit për vitin përkatës tregojnë se mjetet për këtë qëllim shfrytëzohen në bazë të Vendimit të miratuar nga Qeveria në bazë të propozimit të komisionit të formuar nga Qeveria.

Me Vendimin për kriteret dhe procedurën për shpërndarjen e mjeteve për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave të qytetarëve dhe të fondacioneve nga buxheti, të miratuar nga Qeveria, përcaktohen kriteret dhe procedurat për shpërndarjen e mjeteve nga buxheti për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave të qytetarëve dhe të fondacioneve. Gjegjësisht me vendimin e përmendur përcaktohen:

- Kriteret kryesore organizative, të cilat duhet t'i përmbushin OJQ-të (4 kriteret);
- Kriteret programore me të cilat vlerësohet cilësia e projekteve të ofruara (3 kriteret, ku në kuadër të secilit kriter ka edhe nënkriteret);
- Mënyra e vlerësimit;
- Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen nga ana e OJQ-ve të interesuara;
- Dorëzimi i raportit për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve.

Me programin për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe të fondacioneve për vitin 2013 janë përcaktuar:

- Lartësia e mjeteve për financimin e aktiviteteve programore të OJQ-ve dhe të fondacioneve;
- Qëllimet prioritare që do të jenë subjekt i financimit;
- Mënyra e shpërndarjes (duke iu referuar zbatimit të Kodit për praktika të mira për përkrahje financiare të shoqatave të qytetarëve dhe të fondacioneve), dhe
- Mënyra e dorëzimit të raportit për mjetet e shfrytëzuara.

Me Rregulloren për mënyrën dhe procedurën e shpërndarjes së mjeteve për shoqatat e qytetarëve për kryerjen e punëve të caktuara nga fusha e mbrojtjes sociale, përcaktohet:

- Mënyra e shpërndarjes së mjeteve për OJQ-të e regjistruara për kryerjen e punëve nga fusha e mbrojtjes sociale;
- Të dhënat dhe dokumentet e nevojshme të cilat dorëzohen me kërkesën/projektin/aplikimin;
- Kriteri i vlerësimit të aplikacioneve, dhe
- Përmbajtja e dispozitave të kontratës që lidhet për marrjen e mjeteve.

Aktet e lartpërmendura nënligjore në masë të caktuar paraqesin progres në rregullimin e fushës së dhënë dhe është kornizë përkaktëse për mënyrën e veprimit të organeve kompetente gjatë shqyrtimit dhe miratimit të mjeteve nga buxheti, buxhetet e komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit, për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve, mirëpo pa përfshirjen e tyre në Ligjin për shoqata dhe fondacione, lihet mundësi për anshmëri politike, instrumentalizim dhe pamundësim të pozitës të pabarabartë për të gjithë OJQ-të dhe fondacionet.

Zbatim adekuat dhe praktikimi i akteve të lartëpërmendura nënligjore në praktikë nga ana e pjesëmarrësve vlerësues në këtë analizë kualitative është vlerësuar me notën mesatare 3,40, gjegjësisht “pjesërisht”, për arsye se për vlerësimin “pjesërisht” janë deklaruar gjashtë subjekte juridike të anketuara, duke mos e marrë parasysh përjashtimin ku për këtë fushë është dhënë vlerësimi “jo” (nga ana e një subjekti juridik) dhe vlerësim “po” (me vlerësimin “po” është marrë informatë kthyesë nga tre subjekte juridike të anketuara), që qartë tregon se në periudhën e ardhshme duhet të ndërmerren aktivitete të caktuara në drejtim tejkalimit dobësive të konstatuara.

Vlerësimi - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Aktet e lartëpërmendura nënligjore paraqesin kornizë të caktuar për mënyrën e veprimit të Qeverisë, komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit. Në zbatimin e tyre praktik janë paraqitur dobësi dhe përjashtime të caktuara, të cilat hedhin hije mbi veprimin e përgjithshëm dhe shpërndarjen e mjeteve nga buxheti, buxhetet e komunave, buxhetet e komunave në qytetin e Shkupit dhe buxheti i qytetit të Shkupit.

Përveç komentit të dhënë nga ana e Qeverisë – Sekretariatit gjeneral, “Përveç akteve të përmendura, në procedurën për shpërndaje të mjeteve nga buxheti që janë të dedikuara për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe të fondacioneve zbatohet edhe Kodi i praktikave të mira për përkrahje financiare të shoqatave të qytetarëve dhe të fondacioneve (“Gaztea zyrtare” nr. 130/2007), qëllimi i të cilit është sigurimi i transparencës, përcaktimi i kriterëve kryesore organizative dhe ndjekja efikase e përkrahjes financiare të shoqatave dhe të fondacioneve nga ana e Qeverisë dhe e organeve të administratës shtetërore, si dhe llogaridhënie më e madhe në shfrytëzimin e mjeteve të ndara nga ana e shoqatave dhe fondacioneve”, me çka tregojnë se procedura e përgjithshme është transparente dhe siguron qasje dhe pozitë të barabartë për gjitha OJQ-të dhe fondacionet e interesuara, të dhënat e marra nga të anketuarit e tjerë i vërtetojnë dobësitë e detektura.

Në fakt, pothuajse se të gjithë personat e intervistuar kanë pasur vërejtje për transparencën në mënyrën e shpërndarjes së mjeteve, duke theksuar se në të gjithë procedurën, transparente është vetëm thirrja publike për shpërndarjen e mjeteve dhe vendimi për grandet e fituara. Me qëllim që të fitohet një pasqyrë e qartë për mënyrën e të menduarit të subjekteve juridike të anketuara, në vazhdim do t’i citojmë disa vlerësimeve nga ana e tyre edhe atë si më poshtë:

“Vetë madhësia e fondit të dedikuar për përkrahjen financiare të shoqatave dhe të fondacioneve nga ana e Qeverisë për vitin 2014, vetëm prej 12 milionë denarëve, si dhe qëllimet e përcaktuara për financim (zhvillimi ekonomik, integrimi në NATO dhe BE dhe të ngjashme), flet mjaft se nuk ka qëllim serioz për përkrahjen e sektorit të OJQ-ve. Në gjithë procesin, si duket publike është vetëm publikimi i Thirrjes për shpërndarjen e mjeteve dhe publikimi i listës së fituesve të granteve. Me këtë rast, diskutabile janë kriteret për zgjedhjen e projekteve më të mira (mënyra e ndarjes së pikëve), si dhe mungesa e vetëdijshme e kontrollit dhe e llogaridhënies për shfrytëzimin e parave nga grantet e shpërndara, që e vë në pyetje edhe qëllimin e financimit”.

“Aktet e lartëpërmendura nuk i trajtojnë në tërësi çështjet për kriteret, transparencën dhe llogaridhënien e procedurës. Ligji për shoqata dhe fondacione pothuajse se nuk ka dispozita për kriteret, e as për procedurën për shpërndarjen e mjeteve për organizatat qytetare. Poashtu edhe

në programet dhe vendimet të cilat merren në nivel vjetor nuk ka dispozita të mjaftueshme për kriteret dhe procedurën. Rregulla më konkrete janë paraparë në Kodin për praktika të mira për përkrahje financiare të shoqatave dhe të fondacioneve nga viti i 2007, mirëpo për shkak të karakterit joobligues, ato nuk zbatohen nga ana e institucioneve”.

Me shqyrtimin e realizuar të përgjigjeve në pyetjet e tjera të parashtruara për të fituar një pasqyrë të qartë në fushën e përmendur, me të drejtë konstatohet se ka vërejtje për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve, për kriteret për zgjedhjen e OJQ-ve fituese të mjeteve, shumën e mjeteve të siguruara, mundësinë për qasje në ndarjen e pikëve/rangimin e projekteve/aktiviteve nga OJQ-të, si dhe për pamundësinë për dyshkallësi të procedurës.

Nga analiza e realizuar e akteve ligjore dhe nënligjore, Kodit për praktika të mira për përkrahje financiare të shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve, si dhe nga intervistat e realizuara me më shumë përfaqësues të subjekteve juridike të anketuara, mund të konstatohet se në Ligjin për shoqata dhe fondacione mungojnë kriteret konkrete për mënyrën e shpërndarjes së mjeteve nga buxheti, buxhetet e komunave, buxhetet e komunave në qytetin e Shkupit dhe buxhetit të qytetit Shkupit, gjegjësisht e gjithë mënyra dhe kriteret për shpërndarje të këtyre mjeteve është rregulluar me aktet nënligjore.

Rekomandimi

Qeveria të ndërmarrë aktivitete me të cilat do të përcaktohen kriteret të qarta, transparente dhe të zbatueshme për mënyrën e shpërndarjes së mjeteve nga buxheti, buxhetet e komunave, buxhetet e komunave në qytetin e Shkupit dhe buxheti i qytetit Shkupit në Ligjin për shoqata dhe fondacione. Kjo do të sigurojë qasje të barabartë për të gjitha OJQ-të në mjetet e buxhetit, buxheteve të komunave në qytetin e Shkupit dhe buxhetit të qytetit Shkupit, arsyeshmëri në harxhim, transparencë, joselektivitet dhe llogaridhënie.

Institucioni: Qeveria - Sekretariati gjeneral

Kategoria: Transparenca

Pyetja - indikator: A është bërë praktikë që vendimi për shpërndarjen/financimin e aktiviteteve programore të shoqatave të qytetarëve dhe të fondacioneve nga buxheti, përveç që publikohet në Gazetën zyrtare, të publikohet edhe në ueb-faqen e Qeverisë?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Vendimi për shpërndarjen e mjeteve nga buxheti për vitin 2013 që janë të dedikuara për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe të fondacioneve është publikuar në (“Gazetën zyrtare” numër 185/2013).

Me vendimin e përmendur bëhet publikimi i OJQ-ve dhe i fondacioneve të cilat janë fituese të mjeteve financiare, si dhe afati për dorëzimin e raportit për shfrytëzimin e mjeteve.

Vlerësimi - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Me shqyrtimin e realizuar të Vendimit për shpërndarjen mjeteve nga buxheti i vitit 2013 që janë të dedikuara për financimin e aktiviteteve programeve të shoqatave dhe të fondacioneve, mund të konstatohet ai është miratuar më 17.12.2013 dhe është publikuar në Gazetën zyrtare më 25.12.2013 dhe njëkohësisht është publikuar edhe në ueb-faqen www.nvosorabotka.gov.mk më 27.12.2013. Gjendja e përmendur tregon se procedura për vendosje se cilat OJQ dhe fondacione do të jenë fituese të mjeteve dhe publikimi i tyre është bërë në fund të vitit, që ndikon para se gjithash në:

- Mundësinë për ndarjen e mjeteve OJQ-ve dhe fondacioneve të preferuara ose paraprakisht të vendosura;
- Në periudhën e implementimit të aktiviteteve të projektit;
- Në informimin për aktivitet e realizuara (respektim të afateve), etj.

Me vendimin e përmendur theksohet se mjetet e përgjithshme në shumë prej 12.000.000 denarësh ju shpërndahen (40 dyzet OJQ-ve dhe fondacioneve të veçanta), pa mos e treguar veç e veç shumën që i është ndarë çdo OJQ-je ose fondacioni dhe as nuk janë ofruar të dhëna se cilit qëllim programor/prioritar i takon granti i fituar, si dhe nuk jepen të dhëna për numrin e aplikacioneve të miratuara në një prioritet të caktuar.

Në të njëjtën kohë në Vendim thuhet se afati për dorëzimin e raportit për mjetet e shfrytëzuara është 30 ditë pas përfundimit të aktiviteteve të projektit, më së voni deri më 30.06.2014, pa i marrë parasysh:

- dispozitat e nenit 7 të Vendimit për kriteret dhe procedurën për shpërndarjen e mjeteve për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave të qytetarëve dhe të fondacioneve nga buxheti, ku është paraparë se raporti për shfrytëzimin e mjeteve duhet të dorëzohet deri te organet kompetente, më së voni deri më 31 janar 2014, dhe
- dispozitat e pikës 5 të Programit për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe të fondacioneve për vitin 2013, ku është paraparë se raporti për shfrytëzimin e mjeteve do të dorëzohet më së voni deri më 31.01.2014.

Gjendja e lartë përmendur tregon se me vendimin e miratuar në këtë mënyrë ndikohet në mundësinë për shpërndarjen e mjeteve në periudhën e përmendur për njoftim për OJQ-të dhe fondacionet e preferuara dhe paraprakisht të vendosura, si dhe në periudhën për implementimin e aktiviteteve programore dhe informimin për aktivitetet e realizuara (respektim të afateve), gjegjësisht gjendja e përmendur tregon se ka mosrespektim të akteve nënligjore dhe të afateve të përcaktuara për implementimin e aktiviteteve të parapara të projektit.

Rekomandimi

Qeveria të sigurojë miratim në kohë të aktit për shpërndajen e mjeteve nga buxheti, me çka do të sigurohet harmonizim i akteve dhe do të krijohen kushte për realizimin në kohë të aktiviteteve të projektit dhe dorëzim të raportit në afatin e paraparë.

Institucioni: Qeveria - Sekretariati gjeneral

Kategoria: Transparenca

Pyetja - indikator: Në periudhën e deritanishme të praktikimit të ndarjes/shpërndarjes së mjeteve për financimin e aktiviteteve programore të OJQ-ve dhe t; fondacioneve me mjete nga buxheti, a ofrohet mundësia për kundërshtime/ankesa në lidhje me vendimet e miratuara, a ka dyshkallësi në procedurë dhe a janë dorëzuar kundërshtime/ankesa?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Procedura për shpërndarjen e mjeteve për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe të fondacioneve është rregulluar në Kodin e praktikave të mira për përkrahje financiare të shoqatave të qytetarëve dhe të fondacioneve, Vendimin për kriteret dhe procedurën për ndarjen e mjeteve për financimin e aktiviteteve programore për shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet nga buxheti dhe Programin për financim e aktiviteteve programore të shoqatave dhe të fondacioneve që çdo vit publikohet nga ana e Qeverisë.

Në asnjë nga aktet e lartpërmendura nuk përmendet mundësia për dorëzim të kundërshtimeve dhe të ankesave për aktin e miratuar për shpërndarje të mjeteve.

Vlerësimi - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Aktet e lartpërmendura të cilat kanë të bëjnë me rregullimin e mënyrës së shpërndarjes së mjeteve për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe të fondacioneve, si dhe Vendimi për shpërndarjen e mjeteve nga buxheti për vitin 2013 që janë të dedikuara për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe të fondacioneve nuk japin mundësi që shoqatat dhe fondacionet e pakënaqura të parashtrajnë kundërshtime/ankesa ose kërkesë për rishqyrtim të projekteve të dorëzuara nga ana e tyre.

Konstatimi i përmendur është konfirmuar me informatën kthyesë të siguruar nga Qeveria – Sekretariati gjeneral, për pyetësin e dorëzuar me të cilën qartë tregon se:

“Kundër Vendimit të Qeverisë për shpërndarjen e mjeteve nga buxheti që janë të dedikuara për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe të fondacioneve nuk është paraparë e drejta për kundërshtim/ankesë”.

Për ta kuptuar gjendjen e përmendur te NJVL-të është parashtruar pyetje përkatëse edhe për të NJVL-të e anketuara, me ç'rast nga përgjigjet e fituara mund të konstatohet se gjendja e përmendur është identike edhe te NJVL-të, gjegjësisht nuk ofrohet mundësia për kundërshtim/ ankesë për aktin e miratuar.

Me vetë këtë konstatim del se as që janë krijuar kushtet për dyshkallësi në procedurën për shqyrtimin e kundërshtimeve/ankesave të parashtruara nga organizatat e pakënaqura.

Rekomandimi

Qeveria dhe Njësitë e vetëqeverisjes lokale të ndërmarrin masa dhe aktivitete në kuadër të kompetencave të veta me çka do të bëhen ndryshime dhe plotësime të akteve (Ligjit për shoqata dhe fondacione dhe akteve nënligjore të cilat e rregullojnë këtë fushë) me çka do të sigurojnë:

- mundësi për OJQ-të dhe fondacionet e pakënaqura të parashtrojnë kundërshtime/ ankesa, dhe
- dyshkallësi në procedurën për shpërndarjen e mjeteve nga buxheti.

Institucioni: Qeveria - Sekretariati gjeneral

Kategoria: Transparenca/Ilogaridhënia

Pyetja - indikator: A dorëzojnë organizatat joqeveritare dhe fondacionet shfrytëzuese të mjeteve nga buxheti, raporte financiare për shfrytëzimin e mjeteve dhe realizimin e aktiviteteve të planifikuara në afatet e sakta që janë paraparë dhe a i publikon Qeveria ato në ueb-faqe me qëllim që të jenë në dispozicion të publikut të gjerë?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Mënyrat e informimit dhe afatet për informim janë rregulluar me Kodin e praktikave të mira për përkrahjen financiare të shoqatave të qytetarëve dhe të fondacioneve, Vendimin për kriteret dhe procedurën për shpërndarjen e mjeteve për financimin e aktiviteteve programore për shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet nga buxheti dhe me Programin për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe të fondacioneve, që publikohet për çdo vit nga ana e Qeverisë.

Në aktet e lartpërmendura nuk është futur obligimi që Qeveria dhe komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit, ta kenë për obligim t'i publikojnë raportet e veçanta që i dorëzojnë OJQ-të dhe fondacionet që janë shfrytëzuese të mjeteve.

Vlerësimi - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Që të kuptohet gjendja faktike në këtë pjesë, e me qëllim të sigurimit të shkallës së lartë të transparencës, çiltërsisë dhe llogaridhënies në mënyrën e shfrytëzimit mjeteve të ndara nga buxheti, buxhetet e komunave, buxhetet e komunave në qytetin e Shkupit dhe buxheti i qytetit të Shkupit, është përpiluar një pyetësor adekuat, i cili është dorëzuar në Qeveri – Sekretariatit gjeneral, NJVL-të e anketuara dhe disa OJQ, me ç’rast përgjigjet e marra çojnë në konstatimin se OJQ-të dhe fondacionet shfrytëzuese të mjeteve nga buxheti, buxhetet e komunave, buxhetet e komunave në qytetin e Shkupit dhe buxheti i qytetit të Shkupit, e kanë për obligim të dorëzojnë raporte përkatëse për mjetet e shfrytëzuara, mirëpo ato nuk publikohen në ueb-faqen e Qeverisë, gjegjësisht në ueb-faqet e komunave.

Si vërtetim për gjendjen e përmendur është komenti i dhënë i Qeverisë - Sekretariatit gjeneral:

“Shoqatat dhe fondacionet të cilat financiarisht përkrahen nga Qeveria, në afat prej 30 ditëve nga përfundimi i projektit, dorëzojnë Raport përfundimtar në formular të definuar që më parë, i cili përmban pjesën narrative dhe pjesën financiare. Raportet përfundimtare nuk publikohen ueb-faqen e Qeverisë. Në bazë të këtyre raporteve, Njësia për bashkëpunim me organizatat joqeveritare e Sekretariatit gjeneral, Qeverisë i dorëzon Raport për realizimin e Programit për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe të fondacioneve me tregues financiarë dhe me arsyetim për rezultatet arritura. Raporti nuk publikohet në ueb-faqe”.

E gjithë kjo çon në konstatimin se procesi është jotransparent dhe i rrezikshëm për devijime, dhe për këtë arsye, në periudhën e ardhshme Qeveria duhet të ndërmarrë masa me të cilat do të bëhet ndryshimi i dispozitave në Ligjin për shoqata dhe fondacione dhe do të futej obligimi që raportet e pranuar nga shfrytëzuesit e mjeteve të publikohen ueb-faqen e Qeverisë, gjegjësisht në ueb-faqen e NJVL-së, gjegjësisht në ueb-faqen e dhënësit të mjeteve.

Rekomandimi

Qeveria duhet të ndërmarrë masa me të cilat do të bëhet ndryshimi i dispozitave të Ligjit për shoqata dhe fondacione, me të cilat do të futej obligimi që raportet e pranuar nga shfrytëzuesit e mjeteve të publikohen ueb-faqen e Qeverisë, gjegjësisht në ueb-faqen e NJVL-së, gjegjësisht në ueb-faqen e dhënësit të mjeteve.

Institucioni: Qeveria - Sekretariati gjeneral

Kategoria: Transparenca/llogaridhënia

Pyetja – indikatori: A e ka vendosur Sekretariati gjeneral si praktikë përpilimin e raportit për realizimin e Programit për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe të fondacioneve, dorëzimin e tij në Qeveri në afatin e paraparë dhe ato Qeveria t’i publikojë në ueb-faqe me qëllim që të jenë në dispozicion të publikut të gjerë?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Me pikën 5 të Programit për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe të fondacioneve për vitin 2013, është paraparë se Sekretariati gjeneral do t’i dorëzojë Qeverisë,

Raport për realizimin e Programit, me tregues financiarë dhe me arsyetim për rezultatet e arritura, deri më 28.02.2014.

Vlerësimi - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Duke pasur parasysh se me Vendimin për shpërndarjen e mjeteve nga buxheti për vitin 2013 që janë të dedikuara për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe të fondacioneve, afati për dorëzimin e raporteve për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve është caktuar që të jetë më së voni deri më 30.06.2014, ky aktivitet nuk mund të realizohet në afatin paraparë, e a do të implementohet mbetet të shihet në periudhën e ardhshme.

Mirëpo, në të njëjtën kohë, nga përgjigja e marrë nga ana e Qeverisë – Sekretariatit gjeneral dhe nga NJVL-të e intervistuar, mund të konstatohet se nga raportet e pranuar që janë dorëzuar nga shfrytëzuesit e mjeteve, përpilohet një raport përfundimtar për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve dhe aktivitetet programore që janë realizuar, mirëpo nuk është krijuar praktikë që ky raport të jetë në dispozicion publik, gjegjësisht të publikohet në ueb-faqen e dhënësit të mjeteve.

Në vazhdim e japim komentimin e dhënë nga Qeveria – Sekretariati gjeneral:

“Në bazë raporteve përfundimtare nga shoqatat dhe fondacionet të cilat përkrahen financiarisht nga Qeveria, Njësia për bashkëpunim me organizatat joqeveritare në kuadër të Sekretariatit gjeneral, përgatit Raport për realizimin e Programit për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe të fondacioneve, me tregues financiarë dhe me arsyetim për rezultatet e arritura. Raporti dorëzohet për t’u shqyrtuar nga ana e Qeverisë, brenda afatit të përcaktuar me Vendimin për shpërndarjen e mjeteve nga buxheti që janë të dedikuara për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe të fondacioneve. Raporti nuk publikohet në ueb-faqe”.

Situata e këtille çon në konstatimin se në periudhën e ardhshme Qeveria duhet të mundësojë që në Ligjin për shoqata dhe fondacione të parashihet obligimi me të cilin dhënësit e mjeteve (Qeveria, komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit) raportin e përpunuar për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve të ndara dhe aktivitetet e realizuara të projektit, si dhe rezultatet e arritura, do t’i vënë në dispozicion për publikun e gjerë duke i publikuar në ueb-faqet e dhënësve të mjeteve.

Rekomandimi

Organet kompetente, në periudhën e ardhshme duhet të ndërmarrin aktivitete me të cilat do të sigurojnë respektim konsekuent të afateve për dorëzimin e raporteve për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve nga ana e OJQ-ve dhe fondacioneve.

Qeveria të mundësojë përcaktimin e obligimit në Ligjin për shoqatat dhe fondacionet, me të cilin dhënësit e mjeteve (Qeveria, komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit), raportin e përgatitur për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve ndara dhe aktivitetet e realizuara të projekteve, si dhe rezultatet e arritura, do t’i vënë në dispozicion publik duke i publikuar në ueb-faqet e dhënësve të mjeteve.

Problemi/faktori i rrezikut 2:

Marrja e statusit të organizatës me interes publik

Arsyetimi:

Ligji ekzistues parasheh që me propozim të komisionit qeveritar, Qeveria të sjellë vendim për dhënien e statusit të organizatës me interes publik, për shoqata të caktuara, të cilat me këtë janë të privilegjuara në financimin me mjete publike. Duke pasur parasysh faktin se interesi publik shprehet në qëllimet, grupet e qëllimit dhe veprimtaritë e shoqatës, sipas të cilës dallohen shoqatat me karakter publik, me interes grupor apo personal, duhet që kriteret për shoqatat me interes publik të përcaktohen me ligj dhe statusi të merret me aktin e regjistrimit.

Institucioni: Qeveria- Sekretariati gjeneral;

Qendra për komunikime civile;

Qendra maqedonase për bashkëpunim ndërkombëtar - QMBN;

Asociacioni i gazetarëve të Maqedonisë - AGM

Kategoria: Transparenca

Pyetja - indikatori: A mendoni se dispozitat ekzistuese ligjore të Ligjit për shoqata dhe fondacione (“Gazeta zyrtare” numër 52/10 dhe 135/11) në pjesën e përcaktimit të kriterëve dhe të procedurës për marrjen e statusit të organizatës joqeveritare me interes publik, sigurojnë transparenca dhe status të barabartë, që përkon me qëllimet e OJQ-ve dhe të fondacioneve?

Vlerësimi – de jure	Jo	1
	Pjesërisht	3
	Po	5

Arsyetimi:

Marrje e statusit të organizatës me interes publik është rregulluar me dispozitat e neneve 73 – 89 të Ligjit për shoqata dhe fondacione (“Gazeta zyrtare” numër 52/10 dhe 135/11). Në fakt, në pajtim me dispozitat ekzistuese, statusin e organizatës me interes publik e përcakton²³¹ Qeveria me propozim të Komisionit për organizata me status me interes publik. Ky komision formohet nga Qeveria dhe përbëhet nga kryetari dhe dhjetë anëtarë, nga të cilët, 8 anëtarë janë nga ministritë kompetente, një përfaqësues nga Agjencia për të rinj dhe sport, dhe vetëm dy përfaqësues të organizatave që janë të regjistruar në pajtim me këtë ligj.

Mënyra dhe kriteret për zgjedhje, si dhe shakqet për ndërprerjen e ushtrimit të detyrës së kryetarit dhe anëtarëve të komisionit janë të rregulluara me akt nënligjorë që është miratuar nga e ministrit për drejtësi, “Rregullorja për mënyrën dhe kriteret për zgjedhje, si dhe për ndërprerjen e ushtrimit të detyrës së kryetarit dhe anëtarëve të komisionit për organizatat me status me interes publik, të publikuar në “Gazetën zyrtare” numër 142/2010.

231 Neni 79 i Ligjit për shoqata dhe fondacione.

Vlerësimi - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Në aspektin formal-juridik janë të rregulluara kriteret për marrjen e statusit të organizatës me interes publik, si dhe organet dhe trupat që janë të përfshirë në procedurën për realizimin e punëve administrative-teknike dhe miratimin e aktit për përcaktimin e statusit me interes publik.

Edhe përkundër deklarimeve nga ana e Qeverisë – Sekretariatit gjeneral se “Kushtet dhe procedura për marrjen e statusit të organizatës me interes publik janë të definuara qartë në Ligjin për shoqata dhe fondacione dhe se në to kanë qasje të barabartë shoqatat dhe fondacionet e interesuara” dhe se nuk ka nevojë për ndryshim të gjendjes në këtë fushë, i qartë është fakti se në praktikë ka gjendje të cilat ndikojnë në mënyrë negative mbi ambientin e përgjithshëm dhe punën e sektorit joqeveritar, e gjithsesi edhe për marrjen e statusit të organizatës me interes publik, që është e lidhur drejtpërdrejt me mundësinë për shfrytëzimin e mjeteve buxhetore.

Në fakt, një pjesë e OJQ-ve të anketuara, janë deklaruar pozitivisht për qëndrimin e Komisionit shtetëror për parandalimin e korrupsionit (KSHPK), me të cilin statusi i organizatës me interes publik merret me vetë aktin e regjistrimit në regjistrin përkatës, me çka do të eliminohej mundësia për anshmëri, selektivitet dhe arbitraritet.

Përveç konceptit që e ofron KSHPK-ja, i cili përbëhet nga ajo që statusi i organizatës me interes publik të merret me vetë aktin e regjistrimit në Regjistrin qendror në bazë të kriterëve, qëllimeve dhe veprimtarive të përcaktuara në mënyrë të qartë, të cilat OJQ-ja do t’i i posedojë si kapacitete dhe integritet të saj referues.

Pa marrë parasysh qëndrimin negativ të Qeverisë – Sekretariatit gjeneral për propozimin e KSHPK-së për marrjen e statusit të organizatës me interes publik me vetë aktin e regjistrimit në regjistrin përkatës, Qeveria duhet të ndërmarrë aktivitete me të cilat kriteret për marrjen e statusit të organizatës me interes publik do t’i përcaktojnë në Ligjin për shoqata dhe fondacione, kurse akti i marrje së statusit të përmendur, të jetë rezultat i plotësimit kriterëve të përcaktuara që do të konstatohen gjatë regjistrimit në regjistrin kompetent.

Rekomandimi

Qeveria duhet të ndërmarrë aktivitete me të cilat kriteret për përcaktimin e statusit të organizatës me interes publik do t’i përcaktojnë në Ligjin për shoqata dhe fondacione, kurse akti i marrjes së statusit të përmendur, të jetë rezultat i plotësimit kriterëve të përcaktuara që do të konstatohen gjatë regjistrimit në regjistrin kompetent.

Problemi/faktori i rrezikut 3:

Ndarja e mjeteve publike për shoqatat e themeluara me qëllim të caktuar që krijon dyshim për harxhim korruptiv dhe joproduktiv të mjeteve publike.

Arsyetimi:

Kundrejt dhënies së mjeteve për përkrahjen e punës së përgjithshme të shoqatave të ndryshme, që nuk i zgjidh nevojat e tyre materiale, kurse mënyra e shpërndarjes krijon reagime negative për anshmëri, nuk ekziston mundësia që SHQ me kapacitetet, sipas parimit të të partneritetit funksional, të aplikojnë me projektet e tyre që të realizojnë aktivitete për të cilat janë themeluar dhe regjistruar – anketa, trajnime, fushata mediatike, fushata për ndërtimin e vetëdijes së qytetarëve, nxitje të motivimit të qytetarëve për një qëllim të caktuar, debate publike, hulumtime. Fakti që në projektet aktuale qeveritare dhe në projektet e tjera të organeve shtetërore ka hapësirë për realizimin e aktiviteteve të cilat sipas definicionit ju përkasin SHQ-ve dhe se në vend duhet të zhvillohet sektori qytetar, kërkon krijimin e mundësive për kryerjen e punëve publike nga ana e SHQ-ve sipas parimit të konkurrimit transparent para organeve shtetërore me projekte për qëllime të caktuara. Njëkohësisht kjo do të mundësojë që SHQ vendore të mos varen ekskluzivisht nga përkrahja financiare e donatorëve të huaj.

Institucioni:

Kategoria: Transparenca

Pyetja - indikator: A mendoni se dispozitat aktuale të Ligjit për shoqata dhe fondacione (“Gazeta zyrtare” numër 52/10 dhe 135/11) në pjesën e përcaktimit të kriterëve, rregullave procedurave të qarta dhe transparente për aplikim të OJQ-ve me projektet e tyre (sipas parimit të partneritetit funksional) në organet kompetente shtetërore janë adekuate dhe sigurojnë transparencë, joslektivitet dhe pozitë të barabartë për të gjitha OJQ-të dhe fondacionet?

Vlerësimi:

Jo	1
Pjesërisht	3
Po	5

Arsyetimi:

Me dispozitat e nenit 90 të Ligjit për shoqata dhe fondacione është rregulluar mënyra e besimit për realizimin e autorizimeve publike, me bartjen e kompetencave nga një organ shtetëror, nga një organ komunal, organ në komunat e qytetit e Shkupit dhe qytetin e Shkupit, si dhe organe të tjerë që kanë autorizime publike, por je edhe mënyra e partneritetit funksional në mes të organeve të përmendura dhe organizatave joqeveritare dhe fondacioneve

Vlerësimi - de facto	Në masë shumë të vogël	1
	Në masë të vogël	2
	Në masë të caktuar	3
	Në masë të madhe	4
	Në masë shumë të madhe	5

Arsyetimi:

Nga hulumtimi i realizuar i akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe nga intervistat e realizuara në vend nuk është jetësuar koncepti për partneritetit funksional me organet kompetente, përveç në segmente të caktuara ku punohet për realizimin e punëve nga sfera e autorizimeve publike.

Aktualisht, Qeveria dhe organet e tjera kompetente ndërmarrin aktivitete/fushat, të cilat kanë për qëllim:

- krijimin e vetëdijes së qytetarëve;
- nxitjen e motivimit të qytetarëve për një qëllim të caktuar;
- përkrahjen e natalitetit në vend;
- organizimin e debateve publike;
- hulumtimin;
- promovimin e arritjeve të caktuara, etj., dhe

ato i realizojnë me harxhime të veta, në mënyrë të pavarur ose me ndonjë operator ekonomik.

Këto aktivitete vetvetiu mund t'u ndahen në mënyrë transparente dhe të paanshme organizatave joqeveritare nëpërmjet thirrjes publike për dorëzim të projekteve përkatëse me qëllim të caktuar, me çka sektorit të OJQ-ve do t'i jepet vendi i vërtetë në sistem dhe nxitje reale për të mbijetuar dhe për t'u zhvilluar.

Rekomandimi

Qeveria të ndërmarrë aktivitete për ndryshimin e akteve ligjore (Ligjit për shoqata dhe fondacione, Ligjit për Qeveri, ligjeve të tjera), të cilat e rregullojnë mënyrën dhe mundësinë për ndarjen e mjeteve nga buxheti, buxhetet e komunave, për aktivitete në bazë të parimit të partneritetit funksional.

PASQURA E INDEKSEVE

Edhe pse metodologjia bën vlerësim kualitativ të gjendjes, është bërë edhe vlerësimi numerik, me qëllim që të bëhet përmbledhja numerike e informatave dhe të potencohen anët kryesore të dobëta dhe të fuqishme. Prandaj, në tekstin e mësipërm, për çdo pyetje-indikator është dhënë nota prej 1 deri në 5 – ku 1 është nota më e dobët, ndërsa 5 është më e larta.

Në bazë të notave të dhëna prej 1 deri në 5, për çdo pyetje-indikator janë mbledhur notat në nivel të nënkategorive, në nivel të kategorive dhe në nivel të gjithë shtyllës. Me këtë rast, nuk është bërë ponderim (peshim) i notave, por të gjitha notat e mbledhura janë përcaktuar si mes aritmetik.

Problemi	Nënkategoria	Indeksi				
		De jure	De facto	Mesatarja – nënkategoria	Mesatarja – kategoria	Mesatarja – sektori
Problemi 1	Transparenca	2,33	1,66	1,995	2,12	1,873
	Llogaridhënia	3	1,5	2,25		
Problemi 2	Transparenca	3	2	2,5		
Problemi 3	Transparenca	1	1	1	1	

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- Ligji për shoqata dhe fondacione (“Gazeta zyrtare” numër 52/10 dhe 135/11);
- Ligji për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike (“Gazeta zyrtare” numër 47/06, 86/08, 51/11, 28/14);
- Ligji për ekzekutimin e buxhetit (“Gazeta zyrtare” numër 180/2013);
- Kodi i praktikave të mira për përkrahje financiare të shoqatave të qytetarëve dhe të fondacioneve (“Gazeta zyrtare” numër 130/2007);
- Vendimi për kriteret dhe procedurën për ndarjen e mjeteve për financimin e aktiviteteve programore për shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet nga buxheti (“Gazeta zyrtare” numër 23/2009);
- Programi për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe të fondacioneve për vitin 2013 (“Gazeta zyrtare” numër 4/2013);
- Programi për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe të fondacioneve për vitin 2014 (“Gazeta zyrtare” numër 8/2014);
- Rregullorja për ndryshimin e Rregullores për mënyrën dhe procedurën e ndarjes së mjeteve për shoqatat e qytetarëve për kryerje të punëve të caktuara në fushën e mbrojtjes sociale (“Gazeta zyrtare” numër 24/2005 dhe 38/2007);
- Ligji për mediat (“Gazeta zyrtare” numër 184/13 dhe 13/14);
- Ligji për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike (Gazeta zyrtare numër 184/13, 13/14 dhe 44/14);
- Ligji për veprimtari radiodifuzive (“Gazeta zyrtare” numër 100/2005, 19/2007, 103/2008, 152/2008, 6/2010, 145/2010, 97/2011, 13/2012 dhe 72/2013).

